

**Besnik
Mustafaj**

8JH-32

1498



VERA PA KTHIM

tregime dhe novela


8JH-32

NI 98

Besnik
Mustafaj

VERA
PA KTHIM

tregime
dhe
novela



SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

TEHU I SËPATËS

Din Kolgeci tha vetëm se pylli ishte krejt i heshtur dhe ajo e qeshur vajze, që i erdhi papritur në vesh, sesi kumboi. Kaq tha e nuk hyri në hollësi të tregonte se ç'po bënte atë çast, që ulur të ndizte një cigare apo kishte shkuar të afronte mushkën e larguar tek ndiqte fijet e rralla të barit që dilnin me druajtje, si t'u vinte turp prej ngjyrës së gjelbër midis gjetheve të verdha, të shtruara butë në tokë. Nuk tha as në e kishte bërë gati barrën e druve që nuk e solli atë pasdite në shtëpi. Pra, tha vetëm se pylli ishte krejt i heshtur e se kjo heshtje u thye përnjëherë copë-copë, si të kriste befaz në të katër anët rrufeja. Ndërsa ai u shtang, u mpi i tëri prej një ngërçi të panjohur kurrë më parë. As vetë nuk

di të thotë kur e çoi dorën te sëpata e as si nisi ta shkonte gishtin e madh nëpër tehun e saj. Nuk mban mend as çfarë mendoi. Po prekja e ftohtë e metalit sikur ia treti pak mpirjen. Po ta shihte kush atë çast, do të thoshte se Din Kolgeci kishte një dhimbje të rëndë. I ishte varur fytyra dhe lëkura e djegur prej motit nuk ia fshihte dot pikëllimin.

A qëndroi gjatë ashtu? Nuk dihet. Dihet vetëm që më së pari i shkoi ndër mend të shihte nga erdhi ajo e qeshur që ai e njohu me ta dëgjuar. Ishte e së bijës, e Nushës. Po bëheshin tre muaj që Nusha kishte dalë partizane, po bëheshin tre muaj që atij nuk i qeshte buza...

Nushën e kishte fëmijë të vetëm dhe e donte si dritën e syrit. Rritjen e saj e pati ndjekur ditë për ditë me zemër të dridhur, se tre djemtë e vdekur pa i mbushur të pesë vjetët i kishin mbushur mendjen se nuk i rronin fëmijët. Për çudinë e tij, ajo u rrit pa u sëmurrur një herë. E u bë edhe shumë e bukur. E shihte si endej nëpër shtëpi duke i ndihmuar së ëmës dhe diku thellë vetes ndiente t'i mbinte një shqetësim që nuk e kishte pasur më parë. A do t'ia lypte kush për nuse?! Tani e ndiente përditë e më fort pleqërinë dhe donte ta shihte sa më shpejt në krah të një burri të mirë dhe t'u gëzohej fëmijëve të saj. Po tamam këtu i këputej ëndrra dhe ndiente ta kaplonte shqetësimi se mos njerëzit, duke e ditur si i kishin vdekur atij fëmijët, druheshin për ta futur vajzën e tij nuse në shtëpi. Për nuse si ajo thuhej se

janë barknëmura. Atëherë ai ngrysej e nuk mund të rrinte më brenda. Merrte sëpatën e shkonte për dru, ose dilte në arë e punonte si i çmendur derisa kapitej, vetëm për ta larguar mendjen prej andej.

Nusha ishte pak ndryshe nga e ëma, më e qeshur, më e gojës, por as ai si baba nuk e pati mësuar të rrinte me sytë përdhe para tij, siç bënin të tjerët. E kam djalë, thoshte me përkëdheli.

— Të koriti vajza, — i tha një kushëri atë ditë kur Nusha shkoi me partizanët.

— Edhe koria për të gjallin është, — u përgjigj Dini mbyturazi, ndërsa në zemër ndjeu t'i ngulej një akrep që e shtrëngoi fort.

Vëllai e të tjerët që ishin aty, nuk nxorën asnjë fjalë. Dinit i rëndoi tepër edhe heshtja e tyre, po nuk foli më. Hapi kutinë e duhanit e nisi të dridhte një cigare të trashë.

Që prej asaj dite e bija nuk u pa më. As ky nuk e kërkoi, megjithëse me vete bënte sa herë be ta gjente ku të ishte, ta gjente dhe... Di vetë si do të bëj, thoshte, pa e çuar mendimin më tej.

Në atë hutim të papritur që i ra, nuk mundi as të dallonte nga erdhi e qeshura. Mendja i tha se ajo do të qe duke u afruar nëpër një rrugë të rrejshme që kalonte pak më poshtë. I shkoi ajo mpirja e parë dhe i la në trup një bizatje të ftohtë si prej metali. Hajt, luaj vendit, Din burri, e urdhëroi veten, shih një herë, pastaj ndaje punën si do të bësh. Nuk u dëgjua më as zëri as e

qeshura e saj. Megjithatë ai ishte i sigurt se nuk i bënë veshët. Instinkti i prindit i thoshte se e kishte të bijën diku aty pranë.

Siç u ndodh, me sëpatë në dorë, u përvodh buzës së prroskës, doli në një breg nga i zinte syri në të dyja anët një copë të mirë të rrugës që e truponte pyllin. E pa. Ishte vetë e dytë. Me një djalë. Zbritnin nga Qafa e Borës. Po, në Qafë të Borës ajo rrugë ndahej për në tri fshatra e ai nuk mund ta merrte me mend prej nga vinin. Dukej se nuk kishin qenë fort afër tij kur ajo kishte qeshur, ndaj u habit si i zuri veshi kumbimin e saj. Brenga e madhe ia ngryska fytyrën njeriut e ia prekka fjalët, por edhe i zgjoka në të gjitha shqisat një vatër të veçantë dhe tepër të ndjeshme për të kapur e shumëfishuar çdo lloj sinjali që vjen nga jashtë e që i lidhet me ndonjë fije të hallit. Nga lëvizja e buzëve Dini i dallonte prej së largu njerëzit kur ishin duke e përgojuar. Mbrëmjeve, në shtëpi, e kuptonte menjëherë të shoqen kur ndokush i kishte hedhur ndonjë fjalë të hidhur për të bijën.

Të bijën tani e shihte pas shpine. Të mos ia kishte dëgjuar të qeshurën dhe të mos ia njihte mirë të ecurën, do të thoshte se nuk qe ajo. Hera e parë që e shihte ashtu, veshur me pantallona e xhaketë ushtarake. Në vend të shamisë së bardhë, që mbante në kokë që e vogël, kishte kapele, që prej së largu nuk i shquhej mirë forma, se muzgu kishte nisur t'ia shuante shkëlqimin ditës. Në krah i varej një automatik

i shkurtër. «E paska prerë bistekun», tha Dini me vete. E kuptoi që ato fjalë i dolën krejt kot, pasi mendja i vërtitej tjetërkund. Dy duart e saj ishin mbështjellë rreth krahut të djalit, dhe dukej, prej së largu, që e shtrëngonin fort. Koka i anohet herë pas here nga supi i tij.

S'duhej ta lija të vinte kjo ditë, tha ai me vete dhe psherëtiu. Ngriti lart sëpatën dhe e ktheu me teh përpjetë. Kaloi edhe një herë gishtin e madh nëpër kurrizin e tij si për t'u bindur se që i mprehtë. Metali i përcolli nëpër të gjithë trupin një rrëqethje të akullt. U dha këmbëve përpara me vrull, sepse dy siluetat e lidhura njëra me tjetrën po i afroheshin bërrylit të rrugës e do t'i humbisnin nga sytë.

«Po erret, mendoj Dini, po erret e ata nuk kanë si shkojnë larg. Do bëjnë si do bëjnë e do të futen në ndonjë prej staneve, te Livadhet e Pëllumbit. Do të futen domosdo diku për të kaluar natën, se është natë nëntori kjo! Mandej, sa të shtrihen, sa të shtrihen... — Nuk ia nxori goja fjalët e tjera që i vërtiteshin në mendje. — Do t'ua pres kryet të dyve, shtoi, hiç nuk do të më dridhet dora.»

I kishte kërcyer gjaku. Sa herë e sillte nëpër mendje këtë punë, skuqej e zverdhej, ndonëse diku thellë shpirtit një zë i pëshpëriste vazhdimisht se nuk qenë të vërteta fjalët që thuheshin për partizanët. Dhe ky, pa guxuar asnjëherë t'ia pohonte as vetes, i pati besuar atij zëri.

Ra një mjegull e hollë, që nisi t'ia largonte dy

partizanët. Ai çante duke u përplasur pas dru-
rëve, u binte përmes drizave, pa parë më ku e
hidhte këmbën. Krahët e ngritur lart, që shtrën-
gonin sëpatën, ishin tendosur aq shumë, sa, po
të lëshoheshin poshtë, me një të goditur do ta
këputnin në rrënjë një lis të madh. Rendte, ashtu
i çartuar, pa u kujdesur më të shuante zhurmat.
Por atyre të dyve që ecnin përpara, për çudi,
as që u bënte përshtypje gjithë kjo zhurmë. Nu-
sha ecte si gjithnjë, e mbështetur në krahun e
djalit, dhe i përkëdhelej pas trupit me një llas-
tim të turpshëm. Hapat e mëdhenj të Dinit e
mbështollën vetëtimthi largësinë që i ndante,
dhe sëpata e ngritur, kur u ndodh mbi ta, u lë-
shua me rrëmbim. Ishte në një nga ato çastet kur
vajza e pati anuar pak kokën majtas për ta
mbështetur te supi i djalit dhe kolona e bardhë
e qafës së saj ishte zbuluar në të djathtë si për
t'ia çelur më mirë vendin tehut të mprehtë të
sëpatës që e çau pa ngurrim më dysh. Pastaj së-
pata shkoi e këputi në mes, që nga supi deri në
ijë, trupin e djalit. Nuk nxorën asnjë zë, as për
t'u lutur, as për t'u ankuar. Madje as nuk rën-
kuan.

Më është prishur mendja, tha Dini dhe fërkoj
sytë. Nuk kishte rënë mjegull, po dy pika loti ia
kishin veshur vështrimin. Dhe ata të dy vazhdo-
nin të ecnin përpara, të mbajtur te njëri-tjetri,
me një hap jo fort nxituar. Nga lëvizjet e kokës
dukej se më të rrallë këmbenin ndonjë fjalë.
Gjithë ajo skenë iu fanit prej një kujtimi jo fort

të largët. Kishte zbritur në Shkodër për të shitur një lopë e për të blerë kripë e drithë. U end gjithë ditën me lopën për laku, derisa e shiti për hicgjë. Ishte vera e parë pas hyrjes së Italisë. Han nuk gjetën. Bashkë me të vëllanë, me Selimin e Isuf Metës, djemtë e Rexhep Osës e të tjerët, që i kishte mbledhur shtegtimi, zunë vend në lulishte, përballë Kafes së Madhe. Nga kafja vinte muzikë e herë pas here dëgjohej një zë i ëmbël gruaje që këndonte. Njëpër xhamat e mëdhenj dukeshin trupat e njerëzve, që, kur niste muzika, ngriheshin në këmbë e fillonin të lëviznin, të ndarë dy e nga dy. Një burrë e një grua. Burri në dorën e majtë mbante të shtrënguar butë dorën e gruas, ndërsa të djathtën ia shkonte në mes, e afronte aq pranë vetes, sa dukej sikur bëhej njësh me të. Gruaja, dorën tjetër, të përthyer pak te bërryli, e mbështeste te supi i burrit dhe lëkundej si e dehur majtas e djathtas, duke zbardhur dhëmbët sa herë i çuquriste ai diçka te veshi.

Ky kujtim ishte lidhur rrëmbimthi në kokën e Dinit me çka i pati thënë më vonë Azem Halili.

— Thonë se këta komunistët i marrin vajzat në mal jo për luftë, po se janë mësuar në qytet me femra e s'u rrihet pa to.

— Pse më rëndon, o Azem Halili? Pse po më rëndon në shtëpinë time? — nuk u përmbajt më Dini. — Shko, ta pafsha hajrin, shko e më len rehat në hallin tim.

Azemi u ngrit pa folur më. Dini mbeti vetëm. I

gjëmonin veshët. Fjalët e Azemit i përziheshin edhe me çka dëgjonte poshtë e lart se vërtet komunistët shkonin në luftë si në zabërhane, femrat që kishin me vete i mbanin për të fjetur netve me to, nën dritën e hënës. Pse ia vunë syrin asaj vajzës së Din Kolgecit, kishte thënë dikush, a pse që më e bukura në katund?!

Dini nuk dinte asgjë si ishte lidhur e bija me komunistët. Kjo ia shtonte të keqen. Pse s'i tha një fjalë ajo, të paktën sa për të larë gojën?! I takonte t'ia thoshte një fjalë babës...

— Këtu e ke pak të drejtë, — kishte thënë Selim Ahmeti, — po që ke vajzë të mirë, ke. Edhe trime. E që është nxituar, kushedi si ka menduar. Po nxitimi i të riut falet. Ti mos ua vër veshin fjalëve të hallkut, se nuk janë gojë të mira ato, dëgjomë mua! Lufta sa ka nisë, po ka me i nda hesapet e të gjithëve.

— Po të dëgjoj, po të dëgjoj, o Selim, e të lumtë goja! Po nuk më duhet gjë lufta mua që e kam shtëpinë bosh. Luftën ta bëjnë ata që e kanë kullën plot burra. E kam barkun të thatë unë, Selim. Vajza me iku, vetë do të vdes, m'u shkretua trualli.

Kështu i shkoi këta tre muaj: vrenjtu e kthjellu si moti në vjeshtë. Ndryshueshmëria e vazhdueshme e gjendjeve shpirtërore i kishte lënë në fytyrë e në shpirt njëfarë topitjeje, një hutim të dhimbshëm, që e kishte mbyllur edhe më fort në botën e tij, ku vërtitej pa ditur ç'të bënte.

Dhe priti e priti të vinte, ja, kjo ditë, që ta

shihthe vetë të bijën në krahun e njërit prej atyre. Tani e ndiente veten të lehtësuar se nuk e mundonte më asnjë mëdyshje. S'paskan qenë kot ato fjalë, tha me vete dhe hodhi sytë te sëpata, që, prej muzgut, dukej krejt e zezë. Ti do m'i lash hesapet, ani pse ata kanë pushkë, i foli tehut të mprehtë. Shpejtoi hapat që të mos ia fshihte terrin siluetat e tyre.

Ndodhi siç e mendoj Dini. Kur u err, ata ishin afër Livadheve të Pëllumbit. Dredhuan përpjetë e u ngjitën në një stan në skaj të livadhit... Dini e dinte se stani ishte i ndërtuar me gardh thuprash e mund të shihje kollaj brenda përmes vrimave të thurjes së tij.

Dini i ra nga prapa e, kur u afrua, partizanin e pa në oborr, duke mbledhur copëra drurësh të mbetura aty që në pranverë, kur kishin qenë barinjte. Ai mbushi krahun e hyri brenda. Dini vuri syrin e pa Nushën të ulur mbi shtresën e fierit të thatë, të bërë nga barinjte për të fjetur. Nuk i dukej fytyra ngaqë ishte përkulur e po zgjidhte lidhëset e gjata të këpucëve. Dini do të donte që skajet e atyre lidhëseve të qenë ngatërruar në një nyjë që të mos zgjidhej kurrë. Tha kështu me vete e të dyja buzët iu përvolën prej një gazi të hidhur sepse nuk gjeti gjë tjetër që të mund ta pengonte atë që i thoshte mendja se do të ndodhte pas pak. E bija, pasi të hiqte këpucët e rënda, do të ndihej e lehtësuar e do ta çonte dorën te rripi i pantallonave. Pastaj, pastaj... O zot! Ai nuk guxonte ta përfytyronte të bijën të zhveshur e

me siguri, prej nervozizmit, bëri ndonjë lëvizje që u ndie brenda, sepse dëgjoji zërin e Nushës që i foli djalit, i cili po merrej me drutë në vatrën ku do të ndizej zjarri.

— A dëgjove zhurmë?

— Ashtu m'u duk, — u përgjigj ai dhe ngriti kokën. — Kushedi, ndonjë ujk i mësuar të sillet këtej në pranverë, — vazhdoi ai me të qeshur.

Drita e zjarrit e shndriti më mirë stanin dhe tani Dini shihte qartë gjithçka bëhej aty. Asnjëherë nuk i ishte dukur më e rëndë sëpata. Vdekja që do të mbinte pas pak prej tehut të saj, do të qe e llahtarshme, ndaj, me sa dukej, nisën t'i shpërfytyroheshin qysh më parë sendet dhe njerëzit me të cilët do të kishte të bënte. Dini fërkoj dy-tri herë sytë fort, sa i lotuan, se iu bë sikur shtyllat e stanit dhe thuprat e thurura filluan të bulonin e të nxirrnin disa bisqe të çuditshme, që herë merrnin ngjyrë të verdhë, herë të kuqe, herë të bardhë, të pangjashme me bisqet që nxjerrin drurët në pranverë. Po i ngjall gjaku, i tha një zë në vesh. Gjak i ri ai, nuk e tret dheu. Gjaku i ri i jep jetë edhe drurit të thatë.

Dini u ligështua i tëri e nuk po mbahej më dot në këmbë. U ul në gjunjë dhe mbylli sytë. Qëndroi ashtu vetëm një çast, se befas ndjeu një mall kaplues për të bijën. Duke ngritur sytë të shihte edhe një herë ç'bëhej brenda, i vetëtiu nëpër mend se ç'do të thuhej për të në Malësi. Do të sajoheshin gjithfarë tregimesh, sepse askush veç atij nuk po e shihte të vertetën dhe ai

nuk do t'ia tregonte askujt si ndodhi. Një gjë e dinte: më të shumtëve do t'u vinte keq për të, se do ta kuptonin që një hall i madh e kishte detyruar të shkonte deri aty. Për herë të parë në jetë do të përgojohej e do të përmendej në të pesë bajraçet. Do të bëhej i njohur, pasi, edhe pse nuk ishte më i ri, pakkush ia dinte emrin jashtë kaktundit. Tërë jetën që marrë me hallet e veta, nuk i kishte ndjekur as trimëritë e mëdha e as odat e burrave, ku vihej në kandar mençuria e tyre. Ishte vërtitur në heshtje në lëmin e vet.

Tani gjithçka do të përmbÿsej me rrapëllimë e, që të nesërmen, do t'i duhej të fillonte jetë tjetër, jetën e njeriut të njohur prej botës. Pati një ndjesi të papërcaktuar, do ta ndiente veten më mirë a më keq.

Sidoqoftë, çasti kur prej tehut të sëpatës së tij do të kërcenin pikat e gjakut, që do ta përskuqnin flakën e zjarrit, po vonohej. Ata të dy, atje brenda, ende nuk po vepronin siç kishte përfytyruar Dini, që dhe vetë në shpirtin e tij si baba të ishte i larë. Instinkti i prindit është i fuqishëm dhe i mbyt përdhunshëm të gjitha sinjalet që mund të vijnë nga të tjerët për t'ia vënë në dyshim fëmijën.

Syri i shqyer i Dinit po priste me ankth. Partizani e kishte ndezur zjarrin e po i hidhte dru të tjera. Nusha kishte hequr këpucët, kishte liruar edhe dy kopsat e sipërme të xhaketës e rrinte e shihte në heshtje.

— Boll, — i tha pas pak shokut, — boll, nuk është ftohtë.

— Sa të na thahen djersët, — tha ai e drejtoi trupin.

— Të lodha sot, ta këputa krahun.

— Unë kam hallin tënd, ti je lodhur. Të dhemb plaga?

— Jo dhe aq. Por më duket se prej lëvizjes i është ngacmuar dregëza e ka rrjedhur prapë gjak.

— Nxirre njëherë ta shohim, mos i ndërroj-më edhe fashën.

Nusha përvoli ngadalë këmbëzën e pantallonave deri mbi gju e Dini pa lëkurën e saj të bardhë. Njollat e gjakut mbi fashë iu luhatën në sy si zjarre e ia mjegulluan vështrimin.

Partizani mbaroi punë dhe e mbylli përsëri çantën. E vuri në krye të shtrojës prej fieri, pranë çantës së Nushës. Dy, tha me vete Dini, që iu rikthye vetëtimthi mendimi i mëparshëm, dy për t'u mbështetur dy koka. Sëpata ishte aty, në dorën e tij, me një teh të fortë, ku lëpihej dinakërisht errësira.

— Shtrihu pak të pushosh, se do të na duhet të ecim përsëri që pa gdhirë, — foli partizani.

— Jo, shtrihu ti, — iu kthye Nusha.

— Shtrihu, shtrihu, — përsëriti partizani me zë të urtë po të prerë.

— Unë do t'i mbyll sytë kështu, me kokën në gjunjë, sa për ta mbytur gjumin.

Nusha kundërshtoi përsëri, po këmbëngulja e shokut ishte e palëkundshme. Diku tjetër u dha

një lëkundje e fortë, te Dini. Dhe e çara e parë që mori kur pa plagën, u bë humnerë.

Nusha rregulloi edhe një herë çantat dhe e mbështeti kokën butë mbi to. Shoku i saj, i ulur përballë, ndezi një cigare.

Dini nuk ndenji më të shihte nëse fjeti e bija apo vazhduan të flisnin. Eci pak mbrapsht, se nuk i ndaheshin sytë prej kubesë së ndriçuar të stanit. Pastaj u kthye e u dha këmbëve me sa i mbanin. E kishte harruar krejt mushkën, drutë. Eha, tha me një rënkim të brendshëm, si qenka kjo luftë!

1984

BIBLIOTEKA E KREJTIT

GJENDKASTER

44562

MBRËMJA ME PAK MJEGULL

Unë nuk e ndiqja më dot me vëmendje bisedën e saj, por ajo nuk e ndiente. Ndoshta ngaqë në bisedë na mungonte shkëmbimi i vështirimeve, sepse ajo qe ulur në vendin e parë, në krah të shoferit, kurse unë prapa. Nuk kishte njeri tjetër në makinë. Dhe në raste të tilla, kur bisedat janë dyshe, marrëdhëniet e syve janë të domosdoshme, sepse plotësojnë atë që nuk e shpreh dot deri në fund fjala, sado e kërkuar të jetë. Në ato çaste, në të vërtetë; mua më vinte për mbarë që nuk e kisha në krah, se ashtu, me atë pamundësi për ta përqendruar vëmendjen aty, do të më bëhej edhe më i vështirë komunikimi në bisedë.

Kishim gjithë ditën që vërtiteshim bashkë në për muzetë e fshatrave, pasi unë duhej të bëja një shkrim dhe ajo erdhi të më shoqëronte, meqë ishte drejtoreshë e përgjithshme e muzeve të rrethit. Dukej e çiltër dhe e shpenguar qysh në njohjen e parë, dhe mua gjithmonë kjo gjë më ka pëlqyer mbi gjithçka në sjelljen e vajzave. Ndoshta nga kjo ndjeva një keqardhje kur, që në mëngjes, sesi erdhi fjala e ajo më tha se ishte e pamartuar. As e fejuar. Njihja dhjetëra vajza të pamartuara, që i kishin kapërcyer të tridhjetat, por asnjëherë nuk më kishte ndodhur t'i kush-toja rëndësi këtij fakti e aq më pak të ndieja keqardhje për to.

Ndërsa tani pashë të më mbushte njëfarë trishtimi i zbehtë e i largët, që u shpërnda tek unë gjithandej në mënyrë të njëtrajtshme, siç shpërndahet një pikë bojë në një enë të mbushur me ujë. Nuk e desha atë trishtim, po, siç ndodh nga herë me gjërat që nuk i do, për çudinë më të madhe, ajo ndjesi nuk m'u nda gjithë ditën. Mbase ngaqë herë pas here e zija veten në faj duke menduar se ajo vajzë ishte vërtet e bukur dhe se ishte për të ardhur keq që kjo bukuri femërore i shkonte ditët pa dashurinë e një burri. Ky mendim nuk u rrëzua dot edhe kur i thashë vetes me inat se po turrja një absurditet, pasi nuk dija asgjë e as që më interesonte të dija për jetën e saj. Ku e dija unë se asaj i mungonte një dashuri e tillë?! Sidoqoftë keqardhjen nuk e përzura dot deri në fund dhe trishtimi që të mbjell një ndje-

një e tillë mbeti si një re e varur në horizont, që herë pas here, gjatë ditës, kur kishim ndonjë çast qetësie, afrohej dhe ma turbullonte pak qiellin. Unë u ruajta të mos më zbulohej ky mendim i shpifur dhe ajo me siguri nuk kuptoi gjë, siç nuk po e kuptonte as tani që nuk po arrija t'i bëhesha i pranishëm plotësisht në bisedë.

Ktheheshim në qytet. Mbrëmja e majit bashkë me errësirën i kishte hedhur rrugës edhe pak pluhur të lagësht mjegulle dhe shoferi e ngiste makinën jo shpejt. Pas gjithë atyre bisedave të bëra gjatë ditës, plot me emra dëshmorësh dhe heronjsh, me emra e kujtime veteranësh të Luftës së Dytë Botërore, datash, ngjarjesh të shënuara për krahinën e me diskutime për problemet e shumta të organizimit të muzeve të fshatit, Enrieta, kështu e quanin drejtoreshën, më fliste tani për pasionin e saj të madh për historinë. Ndaj më vinte sinqerisht keq që nuk po arrija kësaj here t'i shprehja të paktën respektin e denjë për një njeri kaq të pasionuar.

Sado që përpiqesha, nuk e mblidhja dot veten për t'i kushtuar vëmendjen që meritonte. Ndoshta qe pikërisht ajo mbrëmje e butë maji, e trazuar lehtë me pluhurin e pakapshëm të mjegullës, si për t'i dhënë një përndritje jo tokësore, që ia kishte zgjuar edhe Enrietës dëshirën të fliste për pasionin e vet, të cilin ajo, si femër, me siguri kujtonte se duhej ta vlerësonin të gjithë, ashtu siç më kishte pushtuar edhe mua të tërin një

kujtim i largët, që ma bënte të pamundur, me gjithë thirrjet serioze që i bëja vetes, të merrja pjesë në rrëfimin e bashkudhëtares.

Kishim gati një orë që udhëtonim nëpër një rrugë që vazhdimisht përdridhej nëpër shpatet e kodrave dhe pothuajse tërë kohën kishte folur vetëm Enrieta. Qe munduar të më tregonte jo vetëm rëndësinë që merr në kohën tonë, por edhe të gjitha bukuritë e kënaqësitë e vëçanta që ka puna e historianit. Dhe unë, herë pas here, ndoshta ndonjëherë edhe pa vend, sa për t'u gjen-
dur disi në fjalë, thosha «Ashtu është».

Me siguri ndonjë nga këto ndërhyrjet e mia miratuese të pavend i bëri më tepër përshtypje asaj, sepse e ndërpreu menjëherë të folurën, u kthye prapa e po më shihte, s'di si të them, edhe pak e prekur, edhe me habi, edhe me një lloj dhimbsurie.

— Ç'ke? — tha. — Ndiresh i lodhur?

— Jo, pse? — u zura unë në befasi.

Përgjigjja ime, që doli me një zë të tronditur, e bëri edhe më ngulmues vështrimin e saj, që mezi dallohej në gjysmëerrësirën e makinës.

— Jo, jo, — vazhdova unë përsëri shpejt dhe u mundova të vija buzën në gaz. Po nxora vetëm një buzagaz fajtori, që ma theksoi në fytyrë sikletin që ndieja nga pyetjet e saj, të cilat, sidoqoftë, ishin të natyrshme.

— Të dhemb koka?

Unë vura prapë buzën në gaz si fajtor.

— Pse të shkon ndër mend?

— Sesi dukesh...

— Jo, jo, jam fare mirë.

Sa kujtova se fillova ta mblidhja disi veten, ajo më dha një goditje shkatërruese:

— Atëherë pse s'thua që të mërzita me dërdëllitjet e mia?

Zëri i saj nuk u acarua siç mund ta lypte kjo pyetje, por nga fytyra i iku edhe habia edhe dhimbsuria e i mbeti vetëm shprehja e njeriut të prekur, që sikur ia holloi të tëra tiparet. Nën kubënë e ulët të makinës u shpërnda një përndritje e verdhë. Kam vënë re se kjo lloj shprehjeje, sidomos femrave të bukura, u jep një pamje tepër kërcënuese.

— Jo, më vjen keq, — u nguta ta kundërshtoja dhe me siguri u skuqa.

— Megjithatë diçka ke, ndryshe... — kërcënimi në fytyrën e saj sikur u bë më i mprehtë dhe i sigurt.

Shoferi ktheu kokën e m'i nguli sytë e vegjël një çast të shkurtër. Pastaj, pa shprehur asnjë lloj reagimi, vazhdoi të shikonte i përqendruar rrugën përpara. Pse s'foli diçka, thashë me vete gjithë inat. Shpresoja se një ndërhyrje e tij, sado e kotë, do ta këpuste atë fill të tendosur jashtë mase midis meje dhe Enrietës.

Kurdoherë tjetër do të më dukej pa kuptim një këmbëngulje e tillë, bile edhe mund të isha fyer. Në këtë rast nuk ndodhi ashtu. Mbase ajo,

duke e shprehur e para fyerjen, sikur ma hoqi mua atë të drejtë, gjë që më shtyu më keq në përpëlitjet e fajtorit.

— Ke apo nuk ke gjë, të paktën ta di nëse jam unë shkaku...

— Kam, — u përgjigja pa e zgjatur hesh-tjen, — po nuk lidhet me ty. — Mezi e mbyta një ofshamë çlirimi.

Pashë se ajo u vu menjëherë në pritje, edhe pse u duk që nuk më besoi. Megjithatë mosbesimi i saj nuk më ngjalli pakënaqësi. Një femër e bukur ka nevojë edhe për këtë ndjeshmëri të lartë, e shfajësova në heshtje.

Për çudi, në pritjen e saj nuk dallohej asnjë shenjë padurimi, që zakonisht ta jep kureshtja e tepruar. Ajo nuk kishte kureshtje, se ç'kishte nuk e di, po kureshtje nuk kishte. Qe diçka si lutje e pashprehur, që të detyronte të bëheshe krejtësisht i singertë.

— Kam mall, — thashë, — mall për Emën.

Ajo me siguri e mori me mend për afërsisht se kush ishte Ema, pasi nuk më pyeti.

— Pse, — tha me një zë thuajse të shuar, — ke kohë pa e parë?

— Kam... tri ditë.

Ajo nuk shfaqti asnjë shenjë habie dhe mua më erdhi mirë që tri ditë nuk iu dukën pak që të të marrë malli për njeriun e dashur. Ndoshta kjo më shtyu të shkoja më tej. I thashë se nuk qe gjatësia e kohës që më sillte atë mall. Me

ndarje të tilla, bile edhe shumë më të gjata, ishim mësuar edhe njëri, edhe tjetri. Mallin ma pati zgjuar kjo mbrëmje me pak mjegull të për-hime.

Me Emën s'kishim pak muaj që njiheshim e gjatë gjithë kësaj kohe, për çudi, në Tiranë nuk kishte pasur asnjë mbrëmje me mjegull. Dimrin e kalur Ema kishte ardhur këtu për pushimet, në qytetin tuaj i thashë, dhe kjo mjegull e mbrëmjeve ishte nga gjërat më të pashlyera në kujtimet e saj. Unë nuk di asgjë se si i ka kaluar ajo ditët e të dy javëve që ka ndenjur në këtë qytet, me kë është njohur e shoqëruar, ç'ka bërë, po di se mjegulla binte gjithnjë thuajse në të njëjtën orë të pasdites dhe niste e luante shtruar me muzgun. Me të hirtën e vet të shprishur e të çngjyrosur e afronte atë para kohe, pastaj nuk e linte të ikte deri vonë, për t'ia lëshuar vendin territ të natës. Ema e priste këtë çast në klubin e shtëpisë së pushimit, duke pirë një kafe, pastaj dilte të shëtiste. Vetëm. I pëlqente të shëtiste fare vetëm. Edhe kur ndonjë shok a shoqe donte të dilte me të, ajo i shmangej gjithnjë. Duke ecur ngadalë, me jakën e palltos të ngritur, e ndiente mjegullën t'i tretej nëpër flokë dhe besonte se qe thinjur e tëra. Pak nga pak e humbte vetëdijen e moshës. I dukej vetja gjyshe që ka të drejtë ta shohë tërë jetën si një lodër të bukur, që mbaroi shumë shpejt.

Vura re se Enrieta e kishte kthyer pa u ndier kokën para dhe i mbante sytë të përhumur në drejtim të rrugës së copëtuar prej mjegullës. Por

dukej se më dëgjonte me krejt vëmendjen, ndaj nuk e ndërpreva rrëfimin.

— Më ka folur kaq e kaq herë për shëtitjet në këto mbrëmje, sa unë tani i di deri në imtësiirat më të mëdha nga i fillonte e ku i mbaronte, mund të t'i përshkruaj edhe si dukeshin rrugët, dritat dhe njerëzit e veshur me rrobën e najlontë të mjegullës. Por unë nuk e kam këtu fjalën. Të thashë qëparë se, qysh kur jemi njohur, Tirana s'ka pasur asnjëherë mbrëmje me mjegull. Më kupto, këtë s'e kam thjesht trill prej të dashuruarit. Kohët e para të shoqërimit tonë, kur pashë se u kthehej tepër shpesh këtyre mbrëmjeve, nisa të trishtohesha pak, pasi mendova që ajo ndihej bosh me mua dhe ato kujtime i kishte sa për t'u gjendur në bisedë, të mos i linte vend heshtjes. Më vonë mendova përsëri me trishtim se mos jeta e saj qe aq e varfër, sa nuk kish ku të vërtitej tjetër veç atyre kujtimeve që, në fund të fundit, sado të bukura, zinin vetëm dy javë të jetës së saj. Mirëpo pak nga pak të dyja këto hamendje ranë e u harruan. Ty mund të mos të besohet, po tek unë, fshehurazi, vetëm duke e dëgjuar se me çfarë zjarrmie të brendshme, të re më fliste çdo herë, edhe pse qëllonte të më përsëriste gjëra të thëna, u përvijua një lloj ndjenje që m'u bë nevojë e vetvetishme ta shihja me sytë e mi si e jetonte qenia e saj një mbrëmje të tillë me mjegull. Pasi kam përshtypjen se do të pësojë patjetër një transformim të çuditshëm të panjohur e që nuk mund ta përfytyroj, sado që të

përpiqem. Ë kuptova, mungesën e vajzës që dua më bën ta ndiej edhe më tepër sonte pikërisht kjo e panjohur e saj, që nuk mund të më zbërthehet në rrethana të tjera.

— Mjaft, — tha ajo papritur dhe me rrëmbim, — të lutem, mjaft!

Unë u stepa. Duket se, ngaqë isha magjepsur edhe vetë disi nga të rrëfyerit tim, u hutova më keq prej ndërhyrjes së saj. Pashë se përpara makinës, jo larg, shfaqeshin dritat e lagjeve të jashtme të qytetit, të vakëta prej mjegullës, si sy të sëmurësh me ethe.

— Ndale makinën !— iu kthye prerë shoforit. — Dua të zbres. Më fal, — m'u drejtua mua dhe u kuptua se bëri mundim të madh që të ruante sadopak një pamje të qetë.

— Pse? — munda ta pyesja me një zë që m'u fik në grykë.

— Këtu pranë kam një teze, po kthej njëherë andej. Kam një punë, po kam edhe kohë pa e parë.

Tani zëri i saj u bë më i përmbajtur, po prapë nuk e fshihte dot tronditjen.

— Po të shoqërojmë me makinë, — ngula këmbë unë.

— Jo, jo, falemnderit. Ë ka fare afër shtëpinë. Falemnderit. Shihemi nesër. Natën e mirë!

Hapi derën e makinës e iku gati me vrap, pa thënë më asnjë fjalë, pa na dhënë as dorën.

— Po kjo ç'patit? — foli për herë të parë sho-

feri duke rrudhur supet, që e futën krejt brenda qafën e tij të shkurtër.

— Kushedi si e ka punën, — thashë unë e nuk e zgjata më. Rrugës, dhe më pas në hotel, mendova deri vonë për të me një ndjenjë të çiltër faji. Gjesti i saj më lidhej vetvetiu në kokë me atë keqardhjen që e ndjeva në mëngjes, kur më tha se ishte e pamartuar.

1985

HISTORI E PAMBYLLUR

Me Artën u njoha një paradite dhjetori, fare rastësisht. Ose më saktë, jo fare rastësisht, sepse ma solli një e njohura ime e hershme. Arta sapo ishte diplomuar si ekonomiste kontabël dhe kishte filluar punë në ndërmarrjen tregtare të zarzavateve. Asnjëherë nuk e mora dot vesh përse puna e re i kishte zgjuar një trill të çuditshëm, të mësonte turqishten e vjetër, d.m.th. osmanishten. Po e quaj trill, pasi nuk mund t'i vë emër tjetër. E njohura ime, siç më tregoi vetë, e paska takuar Artën një ditë para se të vinin tek unë, shumë të mërzitur nga një shkak absurd, por që, sidoqoftë, tek ajo merrte kuptimin e vet: nuk po gjente libra në osmanisht dhe po i shkonin dëm edhe mësimet që merrte te profesori. Atëherë e

njohura ime u kujtua për bibliotekën që kisha trashëguar unë nga gjyshi, i cili gjysmën e jetës e pati kaluar në Stamboll. Ndaj, me siguri, duhej të kishte edhe nga ata libra.

Nora, e njohura ime, m'i tregonte këto atë ditë që më njohu me Artën, në sy të saj. Unë do ta merrja për shaka tërë këtë skenë, po pamja e fytyrës së Artës, me sytë e mëdhenj, të hapur disi jashtë mase, që të vështronin me ngulm, si ai që pret me padurm një përgjigje pohuese, më bëri të ndihesha ngushtë.

Një mendje më thoshte se edhe mund të mos qe lojë. Ata muaj në shtyp ishin shkruar disa artikuj radhazi, ku shtrohej me shqetësim të ri problemi i prapambetjes që vihej ende re në ngritjen e shoqeve në përgjegjësi, si aspekt i rëndësishëm i emancipimit të grave. Bile theksohej se çdo ngurrim vinte vetëm nga konservatorizmi, sepse nuk është më Shqipëria e para dyzet vjetëve. Sot kemi shoqe me një përgatitje të shëndoshë shkencore e me aftësi të mëdha organizuese. Tani atyre mund t'u besoheshin detyra me përgjegjësi edhe në sektorët më delikatë. Dhe kjo vajzë e quajtur Arta, meqenëse kishte studiuar ekonomi, ndoshta e ka rregulluar ta çojnë në atashe tregtare në Turqi. Aq më tepër, atë kohë nëpër Tiranë flitej se ish-kryeministri puçist me bashkëpunëtorët e tij kishin dërguar shumë njerëz të vetët nëpër përfaqësitë tona jashtë, ndaj nga tërheqja e tyre andej ishin liruar plot vende.

Por u kujtova menjëherë se ajo nuk mësonte turqishten, por osmanishten dhe është absurde të besosh se një atasheu tregtar i është e nevojshme për punën një gjuhë mesjetare. Këtu, për një çast, vetvetiu m'u dha ta përfytyroja atë vajzë ashtu siç po e shihja tani, me flokët e drejtë si fije të holla bakri që ndaheshin në mes e lëshoheshin me vrull mbi supe, duke u ulur në ndonjë kafene të Stambollit me një grup afaristësh turq të vjetër me feste të gjelbra e të zeza, e ajo, tamam si tani, me sytë paksa të çapëlyer, pret gjithë ankth të mezifshehur përgjigjen e propozimit të vet për shitjen e disa qindra tonëve patëllxhanë të freskët. Kushedi edhe ç'do të më thoshte tjetër mendja, sikur të mos më vinte për të qeshur prej këtij përfytyrimi.

— Ç'ke? — më pyeti Nora, ndërsa tek Artanuk lëvizti asgjë. Siç dukej, ishte mësuar të pritej kudo me buzë në gaz ideja e saj.

— Hiç, — u përgjigja dhe, ngaqë u gjenda i papërgatitur, vetëm mblodha supet. — Hiç.

— Nejse, po Artës nuk do t'ia mbash librat, besoj, — vazhdoi ajo.

— Sigurisht, pse t'ia mbaj?! Aq më tepër kur në shtëpi i ruajmë thjesht si kujtim dhe as që kam menduar se do t'i shfletojë ndonjëherë kush... Por, më duket vërtet i çuditshëm ky trilli juaj, — iu ktheva Artës.

— Pse e quani trill?

— Si ta quaj?

— Quajeni dëshirë. Njeriu mund të ketë gjith-

farë dëshirash, mjafton që ato të mos jenë të dëmshme për të tjerët.

Nuk e ngava më tej. Nuk desha të hyja në arsyetime për dëshirat, diskutime që, për më tepër me vajzat, janë gjithmonë pa fund e pa krye. Pastaj edhe nuk kisha asnjë të drejtë t'i gjykoja dëshirat e saj.

Ra një heshtje. Sa për të folur diçka, e pyeta Artën se kë kishte profesor. M'u përgjigj se me siguri nuk e njihja, një plak, burrë shumë i mirë, dhe iu përshkënditën sytë nga një gaz i brendshëm:

— Ka qenë hoxhë.

Mua nuk më bëri ndonjë përshtypje të veçantë ky fakt dhe asaj, me sa duket, i erdhi inat sepse këtë e quante gjënë më interesante.

— Pse s'qesh? — tha duke u mrrolur.

— Pse duhet të qesh?

— Sepse është për të qeshur. Tani, në vitet tetëdhjetë të shekullit të njëzetë të bësh mësim me një ish-hoxhë. Aq më tepër në një vend ateist. Megjithatë po të them se s'jam e vetmja. Ai u mëson edhe dy djemve që punojnë në Institutin e Historisë.

— Pikërisht për këtë nuk më vjen për të qeshur. Më për të qeshur më duket dëshira jote të mësosh osmanisht.

— Ndërsa mua më vjen të qesh për çudinë tënde.

— Qeshni të dy sa të doni me njëri-tjetrin, se do të keni raste të shiheni shpesh, — tha No-

ra. — Tani si do të bëjmë, do t'i shohësh sot librat që ka Edi, apo do ta lësh për një herë tjetër? — iu kthye Artës.

— Jo, — u hodh ajo, — pse t'i lë?! Ne për këtë punë erdhëm.

Atë ditë ajo mori një libër. Tha se ishte një biografi e Aleksandrit të Madh dhe, kur po i përcillja, më pyeti se sa mund ta mbante.

— Sa të duash, — iu përgjigja unë, — veç, besoj e kupton, nuk dua të më dëmtohet, pasi hyn në reliket e shtrenjta të familjes.

Pasdite dhe në mbrëmje e pata vazhdimisht në mendje figurën e saj. Nuk kishte asgjë për të rënë në sy kur të ndodhej pranë, por, kur largohej, linte pas një mall për ta parë prapë. Të paktën kështu më ngjau mua. Ndaj, të nesërmen, që në mëngjes, vetëm sa u paraqita në zyrë dhe, i shtyrë nga ai mall i pashpjegueshëm, pa ngurruar fare, dola dhe mora rrugën thuajse me nxitim për nga puna e saj. E gjeta në këmbë para tavolinës së vet të punës si të ishte duke më pritur. Nuk më pyeti fare dhe as nuk u habit kur më pa. Krejt natyrshëm më tha se bëra mirë që vajfā dhe, pa më dhënë as dorën, u zgjat të merrte pallton në varëse.

— Shkojmë pimë një kafe, — tha, — këtu afër, te «Partizani».

Unë e prita me kënaqësi e ndoshta kjo kënaqësi ma mbajti humorin tërë kohën që ndenja me të, deri afër drekës. As njëri e as tjetri nuk ishim më të djeshmit. Që dje e hoqëm atë «Ju»-në por

sot m'u shpërfill fare dhe ajo grimë druajtje a vetpërmbajtje, si mund të quhet kur është fjala për të komunikuar me një vajzë, me të cilën je njohur vetëm një ditë më parë dhe për herë të parë rri vetëm për vetëm me të. Aq më fort kur nuk dinim thujse asgjë për njëri-tjetrin. Të paktën unë për të. Aty, për shembull, në atë tavolinë kafeneje mësova se mbiemrin e kishte Rama. Me siguri as që do të isha kujtuar ta pyesja, por erdhi fare rastësisht, kur asaj i hipi në kokë të ngacmohej me një fëmijë që shiste kaushë me bajame të pjekura. Ajo i mori një kaush e hiqej sikur nuk donte t'i jepte para. Dhe për ta frikësuar, meqë fëmija me të drejtë po ngulte këmbë, e pyeti me vetulla të mbledhura:

— Si e ke emrin?

— Artan, — u përgjigj djali prerë dhe gjithë bezdi.

— Artan kush?

— Artan Rama.

— Hë, pse s'thua që jemi kushërinj? Turp të kesh! E bën veten për një kaush bajame! Unë të njoha qysh në fillim dhe doja të shihja si do të silleshe. Po mirë, mirë, ik tani e do të takohemi në drekë, në shtëpi.

Djali kishte mbetur i habitur, sepse në zërin e saj kishte një vendosmëri dhe siguri të çuditshme. Ai nuk çeli gojë derisa Arta i tha përsëri, me po atë zë, të ikte e u kthye nga unë si të mos e kishte më pranë. Unë e ndoqa me sy tërë dialogun e saj, pa e kuptuar ku donte të dilte dhe ç'e shtynte në këtë lojë.

— Ç'kushërirë të kam unë ty, moj?! — tha djali gjithë nerva, por edhe pak i trimëruar, nga që, sig duket, u bind se unë nuk do të ndërhyja. — Ti s'ke turp, ti e bën veten për dhjetë lekë. Hajde, nëm paratë ose bajamet e mia!

Unë nisa të mërzitesha më tepër edhe nga që njerëzit përreth po kthenin kokën nga ne me një kureshtje qortuese. Isha gati t'ia jepja vetë lekun atij djalit, veç ta përcillja, po druhesha mos prekej Artë. Thashë, unë dija shumë pak për të e aq më pak e njihja ç'natyre ishte. — Unë s'e bëj veten, — tha ajo me seriozitetin e mëparshëm, — ja, ajo dhjetë, po njëzet lekë të jap, se të kam edhe kushëri, — dhe i zgjati dy kartëmonedha. Djali vuri buzën në gaz i lehtësuar, ngurroi një çast, sepse nuk po e kuptonte nëse ajo e kishte me tërë mend, pastaj i mori leket pa kundërshtuar fare dhe, para se të largohej, na la një kaush tjetër bajamesh mbi tavolinë.

— Vërtet e kishe kushëri? — e pyeta unë singërisht.

— Jo, çne, as nuk e njoh fare, — u përgjigj ajo duke qeshur paksa me naivitetin tim. — As që e kam parë ndonjëherë.

Kur më pa të çuditur, vazhdoi:

— E bëra kot. Duhet të bëjë njeriu edhe gjëra kot, apo jo?! Veç të jenë të padëmshme. Si thua ti! Edhe prej llamarinë ta kesh lëkurën e fytyrës, po ndenje serioz gjithë kohën, do të të ndryshket.

Përsëri nuk iu përgjigja dhe po e shihja me

një shprehje të papërcaktuar. Unë, edhe të doja, nuk do të mund të sajoja kurrë gjëra të tilla.

Sidoqoftë, në mend më ngeli ai mbiemër e nuk e pyeta më. Tani që rri dhe e kujtoj, them me vetë se me siguri ka mbiemër tjetër. Por aty për aty e besova, siç besova dhe rashë pre e shumë lojërave të tjera të saj, të cilat, kur zbuloheshin, më bënë nga pak qesharak edhe mua. Sado që me kalimin e kohës u mësova disi me të dhe çdo herë mundohesha të mos i merrja seriozisht ato që thoshte, prapë seç më shtynte të hyja në lojën e saj disi verbërisht. Ka shumë raste të tilla, por unë do të tregoj vetëm ndonjërin, ku edhe jam ndodhur më keq.

Një ditë ndeshëm në rrugë një mesoburrë trupgjatë e fytyrëqeshur, për të cilin kohë më vonë mësova se ishte drejtori i ri i ndërmarrjes së Artës. Ai ndaloi gjithë përzemërsi e na takoi.

— S'na njohe me shokun, — iu drejtua Artës me një buzagaz me nënkuptim.

— Ah, po, — foli ajo, — është një shoku im, ose, si të them... ai që... ti, ju e merrni vetë me mend.

— Ne jse, ne jse, — e ndërpreu drejtori me po atë buzagazin e parë, — lere mos e ço më tej. Çështje llokumesh...

— Eh, i keni rënë pikës. Kështu është kur ke hequr vetë vuajtje të tilla.

— Ama janë vuajtje të ëmbla, — vazhdoi drejtori.

Unë me siguri u skuqta i tëri dhe e pashë

Artën me çudi e mosbesim. Ajo po guxonte ta bente publike-diçka që ne ende nuk ia kishim pohuar njëri-tjetrit. Po mënyra si foli ajo, aq natyrshëm, aq shpenguar, si të thoshte diçka për diejllin që nxehte, më mblodhi në shpirt një qetësi të këndshme. Unë nuk e njihja njeriun që kisha përpara, ndaj mezi prita sa u ndamë me të, që ta pyesja Artën kush ishte.

— Nuk të thashë? — u çudit Arta seriozisht. — Më fal! Ishte dajua im. Është burrë shumë i mirë dhe fare i çliruar nga paragjykimet e vjetra. E pe si i priti fjalët e mia, si një gjë më se normale. Merre ndonjë ditë në telefon dhe ftoje për një kafe. Ndoshta gjen rast e bisedoni bashkë edhe për ne të dy. Ja, po të jap edhe numrin e tij të zyrës. Po mos harro!

— Ç't'i them për ne të dy? — u hodha unë menjëherë, i gëzuar që më doli në atë shteg.

Por ajo ishte mjeshtrë për të kapërcyer natyrshëm çdo situatë dhe ma ktheu pa ngurruar fare:

— Ç'të duash thuaji, ç'mendon dhe ç'di për lidhjen tonë.

Vërtet, ç'mendoja, pyeta veten për herë të parë që kur e njihja.

Kur u takuam herën tjetër, unë e kisha harruar atë ndodhi, po nuk e kishte harruar ajo kërkesën që më bëri. Ngaqë ma përsëriti, por edhe jo pa dëshirë, u binda se do të qe vërtet mirë të pija një kafe me dajën e saj. I telefonova që të nesërmen. M'u deshën disa minuta sa e sqarova kush isha e ku qemë njohur.

— Ah, po, — tha ai, — tani po, më kujtohet, si s'më kujtohet?! Patjetër e pimë, pse jo?! Kur të duash, me kënaqësi të madhe. Dakord, dakord, po nisem.

Unë arrita para tij te kafe «Tirana» dhe po e prisja disi me padurim. Ndihesha mjaft i emocionuar dhe kjo më doli edhe më fort në pah kur nisi biseda. Ndërsa ai e zotëronte shumë mirë veten, derisa unë fillova të përpiqesha t'ia shpjegoj larg e larg se ndoshta atë ditë Arta e teproi kur tha që ne ishim më tepër se shokë, domethënë ndienim diçka të veçantë për njëri-tjetrin, sepse ende nuk ishte kristalizuar asgjë midis nesh. Por... Fjalët m'u ngatërruan nëpër dhëmbë e nuk arrita t'ia shprehja sigurinë që, sidoqoftë, lidhja jonë ishte e pastër. Unë e kuptoj, shtova, për ju, si dajë, nuk është e lehtë të dëgjoni se mbesa, domethënë vajza e motrës, shkon me një djalë, ashtu, ashiqare, rrugëve, kafeneve, se vërtet mund të keni besim tek mbesa dhe duhet të keni, po fjalët e botës, kush i mban fjalët e botës?! Akoma nuk po arrinim ta shkulnim këtë mentalitet mesjetar për ta komentuar prapa krahëve jetën private të tjetrit, edhe kur ajo nuk paraqit asnjë interes shoqëror as për mirë, as për keq...

Tani, sado që mundohem, nuk e ndërtoj dot tamam-tamam ligjëratën time të asaj dite, plot fraza të hallakatura. Edhe ai burrë me një besim të fortë në vetvete, të cilin dukej që nuk ia jepte thjesht përvoja e gjatë e as posti, por e kishte në karakter, sidomos kur unë përmenda dajën,

motrën, mbesën, e humbi pusullën dhe fytyra e plotë, e qeshur i mori një shprehje budallaqe. Megjithatë unë vazhdova në timen, pa i rënë në të fare çoroditjes së tij.

— Të lutem, ku e ke fjalën? — më ndërpreu dikur, me një zë të shqetësuar.

— Si ku e kam fjalën?!

Në castin e parë u preka nga ndërhyrja e tij e patakt dhe aq më tepër nga shqetësimi i turbullt që i vura re. Por e përmbajta veten nga që nuk doja të shkëmbeja me të ndonjë replikë të papëlqyer, qoftë edhe për hir të marrëdhënieve të ngrohta, me një intimitet më tepër se familjar, që kishte ai me Artën, siç më pati thënë ajo. Ndaj vazhdova, pa e ditur as vetë nga më doli kjo pyetje, sepse në mend kisha tjetër gjë:

— A jeni ju daja i Artës?

— Unë daja i Artës?!

Pamja e hutuar e tij u shpërbë menjëherë dhe ai shpërtheu në një gaz të papërmbajtshëm, duke tërhequr vështrimet e çuditura dhe qortuese të të gjithë atyre që kishim përreth.

— E bukur, — thoshte ai me zë të lartë, — shumë e bukur. Anekdotë e vërtetë! — Dhe vazhdohte të qeshta zhurmshëm.

— Kush jeni ju atëherë? — Tani isha unë i fyeri që nuk më duronte më tej.

— Unë jam drejtori i ndërmarrjes ku punon ajo, more shok. Po s'ka gjë, s'ka gjë. Do të më mbetet në kujtesë si një keqkuptim tepër anekdotik, shumë-shumë i bukur, s'ka ku shkon më

i bukur. Vajzë e çuditshme ajo, ç'nuk i pjell mendja. — E qeshura e tij, sa dukej se po qetësohej, shpërthente rishtas që nga fundi i krahërorit.

Shpjegimi, i tij i këputur nga gazi më bëri ta mblidhja veten mirë. Sikur më ra tavani në kokë. Më vinte edhe të qeshja, edhe të qaja. Nuk fola më. Thirra me nxitim kamerierin, pagova kafet dhe u ngritëm, sado që ai nguli këmbë singërisht të rrinim edhe pak, dhe nisi të ma lëvdonte Artën, të cilën, edhe pse nuk e njih-te ende mirë për shkak të kohës akoma të paktë që punonin bashkë, prapë e kishte psikologjisur natyrën e saj të veçante prej vajze të zgjuar e me humor të rrallë. Po jo shumë kohë më vonë, në një mjedis të gjerë, ku rastësisht gjendeshin edhe disa të njohur të mi, sesi paska ardhur fjala tek unë e ai paska thënë, duke vënë buzën në gaz:

— E njoh, e njoh, e kam takuar një herë, po më është dukur kaqol fare. — Dhe nuk i kishte treguar rrethanat si i kishte qëlluar të më njih-te. Të njohurit e mi e kundërshtuan, por ai as nuk u tërhoq, as nuk e çoi më tej mendimin që tha.

Sa u ktheva në zyrë, i nxehur dhe i prekur vërtet, i bëra menjëherë telefon Artës.

— Dua të të takoj patjetër, — i thashë.

— Kur? — Në pyetjen e saj m'u duk se dallova një gaz të përmbajtur.

— Sa më shpejt, që tani po munde.

— Pse? Ç'ka ndodhur? Ç'është gjithë ky padurim? — Tani zëri i saj u bë i shqetësuar. Me siguri e ndjeu nervozizmin tim nga mënyra si i fola, aq urdhërues.

— Hiç, hiç, s'ka ndodhur gjë, po dua të të takoj. Mos duhet të ndodhë patjetër diçka që të takohemi?! Tani jam edhe i dashuri yt i shpallur.

— Ëhë, mirë, ja, po vij! — Fjalët e fundit, që më dolën me një kumbim të hapur ironik, e paralajmëruan për zemërimin tim.

Nuk desha t'i tregoja përse e kërkoja me aq alarm, për të mos e shkarkuar paraprakisht një pjesë të inatit, sepse e dija që largësia e futur në mes do ta bënte atë shkarkim gjithsesi më të zbehtë. Përderisa edhe vetë elektriciteti humbet nga pak duke ecur nëpër tela, aq më fort ka arsye që të shpërbëhet, të zbutet e të hillohet një ndjenjë njerëzore, qoftë ajo edhe zemërim.

Po nuk më doli ashtu siç e desha. Me sa më tha vetë Arta kur u takuam, ajo parandjenja që i zgjuan fjalët e mia iu provua shumë shpejt. Ndërkohë që po bëhej gati me nxitim të nisej për tek unë, në zyrë ia bëhu drejtori e, duke qeshur, i tregoi ç'i kishte ndodhur me mua. Ndaj, sa më pa që rrija si i ngrirë në trotuar, duke përtypur bishtin e lagur të cigares së pandezur, zuri të qeshte prej së largu. Dhe ajo ka një të qeshur të plotë e tepër të singertë, sa ta mbjell edhe ty gazin me domosdo. Një e qeshur

e tillë bën çudira. Ajo është hasmi më i madh i inatit, e çarmatos fare atë. Ashtu më ndodhi edhe mua. Munda vetëm t'i thosha se sajime të tilla janë pa kuptim, janë lojra të pakëndshme, krejt të pakëndshme, madje fyese, përderisa e bëjnë njeriun qesharak. Dhe ty, në qoftë se të pëlqen t'i poshtërosh të tjerët, nuk jam unë ai i përshtatshmi për të ta dhënë këtë kënaqësi... Ajo qeshi përsëri, pa m'u përgjigjur, po kësaj here u dallua që mezi e nxori gazin. Për të mos më lënë të vazhdoja më tej, më zuri për bërryli dhe më tërhoqi me një intimitet përkëdhelës për nga bar «Progresi», ku e dinte se më pëlqente të pija gjithnjë kafe. Pas pak, ndërsa rrinim ulur përballë dhe ajo tregonte anekdota nga jeta e Mark Tuenit, e kishim harruar fare ndodhinë time të hidhur.

Një herë tjetër, mbase dy javë më vonë, një paradite, bie telefoni i zyrës dhe mua, sa e ngre, nga përtej më vjen një zë disi i prishur femre që më thotë se ishte një shoqe pune e Artës e se fliste nga reparti i urgjencës, në ambulancën qëndrore. Aty ndodhej Artë me një krizë të papritur.

— Çfarë krize, nga se? — pyeta unë me alarm të vërtetë.

— Duhet ta ketë nga ajo... — u përgjigj zëri gjithnjë i prishur nga përtej, duke e lënë të pambyllur mendimin.

— Nga kush? Çfarë, s'po të kuptoj...

— Ju e dini, pra, nga barra. Të paktën kështu.

tÿ mendon ky mjeku i urgjencës që do ta përcjellë tani për në spital. Ka ngritje të menjëherëshme të albuminës në veshka. Ju mos u shqetësoni, i ka shtatzënia, por e keqja është se nuk ka treguar kujdes në kohën e duhur...

Këtu zëri i largët u ul fare, sa mezi e dëgjoja. Për një çast m'u bë se ajo femër e panjohur kukurisi nëpër dhëmbë, po m'u duk diçka e pamundur dhe ua hodha fajin zhurmave të telefonit.

— Barra?! Cila barrë?

— Nejse, ejani njëherë, unë s'di ç't'ju them, po ju ejani patjetër ta takoni para se ta çojnë në spital. Ju kërkon me ngulm.

E panjohura e mbylli telefonin dhe unë mbeta si guhak me receptorin në vesh. Edhe i çuditur, edhe mosbesues, edhe i shqetësuar. Për ç'barrë ishte fjala? Ne ende... Dhe prapë fraza më mbeti në mes. Një ditë më parë ajo më pati treguar gjithë gëzim se ato ditë do të shkonte me shërbim në Pogradec.

— Do të që mrekulli të rregulloje edhe ti një udhëtim andej, — tha, — jemi bashkë.

Unë pohova sinqerisht se do të që mirë.

Pasi folëm ç'dinim për liqenin dhe qytetin, ajo, me atë lirshmërinë e vet të zakonshme, tha në një çast:

— Do të flemë në një dhomë, apo jo?

Gati më doli jashtë ngazëllimi, ngaqë ajo shprehu me zë pikërisht atë që po mendoja ndërkohë dhe po luhatesha ndërdyzash, t'ia tho-

sha tani apo ta lija për atje në Pogradec. Zgjo-
dha... këtë rrugën e dytë, duke besuar se do
ta kisha më të lehtë. Vetmia, koha e tërë për
ta kaluar së bashku, mungesa e të njohurve
që do të na e rrëmbenin sadopak vëmendjen
nga njëri-tjetri, pra ishin një sërë rrethanash
që do të ma thjeshtonin, shpresoja, kapërci-
min e asaj pengese të fortë që kisha te gjuha
e që më përcillte një frenim të çuditshëm
gjithandej nëpër trup kur doja të nxirrja një
fjalë të tillë që e kisha shkuar kushedi sa he-
rë edhe më parë në mend. Kurse ajo e tha
aq lirisht, si të thoshte se në darkë do të pinim
verë. Mbase e ndërlikoja më tepër edhe nga
vetë natyra ime disi e druajtur me vajzat, por
hedhjen e këtij hapi e kam menduar si gjënë
më të vështirë në marrëdhëniet me to. Këtu
më duket se ato e fshehin më tepër se kudo
veten dhe shpeshherë verbtazi, madje edhe ja-
shtë dëshirës së tyre, krijojnë një mister fare
të panevojshëm, po mjaft kufizues në intimitet-
in dashuror. Kurse Arta, mrekullisht, nuk për-
piquej ta fshihte mendimin e saj as këtu. Ajo
donte të ishte e sigurtë para vetes deri në
fund. Dhe në çastet që më jepte prova të ti-
lla, nuk e përmbaja dot admirimin dhe ndihe-
sha tejet i lumtur.

Ai ngazëllimi i parë që më ngjalli natyr-
shmëria e saj m'u shndërrua në një eufori që
tani më duket e bezdisshme. Nisëm të flisnim
për hotelin, për dhomën që do të zgjidhnim,

për një mbrëmje të rrallë që do të kalonim në Drilon dhe për kthimin më këmbë prej andej, duke llogaritur që në mesnatë të kishim mbërritur, sepse do të na mbyllej hoteli e mund të përfundonim në polici si të dyshimtë.

— Ec e merru vesh me policinë pastaj, — thashë unë, — do të na duhet të japim njëqind shpjegime.

— E ç'do të na bëjnë? — u hodh ajo.

Unë mblodha supet.

— Do të na martojnë me vendim, — thashë.

— Oh, po kjo është mrekulli. Qënka për ta provokuar vetë një rast të tillë.

Unë qesha.

Pastaj fjala erdhi përsëri te dhoma e hotelit dhe pak nga pak na hipi një shqetësim aq i madh për katin, si dhe për anën nga duhej t'i binin dritaret, nga liqeni apo nga parku, sa, po të na dëgjonte ndonjë i tretë, me plot të drejtë do të besonte se kishim të bënë me zgjedhjen e shtëpisë ku do të shkonim jetën dhe kurrsesi me një dhomë hoteli ku do të kalonim vetëm dy-tri net.

Unë po tregohesha më këmbëngulës në shijet e mia dhe kushedi deri ku do të më shkonte zjarrmia po të mos më hidhte ajo një pikë të ftohtë:

— Po kemi harruar kryesoren: s'na lë njëri të regjistrohemi në një dhomë, se s'kemi bërë celebrim.

— Do ta rregullojmë disi, mos ki merak! —
desha unë të mos më zbrazej menjëherë entuziazmi.

— Ëhë, punë që s'bëhet. I kam frikë skandalet unë. Apo s'janë nopranë këta sportelistët e hoteleve!

Me këto fjalë të thëna qetësisht, ajo befas mu shfaq në të kundërtën e asaj pamjeje të bukur, në të cilën ma kishte shpalosur veten qysh nga fillimi i kësaj bisede. Ky shndërrim i përnjëhershëm më trishtoi dhe nuk mundë të përmbahesha pa e pyetur veten se cila nga këto të dyja ishte Arta e vërtetë.

— Atëherë nuk vemi, — u përpoqa unë ta prekja dhe u zymtova.

— Unë duhet të shkoj patjetër, — tha ajo fare e qetë, si të mos i bënte asnjë përshtypje zyrtia ime e menjëhershme. Për më keq, ajo e veçoi papritur dhe krejt lehtësisht veten nga unë, duke më lënë nëpër gjithë trupin një ndjesi të hidhur humbjeje.

— Ti sikur më ftove edhe mua, — i thashë me një zë të vrarë, ku nuk e fsheha dot tonin lutës.

— Të ftova? E pse jo, unë shokë dua për ta shtyrë gjithë atë rrugë.

— Dhe asgjë më tepër?!

Ajo më hodhi një vështrim të çuditur dhe mblodhi supet.

— Po gjithë ato fjalë të bukura që sapo the, ç'ishin? — vazhdova.

— Pse, s'paskam edhe unë të drejtë një herë të përfytyroj gjëra të paqena? Ka njerëz që me përfytyrime të tilla merren tërë jetën.

— Ti je absurde, je aq absurde, sa nuk durohesh, — shpërtheva unë dhe bëra të largohesha duke turfulluar.

Ajo zgjati me rrëmbim dorën e më zuri për krahu.

— Mos u bëj budalla! — tha duke qeshur.

— Budalla e shkuar budallait po më bën ti ditë për ditë, — iu ktheva unë, që s'po më binte inati.

— Po ti s'duhet t'i marrësh kaq seriozisht fjalët e mia, — vazhdoi ajo pa ma hequr dorën nga krahu. — Akoma s'u mësove?! Ç'të bëj, kë shtu jam gatuar. — Në fytyrë i dallova një hije të singertë pendimi dhe më erdhi keq. Megjithatë nuk durova dot pa ia thënë mendimin që më erdhi:

— Diçka nga ti duhet marrë seriozisht, drejtë e mori.

— Ke të drejtë, — tha dhe pendimi në fytyrë iu bë edhe më i dukshëm. — Ja, seriozisht merre këtë që po të them tani: unë të dua.

Unë vura buzën në gaz i zbutur.

Ambulancën unë e kisha pak larg nga puna, ndërsa Arta vetëm dy hapa. Sa të kapërceje një rrugë. Ndaj kishte mbërritur para meje dhe e gjeta te shkallët e jashtme, me një dorë në xhepin e xhakaventos. Sa më pa, pa pritur t'i afrohesha të paktën sa t'ia dallonim sytë një-

ri-tjetrit, më bëri shenjë me atë dorën e pa-
futur në xhep. Dhe i qeshte krejt fytyra:

— Aha, e paske humbur fare! Sikur të ka-
rënë pika, je zverdhur, limon je bërë. Pa më
thuj, si mëndon: juve burrave më shumë ju
prishet gjaku po t'ju vdesë gruaja apo e da-
shura?

— U ndala një çast të rregulloja frymëmarr-
jen.

— Unë s'kam grua, — iu përgjigja prerë, i
inatosur ngaqë me kuptova se tërë kjo kishte
qenë përsëri një trill i saj.

— Nejsë, e kam fjalën; më shumë ndihesh i
lidhur me femrën kur ajo është e dashura jo-
te, apo kur është bërë gruaja?

— Të thashë, unë s'kam grua!

— Si s'ma njohë zërin? — ndërroi bisedë
ajo duke folur pak si me qortim, po më fort
me përkëdhelje: Donte të ma ulte zemërimin.

— Pse, ti ishe?

— Unë, po kush? Hajde tani, na jep një ka-
fe të fortë. Shkojmë e pimë te klubi i Arkës
së Kursimeve. Kam tezen banakiere aty e na
i bën të mira. Hë, si është ajo! Djalli vetë.
Sonte në darkë pastaj do ta marrë vesh i tërë
fisi se kam një të dashur. E them seriozisht,
kjo tezja ime, që e ka nisur dhe po e mbyll je-
tën si banakiere, ka marrë një mani prej za-
natit: zbërthen marrëdhëniet e klientëve nga
mënyra si e pinë kafën. Thotë se ua zbulon
në sy ç'i bashkon në një tavolinë ata. Shkoj-

me njëherë ne të dy, e provojmë sa i ngjit falli!

Unë kaq e kam. Po dite të ma presësh vru-llin e parë, u dörëzova, më bien xhindët. Dhe ajo ma kishte mësuar këtë dobësi. Më ikën inati, vërtetë, po më lë prapa në kraharor një zbrazëti që nuk e mbush dot menjëherë. Edhe tani nuk po dija si t'ia bëja, të shkonim a të mos shkonim te klubi i Arkës së Kursimeve, ishte a s'ishte teza e saj aty, ato që thoshte për të qenë shaka, apo fliste seriozisht. Sa më shumë rrija me të, aq më fort më vështirësohej të kuptuarit e saktë të fjalëve dhe gjesteve që bënte. Sepse gjithnjë do të luhatej me domosdo midis humorit dhe seriozitetit. Vija kufitare që vinte ajo për t'i ndarë këto dy gjendje ishte thuaftë e padukshme edhe për një njeri që e njihte tashmë disi natyrën e saj, siç isha unë. Kishte një aftësi të çuditshme për t'i vëshur edhe gjësë më serioze një maskë komike, ashtu siç mund t'i bënte edhe anekdotës më me humor një prerje të beftë nga një pikë ku i zbulohej palca krejtësisht serioze, madje edhe dramatike. Unë isha i pamësuar me një mënyrë të tillë të sjelluri të tjetrit, aq më tepër kur kjo nuk mbetej në një apo dy raste të veçuara. Po lodhja ime gjithnjë e më e shpeshtë, si dhe mosaprovimi haptas herë pas here i veprimeve të Artës, nuk i tërhoqën kushedi vëmendjen e saj, që edhe ta shtynin të ndërronte sadopak. Kjo gjë nisi të më zemëronte në vetvete.

Nuk e di me ç'ritme do të rritej lodhja ime, i gjendur kohë më kohë në situata të tilla, të cilat, duhet thënë se i improvizonte gjithnjë bukur, sikur njëra prej tyre të mos bëhej shkak që unë të lëndohesha tepër në sedër. Ajo që si një kulm që u bashkua me një sërë rrethash. Atë ditë ndihesha shumë i lodhur. Ndaj, sa u ktheva nga puna, u shtriva të pushoja pak pa ngrënë as drekë. Nga gjumi u zgjova edhe më i drobitur e me një dhembje koke.

Në orën gjashtë kur u ngrita të dilja për ta takuar, siç e patëm lënë, pashë se jashtë binte shi. E kërkova çadrën gjithandej nëpër shtëpi, po nuk e gjeta. Kur e pyeta për të disatën herë nënën nëse e kishte parë, ajo e humbi durimin.

— Nuk ruaj çadrën tënde, — m'u përgjigj duke ngritur dorën e bezdisur.

Gjeta një të vjetër të babait, por ishte me dorezë të thyer e me pëlhurë të çngjyrosur, si t'i ishte hedhur një pah mielli të situar përsipër. Kështu, pati edhe një mijë vogëlsira të tjera që u mblodhën pa u ndier tek unë dhe gjetën rast të shpërthenin kur u ndodha në lojën e saj.

Kishte ardhur bashkë me një shoqe. Nuk u çudita pse bëri vetëm prezantimin e asaj, ndër- sa për mua nuk i tha asgjë, madje as emrin. Mendova se do t'i kishte folur më parë dhe ishte e natyrshme. Po më bëri që në fillim për- shtypje mënyra si më vështronte shoqja e saj. Me sy të hapur jashtë mase, sikur kërkonte të

mblidhte aty tërë dritën e llampave përreth e ta hidhte në fytyrën time, të cilën prapëseprapë nuk arrinte ta hetonte plotësisht. Po më shqetësonte vërtet. Pashë Artën, por ajo dukej fare e qetë. Dreq o punë, thashë me vete, mos është e sëmurë nga mendtë kjo vajzë?

Ashtu të tre hymë në kafe «Rinia». Përsëri sytë e së porsanjohurës nuk ndryshuan. Ajo thua jse nuk fliste. Kjo më përforcoi përshtypjen se ishte një e çekuilibruar mendore e asgjë tjetër. Mirë ajo e shkreta, thashë me vete, po Artë, xhanëm, ç'ma sjell këtu?! Mbase i është ngjitur, u përpoqa ta shfaqësoja. Aq më tepër, si të mos mjaftonte ai vështrim i budallallepsur, nga brënda asaj dukej se i gufonte një gaz që i vërshonte deri në buzë e aty mezi i shuhej prej së thepurës së një goditje të fshehtë që, me siguri, ia jepte Artë për nën tavolinë. Unë i hodha vetes vjedhurazi një sy të shihja mos kisha në pamje ndonjë gjë që e ngacmonte ashtu vëmendjen e së porsanjohurës. Kurrë nuk gjeta asgjë, u ndjeva edhe më këq, se nuk i përgjigjesha më dot bisedës së Artës. U shpërqendrova në mënyrë të habitshme dhe nuk mundesha ta mblidhja veten, me gjithë përpjekjet. Kjo gjendje bezdie dhe nervozizmi, mbase, më shtyu të jem aq i paturpshëm ndaj saj dhe ta pyes:

— Ç'm'i shqyen sytë ashtu? Sikur sheh një lugal!

Edhe sot habitem si fola ashtu, krejt jashtë natyrës sime.

Vajza u skuq deri te veshët, iu mor goja e mezi mundi të nxirrte një grumbull të ngatërruar tingujsh. Të paktën unë nuk e okuptova çfarë deshi të thoshte. Qe diçka edhe si kundërshtim, edhe si shfajësim me një:

— Jo... unë... pse...

Arta vuri buzën në gaz po aq e qetë sa edhe më parë.

— Nuk desha t'ju fyeja, më falni! — thashë, unë sinqerisht i penduar që e rëndova, sepse m'u përforcua në kokë mendimi që ajo ishte një e mangët dhe njerëz të tillë, sidoqoftë, nuk qortohen. Për ta ndrequr disi gabimin që bëra, vazhdova me shaka: — M'u duk sikur po më shihnit me kureshtjen që shihet një gjë e rrallë. — Dhe qesha lehtë.

— Por edhe pak të drejtë e kam, — m'u përgjigj ajo, që kësaj here e kishte mbledhur disi veten. — Ju përfytyroja krejt ndryshe, të them të drejtën.

— Ndryshë?! Si? — Nga zëri që më doli, u kuptua që unë nuk e prisja këtë përgjigje të saj.

— Si të të them, një plak të rrëguar, që, më shumë se moshë, e ka vrarë mundimi i ëndrrave të veta me perëndi e me djaj të paqenë, sado që Arta më ka thënë se jeni i mbajtur jashtëzakonisht mirë. Duket që i keni kushtuar shumë vëmendje vetes dhe keni ditur të përkujdeseni. Dihet, kjo është shenjë kulture të lartë, por, më sadi, jo aq e kulturës orientale.

Unë nuk e ndërpreva deri në fund, me shpresë se do të kuptoja diçka në ato që thoshte, po më kot. Iu përgjigja më fort për t'u argëtuar me vazhdimin e bisedës.

— Me perëndi?! Çne ëndrrat e mia me perëndin e me djaj?! Pastaj, pse duhej të isha patjetër plak e për më tepër i rrëguar? — Desha të shtoja edhe se ç'lidhje kisha unë me kulturën orientale, por e lashë.

Arta rrinte e dëgjonte dialogun tonë absurd me shpërfilljen dhe kënaqësinë që të jep një spektakël variete.

— Edhe me një llogari të thjeshtë të kohës, këtu të çon mendimi, — vazhdoi vajza edhe më e sigurt te vetja. — Po mbushen njëzet vjet që kur u shembën xhamitë. Ç'moshë keni pasur ju atëherë?

— Unë?! Ç'moshë kam pasur unë?! — Nuk po kuptoja asgjë ku donte të dilte. Çdo fjalë që thoshte, sado që fliste me një gjuhë të zgjedhur, vetëm ma përforconte përshtypjen për të metat e saj mendore. Megjithatë, për të mos e lënduar, vazhdova t'i përgjigjesha: — Kam qenë në klasën e dytë të shkollës fillore.

— Mos u tallni!

— Mos u tallni ju! — Thirrja e saj për seriozitet m'i acaroi nervat më keq. — Unë po i përgjigjem pyetjes suaj. Po deshët, jua tregoj edhe letërnjoftimin.

Arta mezi po e mbante të qeshurën. Megjith-

atë e la dialogun tonë të shkante deri në fund, pa na ngacmuar.

— A mund t'jū pyes për kë po më merrni?
— vazhdova, tani me një ironi brutale, të pafshehur. Ajo e ndjeu dhe u skuq përsëri.

— Mos ma merrni për keq, — tha me një pamje të pafajshme, — por Arta më ka sjellë këtu që të më njohë me profesorin e vet të osmanishtes, një ish-hoxhë. Ndaj edhe isha si e topitur, ngaqë nuk po e kuptoja dot, kisha përpara një njeri të zakonshëm, një moshatarin tonë, siç më ngjante, apo dikë që dinte ta fshihte në mënyrë aq të përsosur moshën e vet. Apo e tëra ishte një sugjestion, një marifet nga ato që bënë dervishët. Unë s'kam faj; kur vjen njeriu me një paramendim të ngulitur fort në kokë, e ka tepër të vështirë ta shkulë...

— Jo, ju nuk keni asnjë faj, — foli unë prërë, — fajin ma ka kjo, që nuk hoqi një herë dorë nga kalamallëqet.

Tërë mllafi i grumbulluar pa u ndier, pikë-pikë, nga lojërat e saj të vazhdueshme, ku unë dilja gjithnjë i humbur, shpërtheu. Duket që e pashë tepër egër, se Arta u përmbloodh menjëherë, si ta kishte goditur dikush. Por unë s'i lashë kohë të fliste. U ngrita me rrëmbim dhe dola nga kafeneja duke ecur si i ndërkyer. Dëgjova nga prapa një zë, pastaj trokitjen e këpucëve të tyre, të shurdhuar paksa nga asfalti i zbutur, dhe prapë zërin e Artës që më thërriste në emër.

Në të thirrurën e saj dallohej një alarm dhe keqardhje. Por unë nuk i ktheva përgjigje. Vetëm shpejtova hapat që të mos më arrinin. Nuk kisha marrë asnjë vendim, por atë mbrëmje nuk duroja kurrsesi t'i takoja përsëri. Le që aty për aty nuk mund të merrja vendim edhe të përpiqesha. Vendim për të mos e takuar më nuk kam marrë as sot, kur ka kaluar kaq kohë.

Qëlloi që të nesërmen që në mëngjes më thirri shefi e më tha se duhej të nisesha urgjent me shërbim për në Veri, ku do të rrija dy javë. Kur u ktheva shoku i zyrës më tha se që atë ditë që ika më kishte kërkuar Arta në telefon dhe ishte çuditur shumë nga shërbimi im i befasishëm. Aq më fort ishte çuditur nga kohëzgjatja e tij dyjavore. Unë u mata njëherë t'i telefonoja, sepse më erdhi mirë nga interesimi i saj, po se ç'më mbajti. Po atë ditë u gjenda përballë me të në bulevard. Ishte midis dy vajzave. Ndalova hapat dhe ndjeva zemrën të më rrihte me shpejtësi, por ajo kaloi pa më folur. Ndoshta nuk më pa, ndoshta priti ashtu si unë, që të mos e thyente ajo e para akullin e krijuar gjatë atyre dy javëve. Nuk e di. Di vetëm që u largova nga bulevardi i madh me një ndjenjë këputjeve që më përsëritet sa herë e shoh prej së largu. Pranë nuk na ka qëlluar më të ndodhemi, edhe pse kanë kaluar disa muaj. Ndoshta edhe ajo, si unë, pret një rast.

— Por rastet vijnë gjithmonë kur je i papërgatitur për to, — thotë një shoku im.

Dhe historia ka mbetur kaq gjatë e pambyllur, si një plagë e padukshme që jep një dhembje të njëtrajtshme, me të cilën mësohesh, bile të bëhet e nevojshme.

1985

1985

... dhe historia ka mbetur kaq gjatë e pambyllur, si një plagë e padukshme që jep një dhembje të njëtrajtshme, me të cilën mësohesh, bile të bëhet e nevojshme.

DY JAVË PUSHIM

Në dhomë do të banoja me njëfarë Sihat Nuzi. Punonjësja e hotelit, që bënte regjistrimin e pushuesve, e njihte mirë, pasi ai kishte ardhur dhe vite të tjera. Për të vetmen gjë që e pyeta sportelisten ishte mosha e tij dhe ajo m'u përgjigj:

— Te të tridhjetat. — Pastaj shtoi: — Punon inspektor arsimit diku në një lagje të Tiranës.

Unë nuk desha të vija për pushime këtu, po më detyroi mjeku. Duhej të kaloja patjetër pak kohë në një stacion ujërash termale. Do të më bënte mirë për frakturën që pata në shtyllën kurrizore nga një aksident automobilistik pak muaj më parë. Kur mora vesh se do të isha në dhomë me një njeri pak a shumë të moshës sime, u gëzova, sepse gjatë tërë rrugës kisha merak se

mos më qëllonte ndokush që të mos merresha vesh e do të mërzitesha edhe më tepër.

Nga stacionet e ujërave termale kisha një shije të keqe, të pashpjegueshme, me siguri të mbetur nga leximi i ndonjë libri, sepse asnjë nga të afërmit e as nga shokët nuk kishte qenë atje ndonjëherë, që të më tregonte konkretisht si kalohet koha.

Sihati ishte vërtet te të tridhjetat, i gjatë, i hollë, me një fytyrë të imët e tërheqëse, që e shëmtonte pak e qeshura, sepse i krijonte njëfarë mbledhjeje të lëkurës te mollëzat e faqeve. Më tha edhe vetë se ishte i treti vit rresht që vinte këtu, sepse kurohej nga veshkat, por edhe sepse ky kamp kishte ushqim shumë të mirë. Kishte mbaruar dy vjet pas meje për histori, megjithatë unë nuk e mbaja mend në universitet.

Ishte nga ata tipa që e shfaqin menjëherë jetën e tyre. Kam njohur edhe të tjerë që kanë dëshirë të të flasin që në njohjen e parë për të kaluarën e vet dhe gjithnjë kam menduar, pa i dhënë dot përgjigje se nga u vjen kjo: nga naiviteti apo është një përpjekje e vetvetishme për të kompensuar ndonjë mangësi të së tashmes. Ky Sihati, për shembull, që atë ditë, pa zbritur ende në restorant të hanim darkën e parë së bashku, më tregoi se ishte beqar. Në vitin e fundit të fakultetit kishte pasur një histori dashurie me një vajzë të Institutit të Arteve dhe do të ishin fejuar, po të mos që dënuar babai i saj, oficer me një de-

tyrë të rëndësishme në Ministrinë e Mbrojtjes, i përzier me grupin puçist të ushtarakëve.

Unë ndjeva vërtet njëfarë keqardhjeje për të, jo aq shumë për dashurinë e humbur, sesa për të tanishmen e tij pa dashuri.

Pastaj më tregoi se si kishte qenë mësues në një nga fshatrat e malësisë së Dajtit, si erdhi në Tiranë e një vit më pas u bë inspektor arësimi për lagjen. Tani për tani kjo i dukej de-tyrë e rëndësishme dhe mjaft e pushtetshme, sepse e lidhte me mësuesit e disa shkollave tetë-vjeçare dhe të mesme të kryeqytetit.

— Ata kanë rrethe të ndryshme familjare, — tha ai, — më kupton?

— Sigurisht, — ia ktheva unë, që m'u duk shumë i çuditshëm ky pohim dhe aq më fort këmbëngulja e tij për ta kuptuar.

— Por unë jam inspektor, duhet t'i kontrolloj, apo jo?

Unë tunda kokën me po atë ndjenjë çudie të mëparshme, po tani edhe me njëfarë shpërfilljeje të hapur.

— Mënyra se si i kontrolloj, ç'marrëdhënie ndërtoj me ta më shërben për të ardhmen, — tha ai. — Po në shkollë ndërthuren edhe shumë interesa të tjerë. Ti e kupton vetë, kushdo, pavarësisht nga posti, është në radhë të parë prind, dhe si prind ka dobësitë e veta njerëzore.

Në rrethana të tjera do ta kisha humbur durimin. Atë çast i kalova shumë rrëshqitazi fjalët e tij, madje edhe duke u munduar të mos

mbaja mend shumë nga ato që thoshte. Kisha ardhur me paramendimin që të mos e lodhja kokën fare ato dy javë. Por edhe nuk doja të formoja që në fillim ndonjë opinion të keq për atë njeri, me të cilin, pas këtyre dy javëve, pō të mos doja, nuk do të më lidhte asgjë. Një opinion i keq do të ndikonte domosdo në sjelljet time ndaj tij, do të më ftohte e do të më largonte.

Duke e parë thjesht si një njeri të rastësishëm, me të cilin do të më lidhte një kalim kohe i çlirët në dhomë, loja e letrave dhe e shahut e ndoshta edhe ndonjë shëtitje e shkurtër mëngjesëve dhe pasditeve në pyllin e gjelbër të pishave, mendova se do të ishte më mirë të mos ua vija mendjen dobësive të karakterit të tij, sepse do ta kisha më të lehtë të ndërtoja edhe ato marrëdhënie që më duheshin me të. Aq më tepër që ai kishte edhe diçka që është e mirë, sidomos kur je me pushime: dinte shumë anekdota dhe i tregonte bukur. Të treguarit e historirave i shkollonte edhe me të folurën, që e shoqëronte me shumë lëvizje e me një grimasë tepër të ndërrueshme. Kjo ai kishte siguruar vazhdimisht sukses në mjediset e pushuesve dhe mua, për sa kohë nuk fliste për vete, më bëhej i këndshëm qëndrimi me të. Por, pas asaj zbrazjes së parë, sig duket ai edhe nuk kishte më ndonjë gjë të veçantë për të më thënë, se gati nuk e solli më fjalën aty. Ndaj edhe u afruam më shumë.

Dy-tri ditët e para rrinim më të shumtën

bashkë. Ndërkohë ishim njohur e shkëmbenim përshëndetje me pjesën më të madhe të pushtuesve. Dhe, siç ndodh zakonisht në raste të tilla, ishte krijuar ai shpengim i këndshëm për të hyrë drejt e në grupin ku mund të jenë tre-katër veta duke blseduar, sepse je i bindur se nuk kanë në gojë asnjë të fshehtë që mund të jetë vetëm për ata.

Dita kështu kalonte me njëfarë përhumbjeje, pa u ndier dhe pa lënë prapa ndonjë gjë të madhe që të mbahej mend gjatë, përveç atij gëzimit të mëngjesit, kur njerëzit i kumtonin njëri-tjetrit se ishin gdhirë më mirë dhe lavdëronin ujin e ngrohtë të banjave termale. Pastaj uleshin e tregonin për orë të tëra, duke përsëritur si sot nesër, se me çfarë ishin kuruar më parë, si u kishte lëvizur shëndeti, ç'mendonin mjekët, bënin parashimike optimiste për të ardhmen. I shihja se nuk mërziteshin dhe pak nga pak, pavëmendshëm, po hyja edhe unë në atë gjendje. Kushedi sa herë m'u desh ta përsëritja historinë e aksidentit, aq sa vura re se vetvetiu po më krijohesh edhe njëfarë manie për ta bërë më dramatike sesa kishte qenë në të vërtetë.

Ndoshta nga ky komunikim i përgjithshëm miqësor nuk e ndjeva se Sihati kishte filluar të rrinte më pak me mua.

Për së pari mungesën ia ndjeva një ditë, nga fundi i javës së parë të pushimeve. U zgjova nga gjumi i pasdrekes dhe më vajti mendja të dilja në qytet. Qyteti ishte nja pesë kilometra larg

stacionit termal dhe shkohej me autobus. Thashë ta kaloja andej mbrëmjen edhe për ta ndryshuar një herë regjimin uniform të gjithë këtyre ditëve, me atë rast i shëtitja edhe dyqanet e kryeja ndonjë porosi të gruas. Por edhe të nise-sha vetëm përtoja, ndaj u kujtova për Sihatin. Pashë shtratin e tij të paprishur dhe e kuptova se nuk kishte ardhur fare për të pushuar. Zbrita poshtë se mos e gjeja në sallën e bilardos, nuk ishte. Kalova nga kafeneja, i rashë rrotull parkut të qarkuar prej hoteleve dhe ndërtesave të tjera, po prapë nuk ishte. U çudita se ku do të ishte futur, pasi aty vendi ishte i mbledhur e me një të hedhur të syve mund të gjeje këdo.

— Ku m'u fshehe pasdite? — i thashë kur më erdhi në dhomë në mbrëmje vonë. — S'lashë vend pa të kërkuar.

— Me Selman Vehapin, — m'u përgjigj dhe vuri buzë në gaz.

Unë rrudha supet. Me siguri e kisha parë, po tani nuk lidhja dot fytyrën me emrin që përmen-dej.

Isha pak qejfprishur jo ngaqë nuk vajta në qytet, se mund të shkoja dhe nesër a pasnesër, nuk kisha asnjë ngutje, po vetvetiu, ndodh nga-njëherë që të kalon një rrymë e ftohtë nëpër shpirt e ta prish humorin e nuk je në gjendje të shpjegohesh se nga të ka ardhur. Megjithëse nuk ia kërkoja, Sihati zuri të më fliste për këtë Selmanin dhe mua m'u ngjall një bezdi. Ai e ndjeu vrenjtjen time e nuk e çoi gjatë. Mora vesh

vetëm se Selman Vehapi ishte një veteran i nderuar nga Tirana, me të cilin Sihati ishte njohur qëllimisht para dy ditësh. Qëllimisht?! Pse? desha ta pyesja, por e lashë. Ç'më duhet, shtova, punë e tij. Mbase më shtyu të mos e pyesja edhe mungesa e dëshirës që më kishte hipur, kotnasikoti, të dëgjoja për atë njeri të panjohur.

Të nesërmen, tek shëtitja vetëm nga pylli i pishave, u gjenda përballë Sihatit, që gjithashtu po shëtiste me të njohurin e vet. Të dy ecnin me një hap të ngeshëm e të rëndë, me supet thujajse të puçura, sepse Sihati i kishte futur krahun dhe e mbante afruar nga vetja. Ngaqë asnjëri nuk ishte duke folur, dukeshin sikur jetonin një ëndërr të përbashkët. Për një çast m'u bë t'u shmangesha, po Sihati, që më pa, më thirri duke u gjallëruar përnjëherësh:

— Ky është shoku Selman që të foli mbrëmë, — tha me po atë gjallëri.

Unë i zgjata dorën të porsanjohurit pa shprehur asnjë entuziazëm të veçantë.

— Ndërsa ky është shoku Teki, shoku im i dhomës, por edhe më tej akoma, shoku im i viteve të fakultetit, — iu kthye Sihati veteranit, që bëri lehtë buzën në gaz.

Unë i hodha Sihatit një vështrim të mrrolur, si për t'i thënë: që kur fillove të më flasësh me shoku. Pastaj nuk më pëlqeu as hollësi e paqenë që dha ai për mua si shok i vjetër i fakultetit. Por nuk ishte vendi aty t'ia bëja këtë vërejtje, aq më tepër që më tërhoqi vëmendjen fytyra te-

për e bardhë, sikur të mos i lëvizte fare gjak nën lëkurë, e të porsanjohurit. I mbështetur në krahun e Sihatit, ai përpiqej ta mbante trupin eshtak e të gjatë sa më drejt, gjë që i jepte një solemnitet të hijshëm dhe të ngjallte shumë shpejt respekt.

Sa qëndrova unë me ta, foli thuajse vetëm Sihati, që nxitoi të më tregonte se shoku Selman kishte punuar në detyra shumë të rëndësishme, deri edhe zëvendësministër e do të kishte vazhduar të ishte edhe tani, po nuk i kishte ecur shëndeti.

— Me atë jetë të vështirë, plot luftë e përpjekje të pareshtura, e sidomos vitet partizane, domosdo që do t'i shkatërrohej shëndeti, — m'u drejtua mua Sihati më një seriozitet që nuk ngjante fare i tillë. — Të fortë, për nder, si keni ardhur edhe deri këtu, — iu kthye veteranit, — pa pasur kohë të mendoni një çast për veten... Ne, me gjithë këto kushte të shkëlqyera, e ja, mbetëm spitaleve.. — Zëri i Sihatit qëndroi pezull, si të kërkonte me ngulm ta mbështetja edhe unë. Por unë heshta e i hodha një vështrim si për t'i thënë se e teprove.

— Jo, o Sihat, jo, — ndërhyri Selmani me buzë në gaz, — nuk është vetëm shëndeti. Ne kaq mundëm të bënim.

Fjalët e tij m'u dukën të çiltra e nuk munda të dalloja atë tingëllim që i jep zërit njeriu kur kumton diçka që te dëgjuesi në të vërtetë duhet të thotë të kundërtën, atë që quhet modesti falsë.

Dhe më pëlqeu. Por edhe ma përforcoi mendimin se tërë ajo breshëri fjalësh të fryra që lëshoi Sihatit kishin qenë krejt të pavend.

Sihatit, që nuk kuptoi as vërejtjen time të heshtur, as tonin e Selmanit, këputi edhe një të dytë.

— I ke lexuar kujtimet e shokut Selman?

— Jo, — u përgjigja unë i zënë ngushtë.

— Ah, ju biologët, — m'u drejtua përsëri me një qortim miqësor prej njeriu të sprovuar e të ditur, — sa të mangët e keni kulturën e përgjithshme. Kujtoni, se gjithçka është të njihni si kryhet fotosinteza. Jo, ore, jo, — vazhdoi ai me po atë ton patetik, — duhet të lexoni edhe histori, edhe letërsi. E sidomos libra të tillë, ku ndërthuren aq bukur historia me letërsinë, siç janë kujtimet e atyre që e kanë jetuar dhe bërë historinë si heronj të saj.

— Nuk është ndonjë mangësi pse nuk e ke lexuar një librushkë timen me kujtime, — ndërhyri përsëri Selmani dhe buzëqeshja ia bëri fytyrën e bardhë edhe më të butë.

Unë i hodha Sihatit një vështrim të ashpër për t'i dhënë të kuptonte se kishte shkelur çdo kufi dhe ndihesha i fyer thellë.

Pas kësaj, megjithëse i porsanjohuri më la një përshtypje të mirë dhe do të kisha qëndruar me të me dëshirë, u ndava se m'u krijua një bezdi e papranueshme nga sjellja e Sihatit.

Në mbrëmje Sihatit përsëri erdhi vonë. U mundua të më shpjegonte se kot isha prekur, por unë e ndërpreva duke i thënë ftohtë se nuk ki-

sha asgjë dhe se tani ishte më mirë të flinim.

— Ti e kupton vetë, ai është burrë plak e plaku është si fëmija, e do një fjalë të mirë, merr krahë prej saj... — deshi ai të shpjegohej, por unë e ndërpreva, duke i thënë përsëri, krejt ftohtë, se do të qe më mirë të flinim.

Atëherë ai nuk e zgjati më dhe fiku dritën.

— Ti merre si të duash, po mua më duket se nuk ke aspak të drejtë, madje është absurde,... gjëra të tilla, midis shokësh... — bëri ai edhe një përpjekje të fundit pasi u shtri.

Unë thashë t'i kthehesha njëherë, t'ia bëja të qartë se nuk jemi shokë, po hoqa dorë dhe nuk iu përgjigja. Më mirë le ta kuptonte vetë. Hesh-tja që ra pas këtyre fjalëve e bëri errësirën e dhomës edhe më të plotë.

Unë e ndjeva se mbeti i pakënaqur nga sjellja ime dhe me siguri, në ato minuta që nuk po e zinte gjumi, duke u rrotulluar sa në një krah në tjetrin, mendonte për mua, sepse, me sa kisha parë, që në fillim i kishte bërë përshtypje qëndrimi im konstant, pa entuziazëm të shfrenuar, por edhe pa atë pozën e qëllimtë të njeriut të menduar, që e sheh rëndom te disa, sidomos kur bien në mjedise të panjohurish. Ndoshta ky qëndrim i kundërt me të vetin i krijonte një lloj sugjestionit, sepse gjithnjë e më shumë e shihja të përmbahej, madje shpesh kur gjendeshim vetëm për vetëm kishte njëfarë stepjeje. Kurse në rreth të gjerë do ta merrte me domosdo revanashin. Prania e të tjerëve, siç duket, i krijonte njëfarë

euforie që nuk e shpjegoj dot. Ka mundësi që, i rrethuar nga një grup njerëzish, sidomos kur këta ishin të thjeshtë, siç thuhet, pa ndonjë detyrë drejtuese, aq më fort kur vinin edhe nga rrethe të largëta e të vogla, i zgjohej vrullshëm deliri i superioritetit mbi ta, i ushqyer në mënyrë qesharake nga ideja e njëfarë pushteti që mund të ketë në dorë e që mund ta lidhë me interesat e njerëzve në përgjithësi, sado që për ta ushtruar këtë pushtet kishte vetëm territorin e një lagjeje të Tiranës.

Më të shumtën e këtyre gjërave i kam menduar kështu të stërholluara më vonë, kur isha kthyer në shtëpi dhe, siç ndodh rëndom me kalimin e kohës, në çaste kur gjendesh disi bosh, të rrëmbejnë mbresat e së shkuarës, duke kërkuar shpeshherë t'u japësh edhe një kuptim që s'ia ke dhënë më parë përmbajtjes së tyre.

Thashë pak më parë se në kamp u krijua menjëherë një atmosferë e shpenguar, e pëlqyeshme, sepse e ndieja singërisht që nuk i bëheshe askujt i tepërt duke ia afruar kurdo. Sidoqoftë, pjesën më të madhe të kohës secili e ndante me një ose dy veta. Unë me Sihatën. Dhe kur ai nisi të më largohej, unë fillova ta ndieja veten disi të vetmuar. Ndoshta ndikoi për keq edhe mendimi se Sihatë po më braktiste mua për të ndenjtur me të tjerët. Në këso rastesh se si pëson një lloj deformimi të papërcaktuar, të lind një mëdyshje që ka të bëjë edhe me ty, edhe me atë tjetrin. Ka të bëjë me ty sepse e sheh veten me njëfarë dyshimi

e qortimi, të paktën kështu e pashë unë kur arsyetoja: Selmani është burrë i vjetër e për më tepër i sëmurë. Ç'bën Sihati? E shoqëron duke e mbajtur butësisht për krahu, sepse ai ka nevojë të mbështetet diku. I krijon edhe mundësinë të bisedojë me dikë. Ai mund të rrinte edhe me një moshatar të vetin e të gjente shumë mirë një gjuhë të përbashkët. Po te moshatari atij do t'i mungonte qëndrueshmëria e krahut të Sihatit. Ose një i ri tjetër mund ta kishte bezdi të ndiente t'i mpihej bërryli duke mbajtur tërë ditën varur krahun e një plaku. Ndërsa Sihati, siç dukej, e bënte këtë punë me shumë zell e pa u mërzhitur fare. Duke menduar kështu, i jepja të drejtë Sihatit dhe e qortoja veten ashpër për meskinitet dhe egoizëm. Në këto raste as që më vente mendja te ndonjë dobësi karakteri e Sihatit.

Pastaj qëllonte që arsyetoja ndryshe. Më dukej sikur Sihati më kishte parë si të padenjë për veten, nuk ia kisha plotësuar nevojat që mund të ketë ai për shokun e bisedës. Këtu jo vetëm nuk i jepja aspak të drejtë, por edhe e quaja një megallomani të tepruar nga ana e tij, sepse, duke e shoshitur hollë gjatë kohës, që tani e kisha gjithnjë e më të bollshme, i jepja karar se ai, veç anekdotave, pak gjë tjetër mund të përdorte në bisedat me mua. Ai nuk lexonte thujse fare dhe për mua ky është një nga treguesit më të qenësishëm. Atëherë, kuptohet, fajin ia hidhja atij, duke ruajtur edhe për vete, pa shkas, një ndjesi faji se mbase e teprua me ashpërsinë që tregova

ndaj tij atë natë. Përderisa nuk e njoh thellë, thosha me vete, nuk kam të drejtë të mendoj se ai nuk ma kishte, ashtu siç tha, pa të keq. Tani e kuptoj se te kjo ndjesi e papërligjur faji më shtynte një dëshirë e përhershme që kam unë për t'u pajtuar me njerëzit, ose përndryshe të këput çdo lidhje me ta. Ato marrëdhëniet e ndërmjetme, sipërfaqësore, nuk i duroj dot.

Më ndodhi disa herë të rrija me Sihatit dhe Selmanin sidomos në restorant. Fytyra e plakut ishte gjithnjë e bardhë e fisnike dhe zbukurohej veçanërisht kur fliste. Po gjithnjë, sapo ndahehim, më dukej se në atë fytyrë kisha zbuluar diçka të re, që më lidhej në mënyrë të pashpjegueshme me praninë e Sihatit. Mosha e shtyrë, por sidomos fryma autoritare që e kishte rrethuar veçanërisht vitet e fundit të karrierës, ia bënte atij disi të vështirë ta vlerësonte kurdoherë drejt sjelljen e njerëzve, të ndante respektin e çiltër me interesin.

Unë e kuptova këtë dikur, po nuk arrija ta kuptoja tjetrën: ku e shihte interesin Sihatit. Selmani tani kishte vite në pension, nuk e kishte më, si të thuash, drejtpërdrejt, fuqinë e urdhrit, pushtetin e firmës.

Ku nuk shkonte mendja ime, hallakatej në gjithfarë absurditetesh, derisa lodhej. Atëherë dëgjoja një zë të brendshëm që më thërriste me qesëndi të kthehesha te pushimi, për të cilin më kishin dërguar këtu mjekët. Kisha ardhur këtu me paramendimin e prerë që në këto dy javë të

stakohesha nga çdo lloj vramendjeje, sepse vetëm kështu do ta siguroja atë prehje të vërtetë të trupit e të trurit. Tani e kisha të pamundur të shkëputesha prej pyetjes se kush e kishte fajin që unë me Sihatit nuk rrinim më bashkë, se ai bënte mirë apo keq që i përkushtohej atij tjetrit, se nisej thjesht nga respekti apo e lidhte ndonjë interes, se Selmani ndiente kënaqësi apo bezdi nga prania e tij etj., etj. Isha i sigurt se, po të mund ta ktheja edhe një herë mendjen te puna që më priste pas pushimeve, do të çlodhesha shumë më tepër. Kotësitë, kur të mbushin kokën, janë një makth i vërtetë.

Veç, që ishte e nevojshme të merrja një përgjigje, e cila t'i përmbliidhte pak a shumë gjithë këto pyetje, ishte. Ndaj, një mbrëmje, aty nga fundi, nuk u përmbajta dhe e pyeta Sihatit.

Sihati më pa me njëfarë çudie nënvleftësuese.

— Vërtet nuk e kupton? — tha.

— Jo, — iu përgjigja sinqerisht.

— Jam i ri unë, — tha ai dhe buza i rrëshqiti në atë gazin që nuk ka të bëjë aspak me ndonjë hovje të brendshme shiptërore, po që të ndihmon për të shprehur një mendim pak të vështirë për t'u thënë. — Jam i ri unë, dua të eci përpara, — vazhdoi ai. — Selmani hyn në shtëpinë e filanit (dhe përmendi emrin e një personaliteti politik) si në shtëpinë e vet. Janë shokë të ngushtë qysh nga koha e Luftës.

— E pastaj? — vazhdova unë si hutaq.

— E po, mësohu edhe ti një çikë, de, po pla-

kesh! Një fjalë që mund t'i thotë atij gjatë një dreke Selmani, është një kërcim vertikal për mua. — Ai vazhdonte ta kishte atë buzagazin që i shpërndahej si me zor deri te mollëzat e faqeve dhe i krijonte aty një hije rrudhash të imta që e bënë fytyrën e tij të dukej si e palarë dhe më erdhi pështirë.

Të pasnesërmen, kur do të largoheshim, e pashe përsëri me dy valixhet e Selmanit, duke u afruar tek autobusi dhe mendova se dy javë, qoftë edhe pushime, nuk janë pak për t'u zbuluar njeriu.

1984

NJË LOJË PA TË KEQ

Ne të tre ishim në fakultete të ndryshme, por në konvikt na dhanë një dhomë të përbashkët ngaqë drejtonim qendrën e zërit «Studenti» e na duhej të përgatitnim emisionet e saj. Aty u njohëm edhe me Anestin, teknikun e vetëm që merrej me meremetimin dhe mirëmbajtjen e amplifikatorëve, mikrofonëve dhe aparaturave të tjera.

Me kalimin e kohës u miqësuaam shumë me të. Përveç atyre gjërave të zakonshme, si bie fjala, që ai ishte nga një fshat i Devollit dhe që në Tiranë që vendosur pas mbarimit të ushtrisë, se kishte dy fëmijë, një djalë e një vajzë dhe se gruaja i punonte në ndërmarrjen e prodhimit të qilimave, ne mësuam edhe që ai e kishte hall të madh punën e djalit, sepse nuk i shkonte mirë me

shkollën. Kështu u krijua shumë shpejt njëfarë afërie mes nesh. Ai vinte gati përditë në dhomën tonë të fjetjes e rrinte gjatë. Përgjithësisht me të bënim vetëm shaka. Ndoshta këtë mënyrë komunikimi me humor na e kishte diktuar vetë pamja e tij. Shtatgjatë, i mbushur, pak si tepër i mbledhur te shpatullat, saqë i dukej se ai afrim i mundimshëm i supeve për nga njëri-tjetri ia kishte ngathtësuar të tëra lëvizjet, që në të hedhurën e hapit e deri tek e folura, ku spikaste gjithnjë një grimasë habie e sinqertë, e cila shumë herë të përcillej edhe ty që i rrije përballë ngaqë nuk e shpjegoj dot, pasi, në më të shumtën e rasteve, ato që thuheshin, nuk e kërkonin. Nejse, ne u mësuam edhe me të e nuk na bënte më përshtypje, por vazhdonim të ngacmoheshim me shaka.

Në një nga këto ngacmime unë i thashë se Spiroja, të cilin ai nuk e fshihte dot që e donte më shumë se mua dhe Sokolin, kishte vendosur të fejohej. Spiroja nuk qe aty dhe ai ktheu sytë nga Sokoli, që gjithë seriozitet pohoi me një tundje të kokës. Mirëpo, kur pa se sytë e Nestit na luteshin që të mësonte diçka më tepër, Sokoli e çoi më tej pohimin, duke sajuar aty për aty edhe një histori. Vajzën me të cilën do të fejohej Spiroja e njihte edhe Nesti. Ajo studionte në vitin e tretë në Institutin e Lartë të Arteve për kanto dhe qe e njohur gjithandej si këngëtare. Vitin e kaluar u përfol keqas në tërë qytetin «Studenti» për një histori dashurie me të fejuarin e shoqes

së vet më të ngushtë, edhe ajo studente në Institut e për shkak të së cilës shoqja e vet u nda. Sokoli vazhdoi të tregonte, gjithnjë me atë pamjen serioze dhe thellësisht të merakosur, që i rrinte më së miri mbi fytyrë, se Spiroja ishte njohur me të para disa muajsh, kur ne e kishim thirrur në studion e qendërs së zërit për ta intervistuar pas çmimit që kishte fituar në festivalin e fundit të interpretuesve të këngës së lehtë.

— Qysh atë ditë nuk i ndahet e nuk i ndahet. Por edhe ajo di ta afrojë. E mësuar! Spiros i ka rënë kaq keq në kokë, sa s'ka njeri t'ia ndërrojë mendjen.

Nesti dëgjonte me gojën të hapur përgjysmë dhe në fytyrë i shkonte e i vinte një shprehje mosbesimi.

— Lërini, bre, këto shaka! — tha me një zë qortues e ankues njëherësh. — Nuk janë shaka për t'u bërë!

— S'janë shaka, — u hodha unë po aq serioz sa edhe shoku, bile duke u përpjekur të dukesh edhe më i shqetësuar, — është e vërtetë, për fat të keq.

— Ç'e vërtetë, mo?! Ku ju merret vesh juve kur thoni të vërteta e kur jo! — kundërshtoi ai pa fuqishëm dhe doli nga dhoma.

Ne të dy, siç ishim të shtrirë mbi batanije, secili në shtratin e vet, pamë njëri-tjetrin në sy e vumë buzën në gaz. Pastaj nuk folëm më për të deri në mbremje vonë, kur u kthye Spiroja e ia treguam. Ai qeshi pak e nuk na tha as mirë as

keq. Fjala kaloi diku tjetër, siç ndodhte zakonisht, sepse asnjëri nga ne nuk e kishte zakon të qeshte gjatë. Me siguri, fjala nuk do të ishte sjellë më kurrë tek ajo shaka, sikur të nesërmen Nesti, me të ardhur në dhomë, të mos na e hapte vetë bisedën. Me atë habinë e vet të veçantë, që i rrinte përherë veshur pas lëkurës së butë të fytyrës, na u lut t'i thoshim sinqerisht nëse qe e vërtetë apo jo ç'i treguam një ditë më parë për Spiron. Dukej që i kishte mbetur mendja atje.

— Sigurisht, — ia ktheva unë, që hyra menjëherë në lojë. Por, meqë në raste të tilla gjithmonë e kam të vështirë ta mbaj gazin deri në fund, që të mos e prishja, ia përcolla fjalën, me një vështrim, Sokolit.

— Ç'të bësh, Nesti! — vazhdoi ai me një zë paksa të dridhur, që e bënte më të kapshëm hallin e brendshëm. — Vetëm për këto punë nuk u vika dora në zjarr për asnjëri... Se... të thuash se Spiroja është i papjekur, i paditur, s'e thua dot...

Për mua, aty për aty, ishte krejt i pashpjegueshëm gjithë ky shqetësim i Nestit. Më vonë ne, që e sajuam tërë këtë lojë, do të pikëlloheshim, po tashmë ishte diçka që nuk zhbëhej.

— Po folini, bre, — tha Nesti trishtueshëm, — folini se e keni shok! Do t'i flas edhe unë, xhanëm, po ju e keni më të lehtë, ju ju dëgjon edhe më tepër.

— Ç'ti themi? — tha Sokoli kureshtar, sepse nuk po e merrnim vesh ku donte të dilte.

— Thuajini të ketë mendjen në kokë, nuk shtyhet jeta me laviren. Ja, këtë t'i thoni, hapur, siç i thuhet shokut që e do vërtet me shpirt. — Ai mori zjarr sikur mezi priste ta nxirrte jashtë atë mllef që po e bënte të vuante. — T'ia thoni hapur! Ju jeni të rinj e nuk e kuptoni se ashtu i bëhet mirë.

— Ehe, s'ka më vesh për këshilla të tilla ai, bile i mbetet qejfi, — u hodha unë duke tundur kokën lodhshëm, si për ta përforcuar të keqen që po ndieja. — Ç'po heqin edhe prindërit me të, mbetën këtu, po kujt t'i thuash?!

— Le t'i mbetet qejfi! Sa të dojë le t'i mbetet! Më vonë do ta kuptojë e do t'jua dijë për nder, të jeni të sigurt. Jua them nga jeta ime, se kështu më ka ndodhur edhe mua një herë e një kohë.

— Si? — pyeti Sokoli gati me rrëmbim, sikur të qe duke pritur me padurim që tjetri të dilte tek ajo fjalë.

Nesti hodhi një herë vështrimin nga Sokoli, pastaj nga unë.

— Po ja, kur sapo kisha filluar punë këtu, atëherë, pas ushtrisë, vajta në fshat për pushime. Çun i ri unë, i kisha flokët jo si sot, më rrinin krela-krela mbi ballë, por edhe fytyra më shndriste. Një ditë prej ditësh shoh një vajzë në rrugë. Sikur më ra njeri papritur me grusht kokës, aq u hutova. E ndoqa me sy nga do të vente. Ktheu për në shkollën e fshatit. Ma mori mendja se qe mësuese aty dhe s'u gabova. Yll ishte, yll e për-

mbi yll! Mezi durova sa gjeta dikë ta pyesja për të, se, që nuk ishte nga çupat e fshatit, këtë e dija. Më thanë se vinte nga Korça mëngjes për mëngjes e kthehej në drekë. Por do ti që shumë shpejt i rashë edhe unë asaj në sy! Zaten, si të mos i bija, kur qeshë bërë si i marrë. Ngado që të shkonte, do t'i fanepsesha unë përpara. Kështu që u shty edhe ajo të pyeste për mua. Nuk vonoi e u njohëm...

Filloi kështu Nesti të na tregonte historinë e asaj dashurie, që mua ma thotë mendja se është e vetme në jetën e tij. Fliste me një zjarrmi të brendshme, ku ndihej haptazi malli dhe brenga për humbjen e saj. Duke e dëgjuar, isha i sigurt se kjo përbënte të fshehtën e tij më të shtrenjtë dhe as që dyshoja se nuk ia kishte hapur askujt, të paktën prej shumë e shumë vitesh. Nesti i kishte dalë disa herë para në rrugë, kur shkonte e kur vinte, asaj vajze me trup të hollë e të drejtë, që, kur ecte udhës, i linte ajrit një frushullimë prapa si të mbante me vete një krua të fshehtë që rridhte pareshtur. Tek fliste, flokët e zez të prerë në vetull, i largonte herë pas here me dorë, që të mos ia zinin shikimin e paturbuluar. Nesti, pra, i kishte dalë disa herë në rrugë, po nuk kishte guxuar t'i thoshte gjë. Në një nga ato mëngjese, kur po vinte për në shkollë, ajo i kishte folur vetë e para:

— Paskeni marrë zakonin e tiranasve që t'i bëni shëtitjet gjithnjë në të njëjtin vend, — i kishte thënë dhe kishte vënë buzën në gaz.

Nesti ishte hutuar njëherë, sepse nuk e kishte pritur.

— Ku e dini ju se kam ardhur nga Tirana? — e kishte pyetur pas pak dhe kishte hedhur dy-tre hapat që i ndanin e i kishte qëndruar përballë.

— M'u bënë tre vjet në fshatin tuaj, ia njoh njerëzit tani ku i ka e ku s'i ka. Domosdo, më takon të marr diçka edhe nga zakonet e tij. Po ju, kaq shpejt paskeni harruar se në fshat çdo lajm përhapet si era?

— Unë jam i fshatit, ç'lajm është ardhja ime këtu?

— Është, si s'është?! Ti tani ke ikur, jeton diku tjetër, aq më tepër në kryeqytet dhe nuk mund të mos ngjallësh kërshtëri kur kthehesh.

Nesti na tha se ajo ishte dhe e zgjuar shumë dhe fliste bukur. Tha se nuk kishte parë kurrë ndonjëherë më parë as më pas vajzë që të fliste aq bukur. Pak nga pak, midis fjalëve të ndërprera nga grimca heshtjeje të Nestit, mua m'u ndërtua një përfytyrim i plotë i asaj vajze të panjohur, që dinte ta bashkonte në mënyrë të përsosur kuptimin e asaj që thoshte me mënyrën e mbajtjes së kokës, dritën e syve, lëvizjen e duarve, saqë të bëhej disi e pakapshme, sepse të afrohej e të largohej befas, me shpejtësinë e mendimit që shprehte atë çast. Dhe, kur guxoi ta puthte për herë të parë, Nesti me siguri u shty pikërisht nga një ndjenjë e tillë mosbesimi se ajo vajzë qe reale dhe se qe aty, me të, ulur në shtresën e butë të de-

gëve të shelgjeve në bregun e lumit. Sidomos pasi qenë ndarë që të takoheshin përsëri të nesërmen, atij i qe dukur se i kishte mbetur mbi buzë një lëndë e nxehtë, që e mblidhte ajrin mbi vete, e bënte viskoz dhe, sa herë hapte gojën, ia përcillte përvëlimin nëpër tërë trupin.

— Nuk isha puthur deri atëherë me ndonjë çupë, — tha ai me një zë të largët fajtori dhe unë, për herë të parë që kur e njihja, e pashë fytyrën e tij pa atë shprehjen e papërligjur të habitjes. Që nga balli lart e deri në mjekër i ishte shtresëzuar një dhimbje e verbër.

Bota ishte shqetësuar para se ai ta puthte për herë të dytë atë vajzë. E kishte thirrur i ati dhe e ëma e i kishin folur për të. Çfarë kishin lënë ata mangët, ia kishte plotësuar i kushëriri: «Pasditeve ajo kthehet në Korçë dhe bën dashuri me një sportist.» Unë desha ta pyes nëse e mori dot vesh sa i vërtetë qe ky lajm që i kishte sjellë i kushëriri, i cili banonte në Korçë, po Nesti nisi prapë të fliste:

— Në fakt, e dinte krejt qyteti se ai sportisti e kalonte kohën duke iu sjellur rrotull vajzave. Më vonë, për këtë gjë e përjashtuan edhe nga ekipi.

— Lëre, Nesti, lëre të shkuarën në kohën e vet! — tha Sokoli butë, por prerë. Në sytë e Sokolit unë dallova mugëtirën e trishtimit që e kisha ndier të më mbushte me shpejtësi edhe mua që prej disa minutash. Nuk duhej ta shtynim atë njeri deri këtu. Jo. Loja, sado pa të keq, na ki-

shte shkuar shumë larg, por duhej bërë diçka që të paktën të mbetej me kaq.

Nesti nuk e kapi dot arsyen e ndërhyrjes së Sokolit. Mua më kishin humbur fjalët. Vetëm e shikoja.

— U takuam edhe dy-tri herë të tjera, po... — me siguri ai deshi të shtonte se nuk e puthi më, po Sokoli e ndërpreu edhe më prerë e pa atë butësinë e parë:

— Ç'na i thua këto, Nesti?! Ne bëmë një shaka e kaq. Pse shkon kaq larg?

Sokoli u ngrit nga krevati ku ishte ulur qysh kur hyri Nesti në dhomë e nisi të vejevinte rreth tavolinës e deri te dera me një shqetësim të pafshehur. I shqetësuar isha edhe unë, po nuk di si e shprehja, pasi nuk e përfytyroja dot veten. Më kishte përpirë një mendim i lindur tani së fundi. Padashur, me një lojë krejt miqësore, e detyruam këtë njeri të na hapej në të fshehtën e tij më të dhembshur. Që ishte tepër e dhimbshme për të, tani nuk dyshoja. Dhe që nuk ia kishte treguar askujt që atëherë, prapë nuk dyshoja. Sepse, po ta kishte treguar qoftë edhe një herë, ajo nuk do të ishte më e tillë. Do të qe transformuar patjetër, siç u transformua tani. Duke e dëgjuar, më erdhën disa herë ndër mend imazhet e stolive të çmuara që kanë jetuar të paprekura nëpër varret e faraonëve për dhjetëra e dhjetëra shekuj dhe sot, sapo arkeologët e pakujdeshshëm i nxjerrin në dritë, oksidohen menjëherë. Nesti e kishte mbajtur të ndrydhur në

vete atë histori kaq vjet, pa guxuar asnjëherë t'i kthehej, sepse veten e kishte ushqyer me tjetër mendim, me mendimin se ajo vajzë ka qenë e padenjë për të. Ndërsa... Këtë mospërputhje që ndjeva unë, me siguri e ndjeu edhe ai vetë, sepse pashë si i zbriti në fytyrë ajo dhimbja e pakmëparshme, por tani në një vuajtje tjetër:

— Mosni, bre mosni, bre çuna! — tha. — Pse bëni lojëra të tilla?!

Dhe që atë ditë ai nuk erdhi më në dhomën tonë. Sesi ndihej para nesh, si i zënë ngushtë, por edhe ne mbusheshim me siklet para tij, siç të ndodh me njeriun që i ke një borxh po nuk ia lan dot.

1985

KTHIMI

Nata e butë e prillit i kishte zgjuar të gjithë zërat e fshehtë të tokës së porsaliruar prej borës së gjatë dhe Sherifi kalonte përmes tyre me hap të lehtë, sikur druhej mos i trembte. Në oborr ata zëra mbetën pas dhe ai u ndal pak si për ta mbledhur veten. Gjithë rrugës mendjen e kishte pasur këtu, te dera, te dera e shtëpisë së vet, ku do të trokiste. Do të trokiste ngadalë një herë, dy, tri, se nuk duhej të zgjonte askënd tjetër në katund veç nënës së tij, që flinte fillikat në katin e dytë, në dhomën e zjarrit. Edhe asaj trokitja duhej t'i vinte e butë, të mos ia trembte ëndrrën. Sepse është kohë lufte, kohë terrori, tha ai, dhe një zhurmë pas dere, aq më tepër një goditje, vetëm mendime të liga të ndjell. Ai nuk

donte kurrsesi që nëna t'i dilte përpara me gjak të ngrirë dhe të duheshin pastaj disa minuta sa t'i kthehej fytyra e mëparshme e përmallur. Se do të qenë çastet e para, dhe çastet e para janë gjithmonë më të bukurat e takimit me njeriun e shtrenjtë. Ndaj këtë çast Sherifi nuk donte ta humbiste kurrsesi, sepse më vonë nuk do të mund të përsëritej. Kishte katër muaj pa e takuar nënën.

Qëndroi pak në krye të oborrit sa për t'i përzënë deri në fund të gjitha përfytyrimet që ia kishin shkurtuar rrugën, pastaj, si iu duk se u kthjellua plotësisht, u afrua ngadalë te dera dhe trokiti në të me pjesën e butë të fundit të pëllëmbës. Tani nuk dinte ta maste më kohën dhe nuk mund të thoshte saktë sa priti derisa trokiti për së dyti, sepse nga brenda nuk erdhi asnjë zë. Po përsëri nuk iu përgjigj kush. As herën e tretë, as të katërtën, as të pestën. Ai nisi t'i rëndonte gjithnjë e më tepër dorës dhe i shpeshtoi trokitjet. Njëherë tha se mos nëna nuk qe në shtëpi. Po ku do të vente?! Sidomos këto vitet e fundit, pas vdekjes së babës, ajo nuk donte të shkonte as te dajat. Kur e pyeste kush se përse qe mbyllur ashtu, thoshte se nuk i bënin më këmbët të ecte. Po nuk qe ai shkaku. Sherifi e kishte kuptuar se nëna qe lidhur me kujtimet e asaj shtëpie dhe nuk shkëputej dot prej tyre. Nuk e zinte gjumi në shtrojat e ndonjë shtëpie tjetër, kudo qoftë.

Dikur vonë, kushedi sa vonë, u dëgjua zëri i nënës:

— Kush është?

— Hape, nënë, jam unë.

— Kush je ti?

— Nuk po më njeh?

Sherifi u mpi. Këtë nuk ia pati marrë mendja.

— Jo. Cili je? — foli nëna me po atë zërin e parë, ku nuk dallohej asnjë fije shqetësimi a frike, veç një lodhje e përgjithshme që e bënte gati mospërfillëse.

— Sherifi jam, si s'po më njeh?

— Cili Sherif? — Për herë të parë zëri i nënës u drodh e u mpak si t'i këputej befaz fryma.

Sherifi mbeti. U rrotullua edhe një herë ngadalë nga oborri, i endi sytë e çakërritur gjithandej, si për t'u bindur se që në shtëpinë e vet, pastaj u kthye prapë me kokë të ngritur nga frengjitë e katit të epërm të kullës dhe qëndroi ashtu, pa qenë i zoti të nxirrte asnjë fjalë. Në fytyrën e tij gjatoshe e pa tul. në vendin e syve, terri i natës shënonte dy gropëza të zeza si puse.

— Cili Sherif? — u përsërit pyetja, po Sherifi, ashtu siç ishte i hutuar, kësaj here nuk mundi ta dallonte dridhjen e zërit. Ndjeu një ligështim të përgjithshëm që ia mjegulloi vështrimin dhe i nisi nga fundi i kraharorit një gulç vaji.

— Sherifi, — tha ai përhumbur, — Sherif Paci. — Deshi t'i thoshte «Nënë, si nuk po më njeh, nënë, pse më pyet kështu, ç'të ka gjetur?»,

po sikur iu mpak gjoksi e i mbetën fjalët në grykë.

— Sherif Paci?! Ti?! Qysh kur kanë nisur të ngrihen të vdekurit prej varreve e të vijnë t'ua prishin gjumin të gjallëve?

— Si flet kështu, nënë? Nënë, ç'ke? Pse po më lë kaq gjatë mbas dere, a s'të paska marrë hiç malli?

— Në qofsh biri im, pra, kthehu atje ku e ke vendin. Hajt, hajt, të qoftë udha mbarë! Ta kam bekuar një herë varrin, kudo e paç e po ta bekoj prapë. Hajt, hajt, të qoftë udha mbarë!

Nga nxitimi për t'i thënë ta hapte njëherë derën, pastaj do të flisnin, ai nuk e vuri re se zëri i saj erdhi duke u shuar, si të fundosej me shpejtësi në një humnerë të thellë. Por as fjalët që desh i nuk mundi t'i thoshte, sepse aty për aty i jehoi në kokë lutja e saj për t'u kthyer atje ku e kishte vendin tani, në qe vërtet i biri. Ku e paskam vendin tani? pyeti veten. Pse nëna përmendi të vdekurit, varret? Ç'punë kam unë me varret, apo kushedi iu fanepsa si babai?

Këto pyetje, që i erdhën vetëtimthi njëra pas tjetrës, sikur e shkundën e ia kthjelluan pak mendjen, sa mundi të mendonte me dhimbje se vetmia e paska rënduar shumë shpirtin e nënës. Ndaj i thirri edhe një herë, bile me njëfarë buzagazi të mundimshëm, po me shpresë se shfaqja e tij do t'i çlironte sadopak të dy. Zëri kumboi një çast në ajrin e njomur të natës së prillit e u shua si të mos kishte qenë. Nga brenda nuk iu

përgjigj askush. Ai priti derisa nuk duroi dot më dhe thirri përsëri... Thirri shumë herë. Të thirrurat e tij tani nuk shuheshin më në ajrin e lagësht të fillimit të pranverës, po, pasi përpiqeshin më kot të hynin nëpër frëngjitë e ngushta të kullës, ktheheshin mbrapsht e vinin e vareshin si kambana të padukshme në degët e manit e hunjtë e gardhit, rrotull oborrit, duke zgjuar krejt vendin përreth.

Megjithatë, nga brenda prapë nuk pati asnjë përgjigje.

Nëna, e ngrirë në krye të shkallëve, nuk mundi ta mbante më veten dhe përtheu gjunjët ngadalë, po me një lëvizje të pakontrolluar, e u ul aty, mbi dysheme. Po ta shihte veten, do të habitej me sytë jashtëzakonisht të hapur dhe do të kishte të drejtë të pyeste se ku shkonte drita e tyre, pasi atë çast ata nuk i sillnin asnjë pamje nga jashtë. Njeriu që fliste i tha se ishte Sherifi, bile edhe ndoshta ia përsëriti këtë sepse i bëhej se po e dëgjonte zërin që vinte si i shtypur, ngaqë kalonte nëpër vrimat e padukshme të murit të kullës dhe përzihej me zërat e burrave e vajet e grave, të mbledhur me ngut për të kryer mortin e tij. Një mort dyfish i përzishëm, ngaqë mungonte trupi i të vdekurit. Ajo e dëgjoi lajmin për vdekjen e të birit rastësisht para gati gjashtë javësh. Një muzg doli të mbushte ujë te kroi dhe takoi Nafijen, një kushërirën e vet të largët. Nafija i ndenji pak me kokën mënjanë dhe nuk e pyeti fare si i kishte hallet, si zakonisht.

«Ç'më rri ashtu?», iu drejtua Havaja (nëna e Sherifit).

«Si po të rri?»

«Si me ta pasë një peng të madh.»

«Ma ke. Na ka mbetë hatri që s'na çove lajm...»

«Lajm?! Për çfarë?»

«Si për çfarë? Të ndodhi gjithë ajo gjëmë e...»

Havaja u nguros. Nafija e ndjeu që tjetrës i ranë të befta fjalët e saj dhe kafshoi fort gjuhën duke mallkuar veten. Ndërsa po mundohej të gjente një fjalë tjetër që ta mbulonte disi të parën, dëgjoji Havanë:

«Ç'gjëmë, moj, u bëfsh gjëmë?!»

Nafija u ndie edhe më keq e iu ngatërruan fjalët nëpër dhëmbë. Havaja mundi të merrte vesh vetëm se ajo paska dëgjuar në mëngjes se ishte vrarë Sherifi. E kishte treguar një nga të malit, që qe gjetur vetëm në pyll, i plagosur. Po nuk duhej të qe e vërtetë, se do t'i kishin thënë asaj si nënë më parë. Do t'i kishin ardhur shokët e tij me domosdo t'ia sillnin lajmin.

Nafija ngriti bucelën e u largua pa i thënë as natën e mirë, me hapa të ngatërruar, si të ikte nga një lemeri. Aty për aty Havaja nuk u vuri vesh, se e mori për ndonjë nga ato llafet që përhapte hasmi, siç kishte bërë gjatë gjithë dimrit për partizanët se na qenkëshin vrarë mbarë, se na qenkëshin pastruar një herë e mirë malet prej tyre, se kjo pranverë do t'i vinte vendit e qetë e njerëzit do t'i mbillnin arat të patrazuar e ç'nuk

thoshin. Po në mbrëmje, kur ishte vetëm në shtëpi e gjumi nuk po i vinte, asaj iu vërtit përsëri në kokë ajo fjalë. E përzuri gati me rrëmbim, megjithatë ajo i la prapa një si gërvishtje të lehtë që i hiqej dregëza mbrëmje për mbrëmje derisa kaloi një javë, dy, tri, një muaj nga dita kur e kishte dëgjuar. Dhe e gërvishtura iu bë plagë sepse as nuk mori ndonjë lajm prej të birit, as nuk takoi ndonjë prej shokëve të tij. Tani krejt katundi e quante të vdekur Sherifin dhe e shihnin Havanë me njëfarë çudie që nuk hapi fare mort për djalin e vetëm. Edhe ajo vetë u lodh në atë gjendje të papërcaktuar shprese e mosbesimi, prandaj nuk duroi dot më.

I erdhën shumë veta për ngushëllim, farefis, të njohur, shokë e miq të të shoqit dhe ajo i priti me vetulla të mbledhura prej hidhërimit, po pa lot. Ishte zot shtëpie. Nuk iu ankua askujt as për vetminë, as për pleqërinë, as për djalin e humbur. Kur vinte fjala aty, thoshte se luftë është e lufta i ka ngrënë gjithmonë burrat më të mirë. Ata që e dëgjonin, sillnin nëpër mend të vrrarët nga lufta në fshatin e tyre që kur kishin lindur dhe vërtet nuk u dilte të kishte qenë ndonjëri prej tyre humban.

Me kohë njerëzit që i vinin për ngushëllim nisën të rralloheshin, dhe ajo, në mbrëmjet e vetmura në kullë, filloi të fliste me Sherifin, siç flasin të gjitha nënat e mbetura fillikat me bijtë e tyre të vdekur. Nuk e qortonte për asgjë, përveçse që nuk i pranoi para dy vjetve të martohesj.

Do t'i dhimbsej sa s'ka më t'i kishte mbetur nusja e ve, por edhe do të përtërihej po t'i kishte lënë ai një foshnjë. Mirëpo nga ato biseda pa përgjigje, pa e kuptuar as vetë, ajo kishte harruar si fliste në të gjallë Sherifi, si e kishte zërin.

— Nënë, bre!

— Oh, nënë! Mos qofsha! — shfreu ajo. — Si i besova ashtu ato fjalë të të ligut?! — Shkundin një herë fort trupin dhe bëri të ngrihej rrëmisht.

Mezi e lëvizte drurin që ia vinin derës nga prapa dhe, kur e çeli, nuk kishte më forcë as për t'i zgjatur krahët që ta afronte Sherifin për ta pushtuar. Kraharori i thatë i ulej e i ngrihej si të vërtitej brenda tij një shpend i egërsuar.

— Shkoka larg vdekja, bir! — mundi të fliste. — Ta mbusha keq mendjen. Mbamë pak, se po bie!

1985

LEGJENDA E MALIT TË BUKURISË

Thonë se ajo verë mori jashtëzakonisht e thatë dhe që në javën e dytë të korrikut te njerëzit u vu re një ndryshim: ata filluan të bëheshin gojë-këqinj. Përshëndetjet e zakonshme të mëngjesit, të mesditës e të mbrëmjes, ashtu si edhe urimet puna mbarë e mirupafshim, po dëgjoheshin përherë e më rrallë, derisa u harruan fare. Njerëzit, kur takoheshin, nuk pyeteshin më si u gdhive apo si u ngryse. U bë gati një çudi të dëgjoje kënd të pyeste shokun edhe si je me shëndet. Ata, sa ndodheshin ballas, pa ia dhënë as dorën njëri-tjetrit, hidhnin njëherësh sytë nga misrat, të cilët, që nga koha e shatit, jo që nuk ishin harlisur,

por ishin mpakur më keq, u ishte holluar, zverdhur e varur poshtë fleta. Atëherë njerëzit lëshonin një nëmë të përcjellë me një psherëtimë të gjatë. Ashtu ndaheshin. Nuk ishte parë kurrë të përdorej aq dendur fjala *dreq*. Me të emërtohej thujse krejt bota përreth. Madje, edhe ujin që pinin, gratë që e bartnin me bucela në shpinë prej Lugut të Madh, ku kishte mbetur pa shteruar i vetmi krua, gjatë rrugës ia hidhnin njëqind herë dreqit. Edhe bukën që hanin, burrat, që u duhej ta bluanin drithin te Mullinjtë e Shkallës dhe të humbisnin dy ditë plot për të shkuar e ardhur, ia falnin njëqind herë dreqit, për të cilin as që kujtohej më njeri të thoshte «qoftëlargu», siç e don-te e mbara.

Thonë se u bë e padurueshme sidomos çjerrja e gjinkallave që s'pushonin ditë as natë, sa njerëzit e quajtën pak t'i thërritnin «dreq» e i bënë shtriga.

— Dreqi i ka hyrë në bark edhe kësaj vajzës sonë, — i tha një mbrëmje së shoqes Zef Mici. — Përditë ia zbukuron fytyrën e ia tret mendjen.

— Mos fol ashtu, — ia ktheu e shoqja me një zë të këputur, — Sosja është e urtë.

Ndërsa me vete mendoj tjetër gjë. Atë verë pa ujë Sosja mbushi gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe, papritur, i ra një nur që s'ia kishte marrë mendja kujt. Iu zgjeruan sytë e iu mbushën me një të kaltër të kthjellët që ta përpinte vështrimin e të dukej se ta treste aq larg, sa të mjegullohej drita e të bëhej se mbeteshe i verbër. Iu lëmua fytyra sa s'ia mbante më pikën e djersës, as përskuqjen

e diellit si t'i rrinte zgjuar nga brenda një erë prilli, kur sa ka shpërthyer gjethi. Njëqind metra larg ta kishe, të çonin vetë këmbët t'i kaloje pranë. Një zë i fshehtë të thoshte se do të merrje një fllad që do të ta trembte vapën e do të të shpinte krejt. Por, sa bëje t'i afroheshe, të hipte një i nxehtë që të bënte ta harroje përvëlimin e ditës. Ish e s'ish i nxehtë. Të dukej se të shkriheshin edhe eshtrat, por edhe nguroseshe më këmbë e i ndieje duart të të ftoheshin. Iu zgjatën flokët, flokët e verdhë e të ndritshëm si prej mjalti pranveror dhe iu varën poshtë deri në mesin e shpinës. Hodhi një shtat që dy hije lëshonte rrugës, dy hije si gërshërë që ta prisnin hapin njëqind metra tutje.

Thonë se iu zgjidh gjuha, çka nuk qe parë e as dëgjuar në ato anë. Shkonte rrugës e fliste me zogjtë, me pemët, me barin e me gurët. Po më mirë dinte të fliste me njerëzit. E, midis njerëzve, më mirë dinte të fliste me djemtë. Veç djemtë nisën ta kenë punën më keq se të gjithë. Fliste ajo e ata e harronin gjuhën e vet. Qeshte ajo shpenguar e atyre u hutohej fytyra në një të qeshur marroke, që e vinte në gaz edhe ajrin përreth. Kur s'ishin me të, secili për vete sillte nëpër mend fjalët e tij e fjalët e saj, i shoshiste nga të gjitha anët, duke u shtirur te shoku se e la pas hutimin, ia dha asaj e se tani nuk e lidhte më asgjë me të. Shoku, gjithashtu, shtirej se e besonte, i bindur si budalla se vetë kishte qenë më i zoti sepse kishte di-

tur t'i fshihte mendimet që e mundonin. Njëri prej tyre u kujtua i pari se në tërë atë fshat vetëm ajo nuk e përmendte kurrë dreqin. Duke i përsëritur sa e sa herë në vetmi fjalët e saj, ai e ndjeu se në to mungonte diçka. Jo diçka e vogël: diçka që e bënte të dallueshme nga të tjerët të folurën e saj. I thërriste prapë e prapë i shpëstilloi nga kreu në fund gjithë ç'pati thënë ajo, po prapë i mbetej pas një si zbrazëti që i përcillej atij dhe e bënte të hahej e të hahej pamëshirshëm me veten. Por nuk i binte në të. Ishte gati të shkonte ta pyeste po të mos i druhej, më fort se gjithçkaje, së qeshurës së saj, e cila do t'ia bënte sërish lesharapi mendimet dhe do t'ia ngjiste pas lëkurës së fytyrës atë buzagazin budalla që e bënte ta përçmonte veten, sepse ia shëmtonte gjithë tiparet, duke ia zgjatur aty ku nuk duheshin zgjatur e trashur aty ku nuk duheshin trashur. Ndoshta pikërisht se shpëtoi nga kjo torturë u gëzua edhe më tepër kur më në fund e ftilloi ç'që ajo zbrazëti: gjuha e saj jo vetëm nuk e përmendte kurrë dreqin, por edhe zgjidhte fjalët më të bukura kur donte të të thoshte diçka. Me ta takuar Sosen, ai ia tha gjithë padurim, si të kishte bërë zbulimin më të çuditshëm.

— Pa më thuaj, — iu drejtua me një zë përkëdhelës djali që për herë të parë guxoi ta shihte drejt në sy, — pse ndryshon nga gjithë ne të tjerët ti? — Ai mundi ta shihte edhe një çast fare të shkurtër në sy, duke shpresuar verbërisht se erdhi dita që ta zotëronte veten para saj.

Sosja ia plasi së qeshurës, si gjithnjë, dhe nëpër gojën e çelur përgjysmë qysh më parë, ngaqë gazin e kishte në buzë, i doli një grumbull fjalësh që mezi u renditën në kokën e djalit:

— Oh, po me dreqin nuk kam asnjë punë!

Djalit të shkretë i humbi përnjëherë ai besim i marrë se më në fund qe bërë zot i vetes dhe mbeti si guhak. Ajo vazhdoi të qeshte dhe t'i kërkonte me këmbëngulje sytë e djalit që fshihe-shin për nën vetulla. Ai e përfytyroi shprehjen e fytyrës së vet dhe ndjeu mjekrën t'i dridhej nga lotët e një inati të hidhur. Ai nuk duroi e ua zbuloi edhe shokëve të fshehtë të vet. Ata shqyen sytë të çuditur që nuk e kishin vënë re më parë një gjë kaq të dukshme dhe secili, me vete, u mbush me një zili të mirë për vajzën. Ndërsa djali, pas bisedës me Sosen, u hutua fare. Iku, siç i thonë, aq sa një ditë u harrua në pyll tek endej si në jerm dhe një natë me mjegull u rrëzua te Shkëmbi i Dhive të Egra.

Thonë se të gjithë djemtë, nga kjo mefshtësi, e morën inat vetveten. Po Sosen jo, Sosen nuk e mori askush inat. Se përse, veç ata e dinë. Mendja e shëndoshë ta thotë se s'ke kënd më hasm se atë që të bën ta përçmosh veten tënde. Po, si do që ta thotë mendja, e vërteta është e vërtetë, as blihet, as shitet: ata nuk e morën aspak inat Sosen. Mbase do të donin t'i zemëroheshin, t'i zemëroheshin shumë, madje sa t'ia bënë benë. Kështu do të mund të qetësoheshin pak e të merreshin më mirë me hallet e zeza që u nxirrte

vapa. Po nuk e detyronin e nuk e detyronin dot zemrën.

I ati i vajzës, plaku i urtë Zef Mici, që s'e mbante mend kush të qe zënë a sharë me kënd ndonjëherë, çdo mbrëmje ngrysej me kokën të turbulluar nga ç'kishte parë e dëgjuar nëpër fshat për lulëzimin e së bijës. Kështu, mbrëmje për mbrëmje ai e kapërcente shtegun e oborrit të vet me mendjen të mbledhur top që atë natë të bënte sherr, sherr të madh, t'i kallëzonte asaj... (oh, fjala e rëndë që donte të thoshte i ngatërrohej diku prapa, diç ia ndrydhte e s'ia linte asnjëherë t'i dilte në majën e gjuhës). Këtu mendimi i hallakatej keqas, i shprishej e nuk e mblidhte dot më, si të qe prej avulli. Hynte në shtëpi me fytyrë të vrrarë, po pa e ditur tashmë as vetë se ç'do t'i kallëzonte së bijës.

Zakonisht Sosen e gjente të ulur pranë llambës, duke qëndisur. Përnjëherë ia rrëmbenin vështrimin ato qëndisma, aq të bukura sa s'të besohesh se i kishte nxjerrë maja e gjilpërës dhe i hipte një joshje e fshehtë t'i shkonte vajzës pranë, ta puthte në ballë e t'ia lëvdonte një mijë herë duart. Lypte bukë shpejt dhe shkonte mbyllef në kthinën e vet të fjetjes se, po të rrinte edhe pak e ta kishte para syve fytyrën e saj që e mblidhte krejt dritën që jepte fitili i ngritur i llambës dhe lëshonte rrëth e rrotull pastaj një hije të praruar hëne, pra, edhe pak po të rrinte aty, nuk do t'i bënte dot ball asaj joshjeje dhe nuk do t'i mbetej më pastaj kurrgjë prej vrazhdësisë

që i kishte dhënë dita. Pa atë vrazhdësi të nesërmen do të ndodhej keq para katundit. Në kthinën e vet, fare vetëm, (e shoqja e kishte kuptuar se në këto çaste ai nuk donte njeri pranë, ndaj qëndronte deri vonë në krahun tjetër të llambës duke arnuar ose duke bërë në heshtje çorape), ai vriste e vriste mendjen, gjersa lodhej dhe e kapiste gjumi, për të gjetur se ç'ia lidhte ashtu gjuhën e duart, aq sa s'i thoshte dot as edhe një fjalë të ashpër së vijës. Dhe s'e gjente e s'e gjente.

Thonë se Zef Mici nuk arriti kurrë ta merrte vesh që askush në fshat nuk e quante turp sjelljen e së bijës. Madje, edhe kur ajo i vdiq ashtu papritur e në mënyrën më të çuditshme, si për ta përforcuar atë jetën e saj të ëndërrt që kishte bërë gjithë atë verë, dhe nuk mbeti njeri pa e qarë, me plak e të ri, Zef Mici përsëri e quajti atë vaj si një dhimbje të natyrshme për moshën e saj të re e asgjë më tepër. Nuk bindej e nuk bindej se ishte ndryshe. Megjithatë dyshimin e tij nuk ia shprehu kurrë asnjëri. Mbase edhe nuk pati kohë. Sa nisën vranësiat e para të vjeshtës që ia vuri kapakun asaj vape të tmerrshme, ai shkoi u mbyll përjetë në varr, i pakthjelluar në kishte bërë ndonjë turp vërtet e bija apo jo.

Edhe Sosja e kishte ndier merakun e të atit qysh në fillim dhe mbrëmje për mbrëmje, sapo hapat e tij të ngadalshëm e të rëndë afroheshin në kalldrëmin e oborrit, ajo priste me gjak të ngri-rë që ai të çelte derën duke turfulluar, a të paktën t'i thoshte një fjalë qortuese. Madje edhe më

larg mund të shkonte, t'i jepte ndonjë pëllëmbë së prapthi që t'i nxirrnin sytë xixa jo aq nga dhimbja sesa nga plagosja e shpirtit. Pas kësaj, siç i takonte, do t'ia priste flokët shkurt e rrathë-rrathë si qethjet e dhive e do t'ia mbyllte rrugën te dera e oborrit, që ajo të mos dilte më dimër as verë në sy të botës, derisa t'i vinte fati. Dhe po të mos i vinte ai fat, le të fikej edhe jeta e saj ashtu, ngadalë, por pakthyeshëm, siç fiket fitili i llambës kur i mbaron vaji.

Për çudinë e saj asgjë nuk po ndodhte. Kjo heshtje e të atit zinte vend tek ajo si një vuajtje që rritej. Mbrëmje për mbrëmje ajo bënte be se mëngjesi i nesërm do ta gjente me mendje tjetër. Do t'i mblidhte flokët gërshet, do të vinte në kokë një shami të vjetër, të çngjyrosur të së ëmës e të shkonte rrugës me sytë përdhe e hap të ngutur, pa ndërruar fjalë me askënd. Të shihte punën e vet. Po gjumi i thellë i natës me ëndrrat përrallore ia fshinte benë. E zgjonin rrezet e diellit të parë, që i përkëdheleshin nëpër flokë e qerpikë. Sa dilte jashtë për t'ua çelur dhenve derën e vathës që t'i nxirrte në kullotë pa u tharë ende vesa, do të kalonte andej patjetër ndonjëri prej djemve të fshatit. Sosja mësoi shumë shpejt të gëzohej e të trishtohej me hutimin e tyre. Mësoi edhe të luante përherë nga pak me atë hutim. Mbase ngaqë i kishte parë gjithnjë si lojë marrëdhëniet me ta, i erdhi ashtu, krejt e papritur, pyetja që i bëri njëri prej atyre djemve një mesditë fundgushti, kur ishin mbledhur te Liva-

dhi që S'kositet e i kishin vënë dhentë në mritz, nën hijen e gjerë të lisit të vetëm.

— Me cilin prej nesh do të martohesh?

Deri atë çast ajo as që kishte menduar ndonjëherë për martesë, ndaj edhe të gjithë djemtë i kishte parë me të njëjtin sy. U mundua ta kapërcente, pa u vënë re prej tyre, hutimin e beftë që i mbiu përnjëherë, po nuk ia doli. Për të fituar pak kohë, sa ta gjente fjalën që i duhej, e vendi shikimin ngadalë, duke e ndalur një grimë, nëpër sytë e çdonjërit prej djemve që i rrinin rrotull si të ngrirë. Deshi të kthehej edhe një herë tek ata sy, por e trembi mpirja e tyre e plotë, si t'u qe ndalur papritur gjaku. Kurrë nuk ua kishte parë sytë të tillë, të fishkur e të tharë. Ata prisnin gjithë ankth e ajo nuk dinte ç't'u thoshte. Vërtet, me cilin do të martohem? pyeti atëherë veten. Por edhe kjo pyetje, në vend që ta kthjellonte, ia shtoi mjegullën në kokë. Në të dyja mollëzat e faqeve i digjeshin zjarre që i përhapnin një përvëlim nëpër gjithë trupin.

— Apo asnjëri prej nesh nuk ta mbush syrin? — iu drejtua i njëjti djalë, i cili, prej hutimit të saj, dukej edhe më i trimëruar.

— Nuk do të martohem, — iu përgjigj ajo, duke u përpjekur t'i jepte zërit sigurinë e mëparshme. Po nuk ia arriti dhe këtë e ndjeu edhe vetë menjëherë. Madje e kuptoi se duhej të bënte diçka të jashtëzakonshme për ta fituar atë siguri, ndryshe para tyre e kishte humbur epërsinë përgjithmonë.

— Ooo, si nuk do të martohesh?! — u hodhën disa djem njëherësh.

— Do të martohet, — tha prerë e me një bindje të palëkundshme ai që kishte folur i pari. — Unë e di mirë që Sosja do të martohet.

Po ky, tha vajza me vete gjithë inat, kur flet për mua, ç'ka që u drejtohet shokëve të vet, sikur do t'i çlirojë ata nga halli?! Pastaj, nga i ditka kaq mirë punët e mia?! Inati që e mbushi, i dha zemër.

— Ku e di ti se do të martohem?

— Do të martohesh e do të marrësh patjetër njërin prej nesh. Nuk të lëmë të hidhesh në fshat tjetër. — Fliste gjithnjë ai djali i parë. Shokët e tij tashmë heshtnin dhe sytë e tyre ishin mbushur rishtas me atë dritën e shpëlarë e të palëvizur si fund pusi, ku Sosës iu duk se do të mbytej pas pak.

Livadhi që S'kositej ishte në këmbë të një mali, të cilin, qysh nga ajo ndodhi, e thërresin Mali i Bukurisë. Thonë se deri atë ditë nuk pas-kësh pasur asnjë emër, sepse askush nuk kujtohej për të. Një mal i zhveshur fund e krye, vetëm me ca dëllinja të rralla që ia shtonin më tepër shëmtinë dhe i mbuluar gjithandej me gurë të djegur prej diellit e të rrjepur prej erës. As dru-rë, as bar, as lule. Vetëm në majën e tij, nja pesë-qind metra lart, dukej një ah i drejtë e i gjatë, fillikat, si bisht i ngrehur kali. Në rrënjët e tij thuhej se dilte një krua i hollë që nuk shteronte dimër as verë e që, po ta pije, ta mpinte ballin.

Por asnjëri prej atyre aty nuk kishte vajtur ta provonte. Sosja u kthye andej e mbeti një copë herë pa bërë zë, me vështrim të ngulur tek ai ah. Djemtë e ndiqnin me sy dhe pritnin. Nëpër fytyra po u binte një hije e gjelbëreme. Secili ishte gati të thërriste: mjaft u zgjat kjo shaka! Zemërimin e Soses, edhe pse nuk e njihnin, nuk do ta donin kurrësi. Druheshin mos i humbisnin përgjithmonë çastet e qëndrimit me të. E, po të ndodhte kështu, mjerë ai që e nisi, i pari meselenë! Fytyra e Soses e kishte fituar prapë qetësinë e zakonshme, trazuese. Por jo sigurinë. Për të kjo që humbja më e tmerrshme, që zhvlerësonte gjithçka. Ndaj duhej ta shpëtonte me domosdo. Në kokë iu kthye ai mendimi i pakmëparshëm se s'kishte rrugë tjetër për ta mundur atë ligështim veç të jashtëzakonshmes.

— Burri im do të jetë ai që të më marrë në krahët e tij, të më mbajë siç mbahet një foshnjë, pa më lënduar asgjekundi e të më ngjitë me vrap deri atje lart, tek ah, pa pushuar as edhe një grimë, të pi një herë ujë të ftohtë akull, se ma prishi gjakun kjo verë e thatë, të freskoj edhe sytë e qafën dhe pastaj të zbres me të e s'i ndahem më sa të jetë jeta, as nuk e lë të më ndahet, — tha ajo pa ia hedhur sytë asnjërit.

Të gjithë djemtë, me sytë të ngulur tek ajo, qenë gati të besonin se u ishte ndërruar Sosja. Përnjëherësh, nën vështrimet e tyre të pakëputura, në shteguën e ballit asaj i mbiu një rrudhë që, duke u thelluar së brendshmi, si të kishte

gelur grykën e shpëllës së erërave, ia murrëtoi tërë tiparët. Deri edhe mjekra, që gjithnjë ia kishte rregulluar drejtpeshimin e fytyrës, nisi t'i dridhej. Djali që foli i pari ishte i biri i shartuesit më të përmendur të pemëve në gjithë krahinën. Kujtimin më të hidhur ai e ruante nga fëmijëra. Gjersa u bë dhjetë vjeç, vendi i tij më i dashur, ku ndiqte tërë ditën pa u mërzitur e me sy të habitur fluturimin e zhdërvjellët të zogjve dhe zhvendosjen e çrregullt të reve në qiell, ishte maja e një dardhe të egër në kopshtin prapa shtëpisë. Kur e thërritnin për të ngrënë bukë a për ndonjë punë, zbriste gjithë përtësë dhe ecte si në gjumë: këmbët mezi i përthyheshin te gjunjët për t'i hedhur hapat, trupi i kalamendej majtas e djathtas si i shqitur në këllqe dhe vështrimi i rrëshqiste gjithnjë përtej atij që kishte përpara. Kjo i zgjaste dhjetë minuta a nganjëherë edhe gjysmë ore. Në atë kohë edhe për të folur fliste çapraz e nuk lidhej gjekundi me çka e pyesnin. Tamam kur u bë dhjetë vjeç e filloi edhe t'u jepte një kujtim të vetin formave të turmave të zogjve në fluturim dhe figurave të ndryshueshme të reve tek lëviznin nga një anë e qiellit në tjetrën, i ati e pikasi se nga i vinte të birit përhumbja. Prandaj, një mëngjes, pa i thënë gjë fare, vajti dhe e shartoi dardhën e egër me një të butë. Ai mendoi se gjeti një pretekst për t'ia ndaluar djalit të ngjitej më atje. Por, pas shartimit, degët e dardhës së egër erdhën e u mpakën e u mpakën, derisa mbe-tën si damarë të çuditshëm për të mashtruar

erën. Në vend të tyre nuk dolën degët e gjelbra të dardhës së butë që priste i ati, por ca shkurre që, të mbështjella rreth trungut të gungëzuar, e bënin dardhën të dukej si kokë e palarë magjistari. Djali qau për një kohë të gjatë sepse natë për natë ajo i dilte në ëndërr. Tani iu fanit përsëri vizioni i saj i përçudnuar dhe nuk e mbajti dot veten.

— Mjaft! — thirri. — Unë desha të bëj një shaka. Të lutem, merri si shaka ato që të thashë! Në të kam lënduar, më ndëshko si të duash! Vec mos e vazhdo më këtë lodër të keqe! Edhe ju të tjerët, pse më rrini ashtu të squllur?! Hajde, më jepni ndëshkimin që meritoj! Dhe mos e lini Sosen të trishtohet!

Djemtë ndien t'u shkrihej nëpër trup akulli që i kishte mpirë. Po Sosja nuk la t'u binte deri në fund të këmbëve ajo shpirje, që të gliroheshin plotësisht.

— Jo, — foli prerë, — ti nuk the asgjë për t'u ndëshkuar. Tani mëdojeni sekush për vete cili do të jetë burri që do të flejë me mua sonte e derisa unë të vdes! Fjalën që thashë, do ta mbaj.

Ra përsëri një heshtje e shkurtër, aq sa ajo pati kohë ta ndalte vështrimin nga një çast te secili. Po vetëm sytë e Binakut të Mark Tagës gjeti. Të tjerët i kishin fshehur thellë nën vetulla dhe ajo nuk mundi t'ua nxirrte t'i kryqëzonte me të vetët, sado me ngulm i kërkoi. Ndaj, padashur, u kthye rishtas te Binaku. Nuk i kishte vënë re kurrë më parë ata, sy dhe mbeti e

habitur. Ishin dy sy të kthjellët, por që nuk dukeshin si sy. I majti më i madh se i djathti, dhe të dy fare të rrumbullakët, pa atë tërheqjen e butë që i ngushton në skaje dhe e rrëzon dritën butësisht në mollëzat e faqeve. Po edhe mollëzat e faqeve tek ai nuk ishin si te të tjerët. Në vend të kërcimit të tyre të përmbajtur, kishte dy gropëza, si shtypje nga një goditje e beftë, e fortë. Apo ndoshta ua jepte atë pamje hunda me kurriz jashtëzakonisht të ngritur e të rrjepur pakëz në majë. Duke e parë, Sosja u rrëqeth. Atij nuk i lëvizte asnjë qerpik. Sepse nuk kishte qerpikë fare. Soses nuk i kishte kaluar ende nëpër tërë trupin vetëtima e rrëqethjes, kur dëgjoji një zë të gërvishtur që mezi i merreshin vesh fjalët gagaçe.

— Edhe sikur ky të jem unë, prapë do ta mbash fjalën?

Kishte folur Binaku.

— Kushdo që të jetë. Atë nuk e caktoj unë. Unë vetëm i bindem, — u përgjigj Sosja serbes.

Nuk e kuptonte pse nuk po i përkëdhelej krenaria nga kjo stepje e djemve. Ç'kërkoj më tepër? tha me vete.

Djemtë kthyen me vrull kokën nga Binaku dhe vunë buzën në gaz. Sado që ai nuk bënte kurrë shaka dhe as nuk përzihej në lodrat e tyre, përsëri besuan se i pikoi një herë mendja për diçka të mençur dhe ia ditën për nder që po i nxi-rrte nga ajo gjendje e vështirë.

— Ah! — u hodh djali që e kishte nisur lodrën, — ku je, o burrë i dheut!

Të tjerët qeshën pa u përmbajtur, qeshën me gjithë kraharorin, duke shpërndarë rreth e për-qark një gurgullimë marroke. Vetëm Soses nuk i lëvizi asnjë nerv i fytyrës. Tani djemtë nuk mund ta duronin më vranësimin e saj. Iku, ç'qe për t'u thënë, u tha.

— Sose, — u hodhën tre-katër prej tyre, — prapë do të vazhdosh?!

Në zërin e tyre kishte një ankim plot dhimbje.

Sosja u bë gati t'u përgjigjej, por ia këputi fjalën në buzë Binaku.

— Nuk kam punë me ju, — tha ai prerë dhe u nis drejt saj, duke e çarë me bërryla gjithë mundim grumbullin e ngjeshur të djemve rreth Soses. Ajo ishte zbehur e nuk fliste. Duke ecur, trupi i tij dukej sikur nga hapi në hap do të gremisej. Çalonte keqas. Sa herë e hidhte para këmbën e djathtë, gjuri i saj majhuc përkulej aq poshtë, sa thoshe se do të mbështetej në tokë. Ndërsa e majta mbetej në ajër e përthyer si krah i pajetë zogu e mezi afrohej. Nga kjo shkundje e tërë trupit, kraharori i tij sikur futej më brenda dhe e nxirrte më në pah gungën e shpatullës.

— Eja, Sose! — tha ai dhe shtriu përpara krahët e hollë. — Mbështetu këtu dhe mbahu te qafa ime. Mos ki frikë, do të të mbaj siç deshe, si një foshnjë, pa të lënduar aspak.

Djemtë, që u kishte ngrirë gazi në buzë, e kuptuan se ajo u bë gati të thoshte diçka dhe pritën

të dëgjonin: «Ik, o Binakzeza, ik, lëri marrëzirat! S'janë lodra për ty këto! Gjej shoqen tënde!» Por asaj vetëm sa i lëvizën pak buzët, nuk lëshuan asnjë tingull. Pa hetueshëm Binakun në sy, pastaj u zgjat urtësisht drejt krahëve të tij që vazhdonin të rrinin të shtrirë si shkopinjtë të thatë thane.

Thonë se djemtë e dëgjuan që foli vetëm kur u nisën. I tha Binakut:

— Me vrap, ëh! Pa u ndalur as edhe një grimë! Ndryshe prishet magjia e ne më mirë të mos i hyjmë kësaj pune!

Dhe ai iu përgjigj:

— Vetëm me vrap, Sose, pa u ndalur, mos ki merak!

Djemtë e përcollën me një vështrim ziliqar dhe morën frymë thellë me hundë, duke besuar se do ta ndienin në hojëza aromën trallisëse të trupit të saj, që tamam-tamam e ndiente vetëm Binaku. Ku e gjeti vrapin ai?! Ai që s'ishte parë ndonjëherë të vraponte, se, edhe të donte, nuk mundej, me ato eshtra të shtrembra si kërraba! Megjithatë po ndodhte mrekullia. Nga poshtë, të ngulur aty ku qenë, djemtë mezi arrinin ta ndiqnin me vështrim Binakun, aq shpejt i ndërronte hapat. Apo u ishin mjegulluar sytë?

Jo, ai vraponte dhe Sosja ishte bërë njësh me të, në një përçafim të pazakontë, kur trupat nuk e ndienin fare se ishin të takuar. Midis kishin një korridor të padukshëm, nëpër të cilin kalonte era duke fërshëlyer si e lemerisur dhe ikte tutje,

në fshat, të qetësohej pak e të tregonte ç'po ndodhte atje. Soses i ishte shkarkuar tërë zyrtimi i parë dhe i kishte hipur një gaz i papërmbajtur. Fliste e qeshte. As vetë nuk i dëgjonte fjalët që thoshte, po prapë fliste, goreshtur, pa u merakosur se Binaku ende nuk e kishte çelur asnjëherë gojën. Ajo nuk e kuptonte më e gjente gjithë atë forcë ai, por as që e vriste mendjen dhe nuk çuditej.

Ajo nuk e dinte se Binaku nuk e ndiente më rëndesën e saj. Madje, dy-tre herë ai u bë gati t'i mbledhte krahët, sepse e kishte harruar fare që aty mbante Sosen. Ky qe një gjest krejt i vetvetishëm, që ai, as më parë e as më pas nuk e mori vesh, pasi, ashtu si Sosja, edhe ai nuk e mendonte mungesën e rëndesës së saj. Qysh në fillim, veç dy duarve të Soses, që iu varën butë në qafë dhe i dhanë krejt trupit të tij një hovje të mrekullueshme përpjetë, nuk ndjeu gjë tjetër. Në rënie, derisa shputa e këmbës pufej me tokën, i shkundej edhe lodhja e mëparshme dhe mbetej prapa si pluhur i bezdisshëm. Në çapin tjetër, çka nuk i ndodh kurrë njeriut që ecën, ai ndihej më i lehtë.

Ajo fliste e qeshte, vazhdimisht fliste e qeshte, duke e mbajtur kokën të anuar në një mënyrë që ajri i tallazitur prej rëndjes së tyre t'ia shplekste flokët e dendur e ata ta mbështillnin edhe kokën e Binakut si një re e skuqur nga dielli i parë i mëngjesit. Dhe fliste e qeshte hareshëm, kaq pranë me gojën në rrzë të veshit të

tij, sikur i thoshte një të fshehtë të madhe që nuk duhej ta merrte vesh askush. Por ai nuk dëgjonte asgjë. Në veshë i kumbonin të qarat e veta të ditës kur lindi. Qe një e mërkurë e ngrirë janari dhe e ëma, Mria e ngratë, kur nuk mundi t'i duronte më dhimbjet therëse që i kishin nisur që nga mesnata, afë drekës zbriti në ahurin e bagëtive, ku nuk vozë dhe e gjeti plaka e Nuhajve, e cila i ndihmoi të tëra gratë e fshatit të lindnin.

— Paske dy, mri qyqe, — foli qetësisht plaka ndërsa ia priste këthizën të parit, vëllait të Binakut.

— Aman! — belbëzonte Mria duke kafshuar me forcë buzën që të mos i dëgjoheshin klithmat në katin lart, ku ishin burrat. — Aman, nxirre, se vdiqa!

Plaka e Nuhajve pa si u zverdh lehona e nuk po i dëgjohej më zëri. Zgjati dorën me sa mundi shpejt, mbushi një tas ujë në lugun ku pinin bagëtia dhe ia hodhi me rrëmbim në fytyrë. Uji ishte i ftohtë brisk dhe e përmendi.

— Çohu! — i foli plaka ashpër. — Mblidhe veten!

Mria i hodhi një vështrim të dobët mirënjohës dhe ndjeu dorën e saj që përpiquej t'ia tërhiqte fëmijën që s'donte të dilte. Dora e plakës e shtrëngoi fort kokën e foshnjës dhe, aty ku kishte mbërthyer gishtin e madh dhe dëftuesin, Binakut, kur u rrit, i mbetën dy gropëzat e pahijshme në mollëzat e faqeve. Një gisht tjetër ia shtrembëroi

nofullat. «Ç'ke qarë atë ditë! — i thoshte sa herë e ëma. — O zot, ku i kishe mushkëritë për gjithë atë vaj?!» Dhe sytë e saj përloreshin. «Ah, të mund të të lindja edhe një herë!» Këto fjalë asaj i erdhën për herë të parë në gojë ditën që Binaku u ngrit për së pari në këmbë, bëri dy-tre hapa, por shalët e çartallosura e të pamësuarra, nuk e mbajtën dot dhe ai u rrëzua. Qëlloi afër vatrës dhe u përplas me hundë në urëzën e zjarrit, e cila lëvizi dhe rrëzoi vorbën e groshëve. Gjella që valonte i ra vogëlushit të gjorë në krahët e shtrirë përpara. Ai lëshoi vetëm një ulërimë të thekshme dhe humbi ndjenjat. Kur ia hoqën këmishën, në të ishte ngjitur edhe lëkura. Qysh atëherë gjymtimet të tij iu shtuan edhe krahët, që mbetën ashtu të dobët, të kuq si të lyer me salcë e të shtrembër dhe hunda iu ngrit kurriz. Binaku erdhi në vete pas një copë herë e zuri të qante e të klithte sa ta këpuste shpirtin. Qau aq shumë sa, pas shtatë ditësh e shtatë netësh dënesejeje pa pushim, edhe Mria e dhemshur e humbi durimin dhe e nëmi :«U bëfsh më qyqe se je bërë!» Pastaj ajo iku u mbyll në kthinën tjetër e qau edhe vetë duke nëmur barkun e saj, qau aq sa iu enjtën sytë e i dolën përpara si dy gjysma të qëruara patatesh. Ah, të mund të të lindja edhe një herë! Ofshau prapë duke fshirë lotët nxitimthi me skajin e shamisë që të dilte, se dëgjoji ta thërritnin nga jashtë.

Edhe një herë tjetër mbahej mend të kishte qarë fort Binaku, aq fort, sa u mblodhën të tëra

gratë e katundit ta pajtonin e nuk e pajtonin dot: ditën që i vdiq vëllai, kur sa do t'i mbushte gjashtë muaj, vëllai me të cilin kishte qëndruar nëntë muaj i ngjitur shpinë për shpinë në barkun e nënës. Dhimbja që nga ato gjëra që ai e mësoi më vonë. Vdekjen edhe më vonë. Kështu, edhe ditën që i vdiq vëllai, Binaku do ta kishte kaluar si të gjitha ditët e tjera të mëparshme, duke rrotulluar sytë me habi mbi fytyrat e shtuara që vinin e iknin krejt mospërfillëse ndaj tij, po të mos kishte dëgjuar dikë që i tha s'ëmës:

— Të iku djali, Mri!

— Më iku, — iu përgjigj ajo me një zë të mekur.

— Ç'i paskë bërë perëndisë, moj qyqe?! Të mori të mirin e të lã këtë gjytyrym në vatër.

— Sytë e lagur të Mrisë u bënë përrenj e i vërshuan nëpër fytyrë. Nuk tha asnjë fjalë.

— Mos fol ashtu, t'u thaftë goja! — iu hodh dikush tjetër asaj që foli. — Do të ketë fatin e vet edhe ky.

— Ç'fatzi, moj?! Nuk e sheh si është?! E si do të bëhet..)

Binaku ishte i lidhur në djep pak më tej dhe i dëgjoji të gjitha. Ende s'i ishte zhvilluar aftësia e përfytyrimit dhe as nuk e njihte pamjen e vet se nuk ishte parë ndonjëherë në pasqyrë, por vetëiu i hipi një vaj me ulërima që e prishi krejt mortin, sepse i nervozoi njerëzit e ardhur për ngushëllim. Ç'nuk bënë për ta pushuar! E përkundën, e morën në dorë, kush qe grua me fëmijë,

në gji ia zgjati sisën e vet, i thanë fjalë të ëmbla, po më kot. Ai, me sytë e mbyllur përgjysmë e buzët e shtrënguara, nuk pajtohej e nuk pajtohej. Ajri i dilte i holluar për hundësh dhe lëshonte një fërshëllimë të gjatë e të mprehtë, që të shponte drejt e në tigëzën e veshit. Vonë pasdite erdhi plaka e Nuhajve.

— Ma vini në djep, — tha, — ia di unë këtëj.

E lidhën pa pyetur për përpëlitjet, pëplasjet e këmbëve dhe klithmat e tij të çmendura. Ajo nisi t'i këndonte me zë të ulët te koka një këngë që thoshte se si ai do të bëhej kapedan i parë ndër shokë, se do të merrte për grua të bukurën e dheut e se do t'i shkonte emri tej shtatë grykave nëpër të cilat lidhej Malësia me botën. Plaku i Nuhajve, me të cilin ajo kishte pesëdhjetë vjet që flinte në një shtrat dhe i kishte dhënë trembëdhjetë fëmijë, ia dëgjoji zërin nga e ndara tjetër, ku ishte me burrat dhe u hodh përpjetë. Më dy hapa u gjend pranë saj, vetullmrrorur. Kushedi ç'do t'i këpuste, po të mos ia ndërpriste dikush fjalën në buzë duke iu drejtuar plakës:

— Ku pasqe qenë, moj e bekuar!

E bekuar që këndon në mort?! Shtrigë, thujaj! deshi t'i kthehej. Plaku i Nuhajve asaj që foli, por u step sepse edhe gratë e tjera, që ndodheshin aty, lëshuan një ofshamë lehtësuese nga që pushoi vaji i Binakut dhe i hodhën vështrime mirënjohëse plakës që vazhdonte t'i rrinte foshnjës mbi kokë.

Aftësinë për të përfytyruar Binaku e fitoi

kohë më vonë, kur u rrit dhe moshatarët e tij nisën të merren me lodra gjithfarësh, ndërsa ai detyrohej të qëndronte në ndonjë breg e t'i ndiqte me sytë ku i mbledhej një pikëllim memec. Aty, prej gjërash fare të thjeshta, i krijoheshin në mendje figura nga më të çuditshmet. Në fillim, kur mbaronte loja, ia tregonte me dëshirë të madhe gjithë këto fanepsje atij që i afrohej ta merrte me vete të ktheheshin. Por shpejt pa se shokët i prisnin me të qeshura rrëfimet e tij dhe i përdornin për ta ngacmuar më keq, ndaj e gjeti me vend t'i ruante më mirë fshehur në kokën e tij. Pak nga pak iu bë zakon t'i mbante për vete të gjitha mendimet, derisa nuk merrte më pjesë thujse fare në asnjë bisedë që çelej midis moshatarëve të tij.

Ky zakon i erdhi për mbarë sidomos kur, nga zbukurimi i shpejtë i Soses, zbuloi të fshehtën që s'guxoi asnjëherë t'ia pohonte me zë të plotë as vetes. Për herë të parë qysh se i kishte vdekur i vëllai, iu zgjua edhe kujtimi i asaj këngës ndjellmirë të Plakës së Nuhajve. Mos qe Sosja e Bukura e Dheut? pyeti. Kjo e nuk ka tjetër, iu përgjigj vetes i sigurt. Dhe, për ta përforcuar përgjigjen, shtoi: Si mund të jetë ndryshe? Atëherë kjo ka ardhur në jetë vetëm për t'u bërë nusia ime, u vuri ai kapak mendimeve. Megjithatë, edhe pse shihte se ishte një bindje e çuditshme, që nuk shoqërohej aspak me shpresën dhe ethen e përmbushjes, përsëri nuk vuante. Gjithçka ia plotësonte më së miri përftyrimi. Qenia e tij e

dytë, e padhunueshme, e pabindur, e pafrikësueshme e ndiqte Sosen nga pas kudo ndodhej, si zot i vetëm i saj.

Kështu rreth Soses nuk kishte asnjë të fshehtë që të mos e dinte Binaku. Vetëm ai e dinte të vërtetën e këngës që kishte nxjerrë këngëtari i njohur Ndreka Egra, në të cilën tregohej për bijën e Diellit, që në një ditë të ngrohtë e zuri një harlisje në shpirt, sa nuk mund t'i duronte më as petkat në trup. Rendi e rendi nëpër pyll derisa gjeti një breg të vetmuar dhe aty, e bindur se nuk kishte kënd të gjallë përreth, u zhvesh nga mesi e lart e nisi të përkëdhelte e të puthte supet e veta të rrumbullakëta e të lëmuara si mollë vere. Pastaj puthej me erën, si për t'ia përcjellë afshin që e përcëllonte përbrenda. Kushedi sa do të vazhdonte ashtu sikur të mos dëgjoeshin diku larg disa këmborë. Kjo ishte Sosja, dhe Binaku, që ndodhej ndanë saj, si gjithnjë i padukshëm, e kishte parë Ndreken e fshehur, që rrinte e kundronte me dy sy të ndritshëm si t'u digjeshin yje nga brenda.

Të nesërmen, kur e dëgjoi këngën, të cilën e mësoi tërë djemuria e katundit pa rënë mbrëmja, Binaku vuri buzën në gaz dhe s'e përmbajti dot dëshirën t'ia thoshte Ndrekes ato që dinte. T'ia thoshte edhe për ta trembur, që ai të mos guxonte më t'i shkonte Soses vjedhurazi nga mbropa, me shpresën se nuk e shihte kush. Sepse, nga tërë djemtë, vetëm Ndreken kishte frikë mos ia rrëmbente, pasi edhe vajzën e kishte dëgjuar me

veshët e vet ta përmendte emrin e tij në gjumë. Në një çast, një shkulum i marrosur ere ia largoi flokët e Soses nga fytyra dhe ai pa se nuk i mbetej shumë për të mbërritur në majën e malit. Nuk ishte në gjendje ta ndiqte veten si rendte, por e dinte shumë mirë se këmbët i hidheshin shkathtësisht njera pas tjetrës, pa u ngatërruar, pa u lëkundur. Si e qysh i erdhi kjo zotësi, nuk e dinte. Mundi vetëm të kuptonte se trupi, duke u zhvendosur përpëra, nuk i kalamendej e nuk i përthyej si më parë dhe gjymtyrët merreshin shumë mirë vesh me njëra-tjetrën e nuk bënë asnjë lëvizje të pakontrolluar.

Po të kishte pasur edhe pak kohë të mendonte ç'ishte ajo çudi që po ndodhte, do të ishte hutuar e me siguri do të bindej se që në ëndërr, po lëvizja e vrullshme përpara dhe përplasje e ajrit të tallazitur pas ballit ia ndërronin edhe mendimet me shpejtësi, siç ndërrohen pamjet në fundin e një lumi të rrëmbyer. Më gjatë i qëndroi një ndjesi që i vinte së brendshmi dhe i bëhej se digka e lëngshme, e trashë si gjalpë i shkrirë i rrëshqiste nëpër të gjithë fyejt e eshtrave, duke i lënë një djegësirë gudulisëse gjithandej nëpër trup.

Sosja në krahët e tij vazhdonte të fliste e të qeshte hareshëm. Por ai nuk arrinte të kapte asnjë fjalë të saj. Edhe ajo e ndiente se ai nuk përqendrohej dot, megjithatë nuk i bënte fare përshtypje. Nuk i kërkoi t'u përgjigjej asnjëherë atyre që thoshte për të mos e vënë në siklet. Çse

ndoshta nuk i duheshin përgjigjet e tij, madje mund edhe t'ia prishnin harenë. Për këtë nuk thuhet asgjë.

Thuhet vetëm se mbërritën pa vonesë në majë. Me t'u futur në hijen e lehtë të ahut, Sosja preu si me thikë të folurën e të qeshurën, liroi krahët e harkuar në qafën e Binakut dhe vari këmbët poshtë të mbështetej në tokë, duke thënë tepër me habi:

— Sa shpejt erdhëm!

— Erdhëm, — foli Binaku për herë të parë që nga nisja, me një zë të qëruar, që nuk iu duk aspak si i veti.

Për një çast djali deshi ta kujtonte zërin e vet të mëparshëm, rrëshqitës nëpër buzë, ngaqë zanoret i dilnin gjithnjë të mbytura, po nuk i kujtohej. Atëherë u ngazëllye sepse besoi që ky ishte zëri i tij i vërtetë, të cilin ia kishte mbajtur të kyçur kaq vjet ai tjetri, i shurdhëti, që dilte çdo mëngjes nga ëndrrat e frikshme të natës dhe në mbrëmje strehohej rishtas atje. Ky ngazëllim sikur e përmendi dhe bëri një hap prapa t'i lironte pak vend Soses që të drejtonte trupin e të shtriqej për t'u shpirë. Ndjeu vështrimin e saj ngulmues, por aty për aty nuk i vajti mendja se do të kishte shkak të veçantë.

Vetëm kur ajo nuk po lëvizte, ia vuri re sytë e zgurdulluar sa nuk dukeshin më si sy njeriu. U ishte tharë befasi tërë lëngu vezullues. Që nga kreu i ballit i zbriste një zbehtësi që i mblidhej në gropëzën e mjekrës, si t'i kishin derdhur një

kovë me qumësht të rrahur atje lart. Ç'pate, deshi ta pyeste, po zëri iu shua që në fyt. Ç'pate? Kësaj here e bëri mundin më të madh, megjithatë, për çudi, lëvizja që do të duhej për ta formuar këtë fjalë u përvijua në buzët e Soses. Ndërsa për vetë ndjeu një gërvishtje të mprehtë në fyt, që ia largoi për një çast tmerrin që të jep pamundësia e të shprehurit. Vetëm një herë në jetë e kishte lavdëruar gjymtimin e vet: kur ishte ndodhur pranë një memeci, i cili përpiqej me sy e me gishta të thoshte diçka e nuk arrinte. Veç duke e parë, Binakut gati po i merrej fryma, sepse e ndiente te vetja shtypjen e kraharorit të memecit, nga fjalët që i ngjisheshin përbrenda. Ehu, mendoj, kjo imja është lule. Pa gojë mos mbetshja, pa këto që kam, i puth i vë në ballë. Memecëria, që e kam pasur më frikë, tha tek rrinte si i ngulur në këmbë, ja ku më gjeti tani. E tmerrshme. Po gërvishtja e fytit, që po i zgjaste, sikur e solli në vetë dhe e kujtoi për ujin që rridhte aty pranë me një shushurimë të lehtë si zukamë blete. Mbase mund të më bëjë mirë një gllënjë, tha. U zbraps edhe një hap, pastaj u kthye ngadalë, si të shkëputej me zor prej vështrimit të ngrirë të Soses dhe bëri për nga kroi. Njëpër një gurrë druri, që lëmashku i gjelbër e vjetronte, edhe më tepër, rrëshqiste një gisht ujë, i cili vetëm kur binte në pellgun e vogël e të rrumbullakët dëgjohej paksa. Po pellgut nuk ia trazonte dot sipërfaqen e lëmuar.

Kur u përkul për të vënë buzët te lëfyti i

gurrës, Binaku pa poshtë në pellg një fytyrë djalo-
loshi që nuk e njihje dhe nuk e kishte parë kur-
rrë. Një lëkurë e bardhë, e pavarur fare nga dielli
e as nga era tendosej aq sa të mos lëndohej, por
as të mos i mbetej gjëkund gjurmë rrudhe, mbi
ballin e drejtë që ngrihej lart dhe lëshonte një
hije të lehtë mbi sytë e kthjellët e ua shtonte
thellësinë, mbi faqet që afroheshin pa u ndier te
hunda e lakuar një grimë si në një valëzim të lar-
gët e mbi mjekrën që i rrinte gojës aq poshtë, sa
të mund t'u bëhej kambanë e padukshme fjalëve
të saj. Binaku e harroi fare ujin që do të pinte
dhe gërvishtjen e fytit, i përpirë nga ajo fytyrë.
Pak nga pak, atëherë kur e harroi edhe Sosen që
ndodhej aty, iu duk se tiparet e asaj fytyre nisën
t'i bëheshin të njohura. Diku i kishte ndeshur. E
madje jo vetëm ndeshur rastësisht, kalimthi. U
kishte qëndruar edhe pranë, i kishte kundruar
gjatë i mahnitur sepse ua mbante mend edhe gri-
masën.

— Ç'po bën? — i erdhi nga pas durimhum-
bur zëri i Soses. — Pi më, ose lëshoma mua të
pi. Për këtë e bëmë gjithë këtë rrugë.

— Ah, po, më fal, u hutova fare, — u kthye
ai i zënë keq. — Po se ç'ka këtu në fundin e ujit,
se ç'më fanepset një fytyrë... — Ai u habit nga
i erdhi kështu, i plotë, zëri.

— Nuk e njeh?

— Si të të them? Edhe e njoh, edhe s'e njoh.
Diku e kam parë, po nuk e sjell dot në mend se
ku.

— Në ëndërr. Është fytyra jote, ajo që ke dashur të kesh. Shihe sa e bukur duket në sytë e mi.

Ndërkohë Sosja u afrua. E zuri Binakun nga supet, me një shpengim të një lloji tjetër nga shpengimi që kishte pasur gjithnjë para djemve, e ngriti butësisht dhe e këtheu me fytyrë nga vetja. Binaku ndoqi i bindur lëvizjet, po kjo, në vend që ta bënte vajzën edhe më të pushtetshme, e bëri të druajtur. Kur fytyrat e tyre u ndodhën ballas, thujtë të puqura, aq sa nuk e shquanin më pamjen e plotë të shoqja-shoqes, ajo ndjeu t'i vërshonte me vrull, për nën lëkurë, një gjak i nxehtë dhe t'i mbledhej në dy mollëzat e faqeve. Tani nuk dinte më ç'duhej të bënte. Nuk i vinte asnjë mendim.

Asnjë mendim nuk i vinte as Binakut. Në sytë e Soses, që kësaj here ajo i mbante me zor pa lëvizur, ai pa fytyrën që porsa e kishte braktisur në pellgun e ujit. Dhe iu duk aq e bukur ajo fytyrë, sa nuk e mbyti dot dëshirën ta puthte një herë. Vetëm një herë. Sosja, thua se e kuptoi, zgjati krahët dhe i mbështolli ngadalë në qafën e tij. Po sapo trupi i saj i derdhur u takua me të tijën, ajo ndjeu t'i rëndohej në kraharor ai trup si të qe prej guri. Deshi t'i thoshte njëherë me të qeshur të mos rrinte ashtu si i ngordhur, po nuk i tha, edhe pse mezi po e mbantë atë e veten pa e rrëzuar. Nuk i tha sepse iu dhimbs ai dhe vetja. Nuk deshi t'u prishej ky përçafim i papërfytyrueshëm deri pak çaste më parë. Ndaj, vetëm bëri

një lëvizje të pandjeshme që t'i ngulte më mirë thembrat në tokë.

Grumbulli i djemve që vinin nga poshtë duke gulçuar thanë se Sosja me Binakun qëndruan gjatë të përçafuar. Ose u është dukur gjatë nga zilia. Sosen vetë nuk e takoi dot askush që ta pyeste. Sepse, pas pak, kur ai nuk po e bënte as atë lëvizjen e natyrshme të lypjes së heshtur me buzë të buzëve të saj, ajo mendoi se Binaku do të qe hutuar keq dhe, për ta çliruar disi, por edhe ngaqë mezi e priste atë puthje, deshi ta puthte vetë e para. Dhe, me duart që vazhdonte t'ia mbannte në qafë, ia zuri kokën me një gjest lozonjar. Por koka e tij u luhat dhe u rrëzua si e prerë anash. Ajo shqeu sytë e lemerisur dhe vetvetiu bëri një hap prapa. Atëherë trupi i Binakut, që mbeti pa mbështetje, u përthye te gjunjët e në mes dhe u rrëzua.

— Vdiqe?! — i tha ajo me një zë krejt të shuar. — Pse vdiqe? Po unë ç'të bëj tani?

Kur arriti grumbulli i djemve të djersitur e pa frymë, Binakun e gjetën ashtu kruspull, ndër-sa Sosen drejt në këmbë, qiri të bardhë, me gojën të hapur, përgjysmë e sytë të ngrirë te trupi i ftohur i Binakut. Nga shoku i tyre i dikurshëm njohën vetëm rrobat që dukeshin se nga çasti në çast do të çaheshin nëpër të qepurat nga shtati i mbushur i djaloshit që mbanin brenda.

Në mbarë fshatin ishte marrë vesh lajmi për se të mbërrinin djemtë që sillnin dy të rinjtë e pajetë. Nuk thuhet se kush ia dha mandatën i

pari të atit të Soses. Thuhet vetem se ai, me ta dëgjuar, ishte skuqur njëherë, pastaj ishte zverdhur fare; si t'i avullonte befasi i gjithë gjaku nëpër mjekrën e porsarruar.

— Mbaje veten! — i tha lajmësi.

— Eeee, po s'e mbajta, do të më mbajë vetja mua, — iu përgjigj ai përhumbshtëm.

Lajmësi u largua kokulur, pa ditur ç'ngushëllim t'i jepte. Belbëzoi diçka se do të kthehej pa vonesë, po Zefi nuk iu përgjigj më. E ndoqi me vështrimin e fikur derisa ai i humbi nga sytë dhe u rrotullua të hynte brenda. Të shoqen e gjeti në derë, krejt të topitur. I kishte dëgjuar të gjitha.

— Të pata thënë se i ka hyrë dreqi në bark, — foli ai pa e parë në sy dhe i bëri shenjë t'i hapte rrugën.

— Lëre tani në vdekjen e vet të bukur, mos ia rëndo më! — ia ktheu ajo me një zë ku kishte edhe lutje, edhe kërcënim.

Por ai nuk i vuri re. Dhe mbetën të dy aty, në prag, ballë për ballë, si të ngurosur.

Ndërsa nëna e Binakut që e vetmja që i doli grumbullit të djemve përpara në të hyrë të fshatit, me një shami të zezë në kokë, të ulur deri mbi vetull. Iu lut t'i ulnin dy trupat pa jetë që t'i shihte. Por Soses qëndroi më gjatë e qau në heshtje, pa nxjerrë asnjë fjalë. Të birit iu përkul sipër, po nuk e preku. E çoi disa herë dorën gati t'ia lëmonte kapakët e mbyllur të syve, po se ç'e bënte ta largonte. Duke e parë ashtu, çuditërisht asaj iu thanë lotët. Atëherë kur fytyra e Mrsë

mori një pamje të përgjëruar pendimi, ajo tha dy fjalë e ky qe i gjithë vajtimi, të cilin ia përsëriti edhe më vonë, kur kufomën e vunë në mes të dhomës, si të mos mbante mend më asnjë fjalë tjetër njerëzore për të shprehur ato që ndiente:

*Si nuk munda me të lindë prapë vetë,
të bajsha ma t'bukrin për n'k'të jetë,
ia bekojsha tokën ku ka shkel njajo çikë,
nëma e shpirtit tem i marrtë perënditë!*

1985

NJË MBRËMJE TETORI NË PARIS

Aty për aty nuk e kuptova përse u befasova dhe u gëzova aq shumë, kur në të dalë të pikës ku bëhej kontrolli dhe vulosja e pasaportave, midis morisë së pafund të njerëzve që vejevinin duke u fërkuar nëpër supet e njëri-tjetrit nga denduria e madhe e lëvizjeve, dallova sytë e Anës që po më kërkonin gjithë ankth e padurim. Pata një mosbesim se që ajo dhe në të parë iu përgjigja si me ngurrim shenjave që po më çonte me të dyja duart, duke u përpjekur me mundim të çante midis udhëtarëve të nxituar, për t'u afruar sa më shpejt tek unë. Pastaj dritat e buta të aeroportit gjigant «Orli» ranë në xhamat e bardhë të syzeve të saj, dhe ma bënë përnjëherë intim

tërë atë mjedis me përmasa dhe gjallëri të papërfytyrueshme për këdo që vjen për herë të parë nga një vend i vogël e i qetë.

— Ana, — i thashë unë, ndërsa hipnim në makinë, — sa mirë paske bërë që dole!

— Ajo buzëqeshte, e kënaqur prej gëzimit tim.

— Ç'kemi nga Tirana? — tha.

— Hiç, — iu përgjigja shkurt, — nga shtëpia jote nuk kam parë njëri. Shokët janë mirë të gjithë dhe të bëjnë të fala.

— Nga shtëpia mirë janë, foli dhe në telefon, — më ktheu ajo dhe në zë i dallova një hije të fshehtë pakënaqësie, që më mbolli në shpirt një shqetësim. Ç'pati? Megjithatë nuk e pyeta, nga druajtja mos niste sa pa mbërritur mirë ndonjë dialog i pakëndshëm. Me Anën shoqëroheshja prej gati dy vjetësh dhe herë pas here midis nesh ndodhnin keqkuptime të kota, sepse ajo, çuditërisht, shpesh, kur më pyeste për diçka, kishte në kokë të formuluar edhe përgjigjen që duhej t'i jepja unë. Po t'i përgjigjësja ndryshe, sipas saj, do të thoshte se nuk e kuptoja, ose i dredhoja pa të drejtë. Unë qeshja sinqerisht me hamendjet e saj absurde dhe më dukej se në atë çast të shkurtër acarimi ajo bëhej më e bukur. Ndaj as që përpiqesha ta bindja për të kundërtën, veç e ndiqja me sy, me një lloj kënaqësie tekanjoze, derisa qetësohej. Ajo ishte mësuar me këtë sjellje dhe, duke e ditur se më pëlqen, ndonjëherë edhe e improvizonte ose e zgjaste qëllimisht.

Po, këtë radhë nuk e doja atë trill. Madje nuk

do të mund ta duroja e jo më të më jepte kënaqësi.

Ora po shkonte njëmbëdhjetë e natës dhe autostrada për në Paris ishte plotësisht e ngarkuar. Ana më rrinte në krah dhe në heshtje mblidhte te flokët e vet të bronztë, të prerë shkurt, tërë shkëlqimin e dritave të makinave me të cilat shkëmbeheshin me një shpejtësi të panatyrshme, si nëpër filmat vizatimorë. Ndërsa futeshim në rrethinat e qytetit, e zura veten me vështrim të përhumbur te flokët e saj. Kushedi prej sa kohe nuk kisha parë fare jashtë, sepse nuk mbaja mend asgjë nga pamjet e kaluara anëve të rrugës. Paskam qenë tepër i përmallur për ata flokë, që tani po më shfaqeshin me një vezullim të përtërirë. Ashtu, pa bërë fjalë, ngrita dorën dhe, ngadalë, pleksa gishtërinjtë nëpër fijet e tyre të ndritshme. Po në çast desh e largova me rrëmëzim. M'u duk sikur papritur dora m'u bë krejt e tejdukshme dhe unë dallova, si në një radiografi, skeletin e saj të bardhë me eshtrat e holla. Më mbajti koka e Anës që m'u përkëdhel butë te supi dhe, me kundërmimin e njohur, më çliroi nga agushtia.

— Sa mirë paske bërë që erdhe! — përsërita unë.

Pas xhamave të syzeve u rrotulluan nga habia sytë e saj të mëdhenj dhe kërkuan vështrimin tim.

— Pse? Mendoje se nuk do të më gjeje në aeroport?

— Nuk e di, — iu përgjigja në mënyrë të pa-

përcaktuar. — Nuk e di. Nuk e di as të kem menduar për këtë gjë.

Vërtet nuk e dija.

— Si?!... — Zëri i saj, që mbeti varur, më la të kuptoj se ajo donte të pyeste diçka më gjatë, po kushedi pse ndërroi mendje në çastin e fundit.

Unë mblodha supet si i zënë në faj.

Ajo nuk tha gjë tjetër dhe ktheu kokën gjithë përtesë në pozicionin e mëparshëm, duke ia dhënë flokët lirisht shkëlqimit të harlisur të dritave. Gishtërinjtë e dorës sime mbetën të nemitur, si të mpirë në majat e përdredhura lehtë të atyre flokëve. Ana duhej të bënte diçka, nuk e dija çfarë, po duhej të bënte patjetër diçka që të më afrohej. Përndryshe, ato drita të pakursyera, që e linin krejt shkëlqimin e vet nëpër flokët e saj, pak nga pak do të ngrinin, do t'ia mbështillin gjithë kokën me një akull të verdhëmë, që unë nuk do të mund ta shkrija kurrsesi.

Kjo ndjesi nuk m'u largua as më vonë, kur mbaruam punë me regjistrimin në hotel dhe po hanim darkë në një restorant të vogël japonez diku pranë stacionit «Birhakeim» të metrosë, që e zgjodha unë rastësisht, ndërsa endeshim kuturu rrugëve, afër mesnate. Vendosa të futeshim aty, sepse ai që i pari që më doli përpara, pasi e kisha pyetur Anën disa herë se ku do të hanim darkë dhe ajo gjithnjë më përgjigjej:

— Ku të duash.

— Nuk ke asnjë restorant të preferuar gjithë këtë kohë?

— Jo, çne?! — Dhe buzëqeshi si e çuditur.

Në të vërtetë duhej të çuditesha unë që e njihja natyrën e saj. Ajo, edhe për një ditë kur shkante me shërbim në një qytet tjetër, puna e parë që bënte, brenda dy-tri orëve caktonte me domosdo restorantin ku do të hante për sa kohë do të rrinte aty, kafenenë për të pirë kafenë e mëngjesit dhe të pasdites dhe pasticerinë për ëmbëlsirën e mbrëmjes. Dhe ishte e sigurt se në lokalet që zgjidhte ajo, bëhej shërbimi më i mirë. E pranonte edhe vetë se kjo ishte mani, por e quante mani të nevojshme.

Tani këtu po mbushte dy muaj dhe nuk jep-te asnjë shenjë të zakonit të vjetër. Ç'ka bërë gjatë gjithë kësaj kohe? pyeta veten dhe nuk isha në gjendje të jepja kurrfarë përgjigjeje. Nuk më shtynte tashmë kureshtja të kjo pyetje, por dika tjetër më e thellë. Nga letrat e saj të rregullta dija se ishte vendosur në një laborator serioz, ku do t'i vazhdohte pa shkëputje të gjashtë muajt e stazhit dhe se temën që po përgatiste për prodhimin në vend të një ilaci për kurimin e mëlçisë mbi bazën e një bime tepër të rrallë mjekësore për Evropën e që gjendej kryesisht në disa zona të Alpeve tonë, ia udhëhiqte një profesor i njohur. Dija edhe se profesori ishte përgjithësisht i kënaqur nga puna e saj. U përpoqa një copë herë të sillja ndër mend edhe ndonjë hollësi tjetër nga ato pesë-gjashtë letra të saj,

po më kot. I mora letrat inat, sikur gjithë fajin për këtë vështirësi mirëkuptimi me Anën ta kishin ato. Bashkëbisedimi me letra është një gënjeshërë, thashë, një diçka që mund të shprehet duke u prishur e ndrequr njëqind a një mijë herë, derisa t'i vijë tamam për shtat atij që ka penën, nuk është kurrë plotësisht i sinqertë. Një bashkëbisedim që bëhet me stil, shfryva në heshtje, sikur pikërisht stili të ishte sinonimi i mashtrimit. E kuptova se po mendoja marrëzira, megjithatë nuk e përmbajta dot veten.

Sidomos pas atij ndryshimi të hollë në mënyrën e saj të jetesës, që mund ta vija re vetëm unë, që ia njihja mirë huqet, m'u bë edhe më i pamundur përfytyrimi i preokupimeve të saj gjatë asaj periudhe larg meje. Duhej të vija këtu që ta kuptoja se ajo kishte hyrë në një zonë atmosferike të papërshekueshme nga valët e trurit tim. Këtu më fshihej edhe ajo diçkaja e papërcaktuar, që ia ndjeva nevojën qysh në fillim e që isha i pafuqishëm ta zbuloja. Ndryshe, ky qytet i madh llamburitës, në vend që të na bashkonte në këtë takim shumë të dëshiruar, do të na ndante keqas.

Menuja ishte e gjatë, disa fletë të mbushura me emra gjellësh, krejt të panjohura edhe për mua, por edhe për Anën. Ndaj as unë, as ajo nuk mund të zgjidhnim. Duke i ndjekur me sy ngadalë rreshtat e atyre fletëve, të shtypura pastër në dy gjuhë, frëngjisht dhe japonisht, u përpoqa të sjell ndër mend ndonjë emër gjelle të lexuar nëpër ro-

manet japoneze, po më kot. M'u kujtua vetëm pija e tyre, sakeja. Nga letërsia japoneze klasike dhe moderne kam lexuar mjaft, dhe gjithnjë më është dukur nga letërsitë më interesante të botës. Ndaj m'u duk se pësova njëfarë zhgënjimi, sepse, një herë që pata nevojë për të, nuk më ndihmoi. Dhe pikërisht në një rast të tillë zbulova edhe një mangësi të saj: ajo nuk jepte thujtë aspak informacion për të ushqyerit e atij populli. Pse i ishin shmangur edhe shkrimtarët e mëdhenj këtij fakti, kur dihet se edhe mënyra e të ushqyerit të një populli të ndihmon të analizosh nivelin e tij ekonomik?

Kamerierës i thamë shkurt, pa hyrë në hollësi, të na përgatiste një darkë të vogël, familjare, karakteristike japoneze. Pastaj unë, në mënyrë të pavullnetshme, u ktheva prapë në përhumbjën e mendimeve të mia dhe Ana në të vetat. Heshtja po zgjatej tepër. Ç'bën, i thirra dikur me sy, nxirre më atë fjalë, të shkretën, se po çmendem nga pritja. Ana e ndjeu vështrimin tim dhe foli:

— Ç'po mendon?

Ishte pyetja më e kotë që mund të më drejtohej prej saj në ato çaste dhe gati u hodha përjetë nga nervozizmi, por u përmbajta me shpresë se, boll të fillonim të flisnim, pa do të dilte vetë patjetër edhe ajo e fshehta që më duhej.

— Po ti, ç'po mendon? — ia ktheva pyetjen.

— Unë?! — Ana bëri një buzagaz të lehtë, mblodhi supet si e zënë ngushtë dhe tha: — Hiç!

— Si hiç! Hiçi s'ekziston. Apo, që kur ke ardhur këtu, s'je më materialiste? — desha të bëja një shaka.

— Ja, po mendoja për ty.

— Unë s'jam hiçi, — u përpoqa ta vazhdoja shakanë, po m'u duk se asaj nuk i pëlqeu, ndaj e ktheva me seriozitet: — Ç'po mendoje?

Biseda e kishte një tension të brendshëm, të cilin qëllimisht as unë as ajo nuk donim ta vinim re. Për mua kryesore qe se besova që po nisnim njëfarë rruge që do të na bashkonte, sepse do t'i hapeshim pak nga pak njëri-tjetrit. Dhe u gëzova.

— Po mendoja që kemi më shumë se tri orë bashkë dhe ende s'më ke puthur një herë.

Në sytë e saj farfuriti një trishtim që u përthye si dritë vetëtime nëpër xhamat e tejdukshëm të syzeve dhe shkoi e u fsheh diku prapa retinës, duke ia bërë vështrimin më të thellë, por edhe më të padepërtueshëm. E dija që ajo thellësi do të zbrazej shumë shpejt dhe do të shndërrohej në një hon të errët, po të mos e mbushja unë menjëherë me një mbresë që ta gjallëronte. Papritur ajo ma kujtoi qenien e vet femërore. U rrëqetha. Pse duhej të ma kujtonte me fjalë? Si të mos e ndieja unë vetë praninë e saj të tillë? Nuk munda të përgjigjesha dhe zgjata dorën përmbi tavolinë drejt qafës së saj. Por ajo u largua si e trembur. Nga lëvizja e rrëmbimtare e kokës, nga flokët iu derdhën poshtë të gjitha vezullimet dhe

ato për një grimë herë fituan ngjyrën e dikurshme, të bronztë-të mbyllur.

— Jo, — tha e vendosur. — Tani jo. E puthura s'është borxh që i kërkohet tjetrit kur s'ta jep.

Unë nuk dita si të bëj dhe në fytyrë m'u shpërnda vetvetiu një buzëqeshje budallaqe. Dora më mbeti pezull si e harruar. Isha gati t'i thërritja me zë të lartë se kishte shumë të drejtë dhe se, me fjalë të tjera, tamam këtë gjë mendova edhe unë kur ajo ma kujtoi se ende nuk qemë puthur, edhe pse mbrëmjes po i vinte fundi. Në rrëthana të tjera, në Tiranë, kaq orë të përbashkëta do të kishin mbaruar tashmë me ndjelljen e gjumit nga trupat e shkrehur prej lodhjes. Po këtu, thashë, pse duhet të ndodhë ndryshe? Ndarje të tilla prej muajsh zakonisht e shtojnë joshjen dashurore. Dora ishte tërhequr pa e vënë re unë dhe po luante me çakmakun, e shkujdesur, si të mos qe gjymtyra ime. Atëherë desha ta pyesja edhe Anën se deri kur do të rrinte ashtu e mbyllur, pa ma zbuluar atë enigmë që vërtitej midis nesh si magji e këtij qyteti dhe po më përpinte, aq sa të m'i platiste edhe instinktët e të dashurit të një vajze të bukur.

Por nuk ia thashë asnjë nga këto. Diç më mbante. Nuk i thashë as se, po të vazhdonte kështu, do të ma hinte të huaj edhe vetë qytetin, ku kisha gjithë mbrëmjen që vërtitesha si somnambul. Derisa ajo jetonte aty që prej dy muajsh, unë nuk kisha portë tjetër veç asaj që do të më

çelte Ana për të hyrë në atë jetë, nga ku do të largohesha përsëri pas dy javësh dhe doja të merrja sa më shumë mbresa. Pra, nuk i thashë asgjë nga këto, vetëm vazhdoja ta shikoja me ngulm, pa e përzënë dot nga fytyra atë buzëqeshjen budallaqe.

— Mos më shih ashtu! — tha Ana.

— Ke ndryshuar.

Nga druajtja mos i thosha ndonjë gjë që e zbulonte atë tension që lëvizte si rrymë e nëndheshme ujore në bisedën tonë dhe të dy hiqeshim sikur s'e vinim re, mua më shpëtoi pikërisht ajo fjalë që nuk doja të dilte prej gojës sime, sepse do të vinte, siç erdhi, si një konkluzion. Ndërsa prej saj do të më shpleksej natyrshëm, pak nga pak, si pasqyrim i brendshëm i jetës që kishte bërë ajo ditë pas dite në këtë qytet. Ndaj u pendova menjëherë për fjalën që thashë, po nuk e tërhiqja dot më.

— Po, — m'u përgjigj Ana pa vonesë. — Kam ndërruar skeletin e syzeve, modelin e flokëve. — Në zërin e saj vibronte një ironi e përmbajtur, që ia thante kumbimin.

Sidoqoftë, me këtë përgjigje ajo më dha rast që ta ndreqja mendimin që më iku i pakontrolluar, por tashmë, nuk e di pse, nuk desha.

— Këto i shoh, — thashë. — Dhe i ke bërë shumë bukur. Më të bukura se më parë. Po ka ndryshuar edhe diçka tjetër te ti, që nuk po arrij ta shoh, sado që kam tërë mbrëmjen që përpiqem.

Ajo vuri buzën në një gaz të hidhur për një

çast dhe u bë serioze. Pas pak tërë fytyra i mori një pamje të merakosur.

— Mbase, — tha përhumbshëm. — Por unë nuk e konstatoj dot te vetja. E kam të vështirë, se edhe nuk e kam vrarë mendjen për këtë. Ti mund ta shohësh më mirë se kushdo.

Dukej që Anës i ranë krejt të papritura fjalët e mia dhe e tronditën. Ndaj mua më erdhi vërtet keq. Ndoshta nuk duhej të shkoja kaq larg. Ndoshta ishte edhe thjesht një përshtypje e rreme, e pjellë prej trurit tim të lodhur nga udhëtimi i gjatë dhe të pamësuar me përpunimin e një informacioni të tillë nga mjedisi përreth. Kushedi. Sidoqoftë Ana, kur më tha se askush më mirë se unë nuk mund t'i vinte re ndryshimet e saj, bëri një pohim që mua, si i dashuruar, më shkaktoi një drithërimë kënaqësie dhe më kujtoi se duhej të tregohesha i kujdesshëm, për të mos e lënduar atë krijesë të brishtë që ishte vërtet e dashura ime.

Po pikërisht kjo lidhje dashurore ma ngjallte paprerë nevojën të zbuloja gjurmët që kishin lënë në botën e saj ditët e kësaj periudhe kaq të gjatë pa mua. Nuk dija ç't'i thosha, sepse ky mendim më rrinte gozhdë në tru. Dhe nuk më vinte në kokë asnjë nga ato temat e kota, që janë të shpeshta midis të dashuruarve e që krijojnë një atmosferë të shpenguar në marrëdhëniet e tyre intime. Kjo do të qe rrugëzgjdhja më e mirë. Përsonte më mjaftonte aq ngarkesë e tensionuar sa kisha marrë. Po për dreq, fjala më vërtitej në-

për gojë si një shpend i verbër dhe, sa donte të dilte për të fluturuar për tek Ana, merrte formën e një pyetjeje që lidhej patjetër me ndryshimin e saj të pashpjegueshëm. Mbase që më mirë ta lija atë të fliste e para, të thoshte ç'të donte, ç't'i vinte nëpër mend, veç të fliste. Derisa tek ajo gjithçka kishte ndodhur në mënyrë të pandjeshme, dhe për këtë nuk dyshoja, me siguri nuk do të mund ta kontrollonte veten në atë masë sa të ruante vazhdimisht të errët atë qoshe ku doja të hyja unë. Do të ndizej me domosdo ndonjë dritë që të më ndihmonte të shihja atje.

— Fol diçka! — i thashë dhe ngrita gotën me sake për ta takuar me të. Zëri më doli më i prerë sesa duhej dhe ajo e kuptoi si një urdhër, ndaj u përpoq ta kalonte.

— Ç'të them?! Ja, gëzuar!

— Të pëlqen kjo pije? — i shkova unë pas.

— Nuk e kuptoj pse pihet e nxehtë. Mbase e ftohtë do të kishte më shije.

— Tani shkon. Tetori këtu qenka shumë më i freskët se në Tiranë.

— Nuk besoj të na e kenë servirur të tillë nga ky shkak. — Në zërin e saj dallova atë ironinë e përmbajtur, që e kishte në karakter.

— As unë nuk besoj. — Vura buzën në gaz.

— Atëherë pse thua gjëra që nuk i beson as vetë?

Në brendësi të zërit të saj u tendos përsëri me rrëmbim ai filli i hollë i çeliktë dhe lëshoi ca tinguj të mprehtë nervozizmi. Po ç'të them, pra?

Ato që besoj unë, ty s'të pëlqejnë, gati i thirra para fytyrës. U përmbajta sepse e kuptova që edhe ajo priste diçka prej meje, ashtu siç prisja unë nga ajo. Kësaj here heshtjen e prishi Ana.

— Ç'kemi ndonjë të re nga Tirana? — përsëriti ajo pyetjen që më pati bërë qysh kur erdha.

— Të re?! S'ka. Të reja pres unë nga ti.

— Oh! Të rejat e mia do t'i shohësh vetë me sy nesër, pasnesër...

— Dua t'i shoh me sytë e tu qysh sonte.

— Mos ki padurim! Bashkë do të jemi edhe nesër.

Nuk e zgjata më tej nga druajtja mos e vija në siklet. Ndoshta vërtet nuk i përmbliidhte dot mbresat e veta. Ndosht kjo kur ato janë të dyn-dura. U gëzova sepse m'u duk se gjeta një arsye të bindshme për ta larguar mendjen nga ato humltime të ngatërruara që më kishin lodhur jashtë mase gjithë këtë mbrëmje.

— Si ka mundësi?! Gjithë kjo kohë dhe andej nuk paska ndodhur asgjë e re, asnjë ndryshim për të ma treguar?

— S'ka kaluar shumë, — iu përgjigja i çuditur, — ende s'janë bërë dy muaj.

— Sidoqoftë, dy muaj s'janë pak. Pastaj mua më duket shumë gjatë.

Ajo mori qëndrim pritës, ndaj unë duhej t'i thosha patjetër diçka.

— Në uzinën tuaj u përfundua impianti i ri i prodhimit të shiringave plastike.

— E di, — tha ajo me një buzagaz të lodhur, që iu përhap ngadalë nëpër fytyrë, — e lexova

në gazetë. Edhe këtu na vjen «Zëri i Popullit».

Unë mblodha supet si për t'i thënë: «E po ç'kërkon atëherë?» Lodhja zuri vend e s'po largohet edhe pasi nga fytyra e saj u fik buzëqeshja. Dhe fytyra e Anës, si e të gjitha vajzave të bukura, e ndien shumë lodhjen, sepse, duke e pasur të theksuar freskinë dhe lëvizshmërinë e tipareve, bëhet përnjëherë e flashkët dhe uniforme, si një përrua i kthjellët malor që derdhet në një gjol.

— Çohemi! — thashë unë.

— Po. — U duk që ajo mezi e priste këtë fjalë.

Sapo dolëm jashtë, ajo më futi krahun dhe u shtrëngua fort pas meje. Nëpër rrugët e Parisit kishte vërshuar një mjegull e hirtë që të krijonte një ndjenjë të këndshme vetmie. Piklat e dendura, të pakapshme të mjegullës mbështilleshin me ngulm pas dritave të makinave jashtëzakonisht të shpeshta që vejevinin dhe ua bënë ndriçimin të kapitur, të përgjumur. Por këtë përshtypje ta largonte shpejtësia me të cilën rendnin ato. Ora kishte kaluar dy e natës. Kur fleky qytet, thashë me vete, kur e ka kohën e ëndërrimit? Qytet i çuditshëm, shtova në heshtje pas pak, kur pashë se edhe syzet e Anës, të mbështjella me atë mjegull, dukeshin si dritat e makinave, qytet i çuditshëm, ti do të më ndihmosh ta rinjoh të dashurën time, apo e dashura do të më ndihmojë të të njoh ty? Tani isha i sigurt se vetë mënyra e jetesës e këtij qyteti ia mbante ndezur asaj ndjenjën e pritjes së të rejave prej meje që vija nga atdheu.

FOTOGRAFIA

Pjesa e parë

1

Kapiteni i xhandarmërisë, sado që e mbante veten për psikolog të fortë, me aftësi të lindura, por edhe të zhvilluara nga leximet e posaçme, siç e thotë edhe në relacionin e hollësishëm për shkëlqesinë e tij, ministrin e Brendshëm, nuk arriti të merrte vesh asgjë nga ç'po ndodhte te nëna e Sokol Gecit, që e kishte përpara. Që në vështrimin e parë, sapo mori në dorë foto-

grafinë, ajo njohu flokët, mustaqet dhe diçka nga forma rrumbullake, e mbushur mirë e fytyrës së të birit. Pastaj, në mënyrë të pave-tëdijshme ajo kërkoi sytë. Gjeti dy sy të hapur deri në fund dhe që të shponin tejprëtej. Diku thellë nga brenda u buronte një dritë e pafikur avullore që i përhapej që aty e të shkonte nëpër gjithë trupin si ethe. Dhe nëna ndjeu si i kaloi nga këmbët te koka një rrëqethje e keqe. Instinkti amësor i tha se mjaftonte kjo për t'u bindur se ai nuk ishte i biri. Fëmija, edhe në hallin më të madh, nuk mund t'i dërgojë nënës fantazmën e vdekjes.

Duke i vështruar për një kohë të gjatë, plaka pa me një çudi të lemerishme si nisën të ndryshonin sytë e bojatisur me të zezë mbi copën e vogël të letrës. Ajo drita rrëqethëse që buronte pareshtur prej tyre e që të mbillte në shpirt tmerrin e vdekjes, erdhi duke u mpakur ngadalë, derisa ia lëshoi përfundimisht vendin një krenarie tallëse, që të përzinte edhe më përdhunshëm se frika e fillimit, nuk të linte asnjë shteg t'i afroheshe, të miqësoheshe sadopak me ta. Ky ndërrim i papritur i pamjes e bëri plakën të mos u besonte, për një çast, as letrës së stamposur, as syve të vet dhe, pasi i fshiu me cepin e shamisë, u kujtua se të parët po ia vidhte përditë e më shpejt, por pa e ndier, mosha. Ishte një tallje këmbëngulëse, e papërmbajtur, pa asnjë buzagaz, qoftë edhe të shtirë, për ta fshehur ndopak vrerin. Dhe ç'ësh-

të më e keqja, as që e ndiente të nevojshme ta fshihte atë mllëf. Nuk kënaqej pa të posttëruar gjer në fund. Megjithatë, plakës iu bë se njeriu i letrës ishte i pamësuar në këtë veprim dhe e kryente atë me një zor të madh, zor që i fundosej thellë-thellë syve, siç fundosen gurët në një pus. Burri i letrës, sikur ta ndiente që plaka po gatitej të thoshte për të «i shkreti!», i veshi përnjëherësh sytë e vet me një ngjyrë të hirtë të mbyllur, të papërshkueshme, që i shkonte më së miri egërsisë së talljes.

Sesi ndiheshe, edhe fizikisht i këputur, kur shkëputeshe prej atyre syve. Vetëm prania e kapitenit e mbajti plakën pa u rrëzuar në çastin që shtrinte dorën që i dridhej për ta vendosur fotografinë mbi tryezë. Jo vetëm gju-njët, por edhe supet i dhimbnin nga tendosja e stërmundimshme për të qëndruar drejt. Ç'nuk do të jepte ajo që ta mbaronte sa më shpejt atë bisedë e të dilte prej andej. Gjëja më e habitshme i dukej atë kohë bindja e palëkundshme e kapitenit se në atë copë letër të fortë, që quhej fotografi, që djali i saj dhe askush tjetër. Megjithatë nuk i vuri shumë faj. Tha me vete se me siguri do t'ia donte puna të ngulte këmbë ashtu. Qe mësuar me bëmat e përditshme të xhandarëve, që më të shumtën s'i hante gjëkund arsyeja e malësorëve. Ajo e kishte zakon ta shihte njeriun kurdoherë bre-

nda zanatit të tij. Po hipe në minare, ezanin do të falësh, thoshte, s'do të ushqesh pulat.

Gati po përhumbej në këto mendime, kur kapiteni, që e kishte ndjekur tërë kohën me një vështrim hetues, i foli:

— As djalin tënd nuk po e njeh? — Zëri i tij i shtruar, pa kurrfarë kërcënimi, ia hoqi plakës ngurrimin, ndonëse kuptohej që ndihej disi e prekur në sedër nga kjo pyetje.

— E njoh, — tha, — si s'e njoh?! Por e njoh siç e kam bërë vetë. — Plaka heshti dhe pa nga kapiteni. Iu duk se ai nuk e mori vesh, ndaj vazhdoi: — Njeriu njihet nga shpirti. Im bir, kur rri para meje, është i urtë e i dhimshur, jo si ky burri juaj këtu. Kurrë jo!

Në fjalët e fundit zëri i saj u tha e u hollua si të dilte nga fyejt e eshtrave të plakës. Ajo heshti përsëri dhe kur pa nga kapiteni, në fytyrën e të cilit iu bë se dalloi një hutim, mendoi se mbase e teproi, ndaj e gjeti të udhës t'i lëshonte pak pe. Atëherë i tha se kushedi edhe nuk shihte mirë, ia kishin fajin sytë e lodhur. Megjithatë kapiteni e kuptoi që ajo në vetvete ishte e sigurt që nuk gabohej aspak dhe u shpreh ashtu ngaqë nuk gjeti fjalë tjetër t'i vinte kapak bisedës. Dhe e kishte pikasur drejt. Ajo, me ta ndier se nuk kishte më ç'të thoshte, donte të largohej sa më parë, të shpëtonte gjithsesi prej atij njeriu që, sidoqoftë, nuk po sillej keq me të, siç e pati menduar gjatë rrugës. Mezi priste të ve-

çohej diku e të qante derisa të shfryhej. Befas e kishte zënë një mall kaplues për të birin dhe një frikë e tmerrshme se nuk do t'i shihte më kurrë sytë e tij.

Vetvetiu tërë figura e djalit u mblodh te sytë, dhe nënës ata sy iu fanepsën në kuadrantin e përdiellur të dritares, ashtu siç i njihte, gjithmonë të dhemshur për të. Ishte fare i vogël, as katër vjeç, kur atij i vdiq i ati. Nuk i harrohej një mbrëmje, pak kohë pas mortit. Ajo, ulur në anë të zjarrit, po qante në heshtje. Ai e pa, la macen, iu afrua ngadalë e, duke ia fshirë lotët me duart e vogla, i tha:

«Nëno, mos u mërzit, më ke mua. Hë, pra, mos qaj se do të qaj edhe unë mandej.»

Nënës i shkuan drejt e në zemër ato fjalë. Në sytë e tij pa një dhemshuri të trishtuar, të pafund.

«Kush të mësoi të flasësh kështu?» e pyeti ajo dhe u mundua të bënte buzën në gaz.

«Vetja ime më mësoi. Se vetja ime nuk do që ti të qash», tha ai tani më serbes, ngaqë e kuptoi dhe u gëzua që nënës i erdhi mirë nga fjalët e tij. Dhe iu duk vetja burrë derisa thoshte diçka që e prekte nënën.

«O, të pastë nëna, të pastë!» Ajo s'la vend të fytyrës pa ia puthur djalit, e sidomos sytë.

Ata sy ditën gjithmonë ta shohin si nënë, ta shohin si nënë të vetmuar, që s'ka njeri tjetër veç atij. Ai i kishte mbetur asaj gruaje që të mos i këpotej lidhja me jetën e gjallë.

Edhe kur u bë burrë, prapë sytë e tij nuk ndryshuan. Nuk duruan asnjëherë ta shihnin nënën në vaj. Ose do të pushonte ajo, ose do të vajtonte edhe ai. Ishte një kusht që ajo s'mund ta pranonte. Ndaj i zgjoheshin aty për aty, si prej një mrekullie, forcat e besimit dhe ndiente së brendshmi një drithërimë gëzimi. I çelej fytyra dhe i vinte në buzë një gaz i lehtë, por i vërtetë, që ia nxirrte shpirti. Dhe për ditë të tëra ndihej pastaj më e çliruar. Ky hov i shpenguar për ta marrë jetën përpara me kurajë, ishte dhurata më e çmuar e tij. Sa mirënjohëse i ishte për të! Ajo thoshte sa herë me vete se djali, shyqyr, iu bë i mirë, e donte dhe dinte t'ia jepte dashurinë. Madje, edhe atëherë kur, ndoshta, kishte të drejtë të prekej pak prej saj, prapë.. Një ditë ajo ia rëndoi pa shkak nusen, ia shau dembelicë e duarlënë, i tha se qe mësuar keq t'i gjente të gjitha gati prej saj. Qenë fjalë të helmëta e krejt të pavend për një gjë fare kote, që as ta përmendësh nuk ia vlen, po plaka qëlloi e mbushur me dreqnit e vet, siç thoshte më vonë vetmevete e ia shkarkoi nuses së shkretë! Ishte kohë dreke e Sokoli nuk vonoi të vinte. Pa sytë e së shoqes, të enjtur nga e qara, dhe deshi të dinte ç'i pati ndodhur, por ajo u shmang e nuk i tregoi gjë.

«I bërtita unë», ndërhyri plaka me një vendosmëri të shtirur, pa ia hedhur vështrimin as njërit, as tjetrit. E dinte që ai e donte fort

nusen dhe tani po i qëllonte për herë të parë të hynte në mes të atyre të dyjave. Plaka priti me djallëzi se cilës do t'ia mbante anën.

«Ha-ha-ha, — qeshi Sokoli me të madhe. — Po ma prishët gjakun, more, se më shkoi mendja për ndonjë të ligë. Nëna kështu e ka, — iu drejtua së shoqes. — Të bie me një dorë e të mban me tjetrën. Mos u mërzit! Sa herë më ka rrahur mua! Ti tash po e fillon.»

Nusja vuri buzën në gaz e deshi të thoshte diçka, por ai nuk i la kohë se iu kthye plakës, serioz:

«Nëno, mos ma nguc nusen, nëno, se të bëj atë që s'e pret.»

Plakës nga këto fjalë iu ftoh i tërë trupi, si t'i kishin futur heje akulli drejt e nën lëkurë.

«Ç'më bën?» kërceu gjithë pezm.

«Të çoj peshë e të shtrëngoj sa të të mbyt», i tha ai dhe pa e zgjatur e përfshiu për mesi me të dy krahët e fuqishëm dhe e solli rrotull nëpër dhomë. Sytë e tyre ishin krejt pranë e pranë dhe ajo shihte si lëvizte në ta një e qeshur e brendshme e bukur, që s'linte gjëkund të dukej hije mërie.

Dhe tani, ky kapiten i xhandarmërisë i thoshte se në atë copë letër na qenkërkan ata sy!
«Jo, more zotni! Nuk ngjajnë siç nuk ngjan nata me ditën.» Iu duk se oficeri nuk po i besonte dhe mallkoi veten që kishte rënë aq keq në atë lak kujtimesh e nuk po arrinte ta

nxirrte fjalën që i duhej. Që plakë e «s'ka marre më të madhe se të thonë për plakën që rrejti.» Ç'be t'i bënte këtij xhandari, që ai ta besonte se nuk po e rrente, se nuk po i fshihej, se ata nuk janë e nuk janë sytë e të birit? «Ky vend ta futka dreqin e zi në shpirt, tha pastaj me vete ankueshëm, ta tutka e ta tretka edhe benë atje ku s'kthehet ma.»

2

Kapiteni nuk gabon kur thotë se nusja e Sokol Gecit hyri në zyrën e tij shumë e trembur dhe e shpërqendruar. Nuk gabon as kur thotë se pak më vonë asaj i iku kjo trembje, fitoi qetësi e siguri, bile filloi të përgjigjej edhe me njëfarë egërsie. E nuk kaloi ndonjë kohë e gjatë, vetëm disa minuta. Kapiteni nuk kërkoi të dinte nga i erdhi ky ndryshim, pasi i besoi tepër taktit të vet dhe kjo i dha një kënaqësi të vogël profesionale.

Në të vërtetë, gjatë atyre minutave në shpirtin e saj kishte ndodhur një përmbysje e madhe hamendjesh torturuese që e kishin kapluar qysh kur dy xhandarët e armatosur i thanë, shkurt e ngrysur, të shkonte me ta, bashkë me dy djemtë, sepse i kërkonte komandanti i postës së tyre.

— Qyqja! — kundërshtoi ajo, — ç'punë kam unë në xhandarmëri! Le që keni thirrë edhe nënën. Atje e keni, merruni vesh me të. Ajo është zonjë shtëpie e mundet me ju dhanë përgjigje për çkado që t'ju nevojitet.

— Lëri llafet e bëj si të thonë, — ia prenë xhandarët.

Ajo e pa që nuk kishte rrugë tjetër, ndaj u bë shpejt gati për vete dhe veshi edhe djemtë.

— Mos tregoni që babai vjen herë pas here, netve vonë në shtëpi, — i porositi dhe doli në oborr, ku po e pritnin të dy burrat e armatosur e fytyrëvlarë.

Gjithë rrugës mendja i punoi vetëm për të liga. Një herë tha se do të kenë vlarë Sokolin dhe tërë trupi iu nguroso nga ky mendim, si prej një ngërçi të tmerrshëm. E nëmi një mijë herë veten, po, prapë nuk arriti ta përzinte përfytyrimin e trupit të tij të pajetë, të prishur nga plumbat e shumtë e të lëshuar përmbys drejt e mbi dysheme.

Ajo i rrinte pranë, në këmbë, e ngrirë dhe nuk i jepej të bënte asnjë lëvizje. Diçka, që as vetë nuk e dinte ç'që, e mbante fort, sa as për ta kthyer mbarë nuk përkulej dot. Sytë i ndiente të thatë, krejt të thatë e të lëbyrur, sikur nëpër ta përhapej një i nxehtë guri të djegur. Lotët me siguri i tereshin nga brenda, sepse xhandari që e shoqëronte nuk e përmbajti çudinë që ajo s'po qante.

«Edhe ty ta paska pasë mërzitë jetën ky helekuk.»

Ajo e dëgjoi tjetrin që foli, po veshi nuk ia kapi fjalët. Vetëm nga buzagazi cinik dhe vështrimi i tij i pjerrët mbi kufomën e kuptoi se ai tha diçka si sharje për të vrrarin. Ndaj e shkundi pak veten e ia ktheu:

«Mos i rëndo të vdekurit se bën gjynah para zotit!»

«Para qeverisë mos bëj gjynah, — iu përgjigj ai menjëherë, sikur mezi priste të çelej një bisedë, — se qeveria të bën kështu, — dhe vështrimi i tij ra pjerrët mbi kufomën. — Po, para zotit, ehu...!»

«As qeveria s'duhet të hyjë në gjynah me njeriun e shkretë, zotni, se e çon në ditë të hallit e... dy duar për një kokë janë», tha ajo dhe i uli përsëri sytë nga i shoqi, i cili papritur filloi të lëvizte ngadalë, derisa u rrotullua në shpinë, me fytyrë drejt saj. Ajo nuk mbyti dot një klithmë që iu end një herë si bubullimë nëpër tërë trupin, e tundi mirë e mirë sa e shpiu krejt e pastaj shkrepiti jashtë.

«Ku-ku!»

Sokoli pa që e trembi tepër nusen e i tha me një zë të dhemshur:

«A të kam thënë se nuk jap shpirt në duart e kurrkujt tjetër?»

— Mos ia mbërritsha asaj dite, — tha dhe ndjeu një lehtësim të çuditshëm jo ngaqë ai i

kujtoi përbetimin, po sepse arriti ta zbonte frikën e moskthimit të tij.

— A the gjë, nënë? Me kë po flet?

Zëri i djalit të madh, që ecte në të djathtë të saj, e solli në vete. Ajo bëri hidhur buzën në gaz. E kuptoi që, padashur, kishte folur me zë të lartë. E kishte humbur fare. Pa se rrugës po i shkonin në gjysmë dhe u çudit si nuk qe rrëzuar gjëkund ngaqë i kishte hedhur hapat ashtu kuturu. Megjithatë e ndiente veten krejt të drobitur. Ajo fanepsje e gjatë i iku vetëm nga sytë, por i mbolli në shpirt një angushti që ia shtoi ankthin e së papriturës. Ç'e priste përpara, në postën e xhandarmërisë? «Nuk do të di as të flas, tha me vete, të merrem vesh.» Kushedi si e donin llafin këta njerëzit e qeverisë, me të cilët ajo takohej për herë të parë ballë për ballë. Pastaj thuhej se atje në postë, ndërsa të merrnin në pyetje, një tjetër i mbante shënim të gjitha përgjigjet. Në mbarim të detyronin të vije në fund të letrës së shkruar bulën e gishtit të madh, të lyer me bojë. E keqja e kësaj pune dilte një ditë më pas, kur të numëronin gjëra që i paske thënë e që, në të vërtetë, as që të kishin shkuar ndonjëherë ndër mend. Dhe këtë ta vërtetonin me njollën e gishtit tënd që gjendet për nën vijën e përdredhur, ku thuhej se është emri yt. Le t'i kundërshtojë sa të doje, ligji i besonte vetëm së shkruarës. Dhe, po të ngulje këmbë, të kërcitnin dhëmbët.

«Atëherë kush gënjen? Njerëzit e qeverisë?!»

Po këta i kemi nga më të zgjedhurit. Jo, ore, jo, nuk të lë njeri të hedhësh hije mbi ta.»

Dhe ishin gati të të vinin hekurat po të mos tërhiqesh, madje edhe duke lypur të falur e duke sharë veten si i paditur e i pagdhundur. Nusja kishte dëgjuar disa raste të tilla dhe druhej mos i ndodhte edhe asaj ashtu. Do ta pyetnin për Sokolin, se me siguri do ta kishin arrestuar. Ajo do të përgjigjej si ta shihte se i bënte më mirë atij, pa u trembur për veten. Po halli që se kushedi ç'do të shkruanin në atë fletë. Ç'nuk do të jepte atë çast të dinte shkrim e këndim!... Do t'i shkonin pastaj Sokolit në birucën ku e mbanin të mbyllur e do t'i thoshin: «Pse i bie mohit? Ja si na tha gruaja jote.» Ai, duke i dëgjuar, do të mendonte se ajo e paskësh tradhtuar, edhe më keq, paska shpifur. E do të pezmatohet e pendohej për dashurinë që i kishte falur. Pas këtij pendimi, asaj do t'i vinin fjalët e tij: «Mos t'i pafsha më sytë!» Atëherë, më mirë të vinte vdekja...

Po sikur t'ia nxirrnin Sokolin përballë? Dhe aty, në sy të saj ta rrihnin e ta hiqnin zvarrë për flokësh, t'ia shkulnin mustaqet apo ta kapnin në vend të keq, siç kishte ndodhur para disa vjetësh me Hilë Kamanin, atë që, pas vrasjes së Bajram Currit, doli në mal dhe i dërgoi lajm mbretit se do ta vriste për t'i marrë hakun Plakut. Gruaja e Hilës, duke e parë të shoqin si hiqte e si i mbyste dhimbjet përbrenda, ndërsa nëpër faqe i rridhnin çurg lotët e he-

shtur, u thinj e tëra në çast dhe u çmend... As ajo nuk do të duronte dot... Edhe ajo do të çmendej. Por aty për aty u kujtua për fëmijët që do të mbeteshin jetimë, pa nënë e baba dhe u mbush trishtim e dhimsuri për ta. Nuk mundi ta përmbante një gulç të thellë vaji që i doli nga fundi i kraharorit, duke ia shkundur fort supet...

— Nënë, ç'ke, pse po qan? — i foli ulët përsëri djali i madh, duke e parë drejt në sy me një vështrim të pafuqishëm.

Dy xhandarët kthyen kokat nga ata, po nuk hapën gojë.

Nëna vuri dorën në kokën e djalit dhe ia përkëdheli lehtë flokët. Në buzë i doli prapë një gaz i zbehtë, i hidhur. I erdhi inat që nuk po i fshihte dot mendimet që e brenin. E dinte që nuk po bënte atë që duhej. Në vend që të mbahej sa më e fortë për t'u dhënë zemër edhe dy djemve që ishin ende të parritur, po i ligështonte.

— Mos qaj! — i tha djali i madh dhe i shtrëngoi dorën, ndërsa kapërcenin portën e oborrit të postës së xhandarmërisë.

Fjalët e tij dhe dora që e shtrëngoi i dhanë pak forcë, po nuk mundën t'i largonin dridhjet e ftohta që i endeshin nëpër gjithë trupin si fyej akulli. Kur xhandari i shërbimit, në hyrje të postës, u tha dy shokëve të vet që gruan ta futnin menjëherë te kapiteni, ndërsa dy djemtë t'i çonin në dhomën e vogël, ajo ndjeu si iu

thyen përnjëherësh tërë ata fyej akulli, iu bënë thërrime e iu shpërndanë si mjegull e ngrirë nga koka te këmbët. Tha me vete e lemerisur se nuk do të ishte në gjendje as të hapte gojën. «Po ndoshta do të jetë më mirë kështu, se nuk do të kenë ç'të shkruajnë në ato fletët e tyre të nëmura», shtoi duke zgjuar vetëtimthi bren-gën e pakmëparshme për keqkuptimin fatal që do t'i krijonin me Sokolin. Ndërkohë njëri nga të dy xhandarët që e shoqëronte trokiste gjithë druajtje në derën e kapitenit.

Kapiteni iu shfaq ndryshe nga ç'e pati përfytyruar. Nuk ishte i shkurtër e i dhjamosur, me fytyrën vruga-vruga e të regjur, që shpërndante vrazhdësi dhe erë të rëndë goje përreth; përkundrazi, ishte i hollë dhe rrobat e prera mirë pas trupit e tregonin edhe më të gjatë, me një fytyrë të hequr e të pastër, që dukej sikur ndriçohej lehtë e kudo njëlloj së brendshmi. Kur fliste, në ballë i formoheshin dy-tri rru-dha të imëta, si gjurmë gërvishtjesh të vjetra. Këto hollësi si dhe rregullimin e zyrës me tavolinën gjatësore me dy rreshta karrigesh për-anash dhe një në krye për atë vetë, portretin e mbretit të varur në murin midis dy dritareve, pas shpinës së tij, dhe një dollap i madh, me dyer të hekurta, mbështetur në mur, në të djathtë të kapitenit, ajo i vuri re pak më vonë, kur e mori vesh ç'kërkohej prej saj.

Gjatë kësaj kohe ishte bërë ajo bisedë e shkurtër hyrëse, të cilën edhe kapiteni e sjell

në informacionin e tij për ministrin e Brendshëm. Por ka edhe diçka që ai nuk e shënoi aty, nga frika mos u jepte shkas eprorëve ta gjykonin për punë të dobët në propagandimin e figurës së lartmadhërisë. Ai kishte porosi të veçantë që këtë punë ta shihte si nga më kryesoret në detyrën e vet, madje e dinte që për të bëheshin edhe shpenzime të mëdha, aq e rëndësishme ishte. Kur nusja e pyeti për fotografinë se ç'ishte, ai nuk u besoi veshëve. E, ndërsa i përgjigjej, shtoi:

— Hera e parë që sheh fotografi?

— Po.

— S'ke parë kurrë më parë?

— Jo.

— As fotografinë e mbretit?

— As fotografinë e mbretit.

— Nuk e keni në shtëpi këtë? — Ai u rrotullua përgjysmë dhe bëri me dorë nga portreti në mur.

Nusja ngriti sytë dhe pa mbretin, i cili nga prapa xhamit, hidhte mbi ata të dy një shikim të pandërprerë prej kokoroshi. Mblodhi supet e çuditur nga kjo pyetje.

— Në shtëpi? Jo, zotni.

— Lëri këto shaka se janë me zarar, — i foli kapiteni me një ton këshillues dhe vazhdoi, duke u kthyer prapë plotësisht nga ajo: — E njeh atë burrin? — Ajo e kuptoi se ishte fjala për fotografinë që mbante ende në dorë.

— Sytë nuk ia njoh, — u përgjigj ajo. —

Njeriu njihet nga sytë. Unë këta sy nuk i kam parë kurrë.

Kapiteni nguli këmbë disa herë që ajo ta shihte mirë fotografinë, madje edhe e kërcënoi dhe ajo u përpoq vërtet të kujtonte nëse qe ndeshur ndonjëherë në ata sy, po më kot. Nuk i njihete. Nuk i kishte parë kurrë, goftë edhe rrëshqitazi diku. Të folurit singërisht i dha njëfarë lirie të gojës dhe sikur e shpiu pakëz e njëkohësisht ia qetësoi disi të dridhurat që e bënë të shtrëngohej fort që, të paktën, të mos i kërcitnin dhëmbët. Dhe kur shpëtoi prej tyre, u ndie e lehtësuar si të shpëtonte nga rreziku i një turpi. Pasi mori vesh edhe se tek ata sy kërkoheshin sytë e burrit të saj, në tërë qenien i ra një paqe që e çlodhi. Menjëherë fitoi një mospërfillje e një shpengim, që njeriu mund ta ketë vetëm kur flet për një grindje midis dy të panjohurish që ka parë rastësisht në rrugë.

Në heshtjen e shkurtër që ra pas kësaj përgjigjeje, ajo pati kohë t'i thoshte vetes: «Ç'grua për burrë paske qenë, moj Borë! Si t'i polli mendja ato xhevahire që edhe me sy t'i shohësh, s'duhet t'i besosh!» Këto fjalë, të thëna butë, po me një ankim të fshehtë, i erdhën si nga goja e Sokolit. U trishtua dhe e mori inat atë Borën e pakmëparshme, që e mundnin hijet e shpifura. Sokoli pa trishtimin që u përhap nëpër fytyrën e saj nga dy pikat e vetme të lotit që i rrodhën. Nuk e deshë atë trishtim. Nuk e ka dashur kurrë, që natën e parë të martesës.

«Jo, jo, jo kështu», pati thënë ai dhe e kishte afruar pranë vetes, duke ia mbajtur kokën midis dy pëllëmbëve, derisa fytyrat e tyre ishin puqur, aq sa sytë e njërit nuk i shihnin të tjetrit, ndaj qenë mbyllur vetvetiu. Asaj i qe përflakur i tërë trupi nga nxehtësia e trupit të tij. «Ky qenka burri», kishte thënë me vete kur qenë shkëputur dhe pa vetëdijë kishte ngritur dorën të prekte faqet që i digjnin. Kishte përfytyruar veten si do të qe skuqur dhe në heshtje ia kishte ditur për nder Sokolit që e kishte fikur llambën sa kishin hyrë brenda. Nga jashtë vinte gulçe-gulçe kënga e shfrenuar e dasmorëve dhe daullja. Ajo mendoi se ishin ata të dy që ua kishin sjellë atë gëzim gjithë atyre njerëzve dhe qe ndier krenare. I qe dukur vetja e madhe, e fuqishme gjersa kishte mundur t'u bënte një të mirë të tillë aq shumë burrave, grave e kalamajve. Por, jo unë vetëm, kishte shtuar pastaj dhe kishte pasur dëshirë të ndihej përsëri e kredhur në gjoksin e Sokolit, që ishte ulur në anë të krevatit kushedi qysh kur dhe rrinte i heshtur. Ajo i dallonte vetëm formën e trupit dhe këmishën e bardhë. Dhe ia kishte dëgjuar të rrahurat e shpeshtuara të zemrës.

«Fole një fjalë!» i kishte thënë ai.

«Nuk di ç'të them.»

«Thuaj se nuk je më e trishtuar!»

«Nuk jam më e trishtuar...» Zëri i kishte mbetur pezull dhe qe kuptuar se kishte dashur

të shtonte edhe diçka tjetër. Sokoli kishte kërkuar ta mbaronte fjalën. Ajo nuk kishte pasur fuqi të kundërshtonte për asgjë para tij.

«Bile jam e gëzuar.» Fjalët i kishin dalë me ngut, si të druheshin mos i mbyste hovi që i kërceu papritur në kraharor dhe mbeteshin të pashprehura. Përsëri kishte menduar me mirënjohje për Sokolin që kishte fikur dritën. Qysh atë natë ai do të dinte gjithmonë t'u dilte përpara e t'ua priste rrugën çasteve që mund ta vinin gruan në siklet.

«Edhe unë jam shumë i gëzuar, — kishte thënë ai. — S'kam qenë kurrë kaq i gëzuar sa sonte.»

Asaj i qe ngjallur prapë ajo ndjenjë e krenarisë që i vinte nga vetëdija se qe në gjendje t'i gëzonte të tjerët. Dhe aq më fort Sokolin. Përsëri u kishte hyrë në mes një heshtje, të cilën Sokoli nuk e kishte lënë të zgjatej shumë, si herën e parë.

«Ç'po mendon?»

I kishin kaluar aq shumë mendime të ndryshme në kokë, sa nuk kishte arritur të veçonte asnjërin prej tyre që t'ia thoshte atij.

«Nuk e di. Po ti?»

«Unë po ëndërroj.»

Ajo kishte kërkuar sytë e tij, të cilëve vetëm xixëllima u shquhej në errësirë. Kishte pasur një kureshtje të madhe t'i shihte ata sy si bëheshin prej ëndrrës.

«Ëndërroj për ty... Dhe për vete», kishte shtuar pas pak.

Ajo kishte qenë gati t'i thoshte se e dinte ç'ëndërronte ai, por nuk kishte folur. Krahët e tij qenë zgjatur përsëri drejt saj dhe e kishin përfshirë butësisht për supesh. Megjithatë, ajo kishte ndier se si gishtat e tij kishin lënë një gjurmë të thellë në mish. Kishte ndier një dhe- mbje të ëmbël, që qe tretur ngadalë nëpër tërë qenien e saj, dhe i qe dukur se qe kredhur edhe ajo në ëndrrën e atij.

Të nesërmen në mëngjes, sa kishte çelur sytë, i kishte ardhur për të qeshur me atë ndjesi të çuditshme. Se njeriu mund të besojë se hyri në ëndrrën e vet, po në ëndrrën e tjetrit!?... I qe zgjuar përsëri kureshtja t'ia shihte sytë që s'ia kishte parë kurrë drejt e nga pranë. Me ata sy tash e mbrapa do t'i lidheshin shpërthimet më të fshehta të shpirtit. Do të bëheshin ata dëshmitarë të lumturisë a të mjerimit të atij shpirti? Kjo pyetje, që i kishte ardhur e beftë, ia kishte ngucur edhe më fort dëshirën t'i shihte. Por t'i shihte vjedhurazi, kur ai s'e kishte mendjen, që të hetonte sa më thellë tyre. Shikimi i saj i ngulmët ia kishte nxjerrë gjumin Sokolit. Nëpër përpëlitjen e qerpikëve të tij për t'u zgjuar mirë, ajo kishte shquar xixëllimën e çastit të mbrëmshëm, kur ai kishte thënë se po ëndërronte.

Më pas ajo ishte mësuar ta shquante atë xixëllimë, të cilën e mbante gjithnjë ndezur një

ëndërr e bukur për të nesërmen, edhe kur lodhja e ditës e barra e halleve për të mbajtur shtëpinë, për të rritur fëmijët apo për t'ia shtyrë pleqërinë nënës, që ia pati kushtuar rininë e vet atij, e kishin fikur tërë shkëlqimin e zakonshëm të atyre syve. Syve të tij mund t'u mungonin shumë gjëra të tjera në çastin kur e shikonin nusen, por jo ajo përshkënditje ëndërrimtare. Tani vështrimi i saj ishte ngulur në sytë e fotografisë, por asgjëkundi, në asnjë skaj të tyre nuk dukej as edhe një gjurmë, sado e lehtë, e atij xixëllimi të bukur, që, të paktën ajo, do ta shquante pa zor. Si s'e kuptonte kaq gjë ky zotnia i xhandarmërisë? Dhe ngulte këmbë si mushka në të vetën?!... Kokëtrashësia e kapitenit, siç e quajti ajo sjelljen e tij të vendosur, e zemëroi, e bëri të egër. Bora ishte e bindur se Sokoli, sido që të vinte puna, me këdo që ta prishte gjakun, sa t'i dilte ajo përpara, do të zbutej, sytë e tij do të qetësoheshin e do t'ia lironin atë pak vend fërfëllimës yllësore të ëndrrës së tij. Ndërsa ai burri i fotografisë, sado që flokët, ballin, harkun e vetullave, kurrizin e hundës, mbledhjen e nofullave në mjekër i kishte kërjt si të Sokolit, prapë nuk qe ai. Sytë, të rrumbullakosur nga hapja e madhe, derdhnin mbi të pa pushim një ftohtësi thumbuese që s'të linte t'i afroheshe për asnjë çast. Asaj iu duk se vështrimi i tyre e shponte tejprtej dhe shkante diku mbrapa, si të kërkonte me domosdo dikë

tjetër. Ajo, në mënyrë të pavetëdijshme, u kthye se mos pas shpinës së saj ndodhej dikush. Në këtë kohë kapiteni, të cilit nga humbja e durimit i dridhej lehtë buza e poshtme, po e pyeste nëse e njihnte apo jo burrin e vet.

— E njoh edhe me të prekur, zotni, pa e parë fare, — iu përgjigj ajo prerë, e çuditur si guxoi të përmendte në sy të një tjetri prekjen e të shoqit.

3

— Mos kujto se s'ka kush na del zot! Kena babën! Do ta shohësh edhe ti, edhe ti! S'len baba pa na marrë hakun.

Të dy djemtë drejtuan gishtin nga kapiteni, që sillej tërë kohën nëpër zyrë me duart në xhepa dhe vetëm kur fliste i drejtonte sytë dhe nga xhandari me thupër, një mesoburrë ky, që e shfaqte hapur kënaqësinë që ndiente kur i ngarkoheshin detyra të tilla me përdorim dhune.

— Ha, ha, ha! — qeshi xhandari ndërsa dy djemtë tërhiqnin derën pas vetes ngadalë, si të pritnin, nga çasti në çast, që xhelatët të pëndoeshin që i liruan. — Ha, ha, ha! I dëgjuat, zoti kapiten?!

Kapiteni i hodhi një vështrim përçmues. I kam të admirueshëm këta xhandarët, mendoj me

cinizëm. Më mirë të jesh budalla si këta se nuk e humbet kurrë besimin te vetja.

— Mbarove, — i tha me një zë përbuzës.
— Dil jashtë!

— Si urdhëron, zoti kapiten, fjala juaj, fjala e lartmadhërisë, që i qofshim falë! — Xhandari e përshëndeti ushtarakisht duke e kryer atë veprim tepër përcudshëm për sytë e një ushtaraku që e respekton mbi gjithçka rrobën që mban, dhe doli.

Nëpër derën që u hap, kapiteni pa në korridor gruan e Sokol Gecit duke u thënë diçka, me siguri pajtuese, të dy fëmijëve. Dhe i jehoi prapë në kokë kërcënimi i djemve se ati do të shpaguej patjetër për ta. «Dhe sa të bindur, dhe sa të sigurt janë», tha me vete me një ndjenjë gati llahtare për pafuqinë e vet.

Ndërsa të dy djemtë, të cilët bashkë me nënën kishin dalë tashmë nga oborri i rrethuar me kangjella hekuri i postës së xhandarmërisë dhe po merrnin rrugën e shtëpisë, kësaj here të pashoqëruar nga xhandarët, as që donin t'ia dinin si i priti xhandari apo kapiteni fjalët e tyre. Ato fjalë nuk i thanë sa për të shfryrë mllefin që u ziente në shpirt. Jo. Ishin të sigurt se i ati nuk do ta duronte vuajtjen dhe fyerjen e tyre. Madje, ai i vogli, që quhej Martin, në emër të gjyshit, qysh tani po e sajonte në mendje si do t'ua gjente Sokoli rastin edhe njërit, edhe tjetrit.

I pari do ta kishte radhën ai, xhandari që

mezi priste t'i qëllonte fëmijët në duar e në kërcinjte e këmbëve me thuprën e hollë që ta çonte të therurën në shpirt. Dhe u thoshte me zë të ulët, duke kërcëllitur dhëmbët, të tregonin të vërtetën, ndryshe do t'ua merrte shpirtin, do t'ua përdridhte qafën si të qenë këlyshë bushtre. Pastaj, kur pa se kërcënimi i vajti dëm, ai u inatos më keq dhe i shau me një fjalë të rëndë nga nëna. Ata të dy nuk e duruan më dhe shpërthyen në vaj. Kapiteni, që kujtoi se qanin nga e rrahura, u tha, si me keqardhje, se qe më mirë e më burrërore të flisnin hapur e drejt e të mos e bënë veten për dru.

— Vetëm kafsha do dru, — tha ai. — Njeriu merret vesh me fjalë, ndaj është njeri.

Këto i tregonte s'ëmës me një zë të vrarë djali i madh, Ndreka, ndërsa i vogli u shkante në krah pa e çelur gojën. Ishte përhumbur në të vetat... I ati po e pyeste ç'dënim t'i jepnin xhandarit që u rrinte përballë, meit i verdhë, me mjekrën të ngulur në gjoks. Me dorën e majtë ai shtrëngonte fort në kyç të djathtë, atë të thuprës, tani e mbytur në gjak nga një plumb. Herë pas here lëshonte ndonjë ciatje të hollë si gërvimë, që i dilte në vend të rënkimit dhe belbëzonte diçka me të lutur. Kurse nëpër kraharorin e setrës së uniformës i rridhte poshtë një çurg i përzier lotësh e jargësh. Fëmijës i ra një hije e zyrtë prej mendimtari. Babai priste në këmbë vendimin e tij.

«Me vdekje, — tha ai prerë. — Dhe ta he-

dhim ku Then Qafën Drini, që të mos i mbetet as nami e as nishani. Aty të bëhet varri i të gjithë xhandarëve.»

«U bëre burrë, — i tha babai e i rrahu shpatullat, — qysh nesër do të gjej një pushkë për ty. Tani e mbrapa të kam me të vërtetë shok.»

Kapiteni qëlloi më me fat. Por ishte edhe më frikacak e ruhej më tepër. Ai nuk dilte kurrë pa një grumbull xhandarësh përçark. Edhe shtëpia ku flinte, rrinte natë e ditë e rrethuar me xhandarë që i mbanin pushkët gati për zjarr. Sokoli e ndoqi për disa kohë këmba-këmbës, po nuk e zuri dot. Martini çdo mbrëmje shkonte të flinte i mërçitur që iku edhe një ditë pa vajtur beja në vend. Kjo vonesë po i kthehej në një vuajtje që ia trembte gjumin. Përnatë i shpifeshin ëndrra nga më të ligat. Megjithatë, çdo mbrëmje ai e qetësonte veten vetëm pasi e thurte deri në imtësi ngjarjen ku do t'i vinte fundi kapitenit dhe e jetonte atë me aq përkushtim shpirtëror, sa bindej plotësisht se do të ndodhte patjetër, pikë për pikë ashtu.

Babai, sa herë takoheshin, edhe pse djali nuk i thoshte gjë, ia shihte te sytë vuajtjen.

Por, një ditë që e shoqja i tha se Martini nuk ishte mirë, natën çohet i trembur në gjumë dhe kërkonte kapitenin duke qarë nga inati, kurse ditën mbyllet në vetvete e as nuk luante si më parë, as nuk fliste thujse fare me njeri, ai iu përgjigj:

— E po, qoftë e bërë ndryshe atëherë!

Dhe që atë ditë, ndaj të ngrysur, pasi i thirri kapitenit prej së largu, nga korija përballë postës, shtiu tri herë me pushkë dhe e la të vrrarë në vend, aty në oborrin e postës, ku ai kishte dalë e po rrinte vetëm.

Djali i dëgjoi krismat dhe, pa u hapur ende lajmi, tha, me një siguri të patundur, se e pati kapiteni. E ëma pa si iu çliruan menjëherë tিপaret e fytyrës dhe i shndritën sytë...

— Po ti, — i foli nëna për ta ngacmuar, — qenke përqurrur para xhandarit?! E, ke gojë e i thua babës mandej se je burrë.

Martini s'ishte shkëputur ende nga përfytyrimet e veta, ndaj nuk iu përgjigj. Vetëm belbëzoi diçka të pakuptueshme nëpër dhëmbë.

I vëllai, që i kishte treguar s'ëmës deri në hollësitrat më të mëdha gjithë ç'pa e ç'hoqi atje brenda, po ecte në heshtje në krah të s'ëmës, më i lehtësuar e i qeshur. Qeshi edhe nëna. Të mos qe merak u për plakën që e mundonte, ajo do të thoshte se ishte jo vetëm e lirshme, e shpenguar, por edhe e gëzuar.

— Prapë s'të paska dalë frika, — vazhdoi Bora ta ngacmonte Martinin.

— Unë s'pata fare frikë, — u hodh i biri, që tashmë e kishte mbledhur veten.

— Po këta lot nga erdhën?

— Qava për tjetër gjë. — Zëri i tij i prerë dhe i mbyllur i tha s'ëmës të mos e çonte më tej lojën. Dhe ajo e ndërroi:

— Pse t'u duk ai burri i fotografisë si njeri
ëndrre?

— Ku e di unë?! — Ai mblodhi supet. —
Ashtu m'u duk.

Bënë disa hapa pa folur. Martinit iu kuj-
tua se vërtet, kur kapiteni i zgjati fotografinë
dhe ai po e shihte duke e mbajtur lehtë në një
cep, midis bulave të dy gishtërinjve të parë, si
një gjë të ardhur nga bota tjetër, sapo vështrimi
iu ndesh me vështrimin e burrit të ngrirë në
letër sikur i iku zëri, aq llahtarë i mbolli ai në
shpirt. Iu duk vetja tamam si në një ëndërr
të tmerrshme, kur, i ndjekur nga një egërsirë
e tërbuar, do të thërresësh, po zëri s'të del, me-
gjithëse ti shqyen mushkëritë nga zori.

— Edhe mua nuk më ka qëlluar kurrë të
shoh as në rrugë, as ndokund tjetër njeri që të
të kallë lemeri si ai, — e prishi heshtjen Ndre-
ka.

— Ai s'qe njeri, qe fotografi, — shtoi Mar-
tini shumë serioz.

Nëna dhe Ndreka qeshën.

— Pse qeshni?

— Nuk qeshëm me ty, — ndërhyri nëna
urtë. Dhe për ta bindur e për të mos e lënë
të prekur, vazhdoi: — Qeshim me atë kapitenin
që donte të na mbushte mendjen se ai burrë
qe babai juaj.

— E, pra... — u qetësua Martini. — Po pse
kërkonte t'i thoshim se ai është, moj nënë?

— Nuk e di, — u përgjigj ajo mendueshëm.
Bënë përsëri disa hapa në heshtje. Po i afroreshin shtëpisë.

— Mua ai burrë m'u duk si ujk, — foli prapë Martini shumë serioz.

Ndreka prapë s'e mbajti gazin.

— Mos më qesh! — iu hakërrye i vëllai.

— Qesh se m'u kujtua fytyra e kapitenit si u thartua e u shtrembërua e... — Ai nuk diti si ta përshkruante atë pamje të kapitenit, ku përziheshin gazi me zemërimin, me trishtimin e me përçmimin kur e dëgjoji të voglin që e quajti ujk shëmbëlltyrën e fotografisë.

— Po ta shihje babën tënd në një fotografi si ajo, nga do ta njihje? — iu drejtua nëna Martinit.

— Do ta njihja nga të gjitha, — u përgjigj fëmija pasi u mendua një hop. Pyetja e nënës i jehoi në kokë edhe një copë herë, derisa ia përpiu të gjitha mendimet. Ai e donte të atin mbi gjithë të tjerët. Dhe, ndryshe nga zakoni i fëmijëve, kur qante apo ankohej, nuk thërriste kurrë nënën, po babanë. Ndaj, gjyshja, kur donte ta ngacmonte, i thoshte se e ka pjellë i ati. Megjithatë ai nuk prekej. Përkundrazi i vinte mirë. Sokoli, kur e dëgjonte, qeshte. Për të vetëm babai mund të bënte gjithçka: të priste lisat e mëdhenj me një sëpatë sa pëllëmba e vet, të ndeshej me shtazët e pyllit e t'i mbyste, ta ngiste kalin më shpejt se era, të shtinte me

pushkë e ta vriste shenjën e vënë larg sa t'i hante syri. Me mendjen e tij nuk gjente kurrgjë të pamundur për babanë. Ai ishte aq i fuqishëm, aq i zoti! Dhe ishte për t'i mbrojtur ata, fëmijët e tij. Edhe kur po ikte në mal, pasi u vra me xhandarët, ndërsa i puthte e i shtrëngonte në gjoks me një dhemshuri të thellë, u tha të mos mërzitëshin e të mos trembeshin as për të, as për vete. Një fije floku t'u prekte kush, ai i vinte zjarrin, shtatë pashë në dhé e fuste. Martini pa sytë e tij të mrrolur, që shkrepstin e prapë mbeteshin të butë. U përpoq më kot t'ia kujtonte krejt fytyrën. Tiparet e tjera i kishte humbur në një si tym të bardhë që linte t'i dukeshin vetëm sytë. Pastaj iu shfaq fotografia dhe ai e nguli vështrimin të gjente aty sado pak diçka prej syve të babait. Por jo, asgjë. E nisi disa herë nga e para atë hetim, duke u ndalur në çdo imtësi, por gjithnjë i dilte njësoj. Ai kishte një vështrim që kërcënonte ligisht, sa të bënte të dridheshe. Kurse babai...

Nga këto mendime e nxori nëna që, përmes një ofshame të thellë, tha:

— Erdhëm edhe një herë në shtëpinë tonë, — dhe shtyu trinën e gardhit të oborrit. Qeni u kërcëu të këmbët me një hungërimë të zgjatur, si të donte t'ua shprehte mallin dhe ankimin që e lanë vetëm.

— Nënë, — i foli Martini dhe e zuri për mënge në mes të oborrit, — babën do ta njihja

nga sytë. Janë sy për të më dashur mua, jo për të më frikësuar. Janë sy që më dalin zot. E di unë, i kam provuar.

— Po, të pastë nëna, — ia ktheu ajo, ndërsa nga brenda u dëgjua e thirrura e gëzuar e plakës.

Pjesë e dytë

Duke mbajtur gjërat përparësi, ministri i Brend-
shëm, në lidhje me sa më kërkoni për aktin e të
arratisur politik Sokol Geci dhe hetimet e
objektet tona të bashkëpunimit të tij, ju in-
formoj:

Pjesa e dytë

Shkëlqesisë së tij, zotit ministër i Brendshëm,

Në lidhje me sa më kërkoni për aktin e të arratisurit politik Sokol Geci dhe hetimet e ndjekjet tona të deritanishme rreth tij, ju informoj:

Duke mbajtur gjithnjë parasysh porosinë

tuaj të çmuar që më dhatë ditën që më komunikuat emërimin komandant i postës së xhandarmërisë këtu, jam përpjekur të shmang çdo lloj përplasjeje ballë për ballë me malësorët dhe, për t'i eliminuar kundërshtarët e lartmadhërisë së tij, të përdor vetëm dredhinë. Me sa kam parë gjatë këtyre muajve që ndodhem këtu, vendasit bien lehtë në lak, pasi nga natyra janë të çiltër, nuk kanë prapamendim dhe dalin kurdoherë haptas, gjë që i bën edhe të mashtrohen, pa vështirësi. I tillë është edhe i arratisuri në fjalë, të cilin unë nuk kam pasur rastin ta njoh para se të kryente aktin e rëndë të vrasjes së dy xhandarëve të ekspeditës sonë shëtitëse, akt që i vë, padyshim, damkën e kundërshtarit politik të regjimit tonë mbretëror.

Krimi është kryer pasditen e 4 prillit, në të dalët të fshatit Katundi i Pages, që është edhe vendbanimi i familjes së të kërkuarit. Për fat të keq, ne nuk kemi dëshmi nga asnjëri prej tre pjesëmarrësve të ngjarjes, pasi, siç dihet, dy xhandarët i mori vdekja, kurse ai iku. Po nga të dhënat e pjeshme të disa fshatarëve del se recidivisti Sokol Geci, një burrë shtatshkurtër, 39 vjeç, i njohur si shakaxhi dhe herë-herë pak shpotitës, është ndeshur në rrugë me xhandarët Emin Lëngu dhe Nikollë Gega, të dy pa asnjë gradë, të cilët sapo kishin dalë nga shtëpia e vendasit Isuf Noka. Isuf Noka thotë se i pati për drekë dhe aty pinë shumë raki. Kur ne ngulëm këmbë

të dinim hollësisht rrethanat që i çuan viktimat për drekë tek ai, Isuf Noka na shpjegoi, jo pa druajtje, se ata i paskan vajtur vetë në derë dhe i janë paraqitur si të dërguar nga komanda eprore për ta marrë në pyetje, meqenëse qeveria dyshoka për të. Ai është trembur dhe, pasi u është betuar e stërbetuar që nuk ngatërrohet në politikë e se sheh vetëm punën e tij, u është lutur përulësisht t'ia rregullojnë këtë punë. Ata, gjithnjë sipas Isufit, i paskan thënë se vërtet nuk u dukërka soj ngatërrestari dhe se do të përpiqeshin ta mbyllnin meselenë e tij pa zhurmë e në fund i kanë kërkuar t'ua shtrojë. Isufi, i gëzuar nga premtimi, ka prerë dy pula. Tërë kjo është një sajim ose i xhandarëve, ose i fshatarit Isuf Noka. Ata të dy, me sa del tani, i kanë punuar edhe ndonjë tjetri rrengje të ngjashme, duke përdorur gjithnjë rrobën e qeverisë. Por edhe kanë ditur ku shkojnë. Sepse Isuf Noka, 51 vjeç, bujk, duket frikacak e mendjelehtë. Neve, si komandë xhandarmërie, nuk na figuron në asnjë dosje.

Sidoqoftë, ajo puna e rakisë me tepri mund të jetë e vërtetë, pasi edhe fshatarë të tjerë pohojnë që i kanë parë kur dolën nga dera e Isuf Nokës duke u kalamendur. Dhe pikërisht për këtë kalamendje u ka hedhur një thumb Sokol Geci, që ndërkohë kalonte atypari. Një fëmijë që po shkonte rrugës ka dëgjuar këtë dialog midis tyre:

Sokol Geci: — Pse qenkeni bërë kështu, zotërinj? A s'po ju mjafton tuta që na shtini kur jeni esëll?

Njëri xhandar, që me sa duket ishte pak më i kthjellët se shoku, e kupton ironinë, po nuk është në gjendje t'ia kthejë me të njëjtën gjuhë, ndaj i bie shkurt: — Do të të vijë radha edhe ty, mos u mërzit!

Sokol Geci: — Ju xhandarët e ekspeditës shëtitëse e ngatërroni keq, radhën e na keni hutuar edhe ne, s'po e marrim vesh kur na bie e kur na ikën. Nuk e dimë, a ju, a qeveria i bëni punët kështu lëmsh.

Xhandari tjetër dëgjon fjalët «qeveri» dhe «lëmsh» pranë njëra-tjetrës, dhe me siguri, pa hyrë fare në kuptimin e së tërës që tha recidivisti, i eksituar më fort edhe nga pija, i hidhet: — Kush je ti, more, që shan qeverinë?! Kjo qeveri po na mban me bukë, more derr i dërrit!

Sokol Geci duhet të jetë fyer rëndë nga sharja e xhandarit, sepse kësaj here e ka ngritur zërin: — Ju mban ju, zotërinj dhe disa derra si ju, që i duheni vetëm për mishin e jo për mendtë.

Njëri nga xhandarët, mundet ai më i piri, pa e zgjatur, nxjerr koburen dhe përpiqet të shtjerë mbi fshatarin. Po bën disa lëvizje të pakontrolluara si duhet, që i japin kohë civilitet jo vetëm ta kuptojë qëllimin e tij, por edhe të veprojë. Fëmija që dëshmon e që është i vetmi

i ndodhur atë çast aty rrotull thotë se Sokol Geci kërcen vrulltas mbi xhandarin, i cili, në atë gjendje ishte edhe më i pamundshëm fizikisht, i rrëmben revolverin dhe i thotë:

— Unë ta pshurr barutin e mbretit, more zotni.

Xhandari tjetër, që, siç thashë, do të ketë genë disi më i kthjellët, fut dorën në brez, po nuk ka kohë ta nxjerrë armën, pasi e marrin tre plumba në kraharor. Në këtë moment shoku i tij i çarmatosur mbush brekët, diç belbëzon dhe shpërthen në vaj.

— Mbaji erë asaj që bëre! — i thotë Sokol Geci dhe bën të largohet pa ndonjë ngutje të veçantë.

Xhandari, kur e sheh se vrasësi i ktheu shpinën, kujtohet për revolverin e të vrarit, e merr dhe këput një plumb të panishan, i cili bëhet edhe shkak përfundimtar për vdekjen e tij, sepse kriminelin kthehet fare gjakftohtë dhe ia lan borxhin trefish.

Kur arritëm në një vendin e ngjarjes, atë e gjetëm të katandisur në një gjendje krejt të padenjë për një njeri me uniformën e xhandarit mbretëror: lotët e përzier me jargët si dhe pantallonat e mbushura të krijuar në veri. Për një grumbull fshatarësh të mbledhur aty pa vonesë, pamja e tij u bë objekt talljeje për xhandarmërinë në përgjithësi, duke e ulur e nëpërkëmbur gjithësi figurën tonë. E theksova këtë për të shtuar se mendoj që ai të

mos shpallet, në asnjë mënyrë, dëshmor i mbretërisë dhe rasti i tij t'u bëhet i njohur, nëpërmjet një qarkoreje të hollësishme, edhe një-sive të tjera të xhandarmërisë, që të nxirren mësimet e duhura nga të gjithë ata që e kanë veshur këtë rrobë të lartë, që u siguron jo vetëm nderin, por edhe një rrogë të majme, siç dihet. Në qoftë se vdekja e një xhandari nuk do të jetë kurdoherë një akt heroik, ekzistenca jonë nuk do të mbjellë frikën e nevojshme të kundërshtarët e mbretërisë, të cilët ende janë të shumtë.

Jua përshkrova ngjarjen me imtësi që ju, në analizat që do të bëni dhe përfundimet që do të nxirrni, të cilat do të jenë shpëtimtare për ne në qorrsokakun ku kemi rënë, ta keni tërë materialin në dorë e të mos ju mbetet asnjë skutë e errët. Në qoftë se do t'ju interesonte mendimi ynë, do t'ju thoshim se incidentin nuk e konsiderojmë të rastësishëm. Të arratisurin Sokol Geci e shohim si provokatorin e parë. Në fjalët e tij që në fillim zbulohet një nëntekst politik, gjë që dëshmon se midis fshatarëve ka nga ata që flasin me njëri-tjetrin rreth nesh dhe nuk na quajnë ruajtës të rendit e të qetësisë publike, po mohues të lirive të tyre. «A nuk po ju mjafton tuta që na shtini kur jeni esëll?» Fjalë të tilla nuk janë kurrë spontane. Ato vijnë nga një mendim i pjekur më parë dhe nuk mund t'u vësh emër tjetër veçse propagandë antiqeveritare. Unë e shoh

këtë shfaqje si pasojë të njëfarë liberalizimi të regjimit, të cilin, natyrisht, dhe për këtë jam i bindur, lartmadhëria e tij po e bën me qëllim të mirë, po që ky popull, i mësuar historikisht të qeveriset me dru, nuk mund ta kuptojë.

O! Ju lutem, komentet dhe mendimet e mia të shprehura hapur mos i merrni si këshilla, pasi unë kam qenë dhe jam gjithmonë i bindur se vetëm urdhrat dhe zgjidhjet e lartmadhërisë, të përpunuara dhe të zbërthyera imtësisht prej jush, si krahu i tij i djathtë, janë më të drejtat dhe më të përshtatshmet për të kapërcyer çdo situatë. Gjithë ç'ju shkrova më lart, ju lutem përulësisht, merreni vetëm si një dëshmi të sigurtë të preokupimit tim të vazhdueshëm për t'ia shpërblyer mbretit dhe juve nderin e lartë për besimin e madh që keni tek unë.

Me këtë bindje po përpigem ta zbatoj edhe urdhrin tuaj për ta kapur me çdo kusht të arratisurin. Sipas radiogramit të fundit që më dërguat, unë ia ngarkova këtë ekspeditës shëtitëse të xhandarmërisë menjëherë, si detyrë të dorës së parë. Ndërkaq jam lidhur edhe me postat fqinje të xhandarmërisë brenda nën-prefekturës dhe në nënprefekturat rrotull dhe u kam yënë në shërbim gjithçka dimë rreth tij. Në popull e shpalla menjëherë vendimin e lartë për shpërblimin prej 1000 frangash ar të atij që do të dorëzojë në duart tona Sokol Gecin. Njëkohësisht bëra demaskimin e figurës së banditit në sytë e njerëzve, duke e paraqitur,

sipas porosisë suaj, si një kriminel të rrezikshëm kundër pushtetit mbretëror, po që nuk përfaqësonte aspak masën e malësorëve të ndershëm e patriotë, tek e cila lartmadhëria ka pasur dhe ka besim të plotë.

Këtu na doli një problem që na u bë i mprehtë sidomos për njerëzit tanë të shërbimit të fshehtë që do të merren me gjurmimin e tij. Nga kontrolli i imët i ushtruar në shtëpinë e Sokol Gecit, ku jetojnë e ëma, gruaja dhe tre fëmijë, me moshë 15, 12 dhe 7 vjeç, nuk gjetëm as edhe një fotografi të tij. Madje, të pesë ata, të cilët u morën aty në pyetje të hollësishme nga ana jonë, del se as që kanë parë ndonjëherë në jetën e tyre fotografi. Për pasojë është për t'u besuar se as recidivisti në fjalë nuk ka pozuar kurrë përpara aparatit fotografik. Sidoqoftë, për ta mbushur sadopak këtë boshllëk, ne, duke u mbështetur në kujtesën e disa njerëzve që e njihnin mirë, u përpoqëm dhe hartuam një përshkrim të portretit të tij fizik, të cilin e shumëfishuam dhe e shpërndamë. Megjithatë, nuk mund të themi se materiali ynë po e përmbushte qëllimin, sepse, vetëm gjatë një jave, forcat tona kanë ndaluar me dhunë në fshatra të ndryshme 13 veta, tek të cilët u është dukur se gjetën tiparet e dhëna prej nesh. Madje, disa prej këtyre keqkuptimeve kanë shkaktuar edhe shfrime inati të të ndaluarve ndaj vetë regjimit, gjë që na ka detyruar të ndërmarrim hetime të mëtej-

shme për ta dhe t'ia kalojmë për vendim gjykatës mbretërore të nënprefekturës.

Siç e shihni, çështja po ndërlikohej tepër, po të mos ndodhte para dy ditësh një ngjarje që na ka lënë krejtësisht të habitur: Një xhandari ynë më solli në zyrë një fotografi të të arratisurit në njëqind kopje. Tha se ia kishte dhënë vetë ai në dorë, duke e porositur të m'i dorëzonte vetëm mua. Megjithëse ne kemi dhënë urdhër të prerë që ushtarakët të mos lëvizin asnjëherë të vetmuar, xhandarit në fjalë na i paska qëlluar të kthehej i pashoqëruar atë ditë dhe i arratisuri i kishte prerë papritur rrugën në një shteg. Pasi i kishte treguar kush që, e kishte siguruar se nuk do t'i bënte asgjë, me kusht që t'ia çonte në vend porosinë që përmenda.

Xhandari, kur u pyet prej nesh nëse që i sigurt se fotografitë janë pikërisht të personit që kërkohet dhe se i ka marrë tamam nga dora e tij, u lëkund dhe filloi të dyshonte. Pasi kjo pyetje iu përsërit disa herë, nuk ishte më në gjendje as të pohonte se njeriu që ka takuar është i njëjti apo jo me atë të fotografisë. Ne nuk e ndëshkuam për këtë, duke menduar se do të jetë hutuar keq, i ziu, nga ajo shfaqje shtrigane e kriminelit dhe më tepër akoma, nga gjesti i tij i pashembullt. Por, në të parë, edhe verifikimin e fotografisë e quajtëm të thjeshtë. Ndaj çuam pa vonesë e thirrëm nënën e të arratisurit. Qysh sa e pashë, më bëri pështypje

se ishte veshur shumë trashë, megjithëse dielli ngrohte mjaft. Ndaj dhe e pyeta, për këtë, para se të dilja atje ku më duhej.

— Erdha të mbyllem në burg, zotni, — m'u përgjigj ajo krejt mospërfillëse. — Burgu, si në verë, si në dimër, është akull. Pse i thonë burg? Për mos me e pa diellin.

— Pse mendove kështu? — vazhdova unë, sepse ma nxiti kureshtjen përgjigjja e saj. — Të tha njeri?

— Jo. Po kështu ka ndodhë përherë me qeveritë: inati i bijve u nxirret nënave të shkreta. Disa ua bekojnë barkun për ç'ka pjellë, disa ua nëmin.

Unë nuk e çova më tej bisedën, se pashë që fytyra e saj e vogël, e bardhë dhe e rru-dhur si një patate e pjekur në hi, filloi të ndizej së brendshmi e kjo mund të m'i prishtë punë sqarimit që më nevojitej. I zgjata një cigare, ia ndeza dhe e lashë një copë herë ta thithte në heshtje, derisa u binda se qe ftohur mirë, qe bërë ajo e mëparshmja. Atëherë nxora fotografinë nga sirtari dhe ia zgjata.

— E njeh?

Ajo e mori krejt mekanikisht, e drejtoi nga vetja dhe e mbajti një çikë disi larg. Unë po ndiqja çdo lëvizje të saj, duke u munduar të merrja më mend ç'ndiente thellë vetes. Pas një çasti pashë si iu picërruan sytë, ndërsa e af-ronte ngadalë drejt fytyrës letrën e stamposur. Ajo fytyra e vogël, që mpakej dhe më tepër nën

shaminë e ulur deri poshtë mbi ballë e që nuk i linte t'i dukej asnjë fije floku, e cila deri atëherë më ishte shfaqur me një bardhësi të papërshekueshme, si të qe prej guri, filloi të merrte një përshkënditje rozë në mollëza. Kurse dora i përcillte fletës së fotografisë një dridhje të lehtë, që, besoj, i endej si rrymë ujore nëpër gjithë trupin. Unë e lashë e po prisja sa do të vazhdohte ashtu. Ajo ngriti skajin e shamisë dhe fshiu sytë. Pastaj me të fshiu edhe fotografinë.

— E njeh? — ia përsërita pyetjen dikur.

— Nuk shoh mirë, — tha, — ma ndiz edhe një dritë!

Unë e pashë me çudi. Nëpër dy dritaret e mëdha të zyrës vërshonte një diell i pastër e i bollshëm, siç është vetëm dielli i pranverës. Megjithatë nuk ia prisha. Mora llambën me vajguri, sepse, shkelqesi, këtu ende nuk njihet elektriku dhe, pasi e ndeza, ia afrova heshturazi. Ajo ë vuri re gjubhën e zbehtë të flakës, që mezi dallohej si një rektimë, dhe m'u kthye me një ndjenjë zemërimi të pëpërmbytur:

— Zotni, a më ke thirrë me më vu në lojë?

— Dhe bëri një lëvizje të prerë të kokës nga llamba;

Kjo më erdhi e beftë dhe më stepi.

— Ti vetë ma kërrove, — thashë duke u shfajësuar në mënyrë instinktive. — Ti vetë më the se nuk shihje mirë.

Ajo, duket, ë kuptoi se s'që faji im dhe për

herë të parë vuri buzën në një gaz të hidhur.

— Mos m'i shih marritë, zotni, se jam plakë!

Unë i buzëqesha në shenjë pajtimi dhe mendova se do të bëja mirë të mos e lija më të përhumbej me fotografinë. Mjaft e kishte parë.

— A është djali yt aty? — e pyeta kësaj here drejtpërdrejt dhe me një zë të vendosur.

— Djali im?! Herë më duket se po, herë më duket se jo. Po më shumë jo se po, — u përgjigj ajo dhe sytë tanë u kryqëzuan. Kishte dy sy të vegjël, fare të rrumbullakët e të futur thellë. Në ta dallova një dhimbje që më shtyu të besoja se fliste pa djallëzi. Megjithatë vazhdova hetimin.

— Nuk të kuptoj, moj plakë. As djalin tënd nuk e njeh? — Qëllimisht e ashpërsova pak gjuhën, sepse m'u duk se po bëhesha sentimental. Dhe unë gjithmonë kam qenë i mendimit se nuk ka sëmundje më të keqe për një ushtarak, veçanërisht të shërbimit policor, sesa ndjeshmëria e tepërt. Ajo të çon në gabime të pandreqshme, të çon në gjykimin e njerëzve me dhimbsuri, jashtë rregulloreve precize dhe ligjeve. Po ky ndryshim i mënyrës sime të të folurit asaj nuk i ra në sy për keq. Me siguri, që kur erdhi, ishte përgatitur shpirtërisht për gjithçka.

— Djalin tim e njoh, por e njoh siç e kam bërë vetë, — ma ktheu ajo. — Këtu, te kjo letër, sikur ia njoh flokët, sikur ia njoh mus-

taqet, shpirtin s'po ia njoh. E ka ndryshe për mua, Ndoshta ma kanë fajin sytë, — deshi të tërhiqej.

Dhe unë e lashë të tërhiqej, pasi besova se vërtet që faji i pleqërisë. Në moshën e saj dhe me jetën e saj, lajthitja është diçka e natyrshme. Mendova edhe se nuk përbënte shqetësim, pasi kisha edhe të tjerët: gruan e të arratisurit dhe dy fëmijët e tij të rritur, dy djemtë, më të cilët do të merresha vesh edhe më me lehtësi. Ata nuk do të mund të më nxirrnin sebepe të këtij lloji.

Ndërkaq kisha marrë masa që ata të tre të m'i sillnin në postë menjëherë pas plakës, pa ditur gjë ajo, që edhe të mos takoheshin për të rënë në një mendje për përgjigjet. Megjithatë, shkëlqesë, marr guximin t'ju them se edhe tani që po hartoj këtë informacion për ju, mbetem mjaft i errët në vetvete nga çudia se si edhe gruaja, e cila quhej Borë, ishte 34 vjeçe dhe paraqitej për herë të parë në jetën e vet përpara një përfaqësuesi të qeverisë, që për më tepër edhe ky i qëlloi me uniformën e oficerit të xhandarmërisë, pra, edhe tani mbetem mjaft i errët në vetvete nga çudia: përgjigjja e saj, në thelbin e vet, ishte e njëjtë me atë të plakës. Si ka mundësi? pyes veten. E kuptoj që është plotësisht me vend që këtë pyetje të ma bëni ju mua. Po ashtu edhe përgjigjja e djemve. Nuk mund të hedh asnjë dyshim se kanë qenë të përgatitur për çka do të pyeteshin, pasi nuk e

dinte askush veç meje se do të merreshin në hetim dhe çfarë do t'u kërkohej.

Mosha e saj e re, pse jo edhe bukuria e sidomos emocionet që kishte e që nuk arrinte t'i fshihte, më bënë të jem që në fillim më i drejtpërdrejtë e më pak meditativ. Nuk doja të krijoja kurrsesi ndonjë keqkuptim me të, pasi kjo do të m'i acaronte më tej marrëdhëniet me krejt fshatin e saj e më gjerë, gjë që do të ishte jo thjesht në dëmin tim si individ, sesa të mbretërisë. Sidoqoftë, u përpoqa të tregohem, me taktin e duhur. Ndaj e pyeta për shëndetin, për fëmijët, i shpreha keqardhjen që tani, pa burrin në shtëpi, do t'i jenë shtuar punët e rënda, të cilat, aq më fort janë të papërshtatshme e të pakëndshme për një grua të hijshme dhe pastaj, duke i lypur të falur për shqetësimin, i zgjata fotografinë. Dhe, ashtu si së vjehrrës, iu drejtova:

— E njeh?

Pyetjet e mëparshme m'i dëgjoi në heshtje, pa i ngritur asnjëherë sytë, m'u përgjigj shkurt e me një zë të dridhur. Ndërsa tani e mori fotografinë, e pa një çast, pastaj më pyeti:

— Ç'është kjo?

Unë as këtë pyetje s'e kisha menduar, megjithëse e dija tashmë, që kur bëmë kontrollin e shtëpisë, se asnjë prej pjesëtarëve të familjes nuk e njihte fotografinë.

— Kjo quhet fotografi. Të kujtohet, pyetëm edhe kur kontrolluam shtëpinë tuaj, — u

përpoqa t'ia shpjegoja sa më qartë. — E njeh atë burrin e dalë në të? — vazhdova menjëherë ngaqë nuk doja që biseda të ndërrohej.

— Sytë nuk ia njoh, — tha ajo. — Njeriu njihet nga sytë. Unë këta sy nuk i kam parë kurrë. Le që, kaq të palëvizur, më duken si sytë vdekuri.

Mua kjo përgjigje më nervozoi. Për më tepër se ajo ndihej shumë e sigurt në ato që thoshte.

— Shikoji mirë, — i ndërhyra, — dhe fol hapur, pasi mban përgjegjësi para ligjit për dëshminë që jep.

Pashë që kërcënimi im e bëri ta mbledhte veten edhe më mirë. Nuk shfaqte më asnjë emocion dhe dukej fare e qetë. Logjikisht kjo mund të duket gjë e mirë pasi lehtëson komunikimin. Por jo, nuk ndodhi kështu. Ajo u kërcënua në një heshtje mospërfillëse, me sytë të ngulur në faqen e lëmuar të fotografisë. Unë prita një çopë herë, pastaj nuk m'u durua më.

— Foll! — iu drejtova rreptë.

— Ç'të flas? — m'u kthye ajo e më vështroi egër.

— E njeh apo jo burrin e asaj fotografie?

— Thashë një herë se nuk e njoh, zotni.

— Po burrin tënd e njeh?

— E njoh edhe me të prekur, pa e parë fare, zotni, — m'u përgjigj. Në pak minuta, ajo jo vetëm e fitoi çuditërisht sigurinë e vet, por fitoi edhe një ndjenjë krenarie. Tashmë e

kisha humbur unë pak qetësinë. Ndoshta ngaqë edhe nuk isha i përgatitur për një përgjigje të tillë, që më duket disi e paturpshme e jashtë natyrës së të folurit me meshkujt të grave të reja të këtyre anëve.

— Është burri yt ky? Ta kujtoj edhe një herë se gënjeshtër dënohet rëndë dhe nuk është mirë t'i lini fëmijët rrugëve, pa nënë e pa baba.

— Këtë burrë unë edhe ndoshta e kam parë, por jo si burrin tim.

— Dreq o punë, — shfrevë unë me inat e dëshpërim, — ju të gjithë sikur doni të talleni.

— Jo, zotni, mos u gaboni! Kemi mjaft halle tani e s'na bie mendja të tallemi.

Sado që ngula këmbë, nuk nxora dot prej saj një përgjigje të qartë, ashtu si edhe prej të dy djemve, që i mora në pyetje pak më vonë. Madje, ai i vogli, duke e mbajtur fotografinë në dorë gjithë kureshtje, tha se ky nuk qe njeri i vërtetë, qe njeri ëndrre. Kur unë u thashë se ai ishte babai i tyre, ata më panë me sy të zmadhuar jashtë mase prej habitës, si t'u kisha thënë gjënë më të pabesueshme në botë.

— Jo, jo, — m'u përgjigjën të dy me një zë dhe shumë seriozisht. — Baba është i urtë e hokatar, — vazhdoi më i madhi. — Shihe si është ky këtu!

— Si? — u hodha unë menjëherë.

— Si ujk, — ma ktheu i vogli.

Dhëshë e mora një copë herë të gjatë me

ta, po më kot. Atëherë thirra një xhandar të posaçëm për ndërhyrje të tilla. Ai erdhi me një thupër thane të qëruar mirë dhe bëri detyrën e vet deri në atë masë sa unë u binda që ata nuk shtreshin në këmbënguljen e tyre. Ndoshta duhej ta kuptoja më shpejt këtë e të mos shkoja deri aty, pasi, kur po i përzijsa nga zyra, ata, përmes lotve, më kërcënuan se do të ma rregullonte qejfin babai i tyre. Po në ato çaste jam i shfajësuar për çdo teprim, sepse kisha krejtësisht i çoroditur nga qëndrimi i atyre të gjithëve. Prapë m'u soll nëpër kokë mendimi se mos e kishin bërë me fjalë të shpreheshin njësoj. E pamundur, thashë me vete përsëri, pasi as dy gratë, as dy fëmijët, madje as xhandarët nuk e dinin pse i kisha thirrur. Mandej, edhe sikur ta kishin parashikuar vetë, çka përsëri më dukej e pabesueshme, të paktën fëmijët nuk do të mund të ishin aq konsekuentë deri në fund në rolin e tyre, bile edhe kur rriheshin. Në tërë këtë mesele ka një nyjë të pazbërthyeshme për mua, e cila nuk m'u sqarua më tej as kur dërgova e mora në Kukës fotografimin Omer Braka, ku mendoja se janë bërë fotografitë, e nuk dola i gabuar.

Kukësi është qyteti më i afërt nga këtu, qendër e prefekturës që përfshin edhe nënprefekturën tonë dhe mban rreth dhjetë orë të mira rrugë me kalë, pasi udhët janë të tilla sa edhe karroca nuk përdoret dot. Ndërsa Omer Braka është i pari fotograf në këto anë. Ai,

pasi u kthye nga një mërgim prej tetë vjetësh në Amerikë, ku paska punuar si çirak te një fotograf publik, nga i cili ka marrë vjedhurazi edhe pak zanat, ka hapur para disa muajsh një studio të vogël fotografike. Me sa duket, xhandari që e shoqëronte e që e dinte tashmë historinë e gruas dhe të djemve të Sokol Gecit, i kishte treguar përse e kërkoja. Ndaj, kur m'u paraqit, fotografi që mjaft i trembur dhe nisi të fliste vetë i pari:

— Unë zotëri, jam profesionist, i bëj fotografi cilitdo që më paraqitet në dyqan, mjafton të më paguajë. Po ju siguroj se në çdo moment do të dilja jashtë këtij parimi, po ta dija se atakohesha me qeverinë.

Unë vura buzën në gaz se më bëri përshypje mënyra e të folurit të tij, krejtësisht ndryshe nga të tjerët, sepse, harrova t'ju them, Omeri është vendas aty. E ka gdhendur Amerika, mendova. Megjithatë, buzëqeshjen time ai e mori si shenjë miqësore dhe u qetësua disi. Vuri edhe ai buzën në gaz lehtë, si njeriu që gëzohet se po arrin të shpjegohet e të mirëkuptohet me bashkëbiseduesin nga i cili priste t'i vinte rreziku. Ai nuk e duroi dot heshtjen që ra midis nesh, ndaj foli i pari:

— Jam gati t'i përgjigjem çdo pyetjeje sinqerisht dhe pa mbajtur asnjë rezervë.

— Kjo më gëzon dhe është në të mirë të punës, — thashë unë që deri atëherë nuk kisha hapur gojë.

Ai tundi kokën në shenjë falënderimi të përulur. Unë përsëri mendova për efektin latues të qytetërimit.

— A ke dëgjuar për Sokol Gecin? — vazhdova unë.

— Po, zotëri. Është klienti më i çuditshëm që më është paraqitur ndonjëherë në dyqan. Madje, as në Amerikë, ku shihje gjithfarëlloj tipash, nuk më ka qëlluar të njoh një të tillë.

— Dhe pse t'u duk kaq i çuditshëm?

— Dy gjëra më ranë veçanërisht në sy: e para, ndryshimi i përgjithshëm i tipareve të tij kur qëndroi para aparatit fotografik dhe e dyta, porosia që më bëri për foton në njëqind kopje.

— M'i sqaro më tej këto që the!

— Meqenëse qëndruam rreth dhjetë minuta duke biseduar, ndërsa përgatitja aparatin dhe plotësoja faturën, më la përshtypjen e një njeriu të qeshur e që dinte të lidhte shpejt miqësi, sepse e zgjidhte fjalën e bukur dhe të jepej i tëri kur të fliste. Kjo gjë e bënte shumë shpejt të dëshirueshëm e të besueshëm. Por, ndërsa e vështroja përmes objektivit për ta fokusuar, mbeta i shtangur. Nëpër të gjitha tiparet e fytyrës së tij lëvizte një djall që ia përpiu me shpejtësi atë gazin e shpenguar, gati fëmijnor që i kisha parë pak më parë, një djall që e tkurri dhe e ashpërsoi, i hodhi një zjarr të keq zemërimi te sytë, sa mund të them se e denaturoi plotësisht. I fola të rrinte më lir-

shëm, më i çelur dhe, që të bëja një shaka, i thashë se ndryshe do të dilte në fotografi si gogozhel. Por ai m'u përgjigj thatë se ashtu duhej. Unë nuk e zgjata më. Isha i detyruar t'i bindesha dëshirës së tij. Me ta shkrepur aparatit, çuditërisht u përzu edhe ai djalli që e pati mbërthyer dhe ai u bë rishtas i mëparshmi. Megjithatë, tek unë mbeti një enigmë që më shtyu ta pyes ç'i hynin në punë gjithë ato kopje të fotografisë. Ai qeshi me të madhe dhe më tha se kishte hapur fjalë se kërkonte nuse e se donte nusen më të bukur të Malësisë dhe të njëqind shkesët e shpërndarë fshat më fshat duhej ta mbanin në xhep fotografinë e tij.

«Eh, — i thashë unë, — me atë pamje që dole ti, vështirë t'ia rrëmbesh zemrën ndonjëres.»

«Ashtu më do e bukura e dheut», ma ktheu ai duke m'iu përgjigjur shakasë kësaj here.

Unë gjithë këtë e mora si një trill dhe nuk e pyeta më tej. Sidoqoftë, enigma, që nuk m'u kthjellua aspak, m'u bë më munduese edhe për disa kohë. E takova edhe një herë kur erdhi në ditën e caktuar të merrte fotografitë e stamposura dhe nuk e kam parë më. Por emri dhe fytyra e tij më mbetën mirë në mend dhe diçka sikur sqarova nga enigma ime vetëm pak ditë më vonë, kur lexova në Gazetën Zyrtare se kërkohet nga xhandarmëria si rebel.

Fotografi pushoi dhe po më shikonte me ngulm, për të kuptuar nga sytë e mi nëse isha

ndopak i kënaqur prej shpjegimeve të tij. Merrte frymë me nxitim ngaqë u lodh së foluri gjatë e shpejt, pa ndërprerje. Unë nxora fotografinë nga sirtari dhe ia zgjata.

— Kjo është që ke bërë ti?

— Po, zotëri.

— Më parë nuk kishe dëgjuar t'i përmendej asnjëherë emri?

— Jo, zotëri, ju betohem!

— Megjithatë je i sigurt se ky është Sokol Geci?

— Pyetja ime, me sa duket, e bërë me një ton mosbesues, e lëkundi.

— Si të të them... unë s'kam provë tjetër veç atyre që ju tregova. Mbase më është paraqitur edhe ndokush tjetër me emrin e tij. Mund të ndodhë. Sepse, për mua si profesionist, nuk ka asnjëherë rëndësi emri i klientit. Vetëm fytyra e tij më intereson. Ky Sokol Geci më ka mbetur në mend se pati një sjellje të veçantë, ju betohem. Ndaj s'kam si e vë dorën në zjarr.

— Unë heshta, dhe nuk po dija ç'ta pyesja më tej. Padashur, me fjalët e fundit e kisha çuar te dyshimet e mia. Po të dëgjuara prej gojës së tij, mua më ranë si të reja dhe më çoroditën më keq. Heshtja dhe, me sa duket, fytyra ime e ngrysur, e shqetësuan atë përsëri.

— Më falni, në qoftë se nuk arrita t'ju shërbej sa duhet, — tha, — por e ndiej të nevojshme ta theksoj prapë se asnjëherë nuk kam dashur dhe nuk dua të atakohem me qe-

verinë. Unë ndodhem i përzier në këtë histori jashtë vullnetit tim, ju betohem.

E pashë se nuk kisha ç'nxirrja më prej tij, por edhe po më bezdiste me atë sjellje tepër të përrulur, ku nuk dallohej në e kishte nga edukata a nga frika. Ndaj e përcolla, duke e porositur që për këtë bisedë të mos çelte gojë me askënd, nëse vërtet nuk donte t'je atakohej me qeverinë. Ndërsa dilte duke u përkulur e duke më siguruar njëqind herë se porosinë time do ta mbante vëth në vesh, tërë qenia e tij shprehte edhe një dhimbje të thellë nga ironia ime kërcënuese.

Mëdyshjet e mia, pasigurinë time dhe dyshimet e hallakatura ju, shkëlqesë, me të drejtë mund të m'i quani tregues të ngathtësisë e të paaftësisë për t'i zhvilluar hetimet. Ndoshta dikush tjetër do ta shplekste ndryshe gjithë këtë lëmsh dhe nuk do të ndeshte aty kurrfarë magjie, e cila për mua është bërë torturuese dhe ma ka shfuqizuar krejt logjikën profesionale.

Mbetem në pritje të urdhrave dhe udhëzimeve tuaja shpëtimtare.

Kapiteni i xhandarmërisë
Mihal Nikiqi

Pjesa mbyllëse

Kapitenit do t'i shtohet edhe më fort makthi që i la në shpirt ai hetim i çuditshëm, po të merrte vesh se gjatë më shumë se një javë që Sokol Geci nuk u duk në shtëpi, gruaja, nëna dhe dy djemtë e tij, që u morën në pyetje, e përmendnin fotografinë vetëm kur donin ta trembnin vajzën e vogël që bënte ndonjë prapësi foshnjarake.

— Shshsht, mos, se të erdhi burri i fotografisë!

Ajo, e lemerisur më keq se t'i nxirrje djallin me brirë përpara, zgurdullonte sytë dhe tulatej pas fustanit të së ëmës. Hidhte sytë nga fundi i errët i dhomës, ku nuk mbërrinte dot drita e mekur e llambës me vajguri dhe i dukej se shihte vërtet një qenie të përçudnuar, që mund të të gllabëronte vetëm me shikim. Mbyllte sytë fort, i shtrëngonte derisa i dhimbnin, uà vinte të dy pëllëmbët e vogla përmbi, megjithatë ajo lubi arrinte prapë t'i futej nën qepalla. Atëherë ia plaste vajit duke u dridhur e tëra dhe nuk qetësohej pa u bindur se Ndreka do li ta vriste me pushkë.

Bora, që pa se Sokoli e ndoqi fare i paturbulluar e me buzë në gaz, pa e çelur gojën, tregimin për thirrjen e tyre në postën e xhandarmërisë, u bind më tej se ai as që kishte ndonjë lidhje me atë fotografi. Ndaj u shtang e, iu bë gjuha nyjë kur e vuri re se e mbyti një mërziti e thellë pasi dëgjoi për llahtarinë që e zinte vajzën nga burri i asaj fotografie. Gruaja nuk po kuptonte asgjë. Madje, këtë të fundit ia tha me të qeshur, më fort për t'i treguar atij diçka të veçantë nga shtëpia, nga fëmijët.

U desh një copë e mirë kohë, që ajo ta merrte pak veten, sa të mund ta pyeste të shoqin, përse ndërron ashtu përnjëherë. Ai ia

vonoi përgjigjen dhe asaj, nga padurimi, i erdhën lotët në buzë.

— Qenka bërë gogoli i fëmijëve ai burrë, — tha dikur Sokoli dhe psherëtiu gjatë. — I shkreti!

Bora u trondit edhe më keq. Kurrë në jetën e tyre të përbashkët s'kishte parë në zërin e tij aq shumë vuajtje. Nuk diti si t'i përgjigjej dhe heshti. Ai u ngrit, drodhi një cigare, e ndezi dhe vazhdoi ta pinte më këmbë. Errësira e butë e natës pranverore e bënte edhe më të kuqe majën e ndezur të cigares. Borës iu duk se po shihte një pikë gjaku që vlonte në mes të fytyrës së tij dhe u rrëqeth. Megjithatë, Sokoli as që po e vinte re çoroditjen e saj. Ngaqë e thithte fort, cigarja i lëshonte çdo herë një dritë të zbehtë, si dritë hëne nga mjekra e deri lart, te balli. Bora ia ngulte sytë nën atë ndriçim dhe përsëriste me vete si nëpër jerm:

«O zot! Ç'i bëra burrit që u plak kështu, përnjëherë?! O zot! M'i lër mendtë në kokë!»

Ai e piu cigaren deri në fund duke qëndruar si i ngrirë më këmbë. Për ta fikur, e zuri zjarrin e saj me dy gishtat dhe e shtrëngoi fort. Bora ndjeu erën e rëndë të lëkurës që u dogj, po nuk tha gjë. Ndërsa ajo përpiquej me të gjitha forcat të gjente një fjalë që t'ia thoshte, më tepër edhe për të dalë vetë nga ai ankth, ai, ashtu në heshtje, iu afrua vajzës që flinte dhe qëndroi një çast i përkulur mbi të. Pastaj

doli nga dhoma. Bora e mori me mend se shkoi në kthinën tjetër, ku flinin djemtë. Në ajër ndihej ende era e rëndë e lëkurës së tij të djegur. Dhe ajo u kujtua për cigaren që i shoqi sapo piu. Ishte hera e parë që ai pinte duhan në dhomën e fjetjes.

Sokoli u kthye, mbylli derën ngadalë, u afrua edhe një herë te vajza, pastaj erdhi e u shtri urtësisht ndanë saj.

— Po flinin djemtë? — Ajo u gëzua shumë që mundi më në fund të nxirrte një fjalë, sado që pyetja ishte fare e kotë dhe nuk e çonte gjëkund te halli i vet.

— Flinin, — u përgjigj ai me po atë zë të hequr.

Bora e kuptoi se ai prapë nuk do të çelej dhe tha se ndoshta do të qe më mirë të mos e ngacmonte. Ai do të fliste patjetër, kur ta shihte të nevojshme ta nxirrte jashtë vetes të keqen që po ia mundonte shpirtin. Heshti si të mos ndodhej aty. Koha nuk po ecte fare dhe ajo u lut ta zinte pak gjumi. Por jo. Sokoli nuk gjeti për asnjë çast rehat. U ngrit disa herë të shihte fëmijët. Bora e ndiqte me sy, e pushtuar nga një makth i tmerrshëm që gati po ia merrte frymën. Duke lëvizur ashtu, vetëm në të brendshmet e bardha, me një ngathtësi të panatyrshme sidomos për tipin e tij, dukej më fort si një vegim sesa si njeri. Po zbardhte kur ai i dha gruas shenjën e parë që e dinte se ajo ndodhej aty.

— Eh, — tha, — po si, Ndreka del ta vrasë me pushkë atë burrin që i tremb të motrën, ëh? I shkreti burrë! I shkreti djalë!

Bora u ngrit në bërryl me një lëvizje të vrullshme, si të donte të shpëtonte nga thonjtë e një bishe.

— Po janë lodra fëmijësh, bre burrë! Ç'pate kështu? Fole një fjalë, se ma plase shpirtin!

Ai nuk u përgjigj, veç u kthye nga ajo dhe i buzëqeshi trishtueshëm e si i zënë në faj. Po Bora donte më shumë, donte që ai të shpjegohej, ndryshe nuk çlirohej. Sidoqoftë, tani kishte fituar njëfarë sigurie që e bënte më këmbëngulëse. Megjithatë, ai vetëm i buzëqeshte ashtu dhe i përkëdhelte butë flokët e shpleksur mbi nënkresë. Nga zëri i saj u zgjua vajza.

— Nënë, — foli ajo pa i çelur sytë ende, — me kë po flet?

— Ka ardhur baba, — i tha ajo, — hajde merre ngrykë se është shumë i përmallur për ty!

— Ooo, baba! — shpërtheu gëzimi i saj. — Sa mirë që erdhe! A do ta vrasësh atë burrin e fotografisë që vjen të më mbytë mua?

Atij i shpërtheu një dënesë e thellë dhe zuri ta puthte vajzën e ta shtrëngonte si kurrë ndonjëherë më parë.

— Po, — i thoshte përmes lotve, — po, të pastë baba! Do ta vras e ta hedh në përrua, ujqit le ta hanë, korbat le ta hanë, qentë e

tërbuar le ta hanë, krimbat, gjithë egërsirat.

Vajza u mek në kraharonin e tij e nuk hapte gojë. Ai shfrim i papritur e hutoi edhe më tepër Borën e ia lidhi gjuhën. Megjithatë, mendoi se do t'i bënte mirë, le ta zbraste dufin deri në fund, sepse, mbase, do të thoshte pastaj diçka më të qartë.

— Ah, këta xhandarët, po pse më bien në qafë, pse s'më lënë në hallet e mia? Më bëjnë të jem frika e fëmijëve të mi, — filloi prapë ai pas një heshtjeje të shkurtër. — Ma thuaj, si gruaja ime, a kam faj, a kam faj unë? Po të shtie në be për krye të tre fëmijëve.

Bora përsëri nuk po kuptonte asgjë, megjithatë, sa për ta lehtësuar disi i tha se nuk kishte asnjë pikë faji. Kur atij i pushoi dënosa dhe u qetësua pak, ajo e pyeti, si me gjysmë shakaje, se pse i dukej se qenkësh bërë frika e fëmijëve.

— Si? — u kthye ai i çuditur. — Vërtet nuk e ke marrë vesh? Po në atë fotografi jam unë, që mos qofsha!...

— Po si? Pse e bëre? — Zëri i Borës doli i loqhur.

— Sepse po merrja të tjerët në qafë, — iu përgjigj ai dobët.

Bora kafshoi buzën fort për të mos klithur. Vajza, që deri atëherë as që ishte bërë e gjallë, e strukur në gjoksin e tij, u hodh si e trembur:

— Jo, babë, jo, nuk je ti aty.

— Jo, lulja e babës, jo, nuk është baba aty,
— e qetësoi ai dhe e puthi lehtë në flokë.

Pak më vonë vajza u ngrit e doli të lante
fytirën.

— Ta çova të zezë këtë natë, — i foli
ai me dhemshuri së shoqes dhe e afroi më
pranë vetes.

Ajo nuk iu përgjigj, veç iu ngjit më fort
pas trupit.

— Po ne s'të njohëm, ti nuk ngjaje fare, —
i tha ajo. — Si qenkan këto fotografitë kështu?!
Të ndërrokan si dreqi!

— Nuk të ndërrokan fotografia, — tha ai. —
Mua s'më ndërroi fotografia, më ndërroi qe-
veria. Ajo ma ka borxhin.

Në këtë kohë, në derën e shtëpisë u dë-
gjuan trokitje të forta dhe fill pas tyre disa zëra
të trashë mashkullorë që i thërritnin njëherësh
Sokolit të dorëzohej se ishte i rrethuar.

Bora brofi në këmbë e shqetësuar dhe mall-
koi veten që e humbi mendjen e nuk e la bu-
rrin të dilte nga shtëpia, si zakonisht, para se
të gdhinte.

— Xhandarët, — tha pa pikë gjaku në fy-
tyrë. — Të mora në qafë!

Ai po vishej, krejt i qetë, si të mos i dë-
gjonte fare trokitjet dhe thirrjet e shfrenuara
të xhandarëve. Hyri me rrëmbim vajza dhe
pas saj të dy djemtë.

— Ç'janë këta që i bien derës si të çme-
ndur?! — foli ajo me një pozë prej të madhi.

Bora e pa me habi sepse vajza nuk dukej fare e trembur.

— Ka ardhur ai burri i fotografisë, — i tha Sokoli, i qetë si më parë. — Tash do ta vrasë baba që mos mundë të të trembë ty kurrë ma.

1988

Je KOT fore ti
që e lexon keto libër
Kno për vete se kam
lexuar se mos të
gryen mendje

KOHË PEZULL

Ende pa u marrë vesh mirë në qytet lajmi se Italia fashiste kapitulloi, të burgosurit politikë thyen burgun duke u gdhirë e shtuna e parë e shtatorit dhe ikën të gjithë në mal. Nuk qe hera e parë që thyhej burgu politik, i ndër-tuar që në kohën e pushtimit turk në kështjellën e vjetër të qytetit, ndaj kjo gjë nuk ngjalli habi të madhe te njerëzit. Tërë atë ditë, të nesërmen e në disa ditë që erdhën më pas, qytetin e përmbyti një lumë thashethemesh, të cilat vërtiteshin të gjitha rreth Hyqmet Hidit, gardianit më të vjetër të këtij burgu, i vetmi nga të shtatë gardianët e atyshëm, që të bur-

gosurit e liruar e nuk e morën me vete për t'i bërë gjyqin në mal.

— Po Hyqmetin pse e paskan lënë? — e pyeti e shoqja, Sanija, vërtet e çuditur, Myneverin, komshien e tyre, e cila që në mëngjes herët, sapo e dëgjoi te çezma e lagjes nga gruaja e mullixhiut të qytetit, ia solli e para lajmin.

Myneveri rrudhi supet e rëna dhe e pa me djallëzi, mos Sanija shtirej sikur nuk dinte gjë. Ndërkohë, prapa shpine, Sanija dëgjoi zërin e kreshpëruar të së bijës, Selvies:

— E pse ta merrnin?! Ç'ka bërë ai?! Çil e mbyll një derë me një çelës sa herë i jepnin urdhër të tjerët, për të nxjerrë bukën e gojës. Dhe ka vuajtur, sa copë është bërë një jetë të tërë. Edhe i ka ndihmuar ata të gjorët sa ka mundur! E dimë ne si ua qante hallin me gjithë shpirt!

Selvia ishte afruar pa u ndier dhe Sanijes, thellë-thellë, i erdhi mirë kur e dëgjoi vajzën të fliste aq prerë për ta mbrojtur të atin. Pastaj, kur pa se Myneveri nuk po largohej, e ndjeu se ajo donte t'i tregonte diçka më tepër, po nuk i pëlqente të qe vajza aty. Më pas, kur tërë kjo histori do të përfundonte në mënyrë aq tragjike, Selvia e para do t'ia priste shkurt Myneverit të mos u shkelte më në derë, se qe ndjellakeqe e tyre. Por aty për aty iu bind s'ëmës e hyri brenda. Dhe Myneveri, duke përsëritur pas çdo fjale se s'duhej të qe e vërtetë,

i tha se Hyqmeti nuk paskësh kundërshtuar fare kur grupi i parë i të burgosurve të liruar i kishin kërkuar çelësat e qelive të shokëve të tyre. Bile nuk paskësh thënë asnjë fjalë. Veç i kishte ndjekur me sy, ulur në karrigen e vet në krye të korridorit, ku rrinte gjithmonë gjatë orarit të shërbimit, derisa qe larguar edhe i fundit. E kishte pirë deri në fund cigaren e nisur, pastaj qe ngritur e me një çap të ngeshëm kishte nisur të kontrollonte një nga një qelitë e zbrazëta. «Kushedi ç'i ka thënë mendja atë çast, do të jetë hutuar, i shkreti, do ta ketë humbur, se, thonë, ecte si në gjumë. Dhe kur u ka dalë në fund, ka shkuar prapë me atë çap të lodhur te froni i vet. Ka mbështetur kokën mbi gjunjë e ka filluar të qajë me dënesa të thella, siç i kanë dënesat vetëm burrat që u bie a s'u bie të qajnë me lot një herë në jetën e vet. Por s'duhet të jetë e vërtetë, se pse do qante?!»

Sanija deshi t'i thoshte *mjaft*, sepse në zërin e saj dalloj një lloj kënaqësie të ligë, por, sa u bë gati të nxirrte fjalën, vuri re se Myneverin nuk e kishte më përpara. Kishte vetëm dy duart e saj që dukeshin gjithnjë si të palara nga yndyra e enëve. Ato fërkoreshin pareshtur me njëra-tjetrën, si të donin ta fshihnin sa më mirë atë gojën që tregonte se Hyqmeti paskësh qarë një copë herë me ngashërime të thella, pastaj, pa i fshirë lotët, qe ngritur rrëmbimthi e kishte dalë jashtë. Ashtu i ndërkyer, kishte shkukur dy gurë të mëdhenj

në murin e vjetër të kështjellës që mbyll oborrin e burgut e me ta nën sjetull, duke dihatur, që ndalur në qelinë e parë. I lëshon tërë inat në dyshtemenë prej çimentoje dhe qëndron pak duke dëgjuar zhurmën e përplasjes që thërrmohet nëpër muret e ftohta e të lagështa nga mungesa e përjetshme e diellit dhe vjen në veshët e tij si ulërimë e mbytur njerëzore. Pastaj del, tërheq derën me të fortë pas vetes dhe i vë drynin e madh. E provon njëherë nëse është mbyllur mirë, siç bënte gjithmonë dhe, pa i lënë kohë vetes të mbushet me frymë, sulet prapë jashtë. Merr dy gurë të tjerë për qelinë e dytë. Mandej dy për të tretën, të katërtën... dhe kur mbërriti tek e fundit, ishte i mbytur në djersë. Por nga vija e hollë e buzëve i përhapej në gjithë fytyrën një buzëqeshje e tejngopur me kënaqësi. Kaloi përgjatë korridorit të mugët me një hap të rëndë, që të kumbonte fort, si kërcënim, e ta dridhte heshtjen tinëzare të dyerve të mbyllura të qelive dhe u rehatua në fronin e vet të zakonshëm. Vuri tufën e madhe të çelësave në prehër dhe drodhi ngadalë një cigare...

— Vërtet e ke mbushur me gurë burgun? — Me këto fjalë e priti Sanija të shoqin te dera e oborrit, vonë pasdite, kur ai u kthye në shtëpi.

— Ç'thua, moj? — Gati u përplasën fytyrë për fytyrë se ai bëri para, por ajo nuk i liroi rrugë. Priste përgjigjen. Tërë ditën që endur

nëpër shtëpi si e trullosur nga padurimi dhe nuk i kishte zënë dora asnjë punë.

— Burgun, e ke mbushur me gurë burgun që u thye mbrëmë? Na bëre gazin e botës. — Pa e mbaruar mirë fjalën, Sanijes i nxorën sytë xixa prej shuplakës së fortë që mori.

— S'të duhet gjë ty, hajde tani, futu brenda!

Dikush pa vetëm pëllëmbën e zemëruar që u ngrit dhe dëgjoi fjalët e tij të fundit, pastaj ulërimën e dëshpëruar të gruas. Pas disa minutash, në berberhanën e qytetit po tregohej se Hyqmeti paskësh dashur të merrte me zor të shoqen në burg. Po pse? S'duron dot ai të jetë burgu pa frymë njeriu. Dhe do të burgoste të shoqen? O zot! Ç'nuk dëgjon në këtë kohë! Ç'të bënte, njeri tjetër s'i bindej, polici s'kishte. Nuk do ta burgoste, kundërshtonte një tjetër. Nuk rrinte dot vetëm në atë shkretim burgu e deshi ta merrte të kalonin bashkë natën. Qyqari! Pse të rrinte natën atje?! Të ruante mos i iknin gurët? I është bërë jeta burg atij. Para mbretërisë, me mbretërinë, me fashizmin, gjithnjë rojtari aty. Ka harruar si flihet në shtëpi. S'ka faj, qyqari! Vërtet, shtoi një tjetër gjithë seriozitet, po unë bëj çudi kur do ta kenë zënë atë vajzën. Të tjerët përreth qeshën me të madhe. Ndërsa

ai që foli, vetëm tundte kokën, si ta mundonte me gjithë mend ajo enigmë.

Në kohën që përflitej kështu në berberhanë, në derën e Hyqmetit trokiste Hafëz Pasha. I vetmi pasha që ka nxjerrë në jetën e vet ky qytet, por as ai s'e gëzoi gjatë festën e pashait se ra Perandoria Turke. Duket se e ruante si peng të madh atë kohë, pasi uniformën e pashait s'e hoqi kurrë. Bile, edhe kur u bë oficer i kalorësisë mbretërore, prapë se nga nxori një leje të rrinte me atë uniformë. Thuhej se u fye shumë dhe i bëri disa letra të gjata radhazi vetë Ataturkut, të mbushura me mllef kundër një gazetari turk që e paskësh ironizuar në artikujt e vet kur ka vizituar qytetin. Kur hapi derën dhe pa trupin e tij të hollë e të gjatë, që mosha ia kishte mbledhur e shtrembëruar supet në të djathtë, Sanija lëshoi një klithmë dhe u kthye rrëmbimthi të ikte. Ai e zuri për krahu dhe e shtyu mënjanë.

— S'erdha për ty, — i foli ngrysur.

Hyqmeti brenda e dëgjoi, e njohu nga zëri, po nga minderi ku që mbështetur nuk lëvizi as kur pashai hyri në dhomë. Ngriti vetëm sytë pak dhe nëpër buzë iu rrotullua një «ulu» e shurdhër.

— Nuk do të rri, — tha pashai. — Po i mo-

ra vesh të gjitha e s'më mbante vendi pa të parë. Eh, ti je për pasha! Pasha dhe e ke pak. — Dhe ashtu siç hyri, doli, duke shtyrë kalamenthi përpara trupin e vet të gjatë dhe të hollë.

— Ç'ka marrë vesh ky? — Sanija u gëzua se i erdhi rasti t'ia sillte prapë fjalën aty ku e brente. Zëri mbeti pezull e s'mundi të shtonte edhe diçka, sepse pa si lëvizën menjëherë rruhat e ballit të ngritur të Hyqmetit, si t'i shpërndaheshin trembshëm nën lëkurë një tufë gjarpërinjsh helmues.

— Nuk flet fare, nuk e hap gojën, si të qe prej druri të thatë, — i thoshte të nesërmen Sanija së bijës, Selvies, e cila, e mbytur në lot, i tregonte si i kishte dalë prapë në rrugë ai djali i kasapit të qytetit. Ndryshe nga herët e tjera, s'ia kishte lëvduar as sytë, as flokët, s'i kishte thënë se për të po i nxihej jeta, veç, me një pamje përgjëruese, i ishte lutur t'i harronte gjithë ç'i pati thënë më parë. Ta harronte dashurinë e tij të pafaj, të pastër. «Bile, u gëzova shumë që të pashë. Më zuri frika mos më ikje pa m'i falur mëkatet», kishte vazhduar ai. «Si? Pse? Ku do të shkoja?» Zëri i saj doli i holluar, si të artikulohej vetëm me majën e gjuhës. «Atje, pra, në burg. Në burgun e tyt

eti. S'mbahet gjithë ajo bina vetëm me gurë. Gurët as nuk i rreh dot, se të vritet dora, as nuk i ther dot, se të thyhet thika. Gurin, e le pa ngrënë, s'të lyp bukë, e le pa pirë, s'të lyp ujë, i tregon dhemshuri, s'ta di për nder, bëhesh i vrazhdë, nuk të ankohet. Do njeri burgu, ndryshe s'quhet më burg, që edhe të zotët e tij të kenë me kë të gërricen.» Djali i kasapit kishte lëshuar një psherëtimë të gjatë dhe ia kishte ngulur sytë, i pikëlluar, që Selvinë, pas gjithë atyre fjalëve të papritura e të çuditshme, e kishte shpërthyer e qeshura, një e qeshur e marrë, që dilte gulsha-gulsha prej kraharorit të tij të kërcyer, herë e hollë si fishkëllimë, herë e trashë si pëllitje. Ajo pamja e pendestarit të mjerë që larguar menjëherë prej fytyrës së tij të gjerë e pak të shtypur në mollëzat e faqeve, si të ishte prej tymi.

— Po ti mos u mërzit, ai të marrtë të ligat, — i fliste Sanija e i lëmonte flokët. — Ç'na gjeti! O zot, ç'të kemi bërë që na e hodhe këtë rrufe në të kthjellët?! Si s'pate pak mëshirë! Ç'paska hyrë kjo vjeshtë e zezë?!

Hyqmeti i dëgjoi të gjitha nga dhoma matanë, ku ishte mbyllur që një natë më parë, pas ikjes së ngutur të pashait plak. Ndërsa pashai, pak minuta pasi u nda me të, turfullonte në kafenenë e Hakiut, duke pirë sherbet të zier. Nuk qetësohej dot. Kishte ngritur karrigen t'i binte në kokë Malës së marrë. S'është i marrë ai, u thoshte atyre që e mbajtën, s'është i marrë, bën vetë, dëgjomëni mua! Di i marri të flasë ashtu?!

«Si do të bëjë ai miku yt, pasha, — i kishte thirrur Mala nga kreu i kafenesë, sa e pa të hynte, — si do të bëjë tani, ku do të mbahet, e pati fashizmi, s'ka më burgje, s'ka më diktaturë, s'ka më pushtet. Oho-ho! Shkon e vjen njeriu rrugës si t'i dojë qejfi, thotë ç'i vjen në mendje e s'ka nevojë të shqyejë sytë majtas e djathtas mos e dëgjoi ndonjë hafije. Oho-ho! Ngrysesh e ngdhihesh rehat, nuk pret me gjak të ngrirë kur po troket dera nga kondakët e policëve. Jo je marrë me politikë, jo s'je marrë me politikë. Jo bën politikë të kuqe, jo bën politikë të zezë. Politikë me ngjyra, si fustan arixheshke, politikë pa ngjyra, si luspat e peshqve, pashá. Pashë një vandak me resme të Duçes te nevojtoret e Xhamisë së Beqarëve. Oho-ho, si dukeshin! Dhe qeshi mbytur një copë herë, duke mbllaçitur ngadalë një gurabije, i kredhur në lumturinë e vet të pacak.

Edhe të tjerët, që u ndodhën në kafene, u çuditën me fjalët e tij. Malën e njihnte gjithë

qyteti dhe e shihte me dhimbshuri se pati lindur i marrë. Rrinte tërë kohën rrugëve, hante ç'i jepnin dhe flinte qosheve, pasi në shtëpinë e prindërve nuk shkulte. Atje më rrahin, thoshte, duan të më mbajnë mbyllur. Qe i butë në marrëzinë e tij, nuk sulmonte kurrë dhe herë-herë sesi i zgjidhej goja e bëhej i lezetshëm. Megjithatë kurrë nuk kishte folur ashtu. Ata që e dëgjonin, nuk e dinin se vinte nga berberhana e Ali Qyfyres dhe atje i pati mbledhur ato fjalë. Pasi e mbaroi gurabijen, ai vazhdoi me një ton serioz e gati patetik të tregonte se Hyqmeti, pasi i ka mbushur një nga një qelitë me gurë, të fundit e ka ruajtur për vete. Ka hyrë brenda, ka tërhequr derën fort, por pastaj është kujtuar se i burgosuri s'rri dot me derën e qelisë të pakycur. Ndryshe s'është i burgosur, derisa mund të ngrihet e t'ia mbathë kur t'i dojë qejfi. Burgu aty e ka lezetin. Hi-hi-hi! Hall i madh për të shkretin Hyqmet! Si të bënte? Ata që e kanë vënë atë derë, si për kastile, për ta vënë në siklet Hyqmet ziun, bravës s'i kishin lënë vrimë çelësi në anën e brendshme. Dhe i shkoi tërë dita aty, ulur në kanapënë prej dërrasash duke vrrarë mendje si t'ia dilte këtij halli. Hi-hi-hi! Si thua ti, pasha, e zuri belaja mikun tënd, ëh?! Hi-hi-hi!

Hafëz Pashës nuk iu durua më, kapi për shpinore karrigen që iu ndodh pranë dhe e ngriti me sa pati vrull t'i binte kokës së vogël të Malës së marrë, i cili u mpi menjëherë nga

frika, aq sa nuk iu dha fare të lëvizte prej vendi për t'iu shmangur goditjes. Dy-tre veta përreth zgjatën njëherësh duart dhe mbajtën karrigen e ngritur në çastin që ajo po lëshohej rrëmbimthi poshtë.

— Lëshomëni, — shfrynte Hafëz Pasha, i bërë flakë në fytyrë, ndërsa mjekra i dridhej si trokashkë mulliri. — Do ta ngordh të birin e qenit.

— Hi-hi-hi! — i shpëtoi një e qeshur tjetër Malës tek largohej. — Kujton se më shan kur i thotë babait tim *qen!* Budallai! Hi-hi-hi!

Po atë ditë korrespondenti i lirë i gazetës së sapombyllur të qytetit mendonte me trishtim të madh se çfarë fakti sensacional po harxhohej kot, pa parë dritën e shtypit. Në kokën e tij vërtitej skema e një reportazhi të zgjeruar që do të qe tronditës edhe për lexuesin më mospërfillës. Një gardian i moshuar burgu, pasi ka shkuar një jetë nëpër ato korridore të ftohta çimentoje tmerrsisht të lëmuar, rrethuar me porta metalike të trasha, që mungesa e përhershme e ndriçimit të plotë i bën të duken si të ndryshkura, befas gjendet aty vetëm, fare vetëm. Të burgosurit ikën gjithë gaz, duke marrë me vete jo vetëm zërat kundërshtues, ankimet nga plagët e torturave, gërrhitjet e gjumit të shqetësuar, por edhe erën e rëndë të trupit të palarë me javë. Dhe burgu mbarë u mbush vetëm me heshtje, një heshtje e shurdhër si ujë i ndenjor, i turbullt. Gardianit profesio-

nist i duket vetja si në një ëndërr të makthshme ku po i zihet fryma. Dhe për t'u zgjuar, përplas fort kokën pas murit ku është mbështetur.

Kërcitja e thatë e kafkës nuk përhapet përreth, siç ndodh zakonisht me zhurmat, po mblidhet e tëra brenda trurit të tij si breshka që mblidhet brenda samarit të vet kur e kërcënon diçka nga jashtë. Aty vazhdon të gjëmojë mbyturazi një copë herë dhe gardianit i erren sytë. Kur shuhet, vendin e atij gjëmimi e zë një e therur e mprehtë që sikur e shkund dhe ia zgjon mendimin. Ngrihet me një lehtësi të paparë dhe del jashtë. Pasi në oborr nuk gjen gurë të mëdhenj, shfryn një herë nëpër dhëmbë nga inati dhe sulet te muri i vjetër i kalasë, që edhe mbyll oborrit e burgut, ku dikur kalonin minutat e ajrosjes të burgosurit politikë. I hipën një forcë e shfrenuar, e papërmbajtshme, që nuk do të mund të besohej se fshihej në atë trup më se të zakonshëm. Vërshimi i beftë i forcës i krijon një lloj dehje, që pamjet e jashtme ia sjell në tru si të mbështjella me një pëlhurë avullore, të hirtë. Të gjithë gjymtyrët bëjnë vetë atë që u takon, si të drejtuara me magji. Dorës nuk ka nevojë t'ia dëftojë syri gurin që duhet të marrë dhe as vendin ku duhet ta lërë, hapi e zgjedh vetë truallin ku duhet të mbështetet, trupi rrotullohet vetë nga duhet të shkojë. Dhe ai hyn e del disa herë ngarkuar e shkarkuar, i përhumbur në ekstazën

e shpirtit të zemëruar e të fyer e që nuk fal pa e çuar deri në fund hakmarrjen e vet. Në një çast kthjellimi sheh se në korridor është mbledhur një grumbull i madh me gurë. Atëherë i davaritet ajo veshja avullore e sendeve përreth dhe ndien trupin t'i shpiket me një zhaurimë të ngjashme me atë që lëshon prushi kur i hidhet ujë sipër. Ngadalë e gjithë përkujdesje fillon të bëjë një mur të trashë, me të cilin mbyll portën kryesore. Vetë qëndron nga brenda. Punon deri në fund krejt gjakftohtë, madje edhe duke fërshëlyer lehtë një këngë të vjetër dashurie...

«Një vetëmurosje e pashembullt!» tha me vete, gjithë pikëllim, gazetari i pushtuar nga ethet profesionale. Do të dilte një reportazh i mrekullueshëm politiko-psikologjik, ku do të zbërthehej psikologjia e veçantë, krejt e pangjashme, e njeriut që ka kaluar gjithë jetën në një mjedis të mbyllur, ku nuk egziston mirëkuptimi, ku njerëzit i bashkon vetëm dyshimi ndaj njëri-tjetrit e ku ata vihen ballë për ballë vetëm si dhunues e të dhunuar barbarisht. Të jesh vetëm dëshmitar i krimit sistematik, në mënyrë të pandjeshme do të të mbli-dhen në shpirt eksese nga më të papërfytyrueshmet, ku shkrihen në një vreri i hidhur, pikëllimi molisës e çmenduria e rrezikshme. Nga ana tjetër, nuk është vetëm absurditeti i gjestit të gardian Hyqmetit që e bëri menjëherë qytetin të ziente. Jo. Ka arsye shumë më të thella. Se-

pse në qytet ndodh përditë diçka absurde e qesharake, por që kalon pa asnjë bujë, vetëm me një buzagaz shpotitës dhe regjistrohet si një anekdotë për t'u treguar midis të tjerave. Mua në këtë reportazh do të më jepej rasti të trajtoja, ndoshta për herë të parë jo vetëm në publicistikë, vendin që ka burgu politik si institucion në jetën e qytetit dhe jo veç në periudha të qeta, kur arrestimi i një kundërshtari politik të regjimit në fuqi është diçka e veçantë, spektakolare, por edhe në periudha thellësisht të trazuara, kur arrestime të tilla janë nga ngjarjet më të dendura, më të zakonshme dhe në dukje nuk përbëjnë më asnjë kërcënim, pra nuk janë më faktor sigurie për ruajtjen e qetësisë publike. Konstatimi se qyteti, sido që të hiqet në një moment a në një tjetër, vëmendjen e plotë ndaj institucionit të burgut nuk e humbet, e bëri gazetarin ta pyeste veten gati me zë: «A mund të vijë ndonjë kohë kur burgu të shihet ndryshe nga qyteti, jo më me frikë dhe me syrin për ta shkatërruar? Si do të jenë burgjet, po të fitojnë komunistët?» Këtu arsyetimi i tij ngeci.

Atëherë u kthye përsëri te reportazhi për ngjarjen konkrete. Në gazetë shkrimi mund të shoqërohej edhe me një bisedë me Malën e marrë, ku ai të përgjigjej se si i kupton fjalët që thotë poshtë e lart se tani s'do të ketë më diktaturë e të burgosur politikë. Burgjet vetëm me hajdutë duhet të jenë shumë të ndyra, të neveritshme. Kurse ato vetëm me kriminelë duhet

të jenë llahtarë. Ah, ah! Ofshante i pezmatuar gazetari pasionant, duke përplasur pëllëmbën në tavolinë. Një reportazh eseistik me një temë kaq të prekshme për të gjithë, ku ndërthuret aventura me sakrificën e plotë dhe pranë tij, në të njëjtën faqe, konceptet e një idioti për lirinë. Një gjetje krejt origjinale. Gjëra të tilla ta dyfishojnë menjëherë tirazhin e gazetës dhe të japin ty një honorar tepër të majmë e një emër që s'e fiton dot me qindra shkrime të përditshme, të mundimshme. Bisedës me Malën e marrë s'i ikën koha, tha pastaj ai si për t'u ngushëlluar, mund ta bëj edhe më vonë, kur të rihapet gazeta. Nxori bllokun dhe shënoi në të me shkrimin e vet të imët: *Njeriu është i lirë vetëm kur është si unë: bën ç'i do qejfi. — Mala i marrë. Bisedë.*

Vërtet, shtoi pas pak, i çuditur edhe vetë me atë mendim të dëgjuar atë ditë prej Malës së marrë në kafenenë e Hakiut, a mund të ekzistojë një liri e tillë, e pakufizuar për njerëzit që s'janë të çmendur? Ndërsa vriste mendjen t'i gjente një përgjigje pohuese pyetjes së tij, u kujtua se po lodhej për të zbërthyer shprehjen e një të marri dhe i erdhi të qeshte më veten.

Tri ditë, — si për t'ia ngrënë për së gjalli ato tri ditë të fundit të jetës, — gazetari nuk gjeti qetësi. Kaq fort ndihej i lidhur me ngjarjen e burgut dhe kaq domethënie shihte në të, sa nuk i shpëtonte dot për asnjë çast ngasjes

së saj. Duke u vërtitur orë e çast në këtë vorbull marramendëse, ku joshja e madhe ndeshëj me pamundësinë e plotë të realizimit të saj, ai pa se po tërhiqej nga dëshira për të shkruar një roman, edhe pse nuk ishte marrë ndonjëherë më parë me prozë artistike. Vështrimi i lëvizshëm i reportazhistit profesionist fitoi pak nga pak përqendrimin hetues të romancierit. Ky shndërrim, e sidomos çlirimi nga padurimi i njohur i gazetarit për ta parë sa më shpejt të përfunduar e të botuar shkrimin, e gëzuan atë e i dhanë besim te vetja. Në një bllok të ri nisi të shënonte hollësisht gjithçka dëgjonte poshtë e lart për subjektin e veçanërisht variantet e ndryshme që shtoheshin çdo ditë me shpejtësi rreth veprimeve të Hyqmetit, ku elementë të përhershëm mbeteshin vetmia e tij, gurët dhe dekori i burgut. Duke kaluar nga njëri variant te tjetri, gjeje shpërthime të mrekullueshme të fantazisë, të cilat e zhvillonin gjithnjë e më mirë edhe idenë e tij si autor dhe e bënë të jepej më tërësisht, sepse çdo tregim i ri i ngjallte ndjenjën e gëzimit të përmbytur që të japin dhuratat e çmuara e të papritura. Besonte se nuk do të mund të kishte arritur te to kurrë vetëm me përfytyrimin e vet.

Thuhej se më së shumti ato i përhapte berberi i vetëm i qytetit, Ali Qyfyryja, siç e thë-

rritnin të gjithë, ngaqë tërë kohën do ta dëgjoje duke treguar anekdota të stisura për bashkëqytetarët e vet e që i sajonte aq bukur, sa askush nuk ia merrte për keq. Ndaj berberhana, edhe pse klientët i kishte të rrallë, sepse njerëzit zakonisht rruheshin nëpër shtëpitë e tyre dhe qetheshin me njëri-tjetrin, pasi në atë qytet nuk i kushtohej ndonjë rëndësi e veçantë paraqitjes së flokëve se ato, që nga mosha tetë-nëntë vjeç e lart mbaheshin të fshehur nën qeleshe a të mbështjellë me peshqir; pra, berberhana, edhe pse klientët i kishte të rrallë, përsëri ndodhej gjithmonë plot. Mblidheshin sehirxhinj të ngeshëm që e shtynin ditën duke pritur e përcjellur batutat thumbuese të Ali Qyfyres, apo duke ngacmuar shoku-shokun. Në rrethana të tjera, gazetari ynë nuk do të mund ta përfytyronte veten duke qëndruar me orë të tëra midis atyre njerëzve vanitozë, që s'i mërziste asgjë përveçse vapës, që nuk po binte fare edhe pse shtatori po thyhej në mes.

Gazetari e kapërceu gjithë drojë pragun e berberhanës, duke kujtuar se të tërë të pranishmit do të kthenin kokën nga ai me çudi e do t'i hidhnin vështrime pyetëse për të mësuar shkakun që e kishte shtyrë ta begeniste shoqërinë e tyre. Dhe, kur nuk ndodhi ashtu, kur askush nuk i kushtoi ndonjë vëmendje të veçantë, u ndie menjëherë më i lehtësuar e më i qetë. Kërkoj me sy një karrige të lirë dhe shkoi e zuri në heshtje e me një hap të sigurt. Vetëm

berberi i bëri shenjë nëse kishte nevojë për shërbimet e tij. Dhe ai, po me shenjë, iu përgjigj se jo. Berberi i buzëqeshi miqësisht dhe gazetari u shpengua më tej.

Kur po kthehej në shtëpi, në drekë, gazetari mendonte i çuditur se e njihte shumë përciptas jetën e vërtetë të qytetit të tij, edhe pse aty pati lindur e qe rritur. Po tani nuk kishte kohë të përjetonte asnjë lloj mbrese tjetër veç atyre që lidheshin drejtpërdrejt me subjektin e burgut. Në berberhanë mësoi se Hyqmeti, pasi e pa veten të mbyllur nga të gjitha anët në burg, befas u pushtua nga një mall i madh për jetën jashtë atyre mureve të errëta. Iu kujtua kënga e zogjve, erëtimi i luleve, fishkëllima e erës, ngjyra e përflakur e diellit kur lind e kur perëndon, ndriçimi i përmbajtur i hënës që ngrohet netve të verës e ftoh netve të dimrit, përkëdheljet nazike të vajzës, përkëdheljet drithëruese të gruas, kodra e vogël tashmë e ngjeshur mirë e dheut të varrit të babait, një kushëri i vet, Nevzati, moshatar me të, me të cilin para shumë vjetësh pinë një herë sa u bënë tapë dhe ai i thoshte me gjuhën të trashur si të mban-te arra në gojë:

«Më punë të fëlliqur që ke ti, s'ka kush, o kushëri! Lëre, bëji m... dëgjomë mua!»

«E ke gabim, e kundërshtonte Hyqmeti, e ke gabim. Të mos qe ajo puna ime, bëhej një rrëmujë këtu, që s'e merrte vesh i pari të dytin.»

Kur ky e përsëriti disa herë atë mendim, Nevzati, që nuk tërhiqej nga e veta, mblodhi buzët me përçmim dhe nga pas tij erdhi një zhurmë si pëlcitje tullumbaci. Në mëngjes u gdhinë të dy të shtrirë drejt e në pleh në stallën e kuajve, sepse të mbrëmshmen u qe mbushur mendja top se ishin kuaj. Iu kujtuan shumë gjëra dhe gjithçka i vinte jashtëzakonisht e bukur në kokë, aq sa nuk mund të duronte larg tyre. Po të vazhdonte edhe pak, do të plaste...

— Me një fjalë, edhe Hyqmeti për vete nuk i duroi dot prangat, iu zgjua ëndrra për të qenë i lirë, — ndërhyri dikush.

— Po, — iu përgjigj serioz ai që tregonte, një mesoburrë i shkurtër, me shallvarë gjithë njolla vaji e me një shami rreth qafës gjithashtu të lerosur. — Atëherë vendosi të dilte me çdo kusht prej andej. Po si? Nuk shkoi t'i vinte shpatullat atij murit që bëri vetë për të zënë hyrjen e ta shembte, sepse gurët ishin të palidhur me llaç e do të binin lehtë, po filloi të hapte një llagëm të nëndheshëm me një gjysmë luge që gjeti në një qeli e me thonj. Dheun e bartte në xhepa dhe e hidhte në gropën e nevojtores, siç kishin bërë dy të burgosur të arratisur në kohën e mbretërisë. Punoi ashtu derisa e lëshuan forcat. Kur, ndaj të ngrysur, e shoqja shkoi ta kërkonte me gjak të ngrirë nga vonesa e gjatë dhe nga moria e fjalëve që silleshin si erë e tërbuar rrugë më rrugë e portë më portë për të, e gjeti përmbys

në korridor, të këputur në një gjumë të thellë. Klithma e parë i shpëtoi prej së largu, se e kujtoi të vdekur, po tmerrin më të madh e pati kur i pa thonjtë e shqyer si të çukitur prej orlash e xhepat të mbushur me dhe. I vuri veshin te zemra: punonte. Ofshani: qenka çmendur! Dhe me zor të madh e ngriti, e hodhi në kurriz dhe u nis për në shtëpi duke e hequr gjysmë zvarrë.

Një tjetër e kundërshtoi burrin me shallvare e me shami rreth qafës. Ai nguli këmbë se e dinte shumë mirë që e shoqja nuk kishte shkuar fare ta kërkonte në burg. Hyqmeti, pasi u përpoq një kohë të gjatë ta hapte llogëmin, pa se nuk i dilej mbanë. Nga dëshpërimi i madh doli vetëm kur i shkrepri një mendje tjetër: do të arratisesh nëpër kanalin e ujërave të zeza. Kapiteni, komandanti i burgut, i porosiste gjithnjë gardianët dhe rojat që t'i mbanin sytë hapur për ta kontrolluar vazhdimisht atë kanal, si një nga vendet më të rrezikshme nga mund t'u iknin të burgosurit. Hyqmeti u përvodh rrëzë mureve me fshehtësinë më të madhe, i bindur se edhe atë e ruanin një mijë sy të padukshëm, derisa zbriti poshtë në kanal. Sikletin më të madh e pati në rrugën nga bregu i lumit, ku derdhet kanali, deri në shtëpi. Nuk duhej ta shihte kush. E shoqja, kur i çeli derën e oborrit dhe e pa ashtu të llangosur nga këmbët te koka e që kutërbonte qelbësirë një orë larg, s'e përmbajti dot një klithmë lemerie.

Por ai e bëri ta mblidhte shpejt veten me një shpullë të rrufeshme turinjve.

— Për ty jam katandisur kështu, — i tha prerë dhe e shtyu mënjane të futej brenda.

Të gjithë ata flisnin me një seriozitet e vendosmëri të patundur, që gazetarin e çorodiste, sepse nuk arrinte ta dallonte ç'ishte e vërtetë e ç'nuk ishte në gjithë atë lëmsh që mbështillej e shpëstillej pa pushim. Megjithatë, qetësohej duke menduar se më kryesorja ishte që për romanin i vlenin të tëra. Ndaj, me të mbërritur në shtëpi, u ul në tavolinën e punës t'i hidhte në bllokun e posaçëm. Pastaj hëngri drekë me një shije të rrallë dhe piu plot një shishe verë, gjë që s'e bënte shpesh, pasi i përmbahej parimit se gazetari duhet ta ketë në çdo çast mendjen të kthjellët. E shoqja e vuri re gjendjen e tij të ngritur shpirtërore dhe deshi të dinte shkaku. Kur ai nuk i dha asnjë shpjegim, vari buzët duke u ankuar se nuk e fuste kurrë në të fshehtat e veta dhe kjo përbënte një provë të pakundërshtueshme të mungesës së dashurisë.

— Po nuk kam gjë, — u shfajësua ai, — më ka ardhur një gjendje humori ashtu kot, vetvetiu.

Ajo i dha të kuptonte se nuk e besoi aspak, po nuk e zgjati më. Tani për tani punën e romanit ai donte ta mbante të fshehtë. Të paktën gjersa të mbaronte përgatitjet e të fillonte të shkruante, që, sipas parashikimeve të

tij, do të qe shumë shpejt. Ngaqë edhe gazeta nuk dilte, ai ishte krejtësisht i lirë.

Pa i treguar askujt, bile as së shoqes, Anetës, një grua me fytyrë të bukur, por me njëfarë shpërpjesëtimi të pahijshëm në trup: në mes e lart vinte shumë e ngushtë, ndërsa ijët i zgjeroheshin përnjëherësh tepër dhe lidheshin pa nyjë me këmbët pulpëtrasha e të kërcyera, pra, pa i thënë gjë as Anetës, ai nisi të duket më dendur se kurrë nëpër kafenera. Më e zgjedhura mbetej kafeneja e Hakiut. Aty do të gjendej patjetër Mala i marrë, që lavdonte kohën pa pushtet, pa diktaturë, pa të burgosur politikë, që po jetonte qyteti. Dhe bënte sherr me Hafëz Pashën, i cili, pas grindjes së parë me të marrin, dilte përherë nga shtëpia me një jatagan varur pas brezit. «Ky i ndan burrat, thoshte duke ia lëmuar dorezën e argjendtë, jo ato pisqollat që edhe një foshnjeje t'ia vësh në dorë, ia bën «bam» me një gisht. Ky vetëm me krah burri godet.» Njerëzit qeshnin nën buzë dhe i hidhnin ndonjë rromuz për trimëritë e shkuara, të cilat, për çudi, ai i merrte gjithmonë shumë seriozisht dhe fillonte e tregonte gjerë e gjatë gjithë kënaqësi. Mala e shihte gazin e keq të njerëzve përreth dhe trimërohej. I sillej rrotull tavolinës duke kërcyer herë në njërën këmbë, herë në tjetrën, i nxirrte gjuhën e i thërriste përmes piklave të pështymës që u binin edhe të tjerëve në fytyrë: «Pasha-diktatura, vdiqe, mbarove, dy pare s'të bën lëkura! Jepja jataga-

nin Ali Qyfyres ta bëjë brisqe për rrojë! Ha-ha-hiii! Ku ma ke Hyqmet Burgun?!»

Hyqmeti as ditën e dytë nuk doli fare jashtë. Bile nuk doli as prej dhome e nuk takoi njeri. Rrinte shtrirë në shpinë e pinte duhan paprerë. Edhe Sanijes vetëm një herë i foli, kur e porositi shkurt të mos i sillte askënd. Kujtdo që të vinte, t'i thoshte se ai po flinte e nuk donte ta zgjonin. Në të vërtetë as që kishte mbyllur sy tërë natën e natës e, me sa dukej, gjumi do të vazhdonte t'i rrinte larg. Në kokë i digjej pa pushim një zjarr, tymi i të cilit dilte jashtë nëpër sytë e tij paksa të mbyllur, si të mbushur me blozë. Tym shkante fjollafjolla të holla me një amë djegëse dhe mbushte dhomën. Është tym magjie, tha ai me vete, sepse prej tij dilnin pamje nga më të çuditshmet. Në fillim u tremb prej tyre dhe qe gati të ulërinte nga tmerri. Pastaj nuk pati më fuqi të trembej dhe u tulat, duke pritur nga çasti në çast të ndodhte e liga. Më vonë u mësua me to dhe, madje, pa se fshehurazi po e argëtonin. Kjo ndjesi i erdhi kur aty njohu veten. E njohu vetëm nga zëri dhe nga hunda që e kruante tërë kohën. Zakon i mbetur nga të qëndruarit në një vend me orë të tëra, pa lëvizur, pa bërë asgjë, pa pasur dikë pranë për të ndërruar një llaf. Hyqmeti që i shfaqej përpara, nuk i jepte

të njohur. Ai kishte veshur këmishë, setër dhe pantallona llamarine, një palë këpucë hekuri në formën e potkoit, të gjitha të pikura bashkë e që hapeshin vetëm në një vend, në bark, drejt aty ku i binte kërthiza. Aty tundej një dry i madh që përplasej me një tringëllimë gërvishtëse sa herë ai lëvizte. Duart i mbante të fshehura mbrapa dhe i hakërrehej dikujt që nuk shquhej nga sytë e Hyqmetit të vërtetë, atij që rrinte shtrirë në kanape: «Jo, more, dashke çelësin ti, ëëh?! Nuk ta jap, kaq ta bësh dhëmbin! Kot më lutesh! Nuk ta jap, se, po ma hape këtë dry, do të më bien në shesh zorrët, mushkëritë, zemra, të gjitha.» Dhe qeshte pastaj kërcënueshëm. Përmes asaj së qeshure sikur avullohej dhe zhdukej për pak kohë. Kur kthehej rishtas, kishte pamje tjetër, e cila, sado e përçudnuar, prapë filloi t'i pëlqente Hyqmetit. Ndaj i tha së shoqes të mos i sillte njeri në dhomë kushdo që të ishte. Nuk donte të shkëputej nga ajo botë e panjohur deri atëherë, si botë e përtejme.

Ky veçim i tij i plotë ia preu daljet jashtë edhe Sanijes.

Ndërsa vajza, Selvia, që nga mëngjesi kur u kthye nga pazari përsëri me fytyrën të larë me lot, bëri be se vetëm në arkivol do ta ka-

përcente pragon e shtëpisë sot e mbrapa. I kishte dalë prapë përpara i biri i kasapit, kësaj here me një pamje të vrarë nga mërzia e madhe. Me sytë përdhe e pyeti se pse po vonohej kaq gjatë pa u kyçur atje lart. Dhe tregoi me kokë e me dorë nga ndërtesa e braktisur e burgut.

— E ç'punë kam unë atje? — belbëzoi vajza, që s'po kuptonte asgjë, duke kafshuar buzën për të mbytur vajin.

Të shkante që të vinte ai ta çlironte e ajo të bëhej e tij përgjithmonë. Mezi po priste. I kishte mprehur kanxhat për t'u ngjitur në muret e larta të kalasë e i kishte bërë gati sharrat për të prerë hekurat e dritareve të burgut. Pas-taj do ta mbante para duarsh e ajo do t'i varej në qafë butësisht, ndërsa flokët e shpleksur do t'ia trazonte lehtë era. Herë pas here ai do të përkulej mbi fytyrën e saj paksa të përskuqur e do ta puthte ngadalë në buzët që i digjeshin e ajo do t'i përkëdhelej pas trupit si të gjitha princeshat e rrëmbyera përmes rreziqeve të mëdha. Do të bënin një shëtitje ashtu mes për mes qytetit, duke i thyer me krenari vështrimet ziliqare të të tjerëve. Kur të ktheheshin në shtëpinë e tij, do të mbylleshin për një javë në dhomën e tyre e vetëm do të bënin dashuri, pa u kujtuar as të hanin as të pinin. Derisa t'i ndienin trupat t'u mpakeshin e t'u treteshin si të kishin kaluar një ethe të zezë.

Pak nga pak, si t'i tërhiqte lart fjala e përndezur, sytë e tij të rrëzuar përdhe u drejtuan

nga ajo. Ajo pa si lëvizte nëpër ta një hije e papërcaktuar, siç janë hijet e përthyerë mbi rrjedhën e lumenjve. Selvies nuk i vinte asnjë fjalë në majën e gjuhës, nuk i bindeshin gjunjët për t'u larguar as edhe një hap, vetëm gjoksi i kërcente përpjetë prej ulërimave të shpirtit. Tha se po plaste. Ai vazhdonte t'i fliste me një ton përgjërues që të mos vonohej, të mos ia linte t'i ndryshkeshin kanxhat e sharrën e mprehur, të shkonte, qysh atë çast të shkonte të mbyllej në kështjellën e zbrazët të burgut të babait. Ndryshe...

Ajo që Selvia priste gjithë ankth, erdhi: ai ia plasi gazet. E qeshura, si t'i shpërthente nga damarët bashkë me gjakun, ia bëri flakë të kuqe qafën, mjekrën dhe fytyrën e gjerë me mollëzat e shtypura pak. Shpërtheu edhe Selvia, që mezi po duronte. Asaj i doli vetëm një fjalë:

— Pse? — që përsëritej si nëpër jerm, herë e shuar sa mezi i bënte buzët të lëviznin, herë klithëse si t'ia nxirrte i gjithë trupi njëherësh.

Sanija nuk e dinte që edhe kësaj here Hyqmeti po i dëgjonte fjalët që e bija po i tregonte për djalin e kasapit. Por asaj i bëri përshtypje se, kur hyri pak më vonë në dhomën e Hyqmetit, i pa në fytyrë një hije të blertë të ndezur si t'i qe derdhur drejt e mbi lëkurë një helm i freskët barërash të egra. Priti një grimë ashtu në këmbë në mes të dhomës. Pasi ai nuk po fliste, nuk iu durua pa e pyetur edhe një herë se ç'qenë ata gurë të dreqosur që përmende-

shin gjithandej nëpër qytet, që gurë varri iu bërshin atyre që i merrnin nëpër gojë. Zëri i saj lutës e bëri ajrin të hollohej e të kumbonte një copë herë rreth e rrotull kokës së tij të rrëzuar mbi nënkresën e përthyer më dysh. Ai vetëm sa ia hodhi sytë e, me një të ngritur tepër të ngathët të kapakëve të tyre lart, i dha një she një të dilte jashtë, që ajo e kuptoi se ishte e pakundërshtueshme.

Sanija nuk e zgjati më. Tek mbyllte derën ngadalë, i hodhi të shoqit një vështrim të mbyshur zemërim dhe mëshirë. Aty për aty iu këput çdo lidhje me të, si t'u futej në mes një teh i mprehtë shpate. Burri iu bë i gjithi i huaj. Sanijes iu duk se shpëtoi nga një barrë nën të cilën ishte kërrusur mundimshëm që prej dy ditësh e gati po thyhej më dysh. Ndaj u ndie përnjëherë e lehtësuar. U ul ndanë vatrës në dhomën e zjarrit dhe, duke trazuar prushin me mashë, në një lojë të pavëmendshme, po e gjykonte të shoqin me një mospërfillje e gjakftohësi të plotë, si të qe fjala për një të njohur të rastësishtë, nga ata që të mbeten në mend vetëm prej një veprimi të veçantë, të pazakonshëm. Dhe kur e kujton, të përfytyrohet pikërisht ky veprim dhe asgjë tjetër e tij, bile as fytyra. Ajo e dinte se ky Hyqmeti, gardian i vjetër në burgun politik të qytetit, ishte ndodhur në shërbim natën që u thye burgu. Komunistët e mbyllur aty ikën të tërë në mal, duke marrë me vete edhe gjashtë gardianë, të

gjithë më të rinj se Hyqmeti edhe në moshë, edhe në atë zanat. I lidhën e, pa u prekur fare nga përgjërimit e tyre, u thanë se do të jepnin hesap deri në një para gjyqit të popullit për krimet që kishin bërë. Hyqmetin nuk e morën me vetë. Nuk e quanin aq të përlyer me gjakun e tyre. Dhe Hyqmeti mbeti fillikat në tërë atë bina të zyrtë. I pamësuar një jetë ta shihte ashtu, aq të heshtur, por edhe nga tronditja e madhe që i dha furia e të burgosurve që po çliroheshin, vendi ku ndodhej iu duk si varr. Kjo përshtypje iu përforcua edhe më ngaqë drita e mugët e agimit që po çelte hynte me zor nëpër kuadratet e vogla të dritareve të qelive dhe, sadokudo, se zbehte, e ndryshonte dritën e llambave elektrike. Dhe asnjë zë, asnjë rënkim i këputur, asnjë e kollitur njeriu rreth e rrotull. Në të ikur të burgosurit i kishin vënë një tel të hollë nga mbrapa derës së jashtme, që ai të mos mund ta hapte shpejt, po të donte të lajmëronte garnizonin italian poshtë në qytet. Kur ai e shtyu atë derë e ajo vetëm u luhat pak duke lëshuar një gërvimë të thatë, si heqje shpirti, nuk pati më pikë dyshimi se ndodhej në varr. Kjo bindje ia fshiu fare edhe kujtesën. U përpoq një copë herë të gjatë të sillte ndër mend kur vdiq e si vdiq, kush e vajtoi e kush u gëzua, po më kot. «Hajde, budalla, hajde», i foli vetes qortueshëm, po ku mban mend i vdekuri! Atëherë një zë i brendshëm i tha se këtu po niste nga e

para jetën e re, jetën e dytë, ku gjithçka është ndryshe, e pangjashme me jetën tokësore. S'kishte më as strehë, as katandi. Ndaj do të bënte mirë të fillonte të ndërtonte sa më shpejt një shtëpi për vete. U ngrit me vrull nga vendi, i dha një të shtyrë të fortë me sup derës së mbyllur dhe, kur ajo u hap, drita e ditës, e dyndur prapa kanateve të saj të hekurta, iu derdh me vërshimë e tëra në sy dhe ë lëbyri. U vërsul jashtë verbtazi, rrëmbeu dy gurë të mëdhenj në sqetull, nga gurët e rrëzuar prej murit të vjetër të kështjellës dhe, po me vrap, i çoi brenda. Kur u gjend përsëri në korridorin e gjatë, duke u mbushur me zor me frymë, pa se kishte harruar pse i duheshin ata gurë. Dhe që gati t'i nxirrte prapë aty ku i mori, por dikush nga brenda vetes i foli:

«Mos u mashtro! Ata s'janë gurë, janë të burgosur të rrezikshëm që shtiren si gurë që të arratisen. Nxito, se në oborr ke të tjerët që po bëhen gati t'ia mbathin.»

Atëherë ai, pa e zgjatur, i plasi gurët në qelinë e parë dhe ua mbylli me kyç derën nga jashtë. Vazhdoi me të dytën, të tretën... deri tek e fundit. Dhe vajti mandej u ul në ndenjësën e vet të zakonshme. Por lodhja rraskapitëse e humbi menjëherë në një gjumë të thellë e të mbushur me ëndrra. Kur u zgjua pas ndonjë ore, trurin e kishte fare të shpirë dhe e kuptoi marrëzinë e vet. Por ishte vonë ta fshihte. Dikush e kishte parë, ndoshta mullixhiu

i qytetit, që shkonte menatë gjithmonë t'u lëshonte ujin mullinjve. Sepse edhe Myneveri nga gruaja e tij e pati dëgjuar së pari historinë.

E trokitura e beftë e me forcë në derën e jashtme e shkëputi Sanijen nga mendimet ku qe kredhur. Përtonte të ngrihej, ndaj i thirri së bijës të shkonte ta hapte. Selvia nuk iu përgjigj. Sanija lëshoi një ofshamë dhemshurie për të dhe shtyu trupin përpara me një mundim që ia shtrembëroi fytyrën, si të mblidhej gjithë lodhja e atyre ditëve aty. E trokitura u përsërit edhe më e paduruar dhe, i copëtuar nga goditjet e rrepta të shkopit në derë, erdhi zëri i Hafëz Pashës:

— Nuse, të kanë lënë këmbët apo veshët?!

Sanija i lëshoi një nëmë nëpër dhëmbë dhe, pasi e futi brenda pragut, i tha ftohtë se Hyqmeti po flinte, ndaj prapë nuk mund të hynte tek ai. Hafëz Pasha as që ia vuri mendjen ftohtësisë së saj. Atij iu duk e tepërt, shumë e tepërt të vinte për herë të tretë e Hyqmeti të mos tundej prej vendi.

— Mos e ka zënë ai gjumi i gjatë, që s'të lëshon më, moj?! — thumboi ai.

— Helm e ke gjuhën kur të prishet terezia, pasha! — ia ktheu Sanija pak me të qeshur, që ta qetësonte disi të ardhurin. Edhe vetë u

habit pse nuk i erdhën të rënda fjalët e tij për të shoqin.

— Jo po ashtu është, — vazhdoi pashai dhe u kuptua se filloi t'i binte zemërimi. — Mbylle derën, mbylle! Apo mezi pret të më përcjellësh?!

— Dhe i tundi kokën pajtueshëm.

— Jo, çne, pse të shkon vetëm për keq mendja? — tha Sanija dhe u skuq sepse pikërisht këtë gjë po mendonte. — Jo, ti ke shtëpinë tënde këtu, urdhëro!

Ai nuk hyri brenda. Mbështetur në bastunin e vet të ngrënë në dorezë prej fërkimit dhe djersës së shumë viteve, i tregoi shpejt e shpejt, aty në oborr, gjithë ç'flitej nëpër qytet për Hyqmetin. Hafëz Pasha ishte i mbushur inat me këtë jazëk millet që «nuk sheh t'u vërë ndonjë arnë brekusheve, po merr nëpër gojë dhe përqesh një njeri të ndershëm». Si ushtarak i vjetër, ai do t'i jepte Hyqmetit dekoratën më të lartë, pasi kishte treguar se me postin e tij nuk e lidhte rroga, po ndërgjegjja. E kupton ti? Ai mund të ikte, t'ia mbathte, të vinte të strukej në shtëpinë e tij e kudo qoftë, po nuk e bëri. Respektoi rregulloren e shërbimit, që thotë qartë e prerë se për asnjë arsye nuk ke të drejtë të largohesh nga detyra para orarit të caktuar. Ndryshe quhesh dezertor dhe dezertori në ushtri ka fatin e qenit që kafshon të zotin.

Sanija mezi po e mbante të qeshurën, aq me bindje dhe seriozitet fliste ai.

— E ç'i mbeti Hyqmetit të ruante aty, gurët?
— deshi ajo t'ia ndalte vrapin.

— Ah, jo, jo, nuse, s'është ashtu! Ushtaraku edhe hijen e vet t'i japin urdhër ta ruajë, duhet ta zbatojë deri në një. Kupton ti? Ndaj i thonë ushtarak atij. Ah, të qe gjithë bota ushtarake, do të bënim të tjera fjalë bashkë. Nuk do të vinte puna t'i ngjitte njeriut të ndershëm nofka qesharake edhe ai Mala i marrë. E të tjerët, në vend që t'ia thyejnë turinjtë, gajasen pa pikë turpi.

— A do të kishte njerëz të ndershëm atëherë? — Sanija nuk e kuptoi as vetë nga i doli ajo pyetje.

Hafëz Pasha, që s'e kapi mospërfilljen e gruas, ose u hoq ashtu që të zbrazej lirisht deri në fund, ta nxirrte jashtë marazin e shpirtit për të shpëtuar prej tij, aty kërceu si ta pickonte dikush papritur në vend të keq:

— Nuse, nuse, jo kështu, nuse! — Atij filluan t'i dridheshin supet e shtrembra dhe Sanijes për një çast iu dhimbs. Por ai s'e la ta përjetonte gjatë atë dhembshuri e pendesë se iu kthye, kësaj here, duke kërcëllitur dhëmbët: — Të ishe gruaja ime, qafën do të ta përdridhja. — Hështi një grimë dhe vazhdoi me një vrazhdësi të fshehur: — Zaten edhe këtu del fatkeqësia e ushtarakëve të shkretë. Gravë të tyre u zgjatet ca si fort gjuha e u lirohen vidhat, se nuk i kanë natë e ditë burrat mbi kokë t'ua zbutin brinjët.

— Aha, ndaj s'u martove zotrote! — ia ktheu Sanija, që nuk ndiente më asnjë lloj druajtjeje e as mëshirë për të. — Se ka ca që thonë se na mbeti pashai beqar duke qarë harmin e shkuar...

Hafëz pasha lëshoi me hundë e me gojë njëherësh një grumbull të pakuptueshëm tingujsh, u bë gati ta ngrinte bastunin, por e uli prapë, i solli rrëmbimthi shpinën dhe u drejtua me atë vrull nga dera e oborrit, duke belbëzuar mbyturazi:

— I gjori Hyqmet! I gjori Hyqmet! Kur s'e do gruaja e vet, si do ta dojë njerëzia! Vetëm mua më qan xhani për të e ai mua më lë pas porte. Ç't'i bëj kësaj, — ai i ra kraharorit me grusht, — pa s'shkelja më këtu në jetë të jetës?! Po do të vij prapë, — pashai u kthye gjithë zemërim nga Sanija, që e ndiqte me një vështrim nënqeshës. — Do të vij se ai ka nevojë për mua. — Dhe u zhduk. Ndërsa Sanija qëndroi pa lëvizur në oborr derisa nuk u dëgjua më e trokitura e nxituar e bastunit të tij në kalldrëmin e rrugës që zbriste për te kafeneja e Hakiut.

Vështrimi nënqeshës i mbeti Sanijës i ngjitur mbi lëkurën e fytyrës si maskë që i rrinte ngushtë. E para që po e vuante atë tallje ishte vetë ajo. Iu duk se papritur kishte ndryshuar.

Deri atë ditë jeta e saj pati shkuar njëlloj, duke u luhatur sa te përrulja para burrave, te një llafazanëri herë qaramane e herë grindavece me gratë. Po tallje jo, kurrë tallje. Edhe të donte ta provonte, nuk dinte. Edhe tani ajo tallje nuk i dilte prej ndonjë hovi të veçantë shpirtëror, i dilte prej dhimbjes më të thellë që i kishte rënë mbi kokë. Ajo dhimbje e papritur erdhi duke e mpirë të tërën pjesë-pjesë, gjersa e bëri shpërfillëse, të pandjeshme, të pazonjën për të nxjerrë qoftë edhe një pikë loti kur shihte burrin nga një anë e vajzën në anën tjetër, si qenë katandisur.

Zuri vend përsëri pranë oxhakut dhe, pa vetëdije, mori mashën e vazhdoi të luante me prushin që herë pas here kërciste duke lëshuar një tufë të çrregullt xixash të sarta që shuhe-shin duke u përdredhur kuturu pa fluturuar një pëllëmbë. Sanija tha se ato përdridheshin ngaqë shtrëngoheshin fort për të mos u fikur, për të mos vdekur.

Në atë përhumbje, duke u përpjekur, si nëpër ëndërr, të zbulonte pse ndryshoi ashtu befash, çfarë magjie i hodhën që e bënë aq të drunjtë, kush e pati fajin, iu duk vetja fare e përcudnuar, sepse nuk mundi t'u jepte asnjë përgjigje qetësuese pyetjeve që e gërryenin përbrenda. Nuk ishte më grua, se gruaja heq fatin e burrit, i bardhë a i zi qoftë. Fati i burrit për të tani ishte vetëm një përrallë, që edhe ajo ia tregonte vetes, si gjithë qyteti, me të ar-

galisur. Nuk ishte më as nëna. Selvia, në të ndarën tjetër, me fytyrën zhytur në nënkrejsë, qante dhe betohej me gjithë shpirt se do t'ia bënte vetes varrin. Ajo që e kishte pjellë Selvinë shullëhej ndanë zjarrit ku zienin groshët, në qejf të vet dhe as që lodhej për të gjetur një fjalë ngushëllimi për atë krijesë të njomë të mjerë. Tha se po i pëlciste koka nga këto mendime të zeza, po fytyra erdhi duke iu çliruar nga ai ngërçi i maskës, derisa iu lehtësua plotësisht dhe sikur mori frymë me sy, me ballë, me mollëzat e faqeve gjithë babëzi. I dha trupit përpara, me një gjallëri të harruar, të ngrihej të shkonte te njëri e te tjetri, t'u binte në gjunjë e t'u përgjerohej të mos sterronin ashtu se, në fund të fundit, bukën e tyre hanin e jo bukën e botës që t'i vareshin aq fort asaj në qafë.

U bë gati të merrte për nga dhoma e Hyqmetit, po menjëherë iu kujtua shenja e tij e prerë me të cilën ai i kishte thënë të dilte jashtë e të mos e trazonte. Ajo kuptoi se Hyqmeti nuk ndiente asnjë pikë nevojë për të. Dhe u step. Në vetëdijen e saj si gruaja e tij një jetë të tërë u ndie e fyer. Kjo fyerje, që vetëm tani iu shfaq e qartë si e tillë, kishte qenë mundimi i saj i pazbërthyer gjatë tërë kësaj kohe. U gëzua që e mësoi shkakun pse burri iu bë ashtu përnjëherë i huaj dhe u çlirua nga krenaria e vet e paqëllimtë dhe e panatyrshme, gjë që e ktheu rishtas në hallin e tij. E harroi për-

sëri vajzën, por qe një harresë tjetër, jo më prej mospërfilljes. E bija i doli nga vëmendja siç të dalin gjërat e dorës së dytë kur të zë poshtë një kob i madh. E pushtoi ankthi ta dinte prej gojës së tij si ishte ajo puna e gurëve, po nuk guxonte ta pyeste më pas asaj turfullime të pazëshme që mori herën e fundit. «I shkreti ai, — tha gati me zë, — të shkretët ne!» Dhe iu rrëmbushën sytë. Lotët rrodhën të mëdhenj e të rrallë nëpër faqet e saj të zeshkëta dhe i përcollën një vakësi të këndshme nëpër gjithë trupin. Ajo as që ngriti dorën t'i fshinte.

Në atë kohë, gazetari, ulur në tavolinën e vet të zakonshme të punës, po shënonte në bllok se të nesërmen, që i binte të qe dita e tretë nga koha e thyerjes së burgut, i duhej ta takonte patjetër vetë Hyqmetin, si dhe gruan e vajzën e tij, për të dëgjuar nga goja e tyre se ç'mendonin për ngjarjen dhe për të plotësuar njohjen rreth psikologjisë dhe karakterit të secilit nga ata të tre veç e veç e në marrëdhëniet e tyre të mëparshme. Kjo njohje i duhej me domosdo për ta vendosur subjektin në një terren konkret, të kapshëm për masën e lexuesit dhe që personazhet të kishin një biografi mbi të cilën të mbështetej logjikisht zhvillimi

i tyre letrar. «Letërsia s'është si gazetaria, që për analizat e veta mund të mjaftohet edhe në të dhënat e një momenti të caktuar, të shkëputur nga rrjedha komplekse e ngjarjeve», i tha vetes me tonin e një pedagogu të sprovuar.

Filloi të shfletonte ngadalë bllokun e mbushur gati përgjysmë. Vende-vende ndalej, lexonte diçka dhe vazhdonte prapë duke buzëqeshur gjithë kënaqësi. Ishin hedhur aty, pa ndonjë sistemim të veçantë, një mori copëzash bisedash të dëgjuara andej-këndej e që ai tani i shihte thuasjse si kapituj të gatshëm për romanin e vet.

Në një fletë më vete shënoi disa hollësi për atmosferën e pangjashme historike të qytetit kur zhvillohej subjekti. Qyteti gdhiehet e ngrysej pa pushtet, gjë që krijoi menjëherë shqetësim të madh në treg, pasi, me kapitullimin e Italisë, doli jashtë qarkullimit edhe paraja ekzistuese. Ndaj, dyqanxhinjtë i konvertuan pa vonesë çmimet në flori dhe shpallën se nuk shitnin me asnjë lloj kartëmonedhe. Madje as berberi nuk të rruante, as nuk të qethte, po të mos e paguaje me verdhushka. U dashka të jesh pa mbret mbi kokë që të pasurohesh tamam, thoshte me të qeshur Ali Qyfyryja, edhe pse gjatë dy ditëve pati vetëm një klient dhe ky qe doktor Nikoja, i cili iku gjithashtu pa paguar, duke i thënë berberit se do t'i bënte një vizitë falas nënës së tij të paralizuar, kur të kishte nevojë.

— S'ka gjë, doktor, s'ka gjë, — i tha Aliu duke e përcjellë teksa u buzëqeshte djallëzisht

shirxhinjve rreth e rrotull, — rëndësi ka të jesh këmbëmbarë, se e shoh që më në fund erdhi edhe siraja ime të pasurohem.

Në fillim shpallja e dyqanxhinjve u mor me shaka. Mirë lretës së italianit që i humbi vula, thoshin njerëzit, po as dollari i amerikanit, as stërlina e englezit, as marka e gjermanit nuk bëkan?! Nuk bëjnë. Po ç'kanë, pse? Mund të jenë të falsifikuara. Ee! Ku di njeri në qytetin tonë të falsifikojë parà, aman! Thua ti, po ku i dihet?! Janë bërë të mbuluar njerëzit sot, s'tregojnë ëndrrën e mirë e jo më punën e ligë. Nga dolën menjëherë gjithë ato para të botës, ku paskan qenë të fshëhura? Qyteti ynë as kurbetlinj nuk ka pasur shumë në kohën e mbretërisë. Gazetari e nënvizoi fjalinë e fundit dhe shtoi me vete se ishte vërtet e pabesueshme nga u nxorën gjithë ato lloje parash, deri edhe jen japonezë. U bë një amulli e tmerrshme në pazar, derisa dyqanxhinjtë u detyruan t'i jepnin disa sende të domosdoshme si bukën, sheqerin, kripën dhe vajin veresie, aty ku bindeshin se nuk kishte flori. Dyqanxhinjtë e veshmbathjeve e të pajimeve për kuaj nuk luajtën nga e tyrja dhe monedhat e arit i provonin duke i kafshuar me dhëmbë ngadalë, si të donin ta zgjatnin sa më shumë kënaqësinë që u jepte ai kafshim që ua shtrembëronte krejt fytyrën. Jargët e trashura prej djersës së duarve, erës së xhepave, pluhurave e gjithfarëlloj plehurinash të tjera të mbledhura prej kushedi sa vjetësh nëpër relievin e

gdhendur imët të monedhave, u vareshin dyqanxhinjve në qoshet e buzëve. Dhe ata, pa u merakosur fare, ngrinin shpinën e dorës i fshinin. Dhe vazhdonin prapë. Gazetarit iu ngjall para syve kjo pamje. Iu bë se po i përzihej dhe e largoi mendjen andej.

Dëshira që të fillonte të shkruante sa më shpejt, i krijonte gazetaro-romancierit një ekstazë të përgjithshme, që ia bënte perceptimin e realitetit disi magjik. Besonte se kurrë ndonjëherë në historinë e letërsisë nuk ishte ngjizur aq shpejt, nuk kishte marrë formën përfundimtare në vetëdijen e krijuesit një vepër e madhe sa romani i tij. I jepte dorë sidomos ai gjumi 48-orësh i Hyqmetit, për të cilin Ali Qyfyryja kishte thënë se ia pati hedhur perëndia që të mos e linte birin e saj të përvuajtur e të devotshëm të mundohej në jetë të zakonshme njerëzish, që nuk kanë halle të tilla si ruajtja e themeleve të shtetit, po rropaten si të gjejnë opinga për fëmijët, që mungojnë në treg, apo si të sajojnë me helmetat e braktisura të ushtarëve italianë potkonj për kuaj. Jo. Ai burrë besnik nuk mund të zbriste në këtë botë të ndotur qoftë edhe për pak ditë. Ndaj, derisa të vinte gjermani, që thuhej se qe në rrugë, e ta mbushte rishtas burgun me komunistët që kishin hapur depot e italianëve e po u shpërndanin miell falas fukarenjve, atij i qe falur gjumi i plotë.

Do ta pyes për ëndrrat, mendoi gazetari gj-

thë ngazëllim, si ta përgëzonte veten për mprehtësinë që po tregonte në zbulimin e anëve interesante të reja të subjektit. Ëndrrat e një gjumi kaq të gjatë pas një tronditjeje të tillë duhet të jenë poetike dhe dramatike njëherësh deri në fantazmagori, lëndë e jashtëzakonshme për letërsinë. Ah, ah, shtohet ngazëllimi i tij, një lëndë e tillë do të ishte e lakmueshme edhe nga Frojdi për librin e tij mbi ëndrrat. Ah, ah!

Kjo pyetje për ëndrrat e gjumit të atyre 48 orëve që edhe pyetja e fundit që bëri ai njeri në jetën e vet.

Sanija e vuri re që në mëngjes se Hyqmeti ishte më i çelur dhe nuk e fshehu gëzimin kur ai i kërkoi një kafe. Po, ndryshe nga zakonisht, kafën e deshi fare pa sheqer. Pastaj, kur pa se ajo nuk po lëvizte prej vendi dhe i rrinte përballë si e ngurosur, bëri atë që Sanija kishte besuar se ai e kishte humbur përjetë: vuri lehtë buzën në gaz. Të dyja dritaret, prej nga hynte e druajtur drita ende e pandotur e ditës së re, s'qëndruan më dot në vendet e tyre e nisën të silleshin rrotull duke tërhequr pas vetes një vorbull të bardhë ajri që e fshehu të tërin trupin e Hyqmetit. La jashtë vetëm atë buzagaz të pakapshëm si gjurmë hëne mbi ujëra.

— Selvi! — Ajo kujtoi se klithi, ndërsa nga

buzët i doli vetëm një pëshpërimë e këputur dhe, dyllë e verdhë, zgjati të dyja duart të mbështetëj diku ngaqë iu morën mendtë. Nga kthina tjetër nuk erdhi asnjë përgjigje.

Sanija s'e përmbajti dot një klithmë të dytë, që kësaj here i doli e plotë dhe e mprehtë si të kalonte nëpër një perde çeliku të hollë dhe i trembi për një çast dritaret e çmendura e ua ndali rrotullimin marramendës. Ato zunë prapë vendet e mëparshme. Drita, e këputur për pak kohë, vazhdoi të hynte nëpër kuadratet e tyre me një qetësi paqësore, shumë të nevojshme për sendet e ndërkryera të dhomës.

— Ç'ke me vajzën? — foli urtë Hyqmeti.
— Ç'të gjeti?! Mos u marros tani në pleqëri! Shko e ma bëj atë kafe, se më pihet shumë. Më sill edhe një gotë raki, se më paska rënë mendja!

Buzagazi ishte gjithnjë aty, përreth buzëve të tij, gjithnjë i pandryshueshëm, sa asaj i ngjau si damkë e freskët djegieje. U ngjeth nga ky përngjasim, ndërsa në veshë ende i gjëmonin ato fjalë njerëzore «më pihet», «më paska rënë mendja».

— Tani, — i tha duke e përmbledhur veten, — ja, tani, po sesi më erdhi, m'u errën sytë, një si damlla. — Dhe pa e mbaruar mirë fjalën, qe zhdukur.

Pas pak u dëgjua t'i thoshte vajzës, me një zë krejt të ndryshuar, të bluante kafën.

— Asnjë kokërr, — ia ktheu ajo me një

hakërrim të përgjithshëm, — asnjë kokërr! Nuk e prek me dorë atë mulli sikur shpirti t'i shkojë edhe atij, edhe ty bashkë me të. Le t'i bluajë vetë ata gurët e burgut të mallkuar e t'i pijë në vend të helmit.

Hyqmetit në dhomën tjetër i dolën në ballë bulëza të vogla djerse të ftohtë.

— Korbë! — iu hodh e ëma. — Korbë! T'u thaftë goja, t'u thaftë! Të shpëlaftë mortja, të shpëlaftë! Ai burg të ka dhënë bukë, të bëri kaq, që ta hedhësh bishtin përpjetë. — Ajo shqisa e veçantë e gruas së sprovuar i tha Sanijes se Hyqmeti në anën tjetër i dëgjoi të gjitha. Pati vetëm një fanepsje të shkurtër të fytyrës së tij, prej nga zhdukej me shpejtësi gazi i pakmëparshëm si ta përpinte ajri.

— Uf! Bukë burgu! — turfulloi vajza. — Të rabetet në fyt sa e kujton.

Asaj iu bë vërtet një shtrëngim i fortë në grykë, ndaj rrotulloi qafën majtas e djathtas duke shkundur supet, derisa shtrëngimi i zbriti ngadalë poshtë dhe i qëndroi si peshë e plumbtë në fund të zgavrës së kraharorit.

Për herë të parë në jetë vajza pyeti veten nëse i kishte dashur ndonjëherë si prindër dhe nuk diti si të përgjigjej. Po ata, më kanë dashur? shtoi. Duke u rritur pa motër e pa vëlla, shtëpisë ia shtonte edhe më shumë vetmë në mungesa e gjatë e babait. Pjesën më të madhe të kohës ai e kalonte atje, në burg, i cili

nuk i kishte ngjallur asaj asnjëherë ndonjë kureshtje të veçantë.

Sanija vazhdonte të belbëzonte diçka inatçore nëpër dhëmbë, ndërsa rrotullonte ngadalë dorezën e mullirit të kafes. Selvia e kuptoi se e ëma nuk i kishte shfryrë ende gjithë nëmët për të, por as që u bë fare merak të dinte ç'thoshte. Ajo lidhje e përmendur pak më parë e bukës së ngrënë tërë jetën me burgun i vërtitej brenda kafkës si një shumëkëmbësh që ia ngulte thonjtë nëpër nerva e nuk i shqitej pa ia këputur një nga një deri në fund.

— Bukë burgu, — përsëdyti me zë, vajtueshëm, — uf! — Dhe iu bë rishtas se po i ngjitej nëpër fyt ai laku i shtrëngimit mbytës duke u ngushtuar, duke u ngushtuar...

Hyqmeti e dëgjoji të dyja herët shfrimin e dëshpëruar të vajzës. Zgjati dorën, që i dridhej, nga paketa e cigareve, por i mbeti pezull. Në derën e madhe të oborrit u dëgjuan tri trokitje të thekshme. Dhe menjëherë pas tyre erdhi zëri i mbytur, si i tejngopur me lagështirë i Hafëz pashës:

— Me cilën këmbë të hyj tani, o nusja e Hyqmetit? Eh, eh, si erdhi kjo ditë, që mos u harroftë! Të vij në shtëpi të mikut e t'i thë-

rres në derë së shoqes kur burrin e ka gjallë!
Eh, eh!

Drang! kërciti minderi ngaqë trupi i Hyqmetit kërceu vrulltas përpara. Macja, që doli e trembur prej andej, iu ngatërrua nëpër këmbë Sanijes, që po nxitonte të priste të ardhurin, e ajo, e trembur për vete, i lëshoi një sharje të rëndë kafshës së pafajshme, që Hafëz pasha e mori sikur iu drejtua atij, ndaj shpërtheu:

— Tyt, zgërbonjë! U plake e s'u bëre njeri! S'vij për ty këtu, ta kam thënë.

Gruas iu ndez tërë trupi flakë, po nuk bëri zë. U kthye në të ndarën e zjarrit, ku ishte Selvija si hije e zbehtë. Koka e anuar paksa majtas për ta mbështetur në pëllëmbën e dorës, e tregonte vajzën më të qetësuar. Shyqyr! tha gruaja me vete dhe i hodhi një shikim të papërcaktuar. Shyqyr, përsëriti pa e ditur në gëzohej nga shpresa se e bija do të ishte pënduar për ç'i nxori goja, apo ngaqë nuk do të vazhdonte shamata. Por, kur Selvia nuk i dha asnjë shenjë pajtimi, Sanijes i hipi një inat tjetër me të. U përmbajt me zor të madh që të mos i shpëtonte tërsëllima, sepse nuk donte kurrësi ta dëgjonin zhurmën të dy burrat që u takuan në shkallë.

— Ou, ou, ou! — Zëri i Hafëz pashës u tjetërsua menjëherë. Në të u fashit ai zemërim i vrullshëm që ta jep një fyerje e papritur

dhe skaj më skaj iu nder një habi e gëzueshme. — Ou, ou, ou! E di si po më duket vetja?! Si atë ditë kur takova doktor Adhamudhin, që e kisha qarë një herë për të vdekur. Nisa t'i tregoja si fliste mbarë qyteti, me pleq e çiliminj vetëm për të. E ai, i ndjeri, se tani ka vdekur vërtet e në xhenet i vaftë shpirti, se vdekje qeni të braktisur pati, i shkreti, më tha duke më tundur gishtin para syve: Vdiqa një herë, po ato fjalë të liga më ngritën nga varri. Tani e pashë kë kam mik për shpirt e kë hasëm, më tha e prapë ma tundte para syve atë gisht të hollë e të verdhë prej duhanit që pinte natë e ditë. Ndaj s'më mbante dheu, erdha edhe një herë të piqem me të gjithë. Ta dinë që s'ka më keq se kur ta ka zbuluar tjetri edhe ç'të fshehin zorrët e barkut. Tani, kur më shohin, më keq se prej lugatit dridhen. Mos loz më me vdekjen, i thashë, se ndjell keq për vete, po edhe dashamirësit i vë në siklet. Njeriu nuk luan dot me vdekjen, ma ktheu. Vdekja luan me njeriun si të dojë, si me një mace të urtë shtëpie. Sa për dashamirët, më mirë mos i përmend, të gjorët. Kjo s'është botë e tyre. Ata janë shumë pak e humbasin si pika e ujit të ëmbël në detin e njelmët të dashakëqinjve. Dhe, duan s'duan, me sot e me nesër do të bëhen si ata.

— Nuk ia mbusha e nuk ia mbusha dot mendjen se nuk ishte ashtu, — vazhdoi të fliste Hafëz pasha. — E pashë vetë, ngulte kë-

mbë doktori, s'ke ç'më thua. I shkreti Adhamudh, shëronte dynjanë, po për shëndetin e vet nuk donte ta pyesje. As ty s'po të pyes si vete.

— Mos më pyet! — foli për herë të parë Hyqmeti dhe në zërin e tij i ardhuri nuk mundi të dallonte kurrfarë shenje çmendurie, siç e pati përfytyruar disa herë gjatë kësaj kohe, pa guxuar t'ia pohonte askujt, as ndonjë zemërim a shpoti të çastit, të ngacmuar prej lidhjes që i bëri ai pa dashje me historinë famëkeqe të doktor Adhamudhit. Kjo iu duk ogur i mirë dhe e ndoqi gjallërisht Hyqmetin, që priu të hynin brenda.

— Bëj edhe një kafe për pashanë, — i thirri Hyqmeti së shoqes kur u gjendën në dhomë, ende pa u ulur.

— Unë vetëm sherbet të zier pi, ti e di. Të hidhura s'dua se i hidhur jam vetë, — u hodh pashai, i cili sikur mezi priste rastin të bënte një shaka me kripë. Dhe qeshi vetë i pari me gjithë kraharorin, ndërsa mënjanoi pak dollomanë e holluar, që, nga përdorimi i shumtë, nuk merrej vesh në kishte qenë gri apo e gjelbër dikur, për të treguar dorezën e argjend-të të jataganit të varur në brez. — Burri burrëmbetet, ka s'ka qeveri atje lart, — tha me një ngrëfosje fëmijore që nuk i shkonte fare e që e përforcoi më tej duke rrahur me pëllëmbë dorezën e ndritshme të jataganit. — Si s'ia preva kokën atij të marrit të pazarit, Malës?! S'më

linte rehat. Sa dukesha në kafenenë e Hakiut, ia niste, jo po tani s'ka më diktaturë, jo po tani s'ka më politikë, jo po tani s'ka më burgje, as të burgosur, jo po ashtu, jo po kështu. Një mijë llogje që ma bënin gjakun prush. Vallahi bilahi unë e di si kam duruar pa ia dërdhur trutë në shesh. E di se do të bëhesha gazi i botës, po... — Ai heshti një çast dhe pa mikun e vet që dukej krejt i qetë e luante me gishtat, i mbështillte e i shpështillte pa vëmendje me njëri-tjetrin. — E kishte fjalën për ty, — shtoi pashai ngadalë, me zërin të përvjedhur ngaqë deri në fund u mat ta nxirrte apo jo atë fjalë. Pastaj ia nguli sytë Hyqmetit, me një vështrim hetues e të trembur, se mos e prishi gjithë atë paqe të dëshiruar që gjeti tek i zoti i shtëpisë e që sapo u takuan ia përcolli edhe atij vetë duke ia qetuar mendimet e kërleshura, të cilat nuk i mblidhte dot që prej dy ditësh.

Megjithatë Hyqmetit prapë nuk i ndryshoi asgjë në fytyrë. Pashanë as kjo nuk e gëzoi e nuk ia përzuri nga sytë atë trembje që i farfuratej nëpër dritën e përhime të bebëzave dhe ia errësonte pak shikimin. Nuk diti si ta merrte, shenjë të mirë a të keqe, mospërfilljen e tjetrit. Po nuk deshi t'u hynte gjatë në mes heshtja, se në këso rastesh ajo kall gjithmonë vetëm mendime të liga, ndaj nisi t'i tregonte, me një të folur të ngutur, se si një natë më parë, në të ngrysur, një grumbull fëmijësh,

dhjetë-pesëmbëdhjetëvjeçarë, nga të lagjes së poshtme, e paskan gjetur taksidarin Met Rre-
pishti tek kthehej në shtëpi të dehur tapë, du-
ke u kalamendur e duke folur me vete.

— Ashtu?! Ç'thoshte? — u gjallërua pak
për herë të parë Hyqmeti.

— Allahu e di sa të vërteta janë, po mi-
leti thonë se shante shpirtin e vet.

— Shpirtin e vet?! — Hyqmeti mblodhi bu-
zët i çuditur dhe tundi kokën lehtë. — Po si?

— Urith mbete tërë jetën, i fliste, — vazh-
doi Hafëz pasha, i kënaqur më në fund që
mundi ta zgjonte vëmendjen e mikut, — urith
e shkuar urithit. Gërrryej fukarenjtë me një
dorë, gërrryej qeverinë me dorën tjetër. Vidh
poshtë e vidh lart tërë jetën.

Buzët e mbledhura të Hyqmetit u zgjatën
përpara, të rrumbullakosura sikur do të pë-
shtynin me neveri. Hafëz pashës, edhe pse nuk
pa të dilte prej andej pështymë, iu bë se në
ajër mbeti lagështia e saj e trashur dhe ndjeu
një pështirosje që mezi e kapërceu, sepse nuk
deshti t'i ndërpritej rrëfimi me të cilin, sido-
qoftë, e kishte zgjuar njëfarësoj tjetrin.

— Kur e kishte vënë re grumbullimin e dje-
mve që i shkonte mbrapa dhe kishte dëgjuar
të qeshurat e tyre nën hundë, u qe kthyer:
«Do t'ju jap një këshillë të çmueshme, ve-
tëm një këshillë: Mos u bëni taksidarë kur të
rriteni! Nuk është zanat ky. Tak-fak bie qeveria
në fund të dynjasë, ti mbetesh këtu me gisht

në gojë. Je njeri, sa çel e mbyll sytë bëhesh lugat. Se shpirtin në dorë nuk ta ka as djalli, as perëndia, ta ka qeveria. Dëgjomëni mua, mos u bëni taksidarë. As xhandarë mos u bëni!»

— Çfarë të bëhemi? e pyet seriozisht një nga djemtë, — vazhdon të tregojë Hafëz pasha. — Taksidari e vështron grumbullin, bie një grimë në mendime, pastaj përgjigjet: Bëhuni bishta sëpate! Ka s'ka qeveri, bishti i sëpatës bisht sëpate mbetet, as ngrohet, as ftohet. Atëherë fëmijët qeshin me të madhe. Pse qeshni? u thotë ai. Unë s'jam si ju i gjallë, unë jam lugat. Lugati nuk përqeshet, se të merr me vete. Fëmijët e futin në mes dhe fillojnë t'i thërresin mu para hunde: O lugat! O lugat! Lugati në varr! Lugati në varr! Do t'ju ha, të gjithëve do t'ju ha, u ishte hakërryer ai. Do të na hash m... ia kthen më i madhi i djemve. Taksidari i vërsulet me krahun ngritur që t'i japë një pëllëmbë të fortë, por i ngatërrohen këmbët e bie. Fëmijët shkulen së qeshuri përsëri, e zënë për këmbësh e për koke dhe ashtu, duke thërritur: Lugati në varr, lugati në varr, ndryshe do të lemerisë të gjallët, zbrezin te varrezat e vjetra myslimane të qytetit dhe e shtrijnë trupin e tij si të ngordhur mbi një varr paksa të fundosur. Gjithë ata njerëz, edhe goxha burra, i kishin parë tek kalonin rrugëve ashtu, por askush s'kishte nxjerrë dorën t'i ndalonte. Vetëm kishin pyetur ç'kishte ndodhur dhe, sa merrnin përgjigjen, larmo-

heshin duke u zgërdhirë, si të gëzoheshin e të dëfreheshin me lodrën e tyre të mbrapshtë. Fëmijët e kishin lënë taksidarin aty, në gjumin e thellë të pijes e kishin ikur duke kënduar si qoftëlargët. Kur kishte shkuar shumë vonë e ai s'qe kthyer në shtëpi, e shoqja kishte dalë ta kërkonte. E dinte që tani s'i jepte më kush për të pirë qyl, se nuk kishte më gjë në dorë. Ndaj, së gjorës grua, i kishte shkuar menjëherë mendja për keq. E kishte marrë vesh ngjarjen dikur. E kishte gjetur të shoqin përmbys, pa i dalë gjumi. Në fillim qe tmerruar se e kishte kujtuar për të vdekur, por pastaj, kur e kishte prekur, e kishte parë të ngrohtë dhe ia kishte dëgjuar zemrën t'i rrihte. Kishte zënë ta tundte e ta shkundte. Kishte thirrur edhe hoxhën, mulla Jusufin e të dy, tund e shkund e mezi e kishin bërë të hapte sytë. Por ai gjene nuk shkulej andej, se i ishte mbushur mendja top që ishte lugat.

Sytë e Hafëz pashës takuan sytë e Hyqmetit. Iu duk se dalloi një mërzi e çmeritje në ta e iu fik, si të fundosej në një pus uji të akullt, ajo përndezja e përgjithshme që i kishte dhënë rrëfimi i gjatë. Lëshoi një të sharë të ndyrë për këtë jazek millet që rrit fëmijë të tillë e mandej rri e u bën sehir, duke mbajtur barkun prej gazit, shejtanive të tyre të padëgjua. Mërzitja dhe çmeritja në sytë e Hyqmetit prapë nuk u larguan. Bile u nderën më fej edhe në të bardhën e tyre

si një rrobë e palarë. Hafëz pasha u shqetësua dhe kërkoi me mend ndonjë lajm më të veçantë e që të tregohet më shkurt, që t'i binte i beftë Hyqmetit e t'ia kthente atë gjallërinë e bekuar te sytë.

— S'ka mbetur këmbë xhandari nëpër qytet, — tha. — Janë zhdukur të gjithë si t'i përpinte dheu. Thuhet se i ndjekërkuan komunistët, për t'u bërë gjyq të hapur para popullit.

— E pse i duan kot ato gjyqe? — foli Hyqmeti. — Tani s'ka më burgje gjëkundi, dihet.

— S'kanë nevojë për burgje ata. O i lironë në vend, o i pushkatojnë. S'bëjnë ndryshe.

Hafëz pasha hetoi përsëri në sytë e tjetrit dhe, kur i gjeti më të kthjelluar, u lehtësua. Filloi t'i thoshtë se si natën e shkuar, vonë, ishte ngjitur një herë deri lart te burgu, duke iu vjedhur syve të njerëzve të babëzitur. Kishte dashur të shihte se mos vërtitej kush andej.

— Nuk e ndalova dot veten, — tha si i zënë në faj.

Këtu Hyqmeti, për së pari gjatë gjithë asaj kohe, vuri buzën në gaz dhe pashai mori zemër:

— Se edhe gurët nuk i lë në burg ky millet. Ç'milet i poshtër! S'do t'i shohë burgjet me sy! Allah! Allah!

Në këtë kohë në dhomë po hynte Sanija me filxhanin e kafes dhe gotën e sherbetit mbi tabaka.

— Po si është kjo puna e gurëve, more aman, se na mbiu si mjekra e qoses e na plasi në bark!

Të dy kthyen kokën njëherësh nga ajo. Vështrimet e tyre të çakërritura e mpinë gruan në këmbë. Hyqmetit i shpërtheu një gaz i papritur gurgullues, i papërmbajtur, që ajo nuk ia kishte dëgjuar kurrë më parë. Luajti, iku, tha me vete gruaja, që kukurizmat e atij gazi të kumbueshëm, të kotë, iu ngulën nëpër gjithë trupin si cifla të imta të një qelqi të thërrmuar egërsisht. Ndjeu një dhembje therëse fizike që erdhi duke iu mbledhur me shpejtësi në zgavrën e kokës e aty sikur iu ngurtësua.

Ndërsa qeshte ashtu, Hyqmeti bëri me gisht drejt saj e ajo u kujtua për tabakanë që mban-te ende në dorë. Filxhani dhe gota vazhdonin të lëshonin një avull të lehtë të bardhemë, që përthyhej e valëzohej prej dridhjes epileptike të dorës. Sanija ua la ata me nxitim përpara dhe me buzën e kafshuar fort doli rrëmbimthi, pa pritur përgjigje, si e ndjekur prej djallit.

E qeshura e Hyqmetit u përplas edhe një copë herë si skifter i tërbuar nëpër të katër muret dhe dritaret e dhomës, pastaj, ashtu siç shpërtheu, u platit e këputur te buza e ngrohtë e filxhanit të kafes. Heshtja e plotë që ra aty për aty e zbuloi edhe më keq marrëzinë e së qeshurës së tij të pakmëparshme. Duket se Hafëz pasha, i cili, sa kohë qeshte i zoti i shtë-

pisë, vetëm ndrydhej e shtrydhej në duhej të bashkohej me të apo të gjente një fjalë për ta qetësuar, përsëri nuk e duroi atë heshtje të thellë, të mpiksur si gjak nëpër thërrmijat e padallueshme të dritës, ndaj nisi të fliste.

Edhe dy orë më vonë, kur erdhi gazetari, ata ishin prapë aty, të palëvizur nga vendi e prapë Hafëz pasha po fliste. Jatagani i tij i nxjerrë nga këllëfi rrinte mbi tavolinë dhe vezullonte zbehtë, si peshk i ngordhur. I sapoardhuri, edhe pse qe hera e parë që njihej për së afërmi me ta, u prit me dashamirësi prej të dyve. Mikpritja e tyre e shpenguar, e madje intime, i krijoi shpejt një besim të nevojshëm te vetja. Për të thyer çdo lloj akulli që, gjithsesi, vazhdon të mbetet midis njerëzve të porsanjohur, ai deshë të bënte një shaka të vogël dhe objekti më i përshtatshëm iu duk jatagani. Tha t'i pyeste njëherë me të qeshur se përse, i trembnin miqtë me atë send të ftohtë. Por e la nga droja mos bënte ndonjë hap të pamatur që do ta frenonte lirshmërinë dhe shpengimin e lakmueshëm që fatlumërisht, gjeti dhe do t'i prishte punë bisedës që mezi e priste. Shpresonte që ajo t'i shpalosej edhe më e plotë nga bashkimi rastësor, kokë më kokë, i dy protagonistëve të romanit të vet. E sidomos prania e pashait plak,

të cilin, në shënime e veta, e kishte quajtur rudiment të qytetërimit despotik të perënduar sulltanor, por që në mënyrën e shfaqjes së tij ende nuk përbënte një ekzotikë argëtuese e as një kureshti historike për botën e sotme, gjë që provon se mendësia e tij për qeverisjen e shoqërisë mbijeton e fortë jo thjesht te individë të shkëputur, po në një sfond rezistent klasor. Kjo kujtesë e nevojshme e stepi aq sa nuk po dinte më në duhej ta nxirrte bllokun apo jo për të mbajtur shënime, zakon i mbetur nga profesioni i gazetarit, ku kërkohet saktësia e identifikueshme e gjithçkaje deri në imtësi, duke përjashtuar çdo mundësi apo tekë.

Hyqmeti i rrinte përballë me një gatishmëri dhe përkushtim të natyrshëm ndaj tij. Ai nuk shfaqti asnjë shenjë bezdie edhe kur e kapi vështrimin e tij të ngulmët e disi të tronditur, ngaqë lëkura tepër e bardhë dhe e hollë, si prej sapuni, e fytyrës së ish-gardianit i kujtoi gazetarit vitet e gjata që kishte kaluar personazhi i romanit të ardhshëm në mjediset gjysmë të errëta e me ajër gjithnjë të lagësht nëntoke, në mungesën e përgjithshme të diellit. Përkundrazi, Hyqmeti bëri një grimasë buzagazi për ta ftuar të rrinte si midis të vetve. Gazetari u përpoq edhe pak për ta kuptuar nëse kishte ndopak shtirje në sjelljen e tjetrit dhe, kur nuk shqoi asgjë të tillë, u mbush me një entuziazëm të vërtetë poetik. Nuk pati më asnjë ngurrim ta sillte fjalën aty ku i duhej.

Hyqmetit, kur mësoi pse ia kishte nderuar derën zoti gazetar, i vërshoi në sy një dritë e re, që dridhej lehtë si t'i frynte dikush nga për-brenda.

— Për këtë po flisnim edhe me pashanë, — tha ai dhe në zërin e tij gazetari nuk ndjeu kurrfarë anësie ndjellakeqe.

Pashai pohoi me kokë dhe mori një qëndrim prej kapadaiu që ia bënte krejt pamjen edhe më qesharake.

Gazetari s'i vuri mend nënvleftësimit që shprehte ai qëndrim. Më kryesorja për të po ecte mirë, ndaj u shpëngua edhe më, pasi iu duk se Hyqmeti i çeli kështu një shteg për të hyrë në intimitet. Dhe nisi ta pyeste pak e nga pak, gjithnjë e më pa druajtje. Mësoi prej gojës së tij se Hyqmeti deri në fund, thellë-the-llë, besonte që nuk do të mund të iknin të gjithë të burgosurit. Dhe mendja i rrinte si- domos te njëri me këmbë të gangrenizuar deri përmbi gju prej ditësh, ngaqë ishte kapur i plagosur gjatë atentatit që iu bë prefektit në re- storant «Dafinà». Dhe jo vetëm nuk e mjekoi kush aty në burg, por në një nga seancat e he- timeve, tamam në plagë i lëshuan një gru- mbull mizash të ndotura jashtë mase, që ajo t'i mblidhte krimba. Ai s'kishte si të ikte, me siguri, sepse tërë kohën rrinte kruspull në dërrasën e ngushtë e të vetme të qelisë dhe rënkonte gjysmë në jerm nga dhimbjet e nga zjarr- mia e lartë. Edhe kur shokët ia çelën derën e i

folën si ndihej, ai kujtoi se ishin ata që e merrnin në pyetje atje, në sallën e torturave dhe nisi t'i shante. Mezi i njohu pas një cope herë.

Hyqmeti tregonte me një zë të qëruar e të shtruar dhe sillte nga ato detaje, për të cilat gazetari në punën e vet përgatitore për romanin as që i pati menduar. Ai fliste rrjedhshëm, thua se i kishte renditur që më parë në kokë, për këtë qëllim, të gjitha ndodhitë. Por tamam atëherë kur gazetari po lodhej për të gjetur me mend formulimin më të përshtatshëm për pyetjen se ç'ndjeu atë çast kur i humbi sysh edhe ai këmbëgangrenizuari e burgun e përmbysiti plotësisht heshtja e ngrirë e betonit dhe e hekurit të ndryshkur nga vjetërsia, pra, tamam atëherë, nga jashtë u dëgjua zëri i trashë e i ngjirur i Malës, që këndonte zvargur në rrugë, sipas melodisë së njohur të këngës «Dashnorët vdesin prej dashnisë së madhe»:

*Diktaturë, moj diktaturë,
që shtyp njerëz e shtyp gurë,
koha jote iku, mbet,
ç'do të bëjë, i ziu Hyqmet,!*

Gazetarit i erdhi në majë të gjuhës një sharje për atë sherrbudalla e do ta kishte sharë me zë të lartë, edhe pse kjo gjë nuk ishte në natyrën e tij, aq u inatos nga shfaqja e të marrit, po pa Hyqmetin që vuri buzën në gaz ngadalë, sikur ngrinte nga brenda vetes fitilin

e një llambe me vajguri. Ai buzagaz u nder nëpër krejt dhomën si një hije e paformë që e ftohu përnjëherësh ajrin. Pashai plak lëshoi një hungërimë të mbytur me hundë. Gazetarin, i cili shpresonte shumë te kjo pyetje për të kuptuar traumën e papërballueshme të momentit që e kishte shtyrë Hyqmetin t'i mbushte qelitë me gurë, nuk po e zinte vendi.

— E sheh? — ia ndërpreu mendimet Hyqmeti. — Je i vonuar. Të paska dalë para Mala. Shikoje ç'këngë të bukur ka bërë.

Gazetari e ndjeu ironinë e akullt, po nuk tha gjë.

— Sanije! — i thirri pastaj së shoqes, — ma sill këtu atë këngëtarin që po kalon, të pijë një kafe të fortë!

Pas një çasti Mala rrinte në krah të Hafëz pashës, i cili qe fryrë edhe më keq. Ashtu, këmbë mbi këmbë, mbështetur fort në shpinën e karriges, i hidhte herë pas here një vështrim plot përbuzje të pafshehur të porsardhurit, mandej kthehej nga i zoti i shtëpisë duke fundosur kokën midis supeve e duke lëvizur mjekrën e mprehtë majtas e djathtas, gjë që e bënte kur ishte tepër i habitur e i pakënaqur me veprimet e tjetrit. Por dukej haptas që Hyqmeti as që merakosej fare për habinë dhe pakënaqësinë e tij. Bile, si për ta rënduar edhe më fort habinë e mikut të vjetër, i foli të marrit me një ton hokatar:

— Malë, po s'ka më diktaturë, ëh?

— Jo, zoti Hyqmet, aha, kaput diktatura!
— u përgjigj ai dhe ktheu dorën e vet, ku nxinin thonjtë e paprerë, përmbys, duke qeshur si i gudulisur papritur nën sjetull: hi-hi-hi!

— Po as burgje s'do të ketë më, Malë, ëh?
— vazhdoi Hyqmeti serioz në fytyrë, po gjithnjë me atë tonin e përmbajtur hokatar.

— Jo, zoti Hyqmet. Ah, burgu... — u ndal befasi, rrotulloi një herë sytë nëpër gropat e veta, si të qe kujtuar për diçka tronditëse dhe e uli zërin aty për aty: — Burgu, aha, ndoshta, burgu, s'e di. Ku ta di unë. Kështu thotë Ali Qyfyryja në berberhanë kur të rruan... — Ai e la prapë zërin varur, thua se deshi të shton-te diçka për të cilën u pendua kur fjala i mbërriti te buzët.

— Po ç'do ti në berberhanë, o Malë, ti je qose, ç'rruan?

— Qose! Hi-hi-hi! — qeshi prapë ai. — Po ja, zoti Hyqmet, shkoj ashtu, për qyfyre. Bëhen qyfyre të mëdha aty, s'ke parë ti. — Ai e futi gojën në grusht e vazhdoi të kakarisej edhe një copë herë me të qeshurën e vet cija-tëse.

Hyqmeti tha edhe diçka, si mirë, mirë, pa e prishur hiç terezinë, që gazetari nuk e dëgjoi, se po hahej me veten si ta kthente bisedën përsëri aty ku e kishin lënë pak më parë. Ndërkohë, nga rruga erdhën tri fishkëllima të mprehta e të zgjatura, që asnjërit prej atyre të katërve që ishin në dhomë, nuk u bënë kurr-

farë përshtypjeje. Mala vazhdoi të qeshte në të vetën, Hyqmeti me pashanë të heshtnin dhe gazetari të mundohej të gjente çelësin e humbur të bisedës.

Tri fishkëllimat u përsëritën prapë dhe menjëherë nga e ndara tjetër erdhi trembshëm dënësja e thellë e gulçuese e Selvisë. Dhe pak më pas zëri plot ankth i Sanijes, që nuk merrej vesh ç'thoshte, po me siguri përpiqej të qetësonte vajzën. Hyqmeti u ngrit pa thënë asnjë fjalë e doli duke tërhequr pas vetes derën e dhomës. Hafëz pasha e ndoqi pas me një vështrim të çmeritur dhe, kur dëgjoi Malën që i lëshoi mu në rrëzë të veshit një hi-hi-hi të mbytur ngaqë kishte vënë dorën te goja, iu kthye vrulltas:

— Tyt, edepsëz! Zaten, ti i marrë je, s'ke faj, po...

— Hi-hi-hi! — ia bëri prapë Mala. — Unë i marrë, ti pi sherbet të zier. Edhe tani paske pirë, ja gota. Hi-hi-hi! Sherbeti, kur shkon nëpër zorrë, zihet prapë e bëhet raki. Pashai prish itifanë...

Hafëz pasha tundi kokën dhe kërciti dhëmbët duke parë nga gazetari, si për t'i thënë «ç'na gjeti ne!». Gazetari rrinte i shushatur në të vetat dhe Hafëz pasha kujtoi se edhe ai ndiente siklet nga prania e pashpjegueshme e të marrit, ndaj e gjeti me vend t'i thoshte diçka për ta lehtësuar. Po nuk e mbaroi fjalën, se në derë u shfaq trupi i stërmadh i një djali dhe ngji-

tur pas tij, si të qe duke e cytur, Hyqmeti. Nga e ndara tjetër vinte gjithnjë jehona e dënësive të shpeshtuara të vajzës. Dhe përsëri zëri i ulët i Sanijes që diç i pëshpëriste tashmë me të egër. Fytyra e djalit, e gjerë dhe jashtë mase e rrafshët, e mbushi dhomën me zbehtësi.

— Ulu aty! — i tha qetë, po prerë Hyqmeti, duke i bërë shenjë të rrinte pranë Malës. — Të dua ballas. — Pastaj iu kthye të tjerëve me po atë qetësi dhe me një nënqeshje që mezi shquhej: — Do ta bëj dhëndër. Është bir kasapi, ia di jetës.

Djali e uli edhe më fort kokën, si të donte ta fshihte me domosdo midis shpatullave kaba. Të rrahurat e shpeshtuara të zemrës i gjëmonin në veshë të shumëfishuara, thua se i binte paprerë një çangë brenda në kokë e ia ngatërronte çorap të gjitha mendimet. Mund të thoshte me siguri vetëm se në shtëpinë e Selvisë po hynte për herë të parë, edhe pse kishte kaq kohë që i vinte rrotull. Dhe e mori për krahu vetë babai i saj. U tha edhe miqve të vet se do ta bënte dhëndër. Te këto fjalë djali e humbi fillin fare.

— E kam ca të turpshëm dhëndrin, po do t'i dalë shpejt. — Zëri i Hyqmetit e nxori nga përhumabja.

Gazetari pa se si në vend të zbehtësisë së pakmëparshme, në tërë fytyrën e djalit vër-

shoi një e kuqe e përflakur që e djersiti në ballë e në gropën e mjekrës. Ndërsa Hafëz pasha as që ia hodhi sytë. Rrinte rëndë, me flashkat e rrudhave të faqeve të varura poshtë, për t'i thënë të zotit të shtëpisë se ndihej i fyer thellë nga këto sjellje të çuditshme. Hyqmeti nuk dha asnjë shenjë se po i binte në sy ajo fyerje. Gazetari nuk mund të thoshte nëse Hyqmeti e kishte kuptuar apo jo që Hafëz pasha ndihej keq në një radhë me të marrin e qytetit dhe djalin e kasapit. Për vete tani ai luhatej midis mendimit se nuk kishte ardhur në kohën e përshtatshme dhe kënaqësisë se iu mblodhën mrekullisht bashkë disa nga personazhet kryesore të romanit, të cilat, me përpjekjet e tij, zor se mund t'i ulte njëherësh në një sofër.

— Pra, ti, zoti gazetar, paske ndër mend të shkruash libër? — foli papritur Hyqmeti.

Gazetari ia nguli sytë për të hetuar në kishte ndonjë nënkuptim në fjalët e tij. Nuk mori vesh gjë. Kjo, në vend që t'i jepte siguri, ia shtoi edhe më fort dyshimin.

— Po, — u përgjigj me gjysmë zëri gazetari. — Nejse, mund ta lëmë për sot. Bisedojmë një herë tjetër më ngeshëm, nuk e kemi me ngut, — u gjallërua ai.

— Pse ta lëmë, tanët jemi.
Gazetari nuk foli.

— E tani ç'do nga unë për atë librin tënd?
— Zëri i Hyqmetit qe përsëri i shtrirë njësoj,

megjithatë gazetari, instinktivisht, e ndiente se diku thellë tij fshihej diçka ogurzezë, që nuk e zbulonte dot. Pa një herë nga Hafëz pasha, por ai, si të mos kishte dëgjuar asgjë, e ruante me ngulm atë qëndrimin e parë të kapadaiut të fyer, që nuk mund t'i tërhiqej vëmendja as edhe nga teka të çuditshme si kjo e gazetarit. Ndërsa Mala i marrë tërhiqte fort hundët si t'i kishte të zëna dhe të qeshurën e brendshme e derdhte me gulçe në dhomë përmes syve që i rrotulloheshin paprerë në foletë e veta të zbuluara e të dala rrumbullak para si gogla. Djali i kasapit, emrin e të cilit gazetari nuk e dinte, sikur e pati marrë pak veten e rrinte disi më lirshëm. Ndoshta ngaqë ishte larguar vëmendja prej tij. Kjo shtendosje e përgjithshme i përcolli edhe atij njëfarë sigurie që e shtyu të nxirrte nga goja atë pyetjen fatale:

— Thuhet nëpër qytet se gjatë këtyre dy ditëve ti ke ndenjtur vetëm në gjumë. Ç'ëndrra ke parë?

— Posi, — tha Hyqmeti, pa e trazuar asnjë fije cipën e tejdukshme të qetësisë së fytyrës. — Ta tregoj unë. — Dhe, si të qe përgatitur pikërisht për këtë pyetje, futi ngadalë dorën nën jastëkun e përthyer më dysh, ku qe mbështetur, e nxori prej andej një revolver. Dy rruzujt e syve të Malës ngrinë njëherësh, ashtu siç u ndodhën, në të dy skajet e jashtme të foleve të veta. Djali i kasapit çoi dorën te balli, ndërsa gazetari s'e kuptoi as vetë pse i erdhi

një marrje e plotë mendsh, gjë që e pengoi të shihte shprehjen e habitur të fytyrës së Hafëz pashës dhe ta dëgjonte Hyqmetin kur tha se në ëndërr i qe fanepsur sikur vrau dhëndrin. Krisma e beftë e solli në vete gazetarin. Pa djalin e kasapit, të rrëzuar përmbys mbi gjunjë dhe grykën e revolverit të Hyqmetit të drejtuar nga ai.

— Ëndrra më tha se duhet të të vras edhe ty. Ndryshe nuk bëhet dot libri për mua. — Për çudi, zëri i tij ishte i paprishur fare.

Fytyra e Malës së marrë ishte zgjatur e holluar dhe dridhjet e dendura të mjekrës ia bënë të pakuptueshëm tingujt që nxirrte nga goja.

— Prit, — ndërhyri Hafëz pasha, — dale!
— Ai u zgjat t'ia kapte revolverin, po Hyqmeti i dha një të shtyrë të fortë me dorën tjetër dhe ai u përplas së prapthi mbi tavolinë. Sanija, që nga dera, mundi të shihte shndritjen e tehut të jataganit që ra prerazi mbi majën e kokës së Hyqmetit në të njëjtën kohë me flakën e paformë që doli nga gryka e revolverit të tij për t'ia lënë gazetarit të pathënë kurrë fjalën e fundit, që me siguri qe përpjekje për t'u shpjeguar sepse i kishte mbledhur të dyja duart në gjoks, siç bën njeriu i zënë ngushtë nga një keqkuptim i kotë dhe sytë ia ruanin, edhe pasi nuk merrte më frymë, një lëngëzim të trishtë bojë-hiri. Mala i marrë, të cilit nuk i dridhej më mjekra, lëshoi një ulërimë të

gjatë të përvajshme që e mbylli me fjalët:
— Zoti Hyqmet, si kështu, prapë me dik-
taturë?! — Qeshi edhe një herë hi-hi-hi, ia
ngridu sytë fytyrës së humbur në gjak të Hyq-
metit dhe e mbytën lotët.

1987-1988

VERA PA K'THIM

Kapitulli i parë

Çasti më i vështirë, më tronditës që çasti i parë i takimit. Erdhi krejt papritur dhe ishte mëngjes herët, koha kur njeriu ende është disi nën pushtetin e ëndrrave të natës e bile, jo rrallëherë, i ndodh të priret edhe për t'u shtuar diçka nga ëndrrat figurave reale që e rrethojnë. Sana sapo që zgjuar dhe shtëpinë e kishte në arrëmujë. I pati ngritur të gjithë qilimat e mbulesat e, pasi i shkundi, i vuri palë-palë mbi një karrige në korridor, për t'i shtruar në fund, sa të mbaronte edhe me të tjerat.

Kur ra zilja e derës, po bënte gati makinën larëse për të futur në të çarçafët e hedhur grumbull në fund të dhomës së gjumit. Qëndroi sa tingëlliu edhe një herë zilja, pastaj u kthye me përtesë nga dhoma të gjente një shami çkado për të mbuluar flokët e pakrehur. Nuk priste njeri. Ia kishin mësuar tashmë edhe shokët e miqtë se të dielën paradite merrej gjithmonë me pastrime, ndaj nuk i vinin kurrë në atë kohë.

Ndërsa rrotullonte çelësin në bravë, syri i zuri edhe një herë grumbullin e çarçafëve të palarë, kapakun e hapur të makinës larëse, fshe-sën me korrent të mbështetur pa kujdes në një qoshe tjetër dhe aty pranë palën e madhe të qilimave e mbulesave. U ndal. Ishte gati të kthehej mbrapsht. Ajo kishte qenë gjithmonë meraklie e madhe dhe nuk donte kurrësi të shihte kush çrregullim në veshjen apo në shtëpinë e saj. Dora i kishte mbetur te çelësi. Në atë mëdyshje, ta çelte apo të mos e çelte, nuk e kuptoi as vetë se si foli:

— Kush është?

— Sana, ti je?

Dyshemeja nën këmbët e Sanës filloi të lëkundet dhe ajo, ngaqë u ndodh në befasi, desh ra, ndaj zgjati të dyja duart drejt murit përballë, por edhe ai lëvizi, u ça në shumë vende duke lëshuar një pluhur djegës që iu fut në sy dhe ia mjegulloi shikimin. Lëvizi duart verbtazi nga të gjitha anët dhe, kur nuk i zunë

në asgjë të fortë që të mbahej, tha se po gremisej përtokë, ndaj deshi të klithte që të dëgjon-te dikush. Po klithma i mbeti në grykë sepse menjëherë u kujtua që në shtëpi ndodhej fare vetëm, si gjithmonë. Kjo sikur e solli pak në vete, e përmblodhi dhe atëherë iu kthye në veshë jehona e butë e zërit që i erdhi pak më parë nga prapa derës.

— Gori! Gori!

Sana nuk e kuptoi nga i dolën fjalët, sepse, ndërkohë nuk po mendonte asgjë, ngaqë nuk ngopej së shiuari tingëllimin e atij zëri, i cili ishte nga të vetmet gjëra të Gorit që ajo besonte se nuk rronte në kujtimet e saj. Iu duk e pafalshme kjo harresë, sepse vuri re që zëri të çmalkka edhe më shumë se fotografitë dhe sendet e tjera, ndaj nëmi veten. «Apo të jetë ai vetë që më flet?» pyeti sakaq dhe e mbytën gulçet që iu ngjitën me rrëmbim që nga fundi i kraharorit.

— Gori?! — foli ajo prapë me mundim, sepse zemra, nga të rrahurat e shpeshtuara befas, iu ngjit deri te fyti e gati po i zinte frymën.

— Hape! Unë jam, hape! Pse më lë prapa derës?!

Zëri i Gorit erdhi i zbutur, si të kalonte nëpër shtratin e mjegulluar të një lumi ku ajri i lagësht ua ka shuar kumbimin zhurmave.

— Hape, Sana, pra! Po qan?

— Qaj nga gëzimi, — u përgjigj ajo. — Qaj

nga gëzimi, — përsëriti prapë pak çaste më vonë, me kokën të mbështetur në kraharonin e tij. — Nuk më besohet që erdhe.

— Pse s'të besohet, unë të pata thënë që do të vija patjetër. Ta kam shkelur ndonjëherë fjalën?

— Jo, jo, kurrë, po ja, shkoi kaq kohë...

— Ç't'i bësh, ashtu erdhi puna, — tha Gori dhe zëri i tij erdhi duke u shuar, si ta vidhte po ai, me sytë e vet që iu fshehën vështrimit të Sanës. Megjithatë ai e ndjeu që Sana u bë gabim ta pyeste diçka dhe do ta pyeste pikërisht për ato punë që e kishin mbërthyer kaq vite larg saj, ndaj, për të mos i lënë kohë, ia mori fytyrën midis pëllëmbëve me një gjest përkëdhelës, ia ngriti ngadalë drejt vetes dhe e puthi. E puthi gjatë, pa ndërprerje. Por ishte një puthje aq e lehtë, sa Sana, çuditërisht, sado që shtrëngohej pas gojës dhe krejt trupit të tij, përsëri nuk arrinte t'ia ndiente sadopak as prekjen e buzëve e jo më afshin e tyre të valë. Sidoqoftë, e dinte që ai po e puthte, ishte e sigurt për këtë, ndaj, për nën kapakët e mbyllur të qepallave i farfuritej një gaz marramendës.

— Bërë mirë që erdhe, — tha Sana dikur, ndërsa kërkonte me sy vështrimin e tij të thellë që i ikte vazhdimisht, në mënyrë të pashpjegueshme, dhe linte pas një retinë të zbrazët si guaskë. Ky krahasim i papritur, që i erdhi ndër mend, e trembi. Ndaj, për të mos iu përsëritur më, e largoi edhe vështrimin prej syve

të tij dhe e solli fjalën te vetja. — Më kishte marrë shumë malli. Aq shumë...

— Edhe mua, — e ndërpreu ai. — Do të vija së s'bën, të kisha lënë vetëm. Dhe ti gjithmonë je mërzhitur shumë nga vetmia.

Sanës i kishte kaluar disi hutimi i fillimit. Pa shtëpinë e çrregullt e u kujtua për pamjen e vet. Kushedi si dukem kështu, e pakrehur, veshur me këtë rrobëdëshambër të përdorur prej kohësh, mendoi dhe për herë të parë i erdhi inat me maninë e vet për ta pastruar me domosdo krejt shtëpinë çdo të diel. Ajo jetonte prej vitesh pa njeri dhe aty hynin e dilnin aq pak të tjerë, sa fare rrallë mund të ishte nevoja për t'i shkundur shtrojat nga rrënjët. Me siguri zakoni i që krijuar pikërisht ngaqë rrinte vetëm. Dhe më shumë se kurdo vetminë e ndiente të dielën. Atë ditë shtëpia i dukej tepër e zbrazët. Nuk mund ta duronte gjithë atë hapësirë ajri, i cili i patrazuar nga fryma e askujt tjetër, sikur vinte duke u trashur, derisa shndërrohej në një ujë të ndenjtur që ia zinte sytë dhe veshët e, po të zgjaste ashtu, do ta mbyste. Prandaj, edhe pse e dinte tashmë që dita do t'i zgjatej tej mase e do t'i bëhej shpeshherë e padurueshme, prapë nuk ndalej dot pa u ngritur shumë herët, vishte robëdëshambrin e përdorur, vinte përparësen dhe e kthente gjithçka përmbys gati-gati me një lloj inati. I ngjante se ashtu dhomat gjallëroheshin, por edhe vetes i nxirrte një punë të lodhshme, që ta gjen-

te dreka thujse të këputur, t'i vinte shpejt gjumi e të mos kishte fuqi të hallakatej nëpër mendime të trishta. Pak nga pak ky proces iu kthye në zakon dhe iu ngurosoi në mënyrën e jetesës, aq sa nuk mund ta prishte më asgjë.

Kraharori i këmishës së kaltër të Gorit ishte njomur në tri-katër vende nga lotët e saj që kishin rrjedhur heshturazi, pa u vënë re.

— Ç'do të bëjmë tani, e humbëm fare, — tha Gori.

— Tani ti do të dalësh në ballkon, unë do të rregulloj shpejt e shpejt vendin, pastaj... pastaj bëjmë ç'të duash. Mirë?

— Mirë, veç mos na vono! — Fytyra gjashtose e Gorit i përcolli këto fjalë me një lëkundje të lehtë çapkëne.

Duart e shkathtësuara të Sanës shtrinë qilimat, nxorën një mbulesë tavoline të qëndisur para shumë vjetësh, që kur përgatitej për dasmën e të pashtuar kurrë, vendosën vazot e luleve në qoshet e tyre, morën togun e çarçafëve e i futën siç qenë, të panjomur në makinën e larjes.

Para se të shkonte për të bërë tualetin e vet, i thirri Gori që nga brenda me një zë të hareshëm, për t'i thënë se gjithçka ishte gati. Gori nuk iu përgjigj, megjithatë Sanës nuk i bëri përshtypje, sepse ndërkohë kishte hapur kutinë e tualetit dhe po shihte me pikëllim që e kishte shumë të varfër. Uf, edhe unë!

tha me vete, s'duhej ta kisha lënë kaq pas dorë! Vite më parë ajo kuti tualeti, të cilën Sana nuk e përdorë, ishte nga gjërat që e trishtonte më tepër sa herë i dilte para syve. Në çaste të tilla nuk përmbahej dot pa shkuar te pasqyra dhe ngulej gjatë para saj. Fillonte të merrrej me vetullat, me sytë, me buzët, me mollëzat e faqeve, pastaj krihte flokët duke i fryrë e përdredhur, gjersa shndërrohej në një nuse të vërtetë. Jo rrallë kjo punë i hante një pasdite të tërë dhe, po të mos mbyllej me të qarat e shfrenuara që vinin gjithmonë tamam atëherë kur nuk i mbetej më asgjë për t'i shtuar portretit të vet të ri, do të ishte një kohë e bukur, që e fuste pak nga pak në botën e ëndrrës së vet më të fshehtë. Por, duke mos e duruar dot vuajtjen që i vinte më pas (sidomos më vonë, kur edhe fytyra nisi t'i bindej me vështirësi dëshirës për ta marrë pamjen e shndritshme të nuses,) Sana e fshehu kutinë në një skutë që të mos e shihte. Uf! i shfryu përsëri vetes, edhe ti, sikur ta kishin fajin këto! Megjithatë tani s'kishte ç'bënte dhe filloi t'i përdorë ato që i ndodheshin. Gati lëshoi një klimë gëzimi kur pa që nuk ishte tharë asgjë. Dikur iu duk se po vonohej shumë, sepse duart e kishin humbur shkathtësinë që duhej të kishin në veprime të tilla. U hodhi një vështrim të zemëruar si të mos ishin të sajat. «Duar gjysheje», u tha dhe menjëherë solli sytë përrreth e trembur, ngaqë iu duk se foli me zë.

Nëpër derën e hapur të dhomës së gjumit zgjatej që nga ballkoni hija e Gorit. Ia nguli vështrimin një çast asaj hije që rrinte mbi dysheme e ngrirë, si njollë e vjetër boje. Ai s'kishte hyrë brenda edhe pse Sana i foli pak më parë. Ajo nuk e shihte ç'bënte atje në ballkon, megjithatë iu duk e çuditshme që rrinte ashtu i ngurosur në një pikë. «Edhe në paça folur, nuk më ka dëgjuar», mendoi e lehtësuar, dhe u kthye nga pasqyra të mbaronte sa më shpejt.

— Po të pres! — i thirri Gorit pas pak tek kontrollohej edhe një herë para pasqyrës së sallonit. Zëri i doli i dobët sepse në fyt ndiente një shtrëngim që i jepte një si ethe nëpër gjithë trupin. I pëlqeu vetja, megjithatë prova e vërtetë do të ishin sytë e Gorit.

U mek fare kur dëgjoi hapat e lehtë të Gorit mbi qilim. Nuk guxoi të kthehej anej. Gori u afrua ngadalë pas shpinës së saj dhe e zuri për supesh. Kur e ktheu nga vetja, sikur u step pak me pamjen e re të Sanës: fytyra e qëruar mirë nga gjurmët e natës dhe të lotve të pakmëparshëm, flokët e krehur, të lëshuar lirshëm, sytë me një rimel të lehtë që e ndillte dritën e mëngjesit të mbledhëj në dy pika vezulluese prej nga shpërndahej pastaj valë-valë, fustani i gjelbër që shtrëngohej fort te gjoksi e deri në bel dhe hapej pastaj përnjëherësh duke i dhënë trupit të saj dukjen e një lulekëmbore. Sana e ndjeu stepjen e tij dhe u përkëdhel. Iu davaritën të gjitha hamendjet e këqija

dhe u çel. Por, kur pa se kjo stepje e tij po zgjaste dhe po e mbante disi larg saj, ajo nuk e deshi më. Ndaj, për t'ia kthyer rishtas lirshmërinë e të sjellurit, iu afrua vetë e para. U ngrit në majë të gishtërinjve me një gjest prej çupëline dhe e puthi lehtë. Ai sikur u shkund dhe përpëliti qepallat. Pastaj vuri buzën në gaz. Megjithatë duart vazhduan t'i qëndronin të varura poshtë, si t'i mbanin lidhur me trupin vetëm mëngët e këmishës. Sanës i kaloi nëpër eshtra diçka e ftohtë, por u përpoq të mos e jepte veten. Mendoi se njeriu hutohet edhe nga malli i madh, i duken gjërat ëndërr ngaqë i kapitur kaq e kaq kohë. Duhet folur diçka, tha, një shaka... E qeshura të përmend në raste të tilla.

— Po të lë pak të kuq, — i tha, — që, kur të kalojmë rrugës, t'i bëjmë më shumë njerëzit të kthejnë kokën nga ne. — Sana u përpoq të vinte buzën në gaz, por e ndjeu se i doli më tepër një ngërdheshje, ndaj mbështeti kokën në supin e tij që të mos e shihte ai.

Nëpër dritaret e çelura kanatash, paraditja e fundit të qershorit derdhte brenda afshin e nxehtë të dheut të etur nga mungesa e gjatë e shirave. Sanës iu duk se po i përcëllonin mollëzat e faqeve.

— Mua edhe pa të kuqin tënd te buzët do të më shohin njerëzit me çudi, — ia ktheu Gori duke qeshur lehtë. Sana u gjallërua përnjëherësh.

— Pse, për këto bula lagështie në këmi-shë?! Këto t'i heq Sana, tani. Ja, një hekur t'u kaloj! Mos u bëj merak fare! — tha ajo e nisi t'i zbërthente kopsat pa pritur përgjigjen e tij.

— Jo, jo, — ndërhyri Gori dhe ia largoi butë, po prerë duart nga kraharori, — as që e kisha mendjen aty. Është diçka tjetër.

Duart e Sanës u ndalën.

— Çfarë? — foli ajo duke ia kërkuar përsëri sytë edhe më me ngulm se herën e parë. Shpresonte që ata ta ndihmonin për të kuptuar diçka më tepër, por u pendua shpejt sepse aty iu shfaqën rishtas dy hijet e guaskave të zbrazëta që e kishin rrëqethur pak më parë.

— Hiç, hiç, bëj shaka, — shtoi Gori, po mpirja e beftë që iu ngjit në fytyrë nuk u shpëtoi dot syve të saj, sado që ai nxitoi t'i thoshte me një shkujdesje të shtirur se këmi-sha nuk kishte nevojë për hekur pasi do të thahej vetë. — Pastaj loti nuk lë gjurmë, aq më fort loti i gëzimit.

— Tani ulu na bëj një drekë të mirë, se pasdite do të nisemi për në plazh, — vazhdoi ai me një zë të ngutur, si të donte që, me lajmin e papritur, ta largonte sa më shpejt vëmendjen e vajzës nga fjalët e pashpjegueshme që sapo kishte thënë.

— Sot?! S'kemi si nisemi sot. — Ajo nuk e njohu zërin e vet. Sa kohë kishte pa i folur ndonjë burri ashtu, me kundërshtimin femë-

ror që në të vërtetë nuk është kundërshtim, po joshje për ta bërë atë më këmbëngulës në mendimin e tij, mendim që asaj i ka pëlqyer tepër. Kjo këmbëngulje e tjetrit i është e nevojshme femrës për ta përjetuar deri në thellësitë më të mëdha të vetes drithërimën e zgjuar prej atij lajmi. Nga ana tjetër, rikujtimi i beftë i atij zëri të bukur, të humbur prej kaq vitesh, Sanës i shkaktoi një dhimbje të fortë shpirti që ia mbushi sytë me lot. Dhe ashtu e përloitur shtoi: — Të paktën ta dija që t'u thosha në punë të më jepnin lejen e zakonshme. E lëmë për nesër se do të më bëjnë llafe...

— Ç'është kjo leja e zakonshme?! — tha Gori seriozisht. — Mos shko në punë, nuk do ta paguajnë rrogën e pikë. Ç'ka këtu për llafe?

— U, si flet edhe ti, Gori! Sikur s'ke idenë ç'është puna! S'është halli te rroga... Pse, ty atje, në punën tënde, të lë njeri të hysh e të dalësh kur të duash?

— E, e, e di, e di, — ia ktheu ai duke i lëshuar fjalët gjysma-gjysma, si të kishte mungesë ajri për të artikuluar të gjithë tingujt. — Po si t'ia bëjmë atëherë?

— E lëmë për nesër, pra.

— Jo, jo. Do të nisemi sot. — Sana pa që ai ishte i vendosur.

— Nuk e marr vesh pse ngul këmbë kështu.

— Dua të mos humbasim asnjë ditë. Dy

javët që kemi, t'i kalojmë në plazh. Të kam pasë dhënë fjalën, të kujtohet?

— Më kujtohet, si s'më kujtohet. Po ti flet si t'i kesh ditët të numëruara...

Ai bëri një shenjë me dorë si për të thënë «Ku të shkon mendja edhe ty!» dhe vazhdoi:

— Mos ma prish!

— Mirë, mirë, — tha Sana e përkëdhelur nga lutja e tij. — Mbase e rregullojmë me një telefon drejtorit. Ose më mirë i vemi në shtëpi. E ka këtu afër.

— Ashtu bëjmë, — tha Gori dhe në zërin e tij u ndie menjëherë çlirimi nga tendosja e pakmëparshme kur ajo i përmendi ditët e numëruara.

Për lejen nuk u vonuan. Derën ua hapi vetë drejtori, një burrë i shkurtër, rreth të dyzetave, që sa kishin nisur t'i thinjeshin flokët në tëmtha. Syrit të Sanës nuk i shpëtoi ngurrimi i tjetrit kur i pa. Nëpër fytyrën e tij të gjerë kaloi një i zbehtë që ia bëri njolla-njolla lëkurën kuqoshe. Dora vetvetiu u shty ta mbyllte derën. Po drejtori e mblodhi menjëherë veten dhe, duke parë vetëm nga Sana, i ftoi të futeshin brenda. E folura sikur e lehtësoi disi, megjithatë dukej që diçka e mbante për të mos shikuar nga Gori, të cilin veç sa e vidhte me bisht të syrit. Ai këmbënguli përsëri të hynin të paktën për një kafe, por ata kundërshtuan duke thënë se nuk kishin kohë.

— Si jo, — u hodh ai sapo dëgjoi si ishte

puna. — Ne, more Gori, mezi të kemi pritur. Dhe ta dish se të kemi mbajtur gjithnjë në gojë. — Kësaj here fytyra e gjerë e drejtorit, në të cilën kishin filluar të zhdukeshin njollat, guxoi të kthehej plotësisht nga Gori. Megjithatë, si për të mos e këputur lidhjen me Sanën, ai vuri dorën e majtë në supin e saj dhe shtoi: — Jo dy javë, rrini një muaj, po deshët! Të çmalleni, si jo? Dhe mbaje mirë Gorin, — iu kthye prapë Sanës, — se më duket i dobësuar. Kushedi sa është lodhur andej! — Ai bëri me dorë një shenjë të papërcaktuar, si të tregonte një vend diku prapa diellit që digjtë.

— M'u duk burrë i mirë, — tha Gori kur po largoheshin.

— Shumë i mirë është, — u përgjigj Sana përhumbshëm, sepse ende po i vërtitëshin në kokë si vrunduj ere fjalët e drejtorit për lodhjen e madhe të Gorit andej. Ku andej, ku? deshi të pyeste e tronditur ajo, për e mbajti veten për të mos e zgjatur më tej bisedën. Vetëm e ndoqi me sy gjithë ankth lëvizjen e dorës së tij që mbeti një copë herë pezull në ajër e që s'merrej vesh në caktonte qiellin apo tokën, larg apo afër. Ku është kjo «andej», se po plas, pyeti prapë veten gjatë rrugës.

Po afronte mesdita dhe vapa e madhe i kishte rralluar lëvizjet e njerëzve nëpër rrugë. Megjithatë Sana shihte me çudi dhe njëfarë pakënaqësie të papërcaktuar majtas e djathtas.

Si nuk po ndeshnin asnjë të njohur. «Ku qenkan mbyllur kështu sot?!» Donte të takonte ndonjë nga ata që, edhe pse me dashamirësi të çiltër, sa herë i vinin në shtëpi e bezdisnin dhe ia shtonin vuajtjet duke i qarë hallin për jetën e saj të vetmuar. Pastaj, po me atë dashamirësi, e këshillonin të martohej. T'i takonte ata tani, që ta kuptonin sa të pavend kishin qenë këshillat e tyre. Asfalti, i shkrire vende-vende nga vapa, lëshonte një duhmë të rëndë.

— Nxitojmë, — tha Gori, — era e ziftit më ngacmon të vjellat e më jep dhimbje të tmerrshme koke që nga koha e... — dhe e la në mes fjalën si t'i zihej papritur fyti. I hodhi Sanës një shikim të trembur dhe priti me sy të ngrirë që ajo ta pyeste se qysh nga cila kohë. Kur pa që ajo nuk e kishte mendjen aty, u qetësua.

— Po ti, Gori...

Sana ndjeu një turbullirë t'i ngjitej në kokë dhe iu pre fjala. U gëlltit fort për të mbytur një valë të nxehtë lotësh që i vërshoi në sy dhe, nëpër mjegullën e tyre, pa të ngrihej e të lëkundej në ajër dora e drejtorit. Lëkundej poshtë e lart, majtas e djathtas me ritmin e një zëri që nuk thoshte gjë tjetër veç «andej, andej». Andej, andej dhe dora me gishtërinjtë e hapur përgjysmë bënte rrathë të pakapshëm në ajrin që asaj ia përcëllonte lehtëzi lëkurën e fytyrës.

Kapitulli i dytë

Sapo u ngjitën në dhomë, një dhomë tepër e madhe, me dy shtretër të gjerë, po çuditërisht të ndarë nga njëri-tjetri, — të tillë Sana nuk kishte parë kurrë nëpër hotele, — Gori tha menjëherë të fiknin dritën.

— Të fikim dritën?! Pse? — u hodh Sana dhe pa orën. S'kishte vajtur ende dhjetë. Për të ishte shumë herët të mbyllej edhe një mbrëmje e zakonshme e jo më mbrëmja e parë e kthimit të Gorit. Po kjo ishte edhe mbrëmja e tyre e parë e përbashkët në vetmi të plotë,

në një dhomë hoteli, pa asnjë rrezik t'ua prishte ndokush intimitetin. «Jo, gati klithi ajo, si mund të ketë gjumë sonte?!»

— Jam i këputur nga lodhja, — ia ktheu Gori më një zë të zvarritur, si për ta plotësuar kështu atë që tha. — Mezi po mbahem në këmbë.

Ai fliste me kokën të ulur, megjithatë, Sana, që nuk ia ndante sytë, ia dalloi kapitjen dhe nuk po i besoj. Deri pak më parë fytyra e tij nuk jepte asnjë shenjë të tillë. Nuk kishte parë kurrë fytyrë njeriu që të shndërrohej vetvetiu në një kohë aq të shkurtër. Mbase është i rëndë ajri i dhomës, po nuk e ndiej unë, mendoj, duke u përpjekur t'i gjente një shpjegim të arsyeshëm pamjes që po i shpalosej përpara.

— Dalim jashtë, — tha, — shëtitim pak bregut të detit ose ulemi në lulishten para hotelit! — Nuk e kuptoi nga i erdhi gjithë ajo druajtje, si të qe duke i kërkuar diçka të turpshme. — Do të çlodhesh, — shtoi, pa mundur ta përzinte sadopak druajtjen.

— Ah, jo, — iu përgjigj Gori dhe ngriti krahun nga ajo. Lodhja ishte aty, si një pllakë e vjetër bronzi, e puthitur pas formave të fytyrës. — Jo, — dhe heshti, duke u përpjekur të bënte një buzagaz të pafajshëm. Pastaj uli përsëri kokën dhe vazhdoi: — Ka shkuar shumë vonë dhe ti e di, nata mua... do t'u dukem të tjerëve si i ngritur... — Atij iu shprishën fjalët.

nëpër dhëmbë dhe Sana nuk arriti të merrte asgjë vesh.

U mat t'i thoshte se po fliste përçart, po në castin e fundit një dorë e fshehtë ia lidhi grykën dhe asaj nuk i doli asnjë tingull. Ndërkaq, drita, që u fik vetvetiu papritur, sikur ia mori fare zërin dhe ajo mbeti e ngrirë në këmbë, në mes të dhomës. Mungesa e përnjëhershme dhe e plotë e ndriçimit i shtyu më larg muret dhe derën e dhomës. Hapësira e re, thuajse e pakufizuar, që u krijua, i mbolli Sanës nëpër gjithë trupin një ndjenjë të frikshme braktisjeje të plotë, që ia mpiu gjymtyrët dhe trurin. Nuk e kujtonte më dot pse pati ardhur këtu, në këtë dhomë të panjohur e të pazakonshme, më kë, kur. Nuk kujtonte më dot asgjë. Mbajti vesh një cast me shpresë që t'i vinte ndonjë zë që t'ia kthente kujtesën.

Duke pritur ashtu, sytë filluan t'i mësohe-shin me terrin dhe dikur vonë, në njërin nga krevatët ajo dallooi hijen e një njeriu të ulur. Uf! tha me vete e çliruar, ç'pata, si më erdhi?! Aty ishte Gori, që e ndiqte me një vësh-trim të butë. Bëri një hap për t'iu afruar, dy. Unë tani jam gruaja e tij, mendoi, do të zhvi-shem në sytë e tij, do të fle me të. Për herë të parë në jetën e vet do të zhvishej në prani të një burri. Sado që ky ishte Gori e ajo, me përfytyrimin e kishte futur më parë qindra e qindra herë në dhomën e saj nga dera e nga dritarja dhe në mendje i kishte shkuar të gj-

tha dialogjet e mundshme, duke besuar se, kur të vinte çasti i vërtetë, do të kishte fituar kë-shtu një aftësi për ta zotëruar veten e për t'i dhënë çdo fjale e gjesti sharmin e duhur ma-gjepsës, të denjë për ngjarjen, prapë u step. Tani që ndodhej realisht pranë shtratit, me Go-rin vetëm një hap larg, e kuptoi se tërë ai për-fytyrim nuk i kishte sjellë asnjë të mirë kësaj mbrëmjeje. Imazhi i zbukuruar që pati ndërtuar, nuk arrinte të përputhej me skenën e thjeshtë që do të zhvillohej fill dhe nga kjo mospërputhje te Sana lindte një gjendje ku ajo e kishte të vështirë të mbahej e zonja e vetes. Prandaj po kërkonte sytë e Gorit, me shpresë se mbështetja te ta do t'ia trembte pak druajtjen e mpirjen dhe do t'ia bënte më të natyrshme lëvizjet për të shkopsitur fustanin. Kjo ishte më e pakta që kërkonte prej atyre syve, të cilët, qëllimisht për t'iu fshehur fare, e kërkuan errësirën. S'është e keqja tek errësira, tha pastaj dhe, ngaqë nuk e gjeti se ku pikërisht ishte e keqja, u inatos. Ajo e dinte se jo rrallë inati e shtynte në marrëzira, ndaj u përpoq të çlirohej prej tij dhe e çoi menjëherë mendjen diku tjetër. Intuuta e femrës e mësonte të qe tepër e kujdesshme, pasi edhe me një gjë krejt të vogël mund ta prishte bukurinë e çastit. Ndërkohë Gori u ngrit ngadalë, u afrua te dritarja dhe ai vështrim i butë i tij, që i shpërndahej Sanës nëpër fytyrë si një përkëdheli, humbi jashtë Çfarë bukurie. i tha ajo vetes me qesëndi.

Ky veprim i Gorit iu duk si mospërfillja më e madhe. Ai rri e shikon yjet, si t'i zbulonte për herë të parë, ndërsa ti, në këmbë, i bën hije nga prapa. Ky shpërthim i erdhi vrullshëm dhe mezi e mbyti brenda gjoksit.

Inati, të cilin tani ajo nuk e zbante më dot prej vetes, do t'ia kishte errësuar edhe më keq atë natë vere, po të mos kujtohej Gori të fliste:

— U zhveshe?

Pyetja e tij e zuri vajzën në befasi e i dha një të çarë të thellë vetëpërmbajtjes së saj të zorshme.

— Pse, mua po më prisje?

Gori nuk u përgjigj, veç u soll nga ajo me një rrotullim të ngathët. Sana mendoi se lëvizjet e tij ishin ashtu të ngathëta sepse urdhëroheshin thjesht prej vetëdijes së detyrës që i takonte të kryente ndaj nuses, për ta krijuar siç duhet kuadrin klasik të momentit të futjes së dhëndrit në dhomën e saj dhe i erdhi keq për veten. Megjithatë nuk bëri zë. Atij iu ngatërruan gishtat nëpër kopsat e fustanit të saj, ndërsa përpiquej t'i zbërthente pa u ndier. I dridheshin duart. Sanës i dukej tani se çdo veprim i tij kishte një lloj panatyrshmërie që i largonte nga njëri-tjetri. Gori po vonohej tepër në atë punë, ndaj ajo lëvizi pak për ta lehtësuar. Veç të mbaronte sa më parë, që të rrinte pastaj e qetë!

Ky mendim iu fshi shpejt bashkë me inatin,

kur i ndjeu pëllëmbët e tij t'i përkëdheleshin nëpër skajet e rrumbullakëta të supeve të zhveshura. Dhe më tej pastaj, kur ai e ngriti në krahe për ta afruar te shtrati, duke e mbajtur fytyrën e vet fare pranë së sajës, tërë qenien e vajzës e mbushi një turbullirë joshëse që i ngjiti lart e i vërshoi jashtë nëpër një valë lotësh. Me vetë tha se ishte mirënjohje, pastaj e mori për frikë, pastaj iu duk si padurim që as vetë nuk e kuptonte pse të qe i tillë.

e të parashikojë për të ardhmen, ku mundësisht të përputhet sa më mirë dëshira me rrjedhën e vetvetishme të ngjarjeve. Gjithçka kalon përmes një procesi të pambarim pyetjesh e përgjigjesh, pohimesh e mohimesh, miratimesh e kundërshtimesh të lodhshme.

Shtretërit ishin krahas. I ndante një rruginë e ngushtë dhe komodina te koka. Aty ishte vendosur edhe abazhuri, që mund të përdorej njëkohësisht nga të dy. Tani nga ana tjetër e asaj rrugine dëgjohej frymëmarrja disi e rëndë dhe e çrregullt e Gorit. Sanës i dukej se ndiente edhe ngrohtësinë që dilte prej mushkërive të tij, të cilat lëshonin një gërvimë të mbytur që ngjante si rënkim i largët, i njëtrajtshëm. Sana tha se që ky rënkim që nuk e linte të flinte. Në të vërtetë vetëm sa u përpoq t'i mbushte mendjen vetes kështu, ngaqë donte gjithsesi të mos ndryshonte në sjellje nga Gori. Po thellë-thellë e dinte shkakun e pagjumësisë së vet dhe e pashpjegueshme i dukej tamam e kundërta që bënte ai. Më të përshtatshme dhe më të natyrshme do ta quante zbardhjen e kësaj nate nga të dy. Sana gati po besonte se Gori, i rrëmbyer nga çastet e dashurisë, e kishte harruar tashmë lodhjen e fillimit dhe po gëzohej, kur ai tha se kishte shkuar shumë vonë e duhej marrë një sy gjumë. Sanës i ra menjëherë gëzimi, por u përpoq të mos e bënte veten. Përderisa atij i flihej, le të flinte.

Sana e kuptoi që po e tepronte me arsyetimet të tilla. Pasi i kaloi edhe një herë nëpër mend,

më të shumtat iu dukën fare pa kuptim dhe i thirri vetes. Lëri marrëzirat, tha, kjo natë, edhe më tepër se gjithë të tjerat e jetës sate, ka nevojë të jetë natë, të ketë domosdoshmërisht ëndërrën e saj, më të bukurën nga ëndrrat që ke parë ndonjëherë, sepse do të jetë vazhdim i jetës sate të minutave të paragjunit. Si mund të kuptohet kjo natë pa një ëndërr që të mbahet mend vite e vite më pas, të tregohet gjithnjë e më me mall dhe pas çdo ngjarjeje të jetës të gjendet patjetër një parandjenjë pikërisht tek ajo ëndërr?! Si do të na duket ajo ëndërr kur t'ia tregojmë njëri-tjetrit mbrëmjeve të zjarri, duke pirë një kafe pa sheqer në pleqërinë e vonë?!

Te kjo pyetje Sanës iu ndal përsëri mendimi dhe Gori, po të hapte papritur sytë, do të shihte buzët e saj gjysmë të çelura, prej nga ngjitej deri lart mbi mollëzat e faqeve një shprehje qesëndie dhe ankimi. Si shumë larg e çove pleqërinë, moj qyqare, po i thoshte vetes atë çast, ti që tani je në prag të pleqërisë. Çfarë, çfarë? Si qenkam plakur?! Iu hodh një zë tjetër që i përcolli një dridhmë të shkurtër nëpër buzë. Si qenkam plakur?! përsëriti ajo, por iu duk se pa fytyrën e vet që ishte aq e lodhur, sa nuk arrinte ta shprehte fyerjen. Unë sonte kam natën e parë të nusërisë, vazhdoi, ngaqë deshi ta përzinte deri në fund atë mendim. Dhe besoi se e përzuri. Megjithatë i mbeti një shije e hidhur që i rridhte si lëng i trashë në gojë. Për

ta larguar u përpoq të ngjallte përfytyrime të shkuara për ditën e martesës dhe t'i krahasonte me rrjedhën që mori bashkimi i saj me Gorin. Nuk guxoi ta quante dasmë.

Dasma nuk i kishte pëlqyer kurrë, sepse rituali i saj i dukej gjithnjë tepër i zhurmshëm e i urdhëruar nga të tjerët, gjë që e bezdiste. Bile, kur i qëllonte të shihte nuse, ndiente për to gati-gati dhimsuri. Ashtu, veshur krejt me të bardha e me atë qëndrim të ngrirë drejt si të qenë prej bore, ato ngjnin me kukullat që ndodhen aty, midis njerëzve, thjesht si zbukurim. Ato ishin të vetmet në grumbullin ku gjendeshin, që nuk u lejohej ta shfaqnin gëzimin. Shumë-shumë, për fytyrat e tyre ishte i pranueshëm një trishtim i lehtë që të shpallej nëpërmjet një kokrrë të kthjellët loti varur si brilant në skaj të syrit. Me atë memecëri dhe përmbajtje të drunjtë të emocioneve, nusja duhej të bënte të pamundurën për të mos iu përshtatur euforisë së shfrenuar të dasmorëve. Pse, xhanëm, pyeste veten Sana, pse? Pse të jetë ndryshe për dhëndrin, i cili kishte të drejtë edhe të lozte e të qeshte, t'u përgjigjej ngacmimeve e të ngacmonte të tjerët?! Sanës i bëhej çdo herë se provonte në trupin e saj lodhjen e jashtëzakonshme të nuseve, për të qëndruar, të paktën fizikisht, te tavolina në krye të vendit, para pjatave me gjellë e gotave të verës që edhe pas mesit të natës ishin ende thujse të paprekura. Sidomos tani që dasmat bëheshin nëpër restorante dhe të ftuarit sillnin domosdo një shu-

më parash që i kalonte dy-tre fish shpenzimet e asaj që ata hanin e pinin, dasmat po e humbnin gjithnjë e më tepër atë pamjen spektakolare. Sekush nga të ftuarit sikur e quante të komprometuar mjedisin me paratë që kishte dhënë, ndaj mund t'ua lironte vidat të gjitha dobësive të veta, që gjatë ditëve të tjera i mbyste përbrenda. Fliste me zë të lartë, këndonte edhe pa kuptim, ngrihej të vallëzonte e, duke i hedhur këmbët kot më kot, përplasej me tjetrin, por as që e ndiente nevojën të kërkonte të falur. Pa përmendur që, nga mbàrimi i darkave, d.m.th. nga mëngjesi i së hënës, janë shumë të shpeshta edhe sharjet e hapura e deri zënkat mes atyre që kanë mbetur të fundit. Para skenash të tilla, më vështirë se kushdo, kuptohet, e kishin dhëndri me nusen. Unë nuk do të mund ta përballoja, mendoi Sana, do të këputesha tak e do të bija përmbys mbi tavolinë. Mbi pjatë, tha pastaj e vetëtimthi iu fanit fytyra e vet e ngjyer me salcë kosi dhe i erdhi për të qeshur. Imazhi ia la vendin rishitas mendimit të trembur se ç'mund të thoshin të ftuarit kur ta shihnin ashtu të zalisur. E vazhdoi mendimin me përgojimet që do të tirreshin rreth saj edhe shumë ditë më pas. Do të thuhej se nusja është e sëmurë e do t'i ngjitnin lloj-lloj sëmurdjesh me emra që as i ka dëgjuar ndonjëherë. Të tjerë do t'i kundërshtonin të parët, duke shtuar me zë të ulët për t'i dhënë bisedës intimitetin që nënkupton se kjo gjë është më se e sigurt: «E di mirë unë, por, të lutem, të

mbetet midis nesh, pasi mund të bëjmë një dëm të madh për të dy: ajo është martuar pa qejf». «Si pa qejf, ata janë dashur?» «E, e, ashtu ishte në fillim, po ti e di sa u zgjat dashuria e tyre. Kaq vjet... vullkan të qe, do të ftohej». «Do të jetë ndonjë tjetër që u ka hyrë në mes...» «Diçka është, po më mirë të mos përmendet, i thonë familje, priset pa u ngritur akoma». «Drejt, drejt, ashtu është». Gjithçka mund të tirrej, mendoj. Sana me një ndjenjë alarmi që i ngjethi.

Pati dëshirë ta zgjonte Gorin, që t'i thoshte sa e kënaqur ishte që nuk bënë dasmë. Por, aty për aty ndërroi mendje. Mirë, shumë mirë që e shmangëm dasmën, tha më vonë, por edhe kështu, pa lajmëruar askënd nga të afërmit e as shokët e vjetër, të paktën për një kafe, një urim... Ah, një urim do ta doja, shtoi ajo përmes një ofshame. Jo, edhe fare kështu nuk duhej. Pse kjo nisje kaq e ngutshme për në plazh?! Sikur i vidhemi dikujt!

Kapitulli i katërt

Sapo në kuadratin e dritares, nga përzierja e ndriçimit të hënës me errësirën e natës dhe mugullimin e agut u krijua një dritë që të kujtonte flokët e verdhë kur kanë nisur të thinjen, Gori u zgjua dhe pa nga Sana. Kapakët e syve të saj, të varur pak poshtë, e ruanin ende lodhjen e padurimit të mëparshëm për ecjen e ngadalshme të orëve të kaluara.

— S'paske fjetur fare? — foli ai dhe në fytyrë iu vijëzua një buzagaz fajtori.

— Nuk e di, — u përgjigj ajo, — gjysmë

në gjumë, gjysmë zgjuar. Herë më dukej vetja në ëndërr, herë se po bluaja me mendje të kthjellët. As vetë nuk e di. — Edhe fytyra e Sanës bëri një buzëqeshje të lehtë fajtori.

Me këtë përshtypje të turbullt do ta gjente Sanën çdo mëngjes i ri deri ditën e largimit. Ato pak orë gjumë që bënte Gori, për të ishin orët e një jete të çuditshme. Gori flinte gjithnjë në kurriz dhe, nën çarçafin e bardhë, të mbështjellë pas trupit, dukeshin format e duarve të bashkuara mbi bark. Që të nesërmen e ardhjes, nënë celebrimin dhe morën një dhomë tjetër, me krevat të përbashkët.

Sana u mësua shpejt t'ia njihte Gorit çastin e afrimit të gjumit. Atij fillonte t'i rrallohej frymëmarrja, i bëhej më e rëndë e dukej sikur nga minuta në minutë kraharori i tij do të mpakej. Pas pak e humbte edhe kontrollin mbi gjymtyrët. Të parat i këputeshin këmbët. Pastaj mpirja i ngjitej te krahet, derisa i platitej edhe koka. Nuk fliste më, veç bënte edhe një përpjekje të buzëqeshte e t'i mbante edhe ca sytë e hapur. Sana ia ndiente mundimin, ngrinte dorën e ia ulte butë qepallat.

— Fli tani, fli! — i thoshte me zë nanurites. — Ka shkuar shumë vonë.

Ai lëvizte paksa buzët, po nuk arrinte të nxirrte tinguj. Megjithatë Sana e kuptonte dhe i përgjigjej:

— Ja, edhe unë do të fle fill pas teje.

Zëri i saj sikur e çlironte Gorin nga një

makth i përgjithshëm, që e pengonte të kridhej në gjumë.

Sana u mësua me këtë skenë, bile filloi t'i pëlqente, sepse i krijonte idenë e atij pushteti përkëdhelës mbi të dashurin, që e ëndërojnte të gjitha vajzat. Sa e sa herë dilte të shëtiste vetëm nëpër Parkun e Madh të Liqenit Artificial, sidomos pasditeve, dhe shihte çifte të rinjsh. Vajza e ulur në bar, ndërsa djali i shtrirë, me kokën në prehrin e saj. Kjo pamje, mbase fare e zakonshme për syrin e shëtitësve të tjerë, asaj i mbillte në shpirt një trishtim të këndshëm, i cili, në vend që ta mbyllte në vetvete, e shtynte përherë drejt të njëjtit përfytyrim. Sana me Gorin në breg të një lumi, ulur nën hijen e butë të një shelgu. Gori është mbështetur në supin e saj dhe merr një sy gjumë. Ajo, ngaqë nuk i shikon dot fytyrën, mbyll sytë. I duket se kështu ia ndien më fort praninë. Dhe i bëhet sikur frymëmarrja e tij, që ia ul e ia ngre ritmiksht kraharorin, kalon nëpër fytin e saj, duke e ngrohur të tërën me një afsh që e kanë mollët e pjekura mirë netve të vjeshtës. Sana e zgjaste këtë përfytyrim derisa mbaronte shëtitjen dhe, vetëm pasi kthehej në shtëpi, në mbrëmje vonë, kur duhej të shtronte darkë për një njeri, e ndiente plotësisht se Gori vazhdonte të ndodhej larg, shumë larg, tek e paarritshmja.

Ky kujtim i kthehej Sanës çdo mbrëmje aty, në dhomën e hotelit, teksa Gori i jepej thaujse lumturisht atij gjumi që i vinte saktësisht për-

herë në të njëjtën orë. Ishte një kujtim i dëshirueshëm, sepse e ndihmonte vajzën ta shtynte pa mundim të madh një copë kohë.

Ndërsa me pamjen e tij në gjumë ajo nuk po arrinte të mësohej. Atij i hipte përnjëherë një zbehtësi që vinte duke u zbardhur, derisa gjithë lëkura i mernte një ndriçim gëlqeror. Ishte një vezullim i ngrirë, që derdhej ngadalë, me një ftohtësi të padurueshme midis saj dhe djalit dhe këpuste çdo lidhje ndërmjet trupave të tyre. Ajo çuditej si nuk e ndiente Gori dhimbjen e këputjes së dhunshme të atyre pejzave që deri pak më parë i kishin bashkuar trupat e të dyve në të njëjtën rrahje të nxituar zemre. Ç'është ky gjumë kaq i thellë, thoshte me vete gati me inat dhe, ngaqë nuk i bënte dot ballë asaj rrjedhe të akullt që e përvëlonte ngado që e prekte, fillonte e largohej, derisa arrinte në skaj të krevatit të gjerë. Atje sikur gjente rehat. Netët e para lëvizte gjithë druajtje mos e zgjonte Gorin, po pastaj e kuptoi që gjumin e tij, jo luhatja e butë e sustës së krevatit, por as shkrepitima e një rrufeje te veshi nuk do ta prishte.

Kur arrinte në skaj të shtratit, Sana ngrihej përgjysmë dhe mbështetej në nënkrejsën e palosur më dysh. Sytë e saj vareshin mbi Gorin që flinte i patrazuar. Vinte një kohë kur ata sy, të pambyllur për asnjë çast, fitonin një magjepsje të plotë që i shpërndahej nëpër të gjithë trurin si një ethe. I zgjoheshin kujtime nga më të ndryshmet që as nuk e kishte besuar ndonjë-

herë se ruheshin aq të kthjellëta tek ajo. Këto kujtime e lodhnin jashtë mase, sepse e de-tyronin ta jetonte njëherësh një shpërthim të vrullshëm gëzimi me një hidhërim të papritur. Të tilla i dyndeshin vetë figurat e së kaluarës, pa asnjë rregullsi kohore, pa asnjë interval pushimi në mes. Unë të dua shumë, aq shumë sa nuk mund të jetoj pa ty, i kishte thënë Gori. Ai kishte veshur një triko të hollë pambuku, me një xhep të vogël në të majtë, ku dukej se nuk kishte futur kurrë asgjë. Ajo i kishte pritur këto fjalë prej vitesh, që kur Gori vazhdonte ende gjimnazin. Por, të thëna ashtu, me aq shkujdesje, sikur po thuhej gjëja më e zakonshme, Sanës i ranë të befta e ia humbën fillin e mendimeve. Nuk kishte lidhur dot dy fjalë për t'iu përgjigjur. Kishte ngritur një herë sytë ku përshkënditej një dritë e lëvizshme si bisht zogu dhe kishte pyetur, oh, sa pyetje e kotë për atë çast, përse e mbante atë xhep! Të të fut ty. Nuk duroj dot pa të pasur kudo me vete, ia kishte kthyer ai shkujdesur, ashtu si më parë. Ajo kishte pasur një hovje të vetvetishme fluturuese të trupit lart dhe, pa arritur ta kuptonte se si, kishte mbështetur kokën tek ai xhep. Kishte gjetur aty një prehje të re, të panjohur më parë, që, pa qenë në gjumë, i kishte ndjellur ëndrrat më të bukura. Dhe kushedi sa gjatë do të kishte qëndruar ashtu, symbyllur, po të mos kishte dëgjuar një zë të prishur nga prapa:

«Korba ti, ç'bën këtu? Dushmanët ta morën

burrin, e hipën në një makinë të mbyllur e bashkë me djem të tjerë e nisën për andej, në fund të dynjasë; nga thonë se nuk kthehen më.»

Sana u përdrodh si t'i kishin ngulur një thikë dhe hapi sytë. Pa se ndodhej para njëres nga plakat e lagjes, që i kishte folur, duke gërvishtur fytyrën me thonj. Qe sjellë nga të gjitha anët, po Gori vërtet nuk dukej gjekundi. E tmerrshme, kishte klithur, po ai sapo qe këtu. Plaka vazhdonte t'i fliste duke gërvishtur fytyrën sa i bëri gjak mollëzat e faqeve, por tashmë nga goja e saj nuk dilte zë.

Gëzimi dhe hidhërimi trazoheshin keq me njëri-tjetrin në shpirtin e Sanës dhe i linin aty atë plasaritjen e pandreqshme që u lënë shkëmbinje ngrohjet e ftohjet e dendura të motit.

Sana u hodh përpjetë dhe pak më vonë ajo pa që Gori vazhdonte të flinte qetë i qetë ndanë saj, pa e ditur fare ç'bëhej me të.

Pasi shkëputej me shumë mundim prej kujtimeve, Sana kthehej në të tashmen e vet dhe përpiqej të hynte sadopak në jetën që bënte Gori edhe aty në dhomë. Gjëja e parë që hetoi ishte shkëndijimi xixëllitës i syve të tij, i cili dilte jashtë nëpër të çarën që krijohej nga mospërputhja e plotë e qepallave. Por, që nga fëmijëria e hershme, ajo thujse nuk kishte fjetur kurrë me ndokënd në dhomë. Ndaj edhe nuk kishte parë njeri tjetër me kaq vëmendje ndërsa ai flinte. Kështu që nuk mund të thoshte nëse kjo qe diçka e veçantë, vetëm e Gorit. I pëlqeu

më mirë të përpiqej ta shpjegonte domethënien e atij xixëllimi të praruar që nuk shuhej derisa Gori përmendej. Njëherë tha se kjo tregon që truri i tij punon. Por, vazhdoi, truri punon edhe në gjumë, kur e bren merakun i ndonjë pune të rëndësishme të pakryer gjatë ditës. Ç'do të jenë këto punë, shtoi pastaj dhe u ndie pak e prekur si grua që i shoqi e linte jashtë halleve të veta të mëdha.

Herën tjetër tha se ai xixëllim regëtitës i vinte nga shqetësimet që mund t'i kishte lënë prapa dita e ikur. Dhe s'ka si të jetë ndryshe, e përforcoi mendimin e saj, a s'e kam parë sa herë vetën të bie në shtrat me një shqetësim e të mbetem tërë natën duke u përpëlitur në dyshek?! Ç'ia këpus kot edhe unë, kundër-shtoi pak më vonë, Gori është i kredhur në më të mirin gjumë! Por aty për aty u penđua për këtë kundërshtim, sepse pa që ia mbylli vetes rrjedhën e mendimeve. Ku e di ti në ai po bën gjumin më të mirë a më të keq, tha.

Këto arsyetime përsëriteshin e përsëriteshin, duke u rrotulluar nga të gjitha anët dhe, kur nuk gjente dot asnjë zgjidhje që ta bindte, ndalej. Mbase, po ta rikrijonte edhe një herë gjithë ditën e kaluar deri në imtësi, do të nxirrte prej saj diçka që t'ia zbulonte shqetësimet e panjohura të Gorit. Megjithatë, edhe këtu tepër rrallë arrinte të gjente gjë që, të paktën asaj, t'i dukej e tillë. Atëherë, këto shqetësime të paemër të Gorit dyzoheshin e i ngrinin vatrat e tyre te Sana. Por, si

çdo gjë anonime, e papërcaktuar, i krijonin asaj një gjendje dyshimi. Mos jam bërë unë shkak me ndonjë fjalë a gjest të pamenduar? Dhe, siç ndodh gjithmonë me njeriun e pafajshëm, nxitonte të jepte shpjegime, të komentonte ato që kishte thënë apo bërë, për t'u bindur se nuk kishte asgjë për t'u keqkuptuar.

Midis këtyre hamendjeve i shfaqej e i zhdukej herë pas here ai mendimi i parë se Gori do të kishte ndonjë shqetësim të vetin. Dhe këtu, duke u hequr sikur s'i bënte përshtypje që ai nuk i qe hapur sa duhej e se nuk e kishte drejt kur thoshte që midis të dashuruarve gjithçka është e përbashkët, gëzimi e shqetësimi duhet të ndahen me domosdo, shtonte: Hiq dorë nga këto romantizma letrareske! Çdo njeri ka gjëra krejtësisht personale, intimitete që e kanë bukurinë vetëm kur jetojnë heshturazi thellë në shpirtin tënd, e, po të dalin jashtë, qoftë edhe të thëna në çastin e mirëkuptimit më të plotë midis të dashuruarve, banalizohen. Po këtu nuk është fjala për intimitete, kundërshtonte prapë zëri tjetër, është fjala për merak, për shqetësim e shqetësimi dihet se bëhet më i lehtë kur ndahet më dysh.

Siç duket s'është as njëra as tjetra, vazhdonë Sana ta seliste mendimin. Gori duhet të ketë një sëmundje të fshehtë, që ndoshta nuk e di as vetë. Pse jo, kushdo mund të ketë një cen të lindur, që, kur e sheh mirë, nuk është tamam cen, po diçka e veçantë, që nuk di as unë ç'emër

t'i vë. Kam lexuar një herë për një njeri që ishte në gjendje t'i njihte e t'i bashkonte shkronjat shumë rrjedhshëm; vetëm duke i prekur faqet e zakonshme të librit, me bulat e gishtave. Për t'u bindur se nuk i mashtronte, ata që nuk besonin ia lidhën sytë me një copë të zezë të trashë dhe i vunë përpara një libër që atij nuk i kishte rënë në dorë kurrë më parë. Megjithatë panë se ai i kalonte gishtat sipër rreshtave të shkruar dhe lexonte lirisht. Gorit, për shembull, mund t'i lëshojë dritë gjaku. Pse jo, ndodhin gjëra të tilla. Dhe për një femër është fat të jetojë me një burrë të tillë, sepse gjithçka e tij është e veçantë, interesante, e papërsëritshme të të tjerët.

Kapitulli i pestë

Kambana e një sahati të madh diku larg, nga gendra e qytetit, tingëllonte mbyturazi dhe orët shënonin vdekjen e ngadalshme të natës. Sana dëgjonte jehonën e asaj kambane, që qetësia e natës e sillte të shumëfishuar dhe e shpërndante nëpër trupin e saj si rrëqethje të ligë. Ajo rrëqethje i shkaktonte vajzës një trazirë që sikur e sillte në vete dhe e bënte të ndihej tmerrësisht e lodhur. Atëherë i dukeshin pa asnjë kuptim të gjitha mendimet e veta. Pas kësaj betohej se nuk do ta hallakaste më trurin me marrëzira të

tilla. Mjaft! bërtiste së brendshmi sa i gjëmonin veshët, mjaft! A nuk e sheh se këtu ka diçka tjetër që nuk shkon?! Çfarë? pyeste zëri tjetër. Duke kërkuar përgjigjen e kësaj pyetjeje, turbull-turbull në vetëdijen e saj po lindte përshtypja se në sjelljen e Gorit kishte njëfarë panatyrshmërie, që shfaqej si pa dashje aty-këtu në ndonjë gjest apo copëz bisede, të cilat nisën të veçoheshin vetvetiu te Sana dhe rikrijoheshin gjatë orëve të pagjumësisë, të zëbërthyer deri në imtësi.

Gori u habit kur ajo i përmendi lejen e zakonshme dhe arsyetoi në mënyrën më të çuditshme: Lëre punën, ç'do të të bëjnë?! Nuk do të ta paguajnë rrogën e kaq!

Kur blenë shishet e verës, Gori u duk sheshit që nuk merrte vesh fare nga çmimet, bile as paratë nuk i njihte.

Gori shfaqti habi të madhe kur ajo i tha se, për t'u regjistruar në dhomë të përbashkët në hotel, u duhej dokumenti nga gjendja civile që ishin të martuar.

Gorit i vinte gjumi saktësisht përnatë në të njëjtën orë, ndërsa, për t'i dalë, i lëvizte koha sipas lëvizjes së gjatësisë së ditës. Zgjimi i tij përcaktohej në mënyrë të pagabueshme nga lindja e diellit.

Gori nuk qeshte thujse kurrë. Edhe kur përpiquej ndonjëherë ta bënte këtë veprim, nga më të bukurit te njeriu, i dilte më tepër një shpërvjelje e sforcuar e buzëve sesa ndjesi.

Ajo e quante krejt të natyrshme, bile të domosdoshme të fliste me Gorin për të ardhmen, sepse tani jeta e tyre kishte marrë rrjedhën e re të përbashkët. Me njëri-tjetrin do të kishin shumë gjëra të reja, që nuk i kishin pasur më parë veç e veç. Ajo kishte dëshirë të veçantë t'i përfytyronte këto të reja që e pritnin, ta jetonte që më parë bukurinë e tyre, por ai i shmangej vazhdimisht kësaj bisede. Dhe, sapo ajo niste të merrte zjarr, ia shuante me një të përdredhur me takt, duke e hedhur fjalën diku tjetër. Ajo trishtohej, por, për të mos ia prishur, i shkante pas.

Kishin ardhur në plazh, por Gori ende nuk qe zhveshur as edhe një herë të bënte banja në rërë. Sapo zgjohej në mugullimin e agut, futej në dush, pastaj dilnin shëtitje. Pasi i binin një herë bregut të detit deri në fund, ktheheshin nga pylli i pishave dhe vazhdonin të endeshin nëpër të, duke ndier nën këmbë shtresën e butë të halave të thara. Kur fillonte të nxehte dielli, drejtoheshin për nga restorant «Gjelbërimi», që ishte aty pranë dhe hanin mëngjesin. Nga ora nëntë ndodheshin prapë në dhomë. Ai shtrihej mbi krevat ashtu i veshur, ndërsa Sana, e detyruar prej tij, shkante në rërë. Edhe kur kthehej, pas mesditës, ajo e gjente aty, të shtrirë mbi krevat, duke lexuar i përhumbur libra me kujtime të veteranëve të Luftës. Ajo donte ta dinte se përse i shmangej ai detit ashtu, në fund të fundit përse erdhën në plazh, nëse nuk e

kishin kënaqësi të përbashkët?! Mund të shkolin fare mirë në ndonjë vend malor... Po pyetjet i mbyteshin në grykë nga një stepje e pashpjegueshme.

Pasdite gjithashtu Gori nuk flinte. Vazhdonte të lexonte i përqendruar në librat e kujtimeve për Luftën. Sana vuri re se ai nuk lexonte asnjë lloj libri tjetër dhe në një çast nuk e kuptoi as vetë se si iu shkrep ta pyeste pse qe dhënë kaq fort pas tyre.

— Ti i njeh — u përgjigj ai, — janë shokët e mi të vjetër të Luftës dhe kam dëshirë të di ç'kanë thënë ata pas kaq vjetësh, për mua dhe për ngjarjet ku kam qenë vetë.

Sanës i mbeti në mend edhe kjo përgjigje.

Në mbrëmje i vinte radha shëtitjes së zakonshme, që fillonte nga pylli i pishave, vazhdonte me darkën te po ai restorant i vogël dhe mbyllej me kthimin e vonë bregut të detit. Sana këtu kapi një hollësi tjetër: në mëngjes ata largoheshin nga bregu sapo nisnin të shtoheshin njerëzit dhe në mbrëmje ktheheshin andej po ashtu, kur shëtitësit ishin rralluar shumë. Pse ta kishte këtë dëshirë Gori për t'iu shmangur sa më shumë syve të njerëzve?! Ajo pa se edhe gjatë ditës ai përpiqej të kishte sa më pak njohje të reja dhe biseda me pushues që ua sillte rastësia pranë.

Një herë, duke menduar se përse vallë nuk dilte ai në det, Sana zbuloi edhe një imtësi të re: Gori mbante gjithmonë këmishë me mëngë

të gjata dhe nën të një bluzë pambuku po me mëngë të gjata, të cilën nuk e hiqte as kur flinte. Edhe kësaj here Sanës i shpëtoi një pyetje:

— Pse vishesh kaq trashë në gjithë këtë vapë?

— Unë kam gjithnjë ftohtë, ti e di, — iu përgjigj ai pa e pasur mendjen, i zhytur në leximin e vet.

— Si ftohtë? Çfarë di unë? — u çudit ajo.
— Tani, në këtë kohë...

— Bëj shaka, — ia ktheu ai i përmendur dhe vetëtimthi nëpër sy i kaloi një frushullimë tmerri, që mezi u fsheh në thellësi të tyre. Ai qëndroi një grimë herë si të donte të mblidhte sa më shumë butësi te zëri dhe vazhdoi: — Bëj shaka. E mbaj bluzën e pambukut se është shumë e mirë për të thithur djersët.

Supet e Sanës mbetën edhe pak të ngritura, pastaj u ulën ngadalë me një kapitje dëshpëruese. Deshi të vazhdonte, t'i thoshte se nuk qe ai shkaku i vërtetë e se nuk e besonte, por tashmë nuk i bindej vetja. Dhe ashtu si herët e tjera, iu kyç goja.

Me kohë Sana po shihte se në të gjitha fjalët dhe veprimet e Gorit kishte një vetëkontroll të fortë e që i prishej vetëm në çaste tepër të shkurtra, kur ai qe i harruar tërësisht pas diçkaje tjetër. Pse, pyeste veten ajo, ç'duhet ky vetëkontroll kaq i rreptë? Kaq shumë të fshehta, që nuk mund të më besohen mua, paska ai?

Ato pak orë të pafund të natës po zbulonin

para Sanës se te Gori kishte një enigmë. Dhe, siç ndodh gjithmonë, pafuqia për t'ia kapur fillin enigmës vetëm ia shtonte zjarrminë, e bënte më të padurueshme.

Megjithatë Gori nuk e ndiente gjendjen e saj të shqetësuar, sepse, me t'u dukur zbardhëllimi i ditës së re në dritare, nga fytyra e Sanës fshihej gjithçka dhe aty nderej një pamje e bukur lemërore, ku trazohej pakëz melankoli me atë gëzimin e qëndrueshëm që e sheh zakonisht të të porsamartuarit, të cilëve u duket se tashmë, pranë njëri-tjetrit, nuk do t'u mungojë asgjë.

Ndërsa Gori vazhdonte gjithnjë të flinte në pozicionin e tij të zakonshëm. Ai, sa hapte sytë dhe e shihte Sanën të zgjuar, thuajse përherë i bënte të njëjtën pyetje:

— Nuk paske fjetur fare?

Ajo vinte buzën në gaz dhe afronte kokën pranë tij.

Kapitulli i gjashtë

Kur shihte që Sana nuk kishte mbyllur sy tërë natën, dukej që Gori vuante me vete nga një ndjenjë e fortë faji. Si për ta larë sadopak këtë faj, gjatë shëtitjes mundohej me të gjitha fuqitë të tregohej sa më i përzemërt, sa më i çelur, të tregohej sa më i saj, pa i dhënë Sanës të kuptonte se e bënte qëllimisht.

Megjithatë Sana, me sytë e femrës së dashuruar, e shihte që shndërrimi i Gorit nuk vinte nga zgjimi i shumëfishuar i muskujve dhe nervave të tij, që ndienin praninë e saj, po më

fort qe një qëndrim i vetëdijshëm ngaqë duhej ashtu.

Pse duhet, pyeste veten ajo, pse? Dhe aty për aty përgjigjej: A nuk është dashuria rregullatori më i përsosur i marrëdhënieve midis dy njerëzve? Pra, dashuria ia filtron të mirat secilit e ia rrit. Por edhe të metat ia bën më të dukshme, së pari para vetes. Dhe është e natyrshme që ai të luftojë për t'u pastruar prej tyre. Cili i dashuruar nuk tha se dashuria e ka bërë më të mirë?! Vetëm ashtu arrin dashuria të bëhet fenomen i rëndësishëm shoqëror, sepse ndikon në përkryerjen morale të njerëzve.

Me këtë arsyetim të fillimit ajo e hoqi nga mendja edhe për shumë ditë më pas vizionin e kontraktimit të tij për t'u dukur i përzemërt.

Në atë çast kur dita dhe nata bëjnë përpjekjen e fundit e më të mundimshmen për të bashkëjetuar, ata kalonin bregut të detit me hap të ngadalshëm, mbështetur te njëri-tjetri dhe flisnin me zë të ulët. Hapësira e pangjyrë rrinte pezull mbi det dhe dukej krejt e shkëputur prej tij, pasi nuk kishte asnjë dritë, asnjë refleks t'ia lëshonte mbi rrafshin e ujërave të rrëqethura vetëm prej rrymave të brendshme. Në këtë korridor të zbrazët përkohësisht, derisa mospajtimin e përjetshëm të natës me ditën ta zgjidhte dielli, shëtitnin ata të dy dhe qetësia e plotë e peizazhit i jepte pamjes së tyre një hije solemne.

Sana ndiqte me sy lojën e gishtave të këmbës

së vet, që dilnin prej sandaleve, me rërën dhe dëgjonte zërin e shtruar, krejt intim të Gorit. Ai nuk sajnte asnjëherë dialogje kot, lojëra fjalësh, që janë aq të shpeshta midis të dashuruarve e që në dukjen e parë të lënë përshtypjen e mirë të një gazi fëmijnor, po që, po t'i shtrydhësh pak, nxjerr prej tyre diçka tjetër: një frikë nga heshtja, që nuk e dinë as ata vetë pse e kanë. Gori i linte vend edhe heshtjes. Dhe fliste gjithmonë kur kishte gjë për të thënë. Më vonë, duke i vërtitur shumë herë nëpër mend këto biseda Sana jo vetëm i mbajti gjallë, por edhe krijoi me to njëfarë cikli që gati-gati ndahej me tema të veçanta. Çuditërisht ky cikël niste me një dialog për fjalën e dhënë.

— Më ke nëmur ndonjëherë? — e pyeti papritur Gori.

— Si flet kështu?! Pse do të të nëmja?!

— Se m'u bë kaq kohë pa u kthyer te ti. Unë, që të kisha thënë se asgjë nuk mund të më ndante prej teje...

— Mirë, po... — Sana deshi t'i thoshte se nuk kishte si ta nëmte, kur e dinte pse pati munguar, por e mbajti veten dhe heshti, me kokën pak të ulur për të mos e parë në sy.

Edhe Gori nuk foli.

— Si e përfytyron nëmën time, për shembull? — vazhdoi ajo, tani me dëshirën ta kthente bisedën e nisur në shaka. Por e pa menjëherë se nuk gjeti tamam fjalët që i duheshin.

— Siç nëmet në këso rastesh, — u përgjigj ai.

— E kam fjalën, si mund të formulohet një nëmë e tillë, që në thelb nuk është nëmë?

— Ç'është?

— Është një shkrim i papërmbajtur i dufit të mallit.

— Drejt e ke. Unë do të nëmja me një varg poezie: «Në je gjallë, përse s'kthehesh?»¹⁾.

— Unë s'e di, nuk e kam menduar.

— Megjithatë unë e ndieja gjithnjë se ta kisha një peng të rëndë.

— Ç'peng, si e thua!?

— E them e ashtu është. Sot dashkam të të flas veç me vargje.

*Por ajo me bes' të thellë
priti e priti të parin vit,
priti t'dytin dhe të tretin,
vinë e tretë, të taksur-o;
pra si shkoi i treti vit,
priti prapë e nuk u lodh²⁾*

Pasi i recitoi vargjet, Gori la një çast të lirë që t'u futej në mes të bisedës shushurima e butë e valëve të vogla të detit që përkëdheleshin si të llastuara pas bregut. Sana pati kohë të ndiente gudulisjen e kokrrizave të rërës që i kishin hyrë në sandale.

1, 2 — vargje të Gavril Darës.

— Të pëlqejnë këto vargje? — e prishi Gori heshtjen.

— Më pëlqejnë, janë shumë të bukura, po nuk e gjej ku do të dalësh me to.

— Si nuk e gjen? Ato sikur janë shkruar posaçërisht për ne të dy.

Sana rrudhi supet jo me shprehjen e së paturës, po për të pohuar siç ndodh zakonisht kur nuk do ta shprehësh me fjalë, se të vjen mirë nga ato që dëgjon.

— A nuk kishim ne një besë të madhe bashkë?! Se besa e dashurisë nuk është fjalë në erë, është besë jete. E, a nuk iu mbajte ti asaj të parin vit, të dytin, të tretin, kur edhe u kthyen në shtëpi shokët e mi?! Pse, a nuk ishte ky viti i taksur për t'u kthyer edhe unë?! Si kaloi dhe ky vit, a nuk prite e prite pa u lodhur?! Ndërsa unë isha andej, ku as dy gisht letër nuk t'i shkruaja dot. Këto vargje të mësuara përmendësh në orën e letërsisë shqipe në gjimnaz i paskam mësuar për ty, pra, edhe pse nuk të njihja ende, vetëm e vetëm për ty, që ta kem më të lehtë ta krijoj imazhin tënd tek më prisje.

Zëri i Gorit erdhi duke u shuar, si të rrëshqishte tutje, nëpër sipërfaqen e lëmuar të detit. Dhe ra heshtje.

— Pse s'flet? — tha ai me një shkulum të ri, sikur po i këputej diçka e rëndë brenda kraharorit.

1) Është një varg i G. Darës.

2) Janë vargje të së njëjtës poezi të G. Darës.

— Nuk di ç'të them.

— Të thuash se vërtet fjalën e dhënë nuk e tret as dheu.

— Po kjo s'është e re.

— Ta thuash ti, se shpirti yt i vuajtur për mua e bën të re.

— Tek unë pesha e fjalës së dhënë shfaqej ndryshe, — u përgjigj ajo.

— Si?

— Unë nuk isha pritësja e paepur e të dashurit të humbur në udhëtime të panjohura. Nuk ushqehesha me eliksirin e shpresës së kthimit të tij, që t'i mban natë e ditë shqisat zgjuar. Nuk isha Penelopa që, për ta vrarë kohën e mungesës së burrit, që i zgjatej e i zgjatëj, thurte e shthurte natë e ditë në vegjet e saj. Unë e pranoja moskthimin tënd.

Kapitulli i shtatë

Mëngjesin e nesërm Sana shihte në bisedën e Gorit një prirje krejt tjetër, të papritur për të. Ai nuk ishte më i djeshmi, që pështillte e shpësh-
tillte mendime tepër serioze e paksa të ngurtë-
suara nga përpjekja për t'i thënë e njëkohësisht
për të lënë të nënkuptohen sa më shumë gjëra,
duke ruajtur në hije me kujdes një qoshe, ku se
ç'ishte një e fshehtë, e cila edhe grimcohej në-
për të gjitha fjalët e thëna e nënkuptimet, edhe
bëhej më e pakapshme njëherësh. Sanës, duke i
menduar tërë natën këto, i dukej vetja si të ishte

në mes të një amullie që e vërtiste nga të gjitha anët e i krijonte një gjendje hutimi e pavendosmërie për t'i gjykuar drejt ato, amulli nga e cila e nxirrte prapë vetëm Gori, sapo vinte mëngjesi. Ai zgjohej me pamjen e njeriut që nuk ka asnjë vramendje, veçse t'i gëzohet deri në fund motit dhe peisazhit të bukur.

— Me çfarë do ta krahasoje detin ti? — i tha Sanës.

— Nuk e di. Më duket se deti mund të krahasohet vetëm me vetveten.

— Pse?

— Sepse, siç është ai, i paanë, i thellë, me këtë aftësi për të krijuar edhe pafundësi nuancash të së njëjtës ngjyrë, më huton, ma bën të pamundur t'ia gjej të ngjashmin.

— Oo, mua krahasimet më duken të varfra kur mbështeten vetëm në ngjashmëritë e jashtme.

— Po ku të mbështeten?

— As vetë nuk e di, po duhet të ketë edhe shumë pika të tjera që të japin dorë, përderisa, po ta përmbysësh krahasimin e ta ngrësh prapë në një formë të re, prej tij del edhe një metaforë.

— Mirë, provoje ta bësh këtë gjë një herë me detin!

— Ta zëmë se themi: «Deti si një pasqyrë vezulluese». E ndërtojmë ndryshe me të njëjtat fjalë e mund të kemi: «Pasqyra vezulluese e detit». Cila të pëlqen më shumë?

— E dyta. Po ngjashmëria e jashtme është edhe këtu.

— Sigurisht, s'ka si të mos jetë. Po nuk duhet të mbetet e vetmja. Ke parë kur qëndron para pasqyrës? Nuk ke asnjëherë përshtypjen se shikimin ta kufizon një rrafsh i pjerrët i qelqtë. Përkundrazi, të duket se ai shkon pambarimisht larg. Pra, me këto fjalë mund të japësh figurativisht jo veç pamjen e lëmuar e të pastër të faqes së detit, por edhe idenë e thellësisë së tij. Kup-timin e plotëson më tej fjala «vezulluese», sepse i shton diçka që ka të bëjë me vetitë e tij, që zberthehen kur hyjnë në lidhje me ajrin dhe me diellin. Ndërkohë e pranon edhe fjala pasqyrë. Këtë desha të them kur përmenda ngjashmëritë. Duhet të hyjnë edhe vetitë, gjithçka, apo jo?

Sana nuk u përgjigj.

— Pse s'flet? — tha ai. — Të mërzita?

— Jo, aspak. Përkundrazi. Po ti, kur hyn në arsyetime të tilla, thua gjëra që rrallëherë i shkojnë ndër mend njeriut. Ndaj më pëlqen t'i dëgjoj të më jehojnë në kokë dhe pak, pasi ti ke mbaruar.

— Nganjëherë i quaj me vete kotësira dhe pendohem që t'i them ty. Po se ç'më shtyn të mos i mbaj brenda. Sa herë ndodhem para pamjesh të bukura të natyrës, më nxitet edhe përfytyrimi e mudohem ta gjej edhe fjalën që ta ketë peshën e asaj çka sheh syri. Nuk mundem ta mbaj shikimin gjallë e njëherësh trurin ta kem bosh. Ndosh-ta ngaqë më ka lodhur tepër peizazhi përherë i pandryshuar andej, relievi i tij i paformë, errësira.

Sana ktheu kokën. Ai e ndjeu se i rrëshqiti kontrolli mbi fjalët dhe nxitoi ta mbyllte, pa i lënë asaj kohë të pyeste.

— E kam fjalën se, kur rri gjatë në një vend, sikur mërzitem, më topitet syri nga pamja e njëjtë. Lëvizjet më japin kënaqësi të veçantë edhe për bukuritë e natyrës që më zbulojnë. Më duket se natyra e bukur ma freskon edhe mendimin.

Ai ngriti krahun dhe e mbështeti mbi supet e Sanës. Ajo u afrua më pranë tij dhe ia kaloi dorën rreth mesit pa folur.

Aty ku derdhej në det një përrua i hollë, që, çuditërisht, edhe në verë e ruante pak ujë, ata ktheheshin gjithnjë për të hyrë në pyllin e ri të pishave. Shtresa e butë e halave të vjetra nën këmbë e bënte heshtjen edhe më të pushtetshme. Sana e kishte kuptuar se heshtjen e kësaj pjese të shëtitjes Gori e përballonte me njëfarë zori të veçantë. Ndaj ai mundohej të gjente gjithnjë biseda që kërkonin përqendrim të plotë e që nuk të lirin ta mbaje mendjen tjetërkund.

— S'ka gjë më të papranueshme se pendimi,
— po i thoshte ai një ditë.

— Mos u bëj kaq kategorik! — ia ktheu ajo me të qeshur.

— E, nejtë, po është vërtet i papranueshëm.

— Njeriu mund të bëjë edhe gjëra për të cilat më vonë të thotë se i ka bërë keq, sepse i qëllon të ndodhet para të papriturash që i kanë ardhur pikërisht nga rrjedha e keqe që i ka dhënë vetë ngjarjes.

— Kjo është tjetër gjë. Pendimi nuk është njësoj me vështrimin autokritik. Bile, mua më duket se e përjashtojnë njëri-tjetrin.

— Si?

— Pendimi ka brenda doza të rënda sentimentalizmi dhe përlllogaritje të interesave vetiake: ç'humba që e bëra kështu? Ç'do të fitoja po ta ktheja edhe një herë mbrapsht e ta bëj ashtu? A ka ndonjë mundësi të tretë për të dalë edhe më i fituar? Pendimi shpreh frikë, frikë që në fillim, ndaj edhe ka mundur t'i shërbejë aq mirë edhe fesë. Ndoshta edhe e teproj pak, po nuk i vë dot emër tjetër. Nuk e di, po të pandehurit i mendoj gjithmonë pa shtyllë kurrizore.

— Oh! S'më kishte shkuar ndër mend. Ti e lidh me pozicionin e përkulur të njeriut në bankën e rrëfimit në kishë, — tha ajo duke qeshur.

— Tamam. A s'të duket e neveritshme?

— Lidhja që bën ti, është pak arbitrare, megjithatë shkon.

— Kur më kalon ndonjëherë nëpër kokë mendimi se mund të më qëllojë të pendohem, tmerrohem. Ndaj edhe doja të kthehesha pamtjetër te ti dhe sa më shpejt. Sa kam hequr gjersa ia dola mbanë! Nuk e merr dot me mend ç'torturë!

— Ç'lidhje ka këtu? — Zëri i Sanes sikur kaloi nëpër një tub të gjatë çeliku, që vazhdoi të kumbojë dridhshëm edhe një copë herë.

— Të kisha dhënë fjalën se do të martohe-

shim. Për këtë lashë si pengun më të madh dashurinë e parë dhe mora prej teje po dashurinë peng. Po të mos kthehesha dot, ky peng do të qe vuajtja jote e përjetshme. Ti s'e meritoje gjithë atë vuajtje, atë rrënim të plotë të ëndrrave. Atëherë unë s'do të mund të duroja e do të pendohesha për fjalën që të dhashë. Ky do të qe fundi im, do të bëhesha tjetër, atje, larg, shumë larg syve të tu, pa pasur pranë dikë të dashur që t'i dhimbsesha.

Ofshama e thellë që i doli nga fundi i kraharorit sikur ia mori me vete edhe një pjesë të trupit dhe Sana ndjeu se si u mpak ai, iu lehtësua gati përgjysmë pesha e tij që i mbështetej në krah.

— Gori! — i foli, — Gori! — Dhe e shkundi si të donte ta zgjonte nga një ëndërr e lemërishe atë dhe veten. — Gori! Ç'thua, Gori!

Po Gori nuk iu përgjigj. Vetëm trupi i tij kërkëlliti si t'i zgjidheshin të gjitha gjymtyrët njëherësh.

Sana nuk pati fuqi t'i thërriste më. Vetëm e afroi pranë vetes duke e shtrënguar fort, e sigurt se, po të mos e mbante, ai do të rrëzohej përtokë, i thyer si të qe prej qelqi të hollë. Dhe vazhdoi të ecte në heshtje, pa ditur ç'të bënte.

Për çudi, ai ndiqte ritmin e hapave të saj me rregullsinë e zakonshme, si të mos kishte ndodhur asgjë. Kur i shkuan pyllit në fund, ai i pari mori drejtimin për nga ktheheshin gjithnjë,

aty ku dredhonte rruga për në restorant «Gjelbërimi». Kjo e hutoi Sanën edhe më keq, aq sa po dyshonte në veten e saj. Deshi t'i thërriste përsëri, po nuk i dilte zëri. Nga mundimi për të nxjerrë qoftë dhe një fjalë, pa e kuptuar, shpërtheu në vaj. Gulçet e saj të shpeshta e përmendën Gorin. Ai u ndal, u lirua prej shtrëngimit të saj dhe ngriti duart t'ia fshinte lotët.

— Mos, — i tha, — nuk bën kështu. Unë të fola krejt sinqerisht jo për të të lënduar. Po nuk duroja dot më. Tani u lehtësova, shpëtova. Tani, ne të dy... — Ai bëri atë buzagazin e vet të largët dhe Sanës iu thanë vetvetiu lotët e iu qetësua kraharori. Gori po fliste. Edhe pse thoshte për veten gjëra që ajo s'i merrte vesh, rëndësi kishte që ai po fliste.

Sana vazhdonte të ishte e pazonja të nxirrte edhe një fjalë të vetme, po s'ka gjë, po fliste Gori.

Tutje, në plazh, ishin shpeshtuar çadrat. Shushurima e detit humbiste tani në zërat e shkujdesur të njerëzve që më së shumti ecnin grupe-grupe bregut të detit, duke pritur të ngrohej rëra. Sana sikur po niste të shpihej dhe më në fund arriti të bëjë buzën në gaz.

Kapitulli i tetë

Shëtitjet e pasdites fillonin në regëtimën e muzgut.

Ata i binin buzës së kallamishtes dhe hynin në pyllin e pishave. Deri aty vinin gati pa folur, me hap të shpejtuar, si të nguteshin për t'u fshehur nën kurorën e pishave, që muzgu e bënte më të dendur dhe e shkrinte, pak nga pak, krejt pyllin në një trup të vetëm, i jepte atij pamjen e një humbelle prej nga dilnin zëra misteriozë të dashuruarish.

Gori e mbante dorën të shtrënguar fort pas

krahut të Sanës. Sa linin prapë kallamishten, u dilte para një kanal që e kapërcenin me pak hov. Sanës i kishte bërë përshtypje se gjithmonë, matanë atij kanali Gori sikur çlirohej. E ngadalësonte hapin, hepohej pak mbi supin e saj dhe niste të fliste shpeshherë edhe me një fjali të zënë në mes, si të vazhdonte një bisedë të filluar qyshkur. Ajo u mësua edhe me këtë gjë. Tha me vete se ai u jepte zë mendimeve të zgjuara më parë, duke e kapur fillin aty ku ndodhej. Më së shpeshti ishte ndonjë kujtim nga fëmijëria.

— Fëmijët e tjerë shkonin poshtë nga lumi, unë ngjitesha lart te pylli i gështenjave të egra. Lumi ishte shumë i bukur, po mua më trembnin shpellat e lagështa të bregut të tij, që thuhej se kishin rrugë të fshehta për t'u lidhur edhe me botën tjetër. Bile përmendeshin edhe historira njerëzish që kohë pas kohe kishin dashur t'u shkonin në fund atyre shpellave dhe nuk ishin kthyer më prej andej. Ndërsa përrallat që kishim dëgjuar deri atëherë, tregonin se atje ndodheshin shtëpitë e zanave dhe shtrigave. Ka shokë nga tanët, që, po t'ua mbledhësh ditët e humbura në kërkim të banesave të këtyre zanave, u bëhen muaj të tërë e ndoshta edhe vite. Kur u rritën, ata u bënë më ambiciozët dhe unë e kuptova se pse u duheshin zanat: pavetëdijshtëm ata i kërkonin zanat që ato t'u jepnin fuqi të mbinaryshme. Sepse donin të dilnin medoemos mbi të tjerët. Ndërsa unë pikërisht nga ato zana u trembesha edhe më tepër shpellave e lumit.

— Pse? — ndërhyri Sana. — Takimet e njerëve me zanat nëpër legjenda mua më duken nga gjërat më të bukura në to.

— E, ashtu është. Po zanat jetojnë gjithnjë të ruajtura prej shtrigave. Dhe mua, nuk e di pse, më ishte ngulitur në kokë se së pari do të ndeshesha në njërën nga ato shtriga, që do të më nguroste, do të më kyçte në kthinat e veta të errëta e do të më mbante përjetë nën dhe. O zot, sikur të dija që atëherë se sa tmerr është atje poshtë!

— Ti flet si ta kesh provuar tani!

Gori u drodh.

— E marr me mend, — tha. — Gjithë kjo jetë na e ka zgjeruar edhe përfytyrimin. Pastaj unë e kam më të lehtë ta përfytyroj, sepse kam provuar burgun e fashizmit. Edhe ai burg bodrum i ftohtë e i errët ishte. Pa ditë, as natë. Të dukej vetja i varrosur për së gjalli. Po mua më pëlqente më tepër pylli i gështenjave, — e ndërroi bisedën ai. — Pylli ishte shumë i bukur, sidomos në pranverë e në vjeshtë. Atje, më së shumti vetëm, endesha tërë ditën pemë më pemë, lypja çerdhet e ketrave e nuk lodhesha. Veçse, kur vija në shtëpi e ndieja veten keq. Nëna shihte pantallonat e mia të bëra leckë e më bërtiste. Ishte e mirë, e gjora. As nuk më mallkonte, as nuk kishte zemër të më rrihte. Sado që ia kisha mësuar këtë zakon, prapë kërcënimet e saj më tronditnin.

— Ti flet për të në të shkuarën, si të mos jetë më, — e ndërpreu Sana.

— Nejse, kështu është gjuha, rrëshqet majtas e djathtas. Po nëna ka një intuitë të çuditshme. Sa herë ma ka përsëritur asokohe e më vonë një shprehje që nuk di se nga i ishte ngulitur në mendje: «Mjerë nusja që do të marrësh!» Atë e shqetësonte çrregullsia ime në të mbajturit e rrobave e këtë fjalë ma thoshte gjysmë me ledhati e gjysmë me qortim. Por ama ma ka përsëritur sa herë, edhe kur u rrita e bëja ndonjë veprim që nuk i pëlqente, edhe pse bëma ime nuk lidhej fare me nusen. I qe tiposur në kokë kjo puna e fatit të keq të nuses sime. Ty mund të të duket e çuditshme, po fjalët e saj filluan të më bënin edhe mua përshtypje. Si ta parandjeja se do t'i dilte e thëna.

— Si? — u hodh Sana. — Cila e thënë doli?

— Që nusja ime nuk do të qe e lumtur me mua, — u përgjigj ai ftohtë.

—Gori, je në vete?! E di ç'po flet?! Më vjen keq! Në qoftë se ti ke pakënaqësi ndaj meje, të lutem, të ma thuash. Edhe në qoftë se ke vënë re ndonjë gjë që s'të ka pëlqyer tek unë, prapë do të bëje mirë të ma thoshë që të sqaroheshim. Por, çka nuk ta kam shprehur vetë... — në zërin e saj pati një shtypje të menjëhershme dhe pastaj këputje.

Errësira e plotë ua fshihte të dyve fytyrat, si të donte t'ua pengonte çdo mënyrë tjetër të marruri vesh me njëri-tjetrin veç fjalëve. Dhe ata ecnin si të hardallosur duke u fshikur pas trun-

gjeve të pishave. Herë pas here mbi kokat e tyre trembeshin zogjtë e fjetur nëpër degë. Ata rrihnin krahët me frushullimë e shkundnin poshtë hala të thata.

— Më fal, — tha Gori. — Ti do të më falësh mua sa herë ta teproj. Më vonë do t'i kuptosh të gjitha, edhe fjalët që më dalin nganjëherë kështu, çapraz, sado që nuk dua.

Sana nuk e ngau më tej.

Në bisedat e tyre gjatë shëtitjeve të mbrëmjes, që sipas zakonis fillonin me kujtime nga fëmijëria, gjithnjë e më shpesh po përsëritej një pikë e tillë kritike, ku, prej fjalëve të Gorit, krijohesh një keqkuptim. Sado që të gjitha ato kujtime Sana i dinte prej kohësh, prapë i dëgjonte me dëshirë. Dhe do të ishte shumë e kënaqur që Gori të vazhdonte të tregonte, vetëm të tregonte me zërin e vet pëshpëritës. Të mos hynte në arsyetime të gjata, sepse aty i këpuste ato fijet le-dhatuese që ngre gjithmonë me vajzën tregimi i të dashurit për ditët kur nuk e ka njohur atë. Edhe pse tërhiqej i bindur, fjalët e tij të fundit i linin Sanës një trazim të turbullt, që i krijonte përherë e më shumë një gjendje angushtie, një lloj nervozizmi që e përballonte me mundim të madh e që ia bënte heshtjen e sidomos natën e pagjumë më të rëndë.

Edhe symbyllur e njihnin vendin nga duhej të ktheheshin për të shkuar në restorant «Gjelbërimi» ku hanin darkën e përnatshme. Errësira e pyllit hollohej hap pas hapi e mbetej prapa, e

mbështjellë si bashkë leshi pas kokave të pakrehura të pishave.

Darka dhe vera e butë e bënin paksa më të heshtur shëtitjen pas buke bregut të detit. Dialogjet ishin të shkurtra e më shumë merreshin me emra të njohurish, të cilëve, për çudi, Gori thua jse nuk ua mbante mend fare fytyrat, ose ruante një figurë shumë të zbehtë, gati të pangjashme. Më saktë, ai mbante mend një tipar, një shenjë të veçantë të tyre. Për dikë që s'e njihte njeriun për të cilin flitej, ishte e pamundur ta ngrinte portretin e tij me aq sa i përshkruate Gori. Ndërsa në fjalët dhe gjestet ai ishte i pagabueshëm.

— Të kujtohet Jani? Ai që tregonte gjithmonë anekdota dhe qeshte vetë i pari? Qeshte me gurgullimë e i humbiste krejt nishani në gropëzën që i krijohej në faqe?

— Si s'më kujtohet,! — thoshte Sana e shtonte pastaj se Jani kishte flokë të verdhë, të drejtë e të rrallë, që, ndonëse i krihte anash, ata i rrinin gjithnjë të rrëzuar deri mbi vetull. Kur qeshte, i lageshin pak sytë e kaltër, si të ishte shkundur në ta një vesë e hollë.

Sana ndiente kënaqësi në këto biseda dhe jepej me shpirt, me vetëdijën të harrohej sa më gjatë, që edhe Gorin ta kishte me vete, të mos i linte kohë të merrej me ato mendimet e veta çapraze, siç i quante edhe vetë e që ia bënin edhe asaj kokën tym.

— Ka qenë djalë i mirë, — thoshte Gori në fund për secilin.

— I mirë është prapë, — shtonte Sana herëve të para. Por pastaj, kur pa se ai fliste vetëm në të shkuarën, e la, nga droja se mos ia prishte hirin bisedës.

Ndërsa ktheheshin në dhomë, kambana e mbytur e orës së largët të qendrës së qytetit lajmëronte zakonisht mesnatën me goditjet e veta tepër të lodhshme.

Kapitulli i nëntë

Pa e kuptuar, në sjelljen dhe dukjen e Sanës nisën të shfaqen herë pas here shenja të një alarmi, të cilat prapëseprapë ishin të pazonjat për ta prishur harmoninë e përgjithshme të marrëdhënieve të saj me Gorin, ashtu siç janë të pazonjat t'i zbrazin rrugët nga njerëzit bubullimat e horizontit të largët, kur qielli mbi tokë është ende i kthjellët. Megjithatë, sapo dëgjohen ato bubullima, njerëzve u krijohet vetvetiu një ngutje të ndodhen diku pranë strehëve ose të marrin çadrat për të mos u gjendur në befasi. Sanës iu shtua mundimi

për ta mbytur brenda vetes angushtinë që i sillte mungesa e përgjigjeve të pyetjeve që i ngriheshin në kokë me kryeneçësi. Nuk do të donte kurrësi t'i trazohej pamja e magjepsur e së porsamar-tuarës.

Prandaj, gjatë shëtitjeve, Sana përpiquej të ishte tepër e kujdesshme në fjalët që thoshte. Tek ajo po ndahej përherë e më qartë jeta që ftillohej nëpër dialogjet me Gorin, me jetën e tallazitur të mendimeve që i zienin në kokë. Prej kësaj mos-përputhjeje i vinte edhe angushtia, të cilën e ndiente më pak kur Gori tregonte qoftë edhe nga gjërat më të parëndësishme në botë. Ndërsa heshtja, edhe një çast të vetëm kur zgjaste, sikur i jepej nga droja se mos çmësoheshin të kacafyteshin në kokën e saj ata gjarpërinjtë e ndërkyer të pyetjeve.

Bisedat e tij janë vërtet shumë të këndshme, mendonte ajo. Po ka diçka që nuk shkon: Pse nuk flet asnjëherë për të sotmen? Pse nuk flet asnjëherë për të ardhmen tonë? Edhe kur i sjell kujtimet, unë, që e kam ndjekur me kaq vëmendje, shoh që të gjitha mbledhen në një pikë, te fëmijëria. Shumë-shumë vijnë edhe deri te ditët kur jemi njohur bashkë. E më pas pse nuk shton asgjë? Nuk paska kujtime nga gjithë kjo kohë? E pamundur. Atëherë pse u shmanget? Pse? A thua të jenë kaq të pakëndshme për të hyrë midis nesh ndodhitë e tërë këtyre viteve që ka qenë larg meje? Pse do ta mbajë patjetër në errësirë kohën kur më ka munguar? Pse? Pse?

Vinte një çast që Sanës i dukej se këto pyetje, këmbëngulëse, të mbetura pezull, pa asnjë përgjigje, qoftë edhe të rreme, do të dilnin jashtë saj e do ta fshikullonin egër, nëpër gjithë trupin, si thupra shkoze. Bënte t'u shmangej, po s'dinte nga t'ia mbante. Ndaj ngjishej më fort pas trupit të hollë të Gorit, sikur aty të qe e vetmja strehë mbrojtëse.

— Ç'pate? — i tha ai një herë, sepse i ndjeu fërgëllimat e forta të saj.

— Hiç, — u përgjigj ajo, e hutuar ngaqë nuk e priste pyetjen e tij.

— Mos nuk je mirë?

— Mirë jam, pse?

— Je zverdhur krejt dhe dridhesh.

— Ndoshta të dukem ashtu nga drita e hënës.

— Ndoshta. Po duhet kujdes... — Ai nuk e çoi deri në fund fjalën, po Sana e mori me mend ç'deshi të thoshte dhe i erdhi mirë. Pse thoshte aq rrallë gjëra të tilla, pse? Një burrë që i rri pranë një femre, që e shpall veten me dëshirë i shoqi i saj, duhet të paktën një pjesë të mendimeve të veta t'ia kushtojë asaj. Ndryshe do të qe egoizëm i tepruar, gjë që s'i shkonte Gorit, natyrës së tij të butë, që Sana e njihte mirë. Po pse atëherë, përsëriti, pse kujtohet kaq rrallë të më përkëdhelë me një fjalë? S'po i kërkoj ndonjë hata, aman.

Atë kohë ajo qe zverdhur vërtet. E fshehta e mbyllur te Gori i përcillte një ftohtësi qiellore nëpër të gjithë trupin. Ajo e fshehtë rëndonte

më shumë se gjithçka në sedrën e saj prej vajze, sepse do të thoshte që i dashuri i saj ruante në jetën e vet diçka që e quante të pavend t'ia zbulonte asaj, qoftë edhe pjesërisht. Pse? Nuk i besonte, apo ajo diçka mund t'i trondiste marrëdhëniet e tyre? Gratë nuk duan kurrë që burrat e tyre të kenë të fshehta të tilla, të pakapshme në asnjë fill nga ato. Kujtojnë se kjo u jep burrave një lloj pushteti të veçantë, pushtet që ato nuk e kanë paraparë në përfytyrimet e veta për jetën bashkëshortore. Ndërkohë, sapo shpëtonte nga ky paragjykim, Sanën e mbërthente edhe më keq një inat pse nuk ishte e zonja ta mblidhte sadopak atë perde që ia kishte zënë keqas sytë. Prej kësaj përzierjeje të papajtueshme e të vazhdueshme përjetimesh i vinte angushtia, që herë-herë i dukej se po ia zinte fare frymën.

— Sidoqoftë, këto dy javë do të mbeten të paharruara për ty, — vazhdoi ai.

— Pse, për ty jo? — ia ktheu ajo shpejt, me një zë të shtrënguar, ngaqë u prek pse ai u veçua.

— Edhe për mua, sigurisht, — u ngut Gori të përgjigjej. — Po sidomos për ty. Sidomos për ty, do ta shohësh e do të më kujtosh... — erdhi duke u shuar zëri i Gorit kur u përsëdyt.

Këto fjalë Sanën e hutuan më keq.

Kapitulli i dhjetë

Restorant «Gjelbërimi» në skaj të pyllit të pishave, në të kundërt të detit, ishte një ndërtesë e vogël, e ulët, prej druri, me dekoracione gjeometrike në fasadë. Sanës, vite të mëparshme, kur vinte në plazh vetëm, as që i pati rënë në sy, ndaj, kur e pyeti Gori, mëngjesin e parë, ndërsa po shëtitnin, se ç'ishte ajo ngrehinë e veçuar, ajo kishte mbledhur supet.

— Afrohemi ngadalë dhe e shohim. Qenka e bukur.

— Mirë, — tha Sana. — Ka mundësi të jetë

lokal për punëtorët e pyjores, që merren me mirëmbajtjen e parkut të pishave.

— Shkojmë e shohim. Ti e di, ndërtimet me dru më kanë pëlqyer gjithmonë. Guri më kujton tokën e ftohtë. — Sanës iu duk se pas atyre fjalëve ai lëshoi një «bërr» të shurdhët, si t'i kalonte nëpër trup një peshk i akullt.

— Druri është i bukur, — tha ajo me një zë disi të shpërqendruar, ngaqë e shtyu veten të fliste menjëherë, të thoshte diçka sa për ta larguar mendjen prej fanitjes së ftohtësisë që iu përcoll. — Edhe mua më pëlqen druri. Kam një shok skulptor që punon vetëm me dru e mund të na bëjë diçka për shtëpinë.

— I thuj të të bëjë bustin tim. Statujat prej druri sikur janë më të pranueshme veçanërisht për mjediset shtëpiake, sepse janë më intime se bronzi, guri... Sikur janë më të ngrohta me dru...

— Bustin tënd?! Ç'e dua, kur të kam ty, kam origjinalin. — Sana bëri një përdredhje përkëdhelëse të fytyrës. — Të na bëjë diçka të veçantë për shtëpinë, po...

— Për shtëpinë.. — Gori heshti pak. — Bëji, bëji!

— T'i bëj!? Jo, more!? T'i bëjmë, bile t'i bësh ti, ti je i zoti i shtëpisë, — foli Sana shpejt e shpejt, për të mos i lënë kohë trurit të gjente nënkuptime të padëshiruara në fjalët e tij. Në këtë përpjekje bëri edhe atë nojmën e njohur të nuseve të porsamartuara, të cilat në javët e para të jetës së re rrinë duke ia mbushur vetes

mendjen se në të ardhmen do t'i ndajnë punët në mënyrën më të pëlqyeshme me burrin. Ai do të bëjë këtë, ajo atë etj., etj., dhe gjithçka do të rrëshqasë nëpër muaj e vite, duke lënë prapa vetëm një shushurimë nanuritëse lumturie.

Ndërkohë ishin afruar.

— Qenka restorant, — tha Gori, — mrekulli fare! Dhe ne kemi ardhur tamam në kohë për të ngrënë mëngjesin, si thua?

— Mirë, — tha Sana gjithë dëshirë, ngaqë fjala u hodh diku tjetër.

Që prej asaj dite atyre iu bë e zakonshme të vinin vetëm aty për të ngrënë mëngjesin. Sana vuri re tek ai një prirje të çuditshme në zgjedhjen e gjellëve. Vetëm çaj, vezë të zier e reçel. Në menu gjeje mish, qumësht, djathë, gjalpë, por ai nuk i ndryshonte asnjëherë. U mësua edhe kamerieri, një djalë fytyrërrumbullakët, me një buzëqeshje të përhershme të shpërndarë njëtrajtshëm që nga balli e deri poshtë te mjekra. Sa i shihte, nxitonte t'ua pastronte tavolinën e, pasi i pyeste me një ton gati intim si u gdhinë, shtonte:

— Të përditshmet, apo jo?

— Për mua ato, — përgjigjej Gori.

Ndërsa Sana të vetat i ndryshonte gjithnjë. Gori ndërronte vetëm llojet e reçelrave. Edhe çajin e donte shumë të ëmbël. Sanës i bëri përshtypje gjithë ky sheqer që përdorte ai, ndaj një ditë, tek hanin me sytë të rrëzuar mbi pjata, e pyeti si nuk mërzitej dhe pse nuk vinte kurrë bulmetra në gojë.

— Tani trupi im nuk i duron yndyrnat, — u përgjigj ai përhumbshëm, sikur zgjonte një kujtim të largët.

— Kaq frikë paske nga skleroza? — u përpoq ajo të bënte shaka.

— Jo, nuk e kam aty, s'e kam fare aty. Tani nuk ka ç'më bën më skleroza. Lidhet me vetë jetën që bën trupi im. Trupi im e ka jetën vetëm te eshtrat, e eshtrat më duan vetëm kalcium e sheqer.

Sanës për një çast iu fanit një skelet që ecte duke kërkëllitur dhe që gati të thërriste nga tmerri, por e urdhëroi veten të përmbahej. Ç'ishte kjo jetë eshtrash, e veçuar prej gjakut dhe muskujve? Nuk e bëri me zë këtë pyetje, nga frika se do të lemerisej më keq kur të merrte nga Gori ndonjë përgjigje edhe më të pazbërthyeshme.

Gori hante shpejt. Pasi mbaronte, mbështetej në shpinën e karriges lirshëm, ndizte një cigare dhe, duke e thithur me majën e buzëve, ndiqte me një vështrim të pavëmendshëm lëvizjet e duarve dhe shprehjet e fytyrës së Sanës që ende nuk i kishte përgjysmuar hajet e veta. Në atë kohë edhe ndërronte ndonjë fjalë me të. Zakonisht thoshte gjëra të shkëputura, më së shumti fare kot. Omëleta jote më duket si e djegur pak, a ka idhëtitirë? Piktori që e ka bërë këtë tablonë (e vendosur në murin përballë) duhet t'i hajë shumë të njelmëtat, pasi edhe detit i ka dhënë një gri të shpëlarë, si të kishte parasysh vetëm kripën e tij. Ky dielli i sotëm është tamam për të të

nxirë... Sanën sikur e trullosnin këto fjalë të palidhura dhe, megjithëse e dinte që ai nuk e kishte fare mendjen tek ajo, prapë nuk mund të hante më dhe shpeshherë e linte pa mbaruar pjatën e nisur.

Këto biseda, pak a shumë njëlloj, përsërite-shin edhe në mbrëmje, gjatë darkës, e cila gjithashtu kishte menunë e vet të pandryshueshme: sallatë jeshile vetëm me uthull dhe një pjatë oriz të zier thjesht me ujë. Sana, megjithëse u mësua me këtë rregullsi të tij, kur e shihte të hante ashtu, ndiente në gojën e vet një lëngëzim të pashije, që i binte poshtë në bark e i shkaktonte përzierje. Nuk arrinte dot ta merrte me mend si mund të shtyheshin e jo më të pëlqeheshin gjëra të tilla. Megjithatë se ç'e mbante të mos hapte gojë. Në fund të fundit, derisa atij i shijojnë ashtu, ç'më duhet mua t'ia prish, mendonte ajo.

— Ç'po mendon? — i tha ai një ditë, ndërsa ndizte cigaren e zakonshme të pasbukës.

— Për ty, — u përgjigj ajo.

— Ndonjë gjë të bukur, patjetër!?

— Si të të them?! As të bukur, as të shëmtuar. Të shihja tek haje e thosha me vete se në dukje je shumë i kollajshëm për t'u mbajtur, s'të harxhon fare. Por je aq i vështirë njëkohësisht, sepse duhet të të gatuash gjellë që s'besoj të gatohen në ndonjë kuzhinë familjare.

Gori bëri buzën në gaz.

— Mos u mërzit, — i tha, — nuk do të të mundoj shumë.

— Oo, si e thua atë fjalë, as që më shkon ndër mend se do të mërzitem ndonjëherë duke të gatur ty. Përkundrazi, do të kem kënaqësi, — nxittoi Sana të sqaronë, pa i lënë kohë asaj hesh-tjes së mjegullt që ishte gati të dilte nga hapësirat e krijuara midis fjalëve të tij.

Në darkë, në restorant qëndronin më gjatë se në mëngjes, sado që vinin vonë e atë kohë lokali thuajse ishte zbrazur. Aty-këtu, në tavolinat e qosheve dukeshin çifte të rinjsh që kishin mbaruar së ngrëni, e u pëlqente të rrinin edhe pak kokë më kokë duke çuquritur. Edhe ata iknin njëri pas tjetrit e në fund mbeteshin vetëm Sana me Gorin. Kamerieri qëndronte gjithnjë te banaku kur nuk kishte punë e diç fliste me zë të ulët me banakieren. Ditët e para Sana e kishte pasur merak mos u bëheshin atyre të bezdisur me vonesën e përnatshme, bile ishte matur t'i thoshte edhe Gorit se do të ishte më mirë të vinin më shpejt, që edhe të ngriheshin më shpejt, po, kur pa se as banakierja as kamarieri nuk shfaqën asnjë shenjë mërzie, heshti. Mendoi me vete se ndoshta kjo vonesë u vinte disi për shtat edhe atyre, që dukeshin sikur i lidhte diçka më tepër se puna e përbashkët e kështu u përligjej, në njëfarë mënyre, qëndrimi më i gjatë me njëri-tjetrin. Ndaj nisi të mos u kërkonte më as të falur kur largoheshin, edhe pse kishte kaluar ndoshta një orë a më tepër nga orari i mbylljes.

Kjo përshtypje për lidhjen e tyre nuk i zgjati shumë, sepse një mbrëmje, kur kishin mbetur

vetëm e Gori që në një nga çastet e heshtjes së plotë, asaj i zuri veshi këtë dialog:

— Shihe! — tha banakierja. — A nuk të duket se i del një dritë si xixëllimë e zbehtë nga poshtë rrobave?

— Sigurisht, — u përgjigj kamerieri, — dihet që eshtrat lëshojnë gjithmonë dritë, sepse kanë fosfor.

— Uf! — ofshani banakierja, — sa më dhimbset kjo vajzë! E shkreta! Veç e fortë, nuk e jep hiç veten. Të isha unë, do të isha çmendur.

Sana nuk mundi të dëgjonte më tej, pasi ata e kapën vështrimin e saj të ngulur andej dhe e ndërprejnë bisedën. Ajo i largoi menjëherë sytë nga ata dhe ia mbërtheu Gorit, si të donte ta gjente patjetër atë dritë të fshëhtë që i dilte nga poshtë rrobave, për të cilën sapo dëgjoi të flitej. Pasi u mundua një copë herë, në mënyrë të pavetëdijshme ndjeu t'i rrëshqiste mbi dritaret e syve një fjollë e tejdukshme mjegulle, që ia deformoi tërë pamjen përreth.

— Pse qan? — dëgjoi zërin e ulët të Gorit.

— Unë... — Sana u zu keq, sepse nuk po e gjente fjalën që i duhej.

— Mos ua vër veshin! — tha Gori që, dukej, i kishte dëgjuar të gjitha. — Vezullojnë fijet e arit të qëndismave të këmishës e kushedi si u ngjan.

Kapitulli i njëmbëdhjetë

Po mbushej një orë që ishin larguar nga restoranti dhe shëtisnin bregut të detit, për nga hoteli. Megjithatë Sana nuk ishte shkëputur prej fjalëve që dëgjoji atje, bile ato erdhën duke iu shumëfishuar, si t'i ndiqte jehona nëpër një luginë të zbrazët shkëmbore. Për më keq, ato fjalë po zgjonin copëra të tjera bisedash, të dëgjua kalimthi nëpër korridoret e hotelit, në restorant, në rrugë, në kafene, në banjë, gjithandej e që aty për aty i patën kaluar shpejt, pa i tërhequr vëmendjen. Ndaj, ndërsa i dëgjonte t'i kthehe-

shin në vesh krejt të kthjellëta, u habit se si i kishin zënë vend e i qenë ruajtur aq saktë në kujtesë. Njëherë tha se mos po i krijonte mendja e saj e shqetësuar, po pastaj e kuptoi se po kërkonte një përligjje të paqenë, për ta bindur veten t'i braktiste e të merrej me diçka tjetër. Veç fjalëve, i kujtoheshin imtësisht edhe rrethanat ku i pati dëgjuar.

— Të kam kujtuar vazhdimisht, Maks, dhe kam thënë sa keq që s'erdhe! Jo për plazhin, as se do të ishim bashkë, po do të shihja diçka të veçantë, diçka që as të ka rënë rasti e as do të të bjerë ndonjëherë ta shohësh, ta them me tërë mend. Ngjitur me dhomën tonë është një çift i çuditshëm. Si? Jo, jo, nuk ta tregoj tani. Asgjë nuk të them tani, se të humbet kurioziteti. Mos ngul këmbë kot! Le që nuk tregohet në telefon. Nuk tregohet, pra, është një histori e tërë, shumë interesante, shumë-shumë interesante, e paimagjinueshme.

Ishte pasdite dhe Sana kishte shkuar në postë të merrte fqinjët në telefon, që t'u thoshte të kujdeseshin për lulet se kishte harruar t'i porosiste para se të niseshin. Meqenëse kabina që e zënë, u ul të priste në një nga ndenjëset anës murit. Siç duket, nga vapa, vajza vazhdonte të fliste në telefon me derën e kabinës të hapur.

Sana e njohu vajzën dhe e kuptoi menjëherë se ishte fjala për të dhe për Gorin. Ajo, bashkë me një shoqe tjetër, të dyja studente të vitit të fundit në arkitekturë, e kishin dhomën ngjitur

me të tyren në hotel. Tani që e sillte ndër mend, Sana habitej me veten se ç'e kishte mbajtur pa shkuar ta zinte për flokësh atë fyçkë e ta flakërinte nëpër derën e kabinës. Po aty në postë as që e mendoi një gjë të tillë. Bile, mund të thuash se gati-gati ndjeu njëfarë kënaqësie nga mendimi se ajo me Gorin paskan tërhequr vëmendjen e të tjerëve, ishin interesante në atë kuptim që i kishte dhënë ajo sa herë më parë kësaj fjale, kur shihte ndonjë çift të rinjsh që binin në sy për diçka të veçantë: për paraqitjen, për veshjen me shije a për bisedat me njëri-tjetrin. Në atë kohë edhe telefonata mbaroi e kabina u lirua.

Sanës tani i kujtohej fare mirë se, tek dilte vajza nga kabina, vështrimet e tyre u kryqëzuan për një çast shumë të shkurtër, dhe në fytyrën e studentes ajo pa një alarm të menjëhershëm. Vajza e kuptoi me siguri se Sana i kishte dëgjuar fjalët e saj, që tashmë kumbonin, të pakthyeshme, në veshin e atij Maksit të panjohur, që kushedi ku gjendej. Kur nuk gjeti asnjë grimë zemërimi në sytë e Sanës, vajza sikur u qetësua dhe u largua duke ngritur dorën fare kot të rregullonte flokët e verdhë, të prerë drejt mbi vetulla.

Ndërsa Sanës i fektoi nëpër mend se tani ndodhej diku një djalë që e priste me padurim një mbrëmje të ardhshme, të cilën do t'ia bënte edhe më të këndshme ajo vajzë me bisedën për të dhe për Gorin, për atë çift të paimagjinue-

shëm, siç e quajti ajo vetë. Pas kësaj, Sana ngriti receptorin e telefonit dhe formoi me shpejtësi numrin e fqinjëve, që të mos kishte kohë të mendonte më për bisedën e porsadëgjuar. Nuk donte ta zinte veten në faj me arsyttime të tjera të mbrapshta, që do t'ia prishnin atë hov shpirtëror që i dhuruan ato pak minuta pritjeje. Nuk e marr vesh, thoshte tani me vete, nuk arrij ta marr vesh se çfarë force e fshehtë më detyronte ashtu të gjeja gjithmonë një kuptim të paqenë tek ato që dëgjoja....

Po mirë, cili është kuptimi i vërtetë i tyre, atëherë? pyeti ajo veten dhe ktheu kokën nga Gori. Ai ecte krejt i qetë dhe fytyra i kishte marrë shprehjen e bukur të njeriut të mrekulluar nga peizazhi përreth. E tmerrshme! Dukej kaq i përhumbur pas kësaj pamjeje, sa do të thoshe që i shihte për herë të fundit.

Pas asaj dite, Sana vuri re që ajo vajza e dhomës fqinje përpiquej si e si t'u shmangej. Prania e tyre sikur e mbushte me një fajësi, prej së cilës nuk çlirohej dot pastaj. Një mëngjes, tek kthehe-shin nga shëtitja e zakonshme, befas u ndodhën përballë saj në kthesën e korridorit të katit të dytë. Ajo ndaloi përnjëherësh në vend, para këmbëve të tyre. Qëndroi një grimë kokulur dhe me qafën të tulatur midis shpatullave, si të priste një ndëshkim të tmerrshëm nga ata, pastaj, ashtu e zverdhur, u hoq mënjanë si vjedhurazi. Dhe ndër-sa do t'ia merrte vrapit, tha me një zë të mekur:

— Më falni!

— Po kjo ç'pati? — iu drejtua Sana Gorit.

— Kush e merr vesh ç'i tha mendja?! Punë studentësh! Askush s'hyn dot tamam-tamam në botën e tyre të veçantë, — e kaloi ai pyetjen.

Sana nuk e zgjati më dhe pas disa minutash e kishte harruar fare.

Një ditë tjetër, në korridorin e gjatë të katit, tek shkonte për në dhomë, Sanës i kapi veshi një copëz bisede të dy grave që ecnin përpara saj.

— Edhe pse bën kujdes të madh kur vishet, prapë atë trup nuk e fshehin dot rrobat, — thoshte ajo në të majtë, me kokën të vaisur nga shoqja. Dielli që vërshonte si i pluhurosur nga dritarja e fundit të korridorit, i theksonte së tepërmi konturet e trupave të tyre të ngjallmë, që lëviznin me një ngathtësi pate. — Unë ia shoh eshtrat, të betohem, dhe rri me zemër të ngrirë se hë-hë do t'i shkëputen nga njëra-tjetra e do t'i derdhen sheshit. Si u bëka njeriu, aman! Shyqyr që s'e di për së gjalli ç'e pret andej, se do të çmendej.

— Thua s'e sheh veten si është katandisur? — pyeti tjetra me një zë dyshues.

— Si jo, me siguri. A s'e ke vënë re si u përvidhet vendeve me dritë e me njerëz?! Po kalon java që kur kemi ardhur këtu e unë s'e kam parë as edhe një ditë të dalë në rrëzë si gjithë bota që vjen në plazh. Vetëm shëtit me të shogen varur për krahu, si hije...

— Uf! Sa më dhimbset, e shkreta... Duket aq e mirë, po nuk e fsheh dot përvuajtjen...

— Mua nga një anë më dhimbset, nga një anë them: i ka sytë në ballë apo jo?...

Sanës iu tha pështyma në gojë e iu bë se i mbeti fryma. Iu prenë gjunjët dhe nuk besoi se do të mbahej pa u përmbysur aty, në mes të korridorit. E kuptoi që flisnin për të e për Gorin. U mat njëherë t'u afrohej rrëmbimthi e të shama-tohej keq me to, t'u thoshte se nuk u shkonte hiç, goxha gra, bëheshin të liga e merrnin burrin e saj nëpër gojë. Si s'u vinte pak turp! T'u thoshte pastaj se flisnin marrëzira, kryekëput marrëzira! Ku e paskan parë ato trupin e Gorit?! Trupi i tij qe si të gjithë trupat e burrave. Këtë nuk mund ta dinte askush më mirë se ajo që mbësh-tetej tek ai trup, flinte përnatë me të në një shtrat.

Tamam këtu iu këput mendimi, sepse një zë i brendshëm i tha me qortim se trillimeve të tyre nuk mund t'u përgjigjej me trillime. Si, ia ktheu ajo atij zëri të fshehtë që nuk e kuptoi nga i erdhi, ç'do të thotë kjo? Pse qenkan trillime të miat?! Priti një çast më kot që zëri i fshehtë të vazhdonte për ta sqaruar dhe, kur ai nuk u bë i gjallë, Şana e pa veten fare të pafuqishme të nxirrte edhe një fjalë të vetme nga ato që i buçitën në kokë pak më parë.

Nuk mundi ta dëgjonte më tej bisedën e të dy grave, sepse mbërriti ndërkohë para derës së dhomës së vet. E shtyu me zor, si të qe prej he-

kuri, dhe hodhi gjithë përtesë hapin e parë për të hyrë brenda. Do të donte të mos e gjente Gori aty, të rrinte një grimë vetëm, sa t'i kthjellohej koka. Por jo. Gori ishte si gjithnjë, shtrirë në shtrat, duke lexuar një nga ata librat e veteraneve me kujtime nga Lufta. Sana mbylli ngadalë derën dhe u mbështet pas saj krejtësisht e këputur, me sytë të ngrirë mbi trupin e tij të lëshuar lirshëm mbi çarçafin e bardhë. E hetoi me ngulm një kohë të gjatë, derisa Gori nuk e duroi më vështrimin e saj, lëshoi librin dhe i foli.

Sana mbeti edhe një copë herë në mëdyshje, sepse në tingëllimin e parë zëri i tij i ngjau me atë zërin e fshehtë, që sapo i kishte ardhur në veshë tek matej t'u hakërrehej atyre dy grave gojëliga. Po pastaj, kur Gori foli prapë, ky dyshim iu tret, i mundur nga dyshimi tjetër: Kë të besonte? Në qenë të vërteta fjalët e atyre dy grave, pse nuk e shihte atëherë? Ja ku ishte Gori...

Nga brenda i erdhi jehona e një gazi shpotitës që ia ngatërroi përsëri mendimet. Fërkoi fort sytë derisa i dogjën. Kur i hapi, tek priste t'i kthjelloheshin ngadalë, tha e sigurt se nuk ishte verbuar e se nuk e gënjenin sytë. Ia tha vetes me aq mlllef ato fjalë, si t'u hakërrehej atyre dy grave që ia prishën qetësinë. Është kështu si them unë, vazhdoi me po atë mlllef, si them unë e jo si thoni ju. Megjithatë nuk e mbyti dot buçimën e bisedës së dy grave të panjohura, sepse po në atë çast ai zëri i fshehtë i lëshoi një hungërimë të

mbytur, si të tallej me sigurinë e madhe që po i jepte ajo vetes.

— Ç'ke? — Gori e përsëriti pyetjen me një ton fajtori që kërkon pajtim.

— Asgjë, — iu përgjigj ajo dhe u përpoq të vinte buzën në gaz, si për ta çliruar sadopak Gorin nga ajo ndjenjë e pakuptueshme fajësie.

— Si asgjë, je zverdhur krejt!

— Nuk e di. Se ç'pata një këputje kur po vija në korridor. Mbase ngaqë eca shpejt, i ngjita shkallët me vrap.

Tani ishte Gori që bëri pak buzën në gaz e, pasi heshti një grimë duke e parë drejt në sy, tha:

— Ç'u vë mend edhe ti grave të tilla!

— Çne gratë?... Kush ... të tha? ...Unë... — Sanës i erdhën të bëfta fjalët e tij dhe u hodh menjëherë ta pyeste nga e mori vesh ai, por iu ngatërruan keqas mendimet.

Buzagazi i Gorit mbeti aty, i palëvizur si edhe vështrimi i tij, që kërkonte si me çudi sytë e saj, që u thanë nga hutimi në gropëzat e veta.

— Po më tregove vetë, moj e dashur, harrove? — u përgjigj Gori pas pak dhe nga shpërvjelja e buzëve Sanës iu duk se ai qeshi, megjithëse nuk ia dëgjoi kukurizmen.

— Qeshe apo më ngjau? — Sanës i doli ajo pyetje e pamenduar, e shtyrë nga angushtia që i ngjalli ajo e qeshur e pazëshme e Gorit.

— Të ecje më ngadalë, e dashur, s'po të ndiqte njeri nga prapa, — ndërroi bisedë Gori.

Gori i tha këto fjalë me një tingëllim qortues intim, duke i lënë asaj të nënkuptonte se do të ngatërroheshin më keq, po ta ngitnin më tej. Kështu bënte ai sa herë hynin bisedat e tyre në një shteg ku e parandente se mund të dëgjonte prej saj diçka që lidhej me gjendjen e tij e ku do t'i duhej të jepte shpjegim. Sana ishte pajtuar heshturazi me këtë sjellje të çuditshme, bile shpejt u bind se qe një zgjidhje shumë e mirë për t'u shkarkuar nga vramendjet që e gërryenin e që nuk arrinte dot t'ia zbulonte Gorit për të marrë një përgjigje. Megjithatë tani nuk po shpëtonte dot nga pyetja se nga e mësoi, ai bisedën e dy grave.

— Ulu të marrësh një frymë! — tha Gori.

Sana pa që kishte mbetur, qysh kur hyri, e mbështetur pas derës. I erdhi inat me veten për atë harrim, por edhe përkujdesja e Gorit i erdhi e hidhur, sepse iu duk një përpjekje e tepruar për t'u larguar me çdo kusht prej rrjedhës së parë të bisedës. Prandaj atë çast gati-gati iu zbraz. Pse u dashka gjithë kjo lodër? Pse? Kur kishte nisur e ku do t'i nxirrte? Sa do të zgjaste? Rrotulloheshin marramendthi të dy në atë valle makthi, si në atë përrallën e djalit të vogël me magji, që nuk guxonte t'i zinte në gojë njerëzit e vet, sepse, sa t'ua përmendte emrin, ata jepnin shpirt. Po Gori, tha, nga se druhe? Po mua ç'm'i lidh fjalët në fyt sa herë dua t'i nxjerr jashtë e m'i mban aty që të më gërryejnë së brendshmi? Ç'ndëshkim po vuaj kështu?

— Uf, plasa! — mundi të thoshte me zë dhe vajti duke i hedhur këmbët si e trullësuar të ulej në shtrat.

Gori ndërkohë ishte kthyer te libri i vet dhe as që i ngriti sytë kur shfryu ajo. Ia diti për nder, sepse çdo fjalë e tij tani me siguri do t'i futej si një gërvishtje në trurin e përskuqur. Kurse vetëm nuk do të kishte fuqi t'i bënte ballë më tej zemërimit, siç nuk pati, dhe ai filloi t'i ftohej.

Pas pak e gjithë ajo ndodhi iu duk qesharake dhe fare pa kuptim. Madje gati-gati nuk besonte as se që e vërtetë.

Me atë përshtypje hodhi sytë vjedhurazi te trupi i Gorit, i mbuluar me çarçafin e bardhë. Nuk dalloi asgjë të panatyrshme. Përnjëherë, si për ta përforcuar deri në fund atë bindje se ai që një trup i vërtetë burri, me tërë jetën e natyrshme të mashkullit, iu zgjua dëshira e pushtetit të tij. Deri atëherë e kishte provuar atë pushtet vetëm natën dhe kurrë ditën, si të që diçka që e zhvlerësonte ndriçimi i avullt diellor. Nisi të zhvishej ngadalë, duke e kërkuar tani haptas vështrimin e tij, që mezi po arrinte t'i përshkonte fletët e librit për të mbërritur deri te supet e saj të zbuluara, që nxirja e lehtë e diellit i kishte bërë edhe më të lëmuara. U shtri heshturazi ndanë tij dhe, pa i thënë gjë, ia zuri sytë me njëjërën dorë. Pastaj me tjetrën flaku në fund të shtratit çarçafin.

Që kur kishin dalë nga restoranti, Gori nuk pati hapur gojë. Prandaj edhe këto copëza kujti-

mesh kishin pasur kohë të ftingjälleshin dhe, duke vërshuar të patrazuara, e kishin rënduar së tepërmi trurin e Sanës. Filloi t'i dhimbte koka dhe i buçitnin tëmthat. Ngaqë nuk i gjeti dot një emër domethënies të tyre, i mori inat të tjerët. Ç'janë këta njerëz që i ha kaq shumë meraku për ne, tha me vete me një zë ankues e të pafuqishëm. Psë duan të ma turbullojnë këtë pak lumturi, që mezi më erdhi pas gjithë kësaj kohe? Nata ishte e butë dhe deti pa dallgë, me një shushurimë të përgjumshme, që nuk të zgjonte asnjë përfytyrim tek i kaloje pranë. Ndanë tij ndieje një molisje dhe mungesë dëshire për gjithçka, e cila të kallte frikë. Si për ta trembur atë ndjesi dhe për të mos i lënë më kohë trurit të punonte mbrapsht në vetminë e vet, i foli Gorit:

— Thuaj diçka!

— Ç'të them?

— Tregomë ndonjë gjë për jetën tënde! — Qe një kërkesë që i doli papritur, pa e menduar, dhe për një çast u step si të bënte një faj, duke pritur me gjak të ngrirë ç'do të thoshte Gori.

— Ah, për jetën time?! Për jetën time të mëparshme apo të tanishme? — Zëri i tij u gjallërua befas, si të zgjohej nga një gjumë i gjatë e çlodhës.

Sanës i pëlqeu gatishmëria e tij për të folur, por e kuptoi që ndarja kohore që bëri ai në jetën e vet, sado shpenguar që e shprehu, nuk lidhej

aspak me periudhën e paramartesës e të pasmartesës. Po ç'ishte ai kufi aq i paluajtshëm e që ajo nuk e dinte? Ç'ishte, pra? Që nga koka iu nis poshtë nëpër trup një bubullimë e mbytur, që asaj iu duk se po ia shkallmonte tërë kockat. Mezi po i detyronte gjymtyrët të mbaheshin drejt. Pastaj ajo bubullima iu mbloodh si lëmsh i rëndë diku te kërthiza dhe nisi t'i rrotullohej verbtazi në vend, si lëmsh i tërbuar gjarpërinjsh.

Gori po priste mbase që Sana t'i thoshte për cilën nga të dy pjesët e pabashkuara të jetës së tij dëshironte të dëgjonte, po tashmë ajo nuk nxirrte dot asnjë fjalë.

Po i çahej koka nga buçitjet në tëmtha dhe i vinin të përziera.

Kapitulli i dymbëdhjetë

Sanës nuk i pushoi dhimbja e kokës, edhe pse, me të mbërritur në hotel, piu dy aspirinë radhazi. Të përzierat iu shtuan edhe më kur u shtri për të fjetur. Po Gorit nuk i tha gjë. Pa u mbushur ora që rrinte ashtu në shtrat, me qepallat të shtrënguara, duke shpresuar më kot t'i afrohej ndopak gjumë, ndjeu t'i shkëputej ai lëmshi i rëndë që i rrotullohej çmendurisht te kërthiza dhe t'i ngjitej me shpejtësi drejt grykës, si një përrua malor që ka shpërthyer pritën dhe merr përpara gjithë ç'gjen rrugës. U ngrit rrëm-

bimthi e shkoi te lavamani për të vjellë. Gorin e kishte zënë gjumi i parë dhe, si zakonisht, nuk dëgjoi gjë. Pas disa minutash Sana u detyrua të ngrihej prapë e prapë Gori nuk dëgjoi fare. Kjo iu përsërit disa herë. Përroi i trazuar i ngjitej me vrull deri në grykë e aty i ndalej, duke shkumëzuar edhe më tepër, si të donte ta mbyste ngadalë.

— Uf, nëna ime, vdiqa! — tha ajo me zë, tek rrinte e përmbysur mbi lavaman.

Dhe do ta kishte lëshuar më keq veten, mbase do të fillonte edhe të qante nga dëshpërimi që nuk po lehtësohej, po të mos kujtohej papritur se nga i vinin ato të përziëra të mundimshme. E harroi dhimbjen e kokës dhe u pushtua nga një ndjenjë e panjohur kurrë më parë. I hipi dëshira ta kundronte Gorin dhe nuk u shtri. Mori një karrige dhe i qëndroi përballë. Shtrëngimi në fyt nisi t'i lirohej. Drita e hënës hynte e drujtur nga dritarja dhe i përkëdhelej ëmbëlsisht pas fytyrës dhe supeve të zbuluara. Iu bë se po shihej në atë dritë si në një pasqyrë magjike. Kurrë s'i qe dukur hëna më e bukur e më e domosdoshme për njeriun.

Qëndroi ashtu një copë herë, me sytë pakëz të zvogëluar, pa e marrë vesh nëse pamjet që i shfaqeshin ishin të vërteta apo fanepsje ëndrrash të pakomanduara. Dikur u ngrit siç qe e përhumbur dhe u shtri ndanë Gorit. Po, me t'u gjendur në dyshek, filloi rishtas t'i ngjitej që nga fundi i barkut me rrokullimë një gulç i madh si i

veshur me gëzof iriçi e ajo mezi arriti te lavamani para se t'i vërshonte jashtë.

— Sana, Sana, ç'ke?

— Asgjë, asgjë, më përzihet pak. — Ajo iu përgjigj shpejt, e mbushur përnjëherësh nga një gëzim i ri. Ndryshe nga tërë këto net të kaluara bashkë në këtë hotel, shqetësimin e saj, krejtësisht të veçantë, e ndjeu edhe gjumi tmerrësisht i rëndë i Gorit dhe u prish.

— Të dhemb stomaku?

— Jo, jo, s'kam gjë.

— Mos të bëri keq ushqimi? Do të ketë qenë i prishur,...

Në zërin e Gorit kishte alarm dhe një dhembshuri të çiltër, që Sanën e përkëdheli në sedër. Kjo ndjesi përkëdhelie femërore i dha kurajë të mos ngurronte për t'ia treguar shkaku. Apo ishte më mirë ta linte për të nesërmen? u luhat ajo në çastin e fundit, kur do ta nxirrte fjalën. Po nesër do t'i duhej ta shihte në sy, t'i nënshtrohej vështrimit të tij hetues, të merrte pjesë më drejtpërdrejt në gjendjen që do t'i krijohesh atij kur ta dëgjonte lajmin që ndoshta nuk e priste. Kjo do t'ia bënte asaj edhe më të vështirë atë çast. Le që edhe vetë ndiente një padurim ta nxirrte jashtë gëzimin që e kishte mbushur, ta ndante me të vetmin njeri që i përkiste, Gorin.

— Jo, jo, — vazhdoi ajo hutueshëm, — është diçka tjetër, ku ty nuk të vete as mendja.

— Çfarë?

— Më duket se kam mbetur shtatzënë.

— Pse thua më duket, nuk je e sigurt?

— Jo, e sigurt jam, por...

— Po si? Kur?

— Kur?!... Ti më pyet kur?!

Sana, që nuk e priste këtë pyetje, u shtang. Fjalët e tij i ngjallën shijen e keqe që ta jep fyerja e papritur nga njeriu yt.

— Më fal, — ndërhyri Gori butë dhe u ngrit ndenjtur në shtrat, — më fal! Nuk e kisha fjalën ku të vajti mendja ty. Por as vetë nuk e di si më dolën ato pyetje absurde. Ndoshta ngaqë më hutoi ky lajm kaq i gëzuar. E kupton, s'ka gëzim më të madh për mua. Unë për këtë kam ardhur dhe kësaj ia arrita. E do të jetë djalë, dëgjomë mua, kur të lindë, do të më kujtosh.

Sanës iu fshi menjëherë prishja e qejfit dhe tani i dëgjonte fjalët e tij me një magjepsje të përgjithshme, që edhe fizikisht e ndiente si një vërshim të vrullshëm ngrohtësie nëpër shtat. Bëra mirë që i tregova, tha me vete ajo, si do të kisha duruar deri nesër?! I harroi fare edhe shqetësimet, nuk i vinin më as të përziera. Iu duk vetja krejt e lehtë dhe befasi pati dëshirë të flinte. Ishte e sigurt se do të shihte ëndrra të bukura, ëndrrat më të bukura që kishte parë ndonjëherë. Do të më shfaqet ai, djali, tha me vete, ose ajo, vajza, u ngut të shtonte, ngaqë e zuri veten në faj duke menduar vetëm për djalë. Bile, thonë që është më mirë ta kesh fëmijën e parë vajzë, vazhdoi ta bindte veten, edhe se vajzat janë më të dashura se djemtë, edhe se

i bëhen nënës krah për t'i rritur më lehtë fëmijët e tjerë. Edhe ti, si mendon, sikur do të bësh një tufë fëmijë! dëgjoji ajo zërin e fshehtë brenda vetes. Pse jo, iu përgjigj me të ashpër atij zëri që i vinte gjithnjë vetëm për ta turbulluar. Ku e di ti sa fëmijë do të bëj unë? Ohu, kjo dihet, ia ktheu zëri i fshehtë, ti edhe një... Zëri u zhduk pa e mbaruar mendimin. Sanës i mbeti vetëm vazhda e tij e hidhur, e cila nuk iu fshi edhe pasi tha se do të bënte patjetër më shumë se një fëmijë, patjetër, ajo mund t'i mbante lindjet, sado të vështira të ishin, edhe pse nuk dallohej për shumë shëndet. Nuk mbetem me një fëmijë, tha, me një e ke gjithmonë gëzimin në zgrip.

Gjatë kësaj kohe Gori kishte thënë përsëri diçka, por ajo nuk e pati dëgjuar. Sana iu afrua ngadalë, pa folur, dhe iu shtri pranë. Prekja e trupit të tij ia largoi menjëherë gjumin. Mbësh-teti kokën në nënkrejsë, por e kuptoi se përpiquej më kot, sepse i kishte sytë të kthjellët qelq, si të qe zgjuar atë çast. As Gori nuk po fliste më dhe atë pas pak nisi ta lodhte heshtja. Dëshira e pakmëparshme për të fjetur, që të mund të shihte ëndrra, ia la vendin një dëshire tjetër, më të fortë: të flisnin me Gorin për fëmijën, ta përfytyronin si do të ishte, si do t'i kishte flokët, sytë, hundën, gojën, ç'lodra do t'i pëlqenin, kujt do t'i ngjante, ç'rrugë do të merrte në jetë. Mund të thuheshin aq shumë gjëra, sa të mos u mjaftonte nata. Ajo kishte dëgjuar se biseda të tilla janë nga më të dendurat te çiftet e reja.

Mirëpo Gori vazhdonte të heshte, si t'i kishte harruar fare gjithë ç'pati dëgjuar para pak minutash e që e shpalli si lajmin më të gëzuar për të. E vodhi rrëshqitazi me bisht të syrit dhe e pa në pozicionin e vet të zakonshëm; shtrirë në kurriz, me duart të përthyerë pak te bërrylat e të bashkuara mbi bark, me qepallat si të ngjitura pas njëra-tjetrës, të cilat, pikërisht palëvizshmëria e plotë i dallonte se nuk qenë në gjumë.

— Fol diçka, — i tha ajo me një zë lutës.
— Nuk rrikam dot kështu në heshtje. As gjumë nuk paskam.

— Nuk di nga t'ia nis, — tha ai, pa lëvizur as edhe një muskul të trupit.

Sana nuk qe e zonja ta prishte më heshtjen që ra përsëri.

Dikur vazhdoi Gori:

— Do të kesh një fëmijë shumë të bukur. Do të jetë edhe i dhemshur, edhe i urtë, edhe i zgjuar. Do të të bëjë ta shohësh krejt ndryshe shtëpinë, jetën... — Sana pa se si zëri i tij erdhi duke u larguar e duke u larguar, derisa u shua diku tutje prapa supeve të saj. Mbase kjo përshtypje iu krijua edhe ngaqë e folura e tij ishte fare asnjane. Por edhe ato që thoshte, ai i thoshte për fëmijën që na qenka vetëm i saj.

— Unë s'jam Shën Mëria, — ia ktheu ajo me një zë të pafuqishëm ta përcillte gjithë ç'ziente në shpirt. — Fëmija im ka baba.

— E ka dhe s'e ka, fatkeqi!

Sana nuk po kuptonte asgjë, ndaj vetëm e

shihte me ca sy të zmadhuar jashtë mase, si të besonte ta shpështillte me të parë atë lëmsh të ngatërruar të mendimeve të tij.

— Uf! — i shpëtoi një psherëtimë e thellë.
— Uf!

Heshtja, e trembur për një grimë herë nga e folura e tyre, si të qe e strukur te këmbët e krevatit, u kthye rishtas dhe e mbushi çdo qoshe të dhomës me frymën e vet të mpirë. Sana e ndiente se ia kishte tmerrësisht nevojën për diçka Gorit, po nuk arrinte ta zbulonte për çfarë. Ndaj edhe i kërkoi në fillim ashtu në mënyrë të papërcaktuar vetëm të fliste.

Të nesërmen, ideja se kishte një zbrazëti diku në vëtvete, të cilën nuk mund dhe nuk duhej t'ia mbushte asnjëri përpos Gorit, Sanës iu shndërrua në mundim të vërtetë. U përpëliti gjatë për të gjetur se ç'ishte pikërisht kjo mungesë që ia sillte zbrazëtinë, po nuk qëlloi gjë. Megjithatë Gorin nuk guxonte më ta shtynte të fliste, por rrinte me shpresë se ai do të dilte vetë, qoftë edhe padashur, aty ku duhej.

Ndërsa Gori atë mëngjes dukej më i kënaqur se kurrë. U zgjua më i zbehtë se ditët e tjera, po shumë më i gjallë. Për herë të parë që kur kishin ardhur aty, nuk priti sa t'i dilte vetë gjumi Sanës, por i thirri të dilnin për shëtitjen e zakonshme. Sana deshi ta pyeste ç'qe ky padurim, por i ra menjëherë në sy ndryshimi i tij dhe heshti si para një shenje të mirë. Që nga mëngjesi e deri në mbrëmje ai qe tjetër njeri.

Pati një dëshirë të papërmbajtshme për të folur vetëm vetë dhe tërë kohën nuk i la thujse fare rast asaj të çelte gojë.

Në fillim ndryshimi i tij Sanës i ngjalli ngazëllim dhe e bekoj fëmijën që u bë shkak për të. Po, pak nga pak, duke parë se ai fliste gjëra krejt kot, që nuk kishin të bënin as me fëmijën, siç do të donte ajo të dëgjonte, as me ata të dy, ajo nisi të trishtohej. Ai tregonte thujse vetëm anekdota, disa anekdota shumë të vjetra, që ajo i kishte dëgjuar në vegjëli dhe i kishte harruar prej kohësh. Aq të zvjerdhura i vinin ato anekdota, sa, edhe pse lidheshin me një kohë të largët e të pakthyeshme, të jetës së saj, përsëri nuk i zgjonin asnjë mall. Ngaqë vetë mbetej fare mospërfillëse ndaj tyre, i dukej edhe më i pashpjegueshëm Gori, që i tregonte me aq pasion dhe qeshte me gjithë shpirt, pa u merakosur pse Sana i priste vetëm me një buzagaz të sajuar. Duke e parë ashtu, asaj i kaloi nëpër kokë pyetja e tmerrshme se mos Gorit i qe prekur sadopak ekuilibri mendor. Kishte dëgjuar disa raste kur njerëzit pësonin kriza të tilla të befta nga një lajm veçanërisht i gëzuar. A nuk i vërshoi një varg i pakuptim fjalësh, me ta marrë vesh të vërtetën? Unë vetëm për këtë gjë kam ardhur, tha ai. Si, ke ardhur vetëm sa për të më lënë mua shtatzënë? Ç'do të thotë kjo? Po pastaj, ku do të shkosh? pati dashur ajo ta pyeste, po nuk i kishin dalë fjalët. Vetvetiu i kishte shpëtuar vetëm ajo ofshama e gjatë, që Gorit nuk i kishte bërë asnjë përshtypje.

Pakënaqësia për këtë mënyrë të sjelluri të Gorit erdhi duke iu shtuar aq sa, pasdite vonë, mezi e fshihte. Kjo e bëri edhe më të pavëmendshme ndaj tregimeve të tij. Bile dy-tri herë u zu ngushtë, sepse ai i kërkoi të ndërhynte në bisedë, dhe ajo, që nuk e kish'e dëgjuar fare, nuk dinte ç'të thoshte. Megjithatë ai u shmang me shkathtësi, pa i lënë asaj kohë të skuqej e të mbetej guhak, gjë që sidomos femrën e vë në gjendje të vështirë. Gori vazhdoi të tregonte njësoj si më parë, pa shfaqur asnjë shenjë se qe prekur. Aty për aty Sana e pa me mirënjohje të çiltër, u pendua dhe e qortoi veten rëndë, duke u betuar se do të ndërronte qëndrim. Por nuk vononte dhe e zinte veten përsëri në gabim. Nuk i përmbahej dot atij betimi. I ikte me shpejtësi vetja nga kontrolli dhe i kthehej ajo gjendja e mëparshme, me atë zbrazëtinë e turbullt dhe përhumbej rishtas në kërkim të identitetit të saj. Kur u bind për pafuqinë e vet për ta zbuluar atë diçkanë e fshehtë që ia mbante Gori peng pa e kuptuar, i hyri një dëshpërim e inat i keq. Inati i nisi me Gorin, sepse ai, si burrë, duhej të kishte aq intuitë sa ta ndiente nëse qe ai apo jo shkak i shpërqendrimit dhe trishtimit të gruas së vet e po ashtu ta gjente ç'i duhej asaj për t'u gëzuar. Asgjë më shumë se gëzimi nuk e bën gruan të dhurueshme ndaj burrit.

Para se të flinin, kur ishin shtrirë, e kishin fikur dritën dhe ajo po i falej mbarimit të asaj dite tepër të gjatë e të lodhshme, befas Gori tha

me të njëjtin ton që kishte folur tërë ditën se të nesërmen u duhej të largoheshin nga plazhi.

— Si? Pse? — u hodh Sana si e trembur. —

Pse kaq shpejt? Vetëm nëntë ditë kemi këtu. Mund të rrimë të paktën edhe një javë, s'na ngut gjë...

— Na ngut, — ia ktheu ai, — na ngut, ah!...

— dhe nuk e vazhdoi më tej.

... të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë, të cilat
... të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë, të cilat
... të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë, të cilat
... të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë, të cilat
... të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë, të cilat
... të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë, të cilat
... të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë, të cilat
... të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë, të cilat
... të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë, të cilat
... të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë, të cilat

Kapitulli i trembëdhjetë

... të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë, të cilat
... të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë, të cilat
... të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë, të cilat
... të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë, të cilat
... të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë, të cilat

Tërë natën e natës Sanës iu vërtit nëpër ko-
kë pyetja se ç'ishtë gjithë kjo ngutje e Gorit, pse
nuk i jepte asnjë shpjegim, në fund të fundit
pse nuk i përfillte fare dëshirat e saj, mendimet
e saj. Ata ishin bashkë dhe bashkë duhej të
vendosnin... U shfaq befasi dhe, ashtu siç e gje-
ti, pa i lënë kohë as të bënte mirë gati ndërre-
sati e ngriti dhe e solli këtu. Jashtë rregullave,
me vrap bënë celebrimin, me dy dëshmitarë të
porsanjohur në tavolinën e restorantit, të cilëve
mbase nuk do t'ua shihnin më as fytyrat. Dhe ja

tani, nuk pritnin as sa të mbaronte turni i pushuesve, edhe pse vetëm dy-tri ditë u mbeteshin. Pse gjithë ky ngut, e kishte pyetur ajo edhe atë ditë si tani. Nuk kemi asnjë grimë kohë për të humbur, i qe përgjigjur ai.

Kishte gjithë këto ditë që Gori herë pas here lëshonte fraza të tilla të pazbërthyeshme, si kjo për ngutjen. Instinktivisht Sana ishte e bindur se vërtet kishte diçka të fortë, të pakthyeshme, që i shtynte të linin plazhin. Ndaj edhe nuk mundej t'i thoshte jo Gorit. Po ç'është vallë? përsëriti për të mijëtën herë me vete Sana. Shkonin nga shkonin e mendimet e saj mbledheshin te kjo pyetje, si para një porte hekuri. Trokitnin në të me druajtje, e shtynin, e goditnin me tërë forcën, i silleshin rreth e rrotull mos gjenin ndonjë të çarë të vogël ku të vinin të paktën syrin për të parë çfarë fshihej brenda, po më kot. Nga ky mundim gjumi iu tremb fare e nuk guxoi t'i afrohej më në sy deri në mëngjes.

Po, për çudi, në mëngjes, edhe pse nuk kishte mbyllur sy gjithë natën, ndihej e gjallëruar mirë dhe e shpirë.

Kurse Gori fjeti si gjithnjë, qetë, dhe nuk i ndjeu përpëlitjet e saj. Ose bëri sikur flinte. Gori qëndronte i palëvizur, shtrirë në shpinë, me duart të mbledhura mbi bark si përherë. Drita e hënës, derdhej uniforme nga dritarja dhe i ngjitej pas lëkurës si shtresë e hollë dylli të vërdhemë. Në atë harrim, për Sanën qe njësoj sikur ai të mos ndodhej aty. Ajo mundej jo vetëm të lëvizte, por edhe të qeshte, të qante, të thërriste e madje

të ulërinte, pa u druajtur se do ta zgjonte. E megjithatë ai ishte aty.

Ndaj në mëngjes Sana u ngrit pa u zgjuar ende. Gori, nderzi dritën, pasi nuk kishte aguar mirë, dhe filloi të merrej me përgatitjen e plaçkave.

Gori kishte hapur sytë dhe po e ndiqte me një buzagaz që ia sh'onte zbehtësinë. Ajo vazhonte të paloste rrobat, e përqendruar. I merrte gjithë kujdes nga gardëroba dhe, duke ua ndjekur vijat e hekurosjes, i vendoste në valixhe e në çanta njërën mbi tjetrën që të mos zhubroseshin. Gori nuk i bëri zë derisa ajo vetë e vuri re.

— Pse kaq e paduruar? — foli ai, duke u përpjekur ta çelte edhe më mirë fytyrën.

— Unë e paduruar apo ti?!

— Mund t'i rregullonim më vonë rrobat, kemi kohë, — ndërroi bisedë Gori.

— Më doli gjumi e doja të merresha me diçka, — tha ajo duke i mbajtur për një çast sytë në të tijtë. Sytë e Gorit kishin diçka nga thatësira e shpëlarë e fushëtirave të rërës së plazhit.

— Di gjë kur niset treni? — Ai nuk e duroi vështrimin e saj dhe uli sytë.

— Ka disa. I pari niset tani shpejt.

— Me cilin do të shkojmë ne? Të gjejmë një kur ka më pak njerëz!

— Sot të gjithë trenat të pangarkuar janë, nuk është as fund jave, as fund pesëmbëdhjetëditëshi, kur ka lëvizje të madhe. Por unë do të thosha të bënim diçka tjetër....

— Hë?! — e ndërpreu ai dhe, nga mënyra si

iu drejtua, Sana e kuptoi që kot ta vazhonte mendimin. Ai e kishte vendosur tashmë në këmbë e ve dhe çfarëdo që t'i thoshte ajo, nuk do ta bënte të ndryshonte. Prandaj më mirë heshti.

— Çfarë — përsëriti Gori me po atë ton, sikur të donte t'i thoshte: Mos na nxirr telashe tani!

Sana u detyrua të përgjigjej:

— Meqë pushime kemi ende, sikur të kthehemi dy-tri ditë në Elbasan të takonim prindërit, të tutë e të mitë! Sidomos për ty do t'i ketë marrë shumë malli. Nuk e dinë që ke ardhur, se do të kishin vrapuar këtu.

— Mirë do të qe vërtet, — tha Gori, kësaj here urtë, — po tani na duhet të kthehemi patjetër në Tiranë. Më vonë...

Sana i hodhi një vështrim të mundur dhe vazhdoi të merrej me rregullimin e rrobave në valixhe. Vuri re se mezi rrinte e përkulur dhe i merrej fryma siç nuk i qe marrë kurrë. Më qenka rritur barku, tha me vete me një ndjenjë gati-gati llahtarë, kur u drejtua pas pak të mbushëj me frymë. E tmerrshme, si ka mundësi?! Vetëm pas dy-tre muajve nis e u dallohet barku grave shtatzëna, kurse unë kam e s'kam një javë!... Mendimet iu këputën në mes dhe ajo u hodh përjetë pa e kuptuar ç'po i ndodhte. Diku në thellësi të barkut i lëvizi diçka e gjallë, që i ngjau me një kërcim të trembur lepurit.

— Fëmija!... — belbëzoi ajo mbytur dhe sytë iu mbushën me lot. — Fëmija!...

Hodhi vështrimin nga Gori me një lutje për

gjëruese që ai t'i thoshte se nuk qe e vërtetë, po Gori vazhdonte të thithte i përhumbur cigaren dhe as që e kapi vështrimin e saj. Gori qëndroi i shtirë edhe pak pasi e fiku cigaren, pa shkëmbyer më asnjë fjalë me Sanën. Pastaj u ngrit e shkoi drejt e te pasqyra e tualetit. Sana ndërkohë kishte mbaruar punë me rrobat dhe po e ndiqte me një vështrim të çmeritur. Vetëtimthi iu kujtua prapë biseda e dy grave që dëgjoji në korridorin e hotelit. Pati një përzierje të rrëmbyer inati ndaj vetes e ndaj tyre dhe i erdhi të qante. U kthye pak mënjane që të mos e zinte vështrimi i Gorit, i cili, që nga pasqyra, i vinte i largët si nga një botë tjetër. Ngriti ngadalë dorën dhe fshiu sytë me shpinën e saj. Qëndroi një çast ash-tu, sa iu kthjellua vështrimi dhe u rrrotullua për-sëri siç qe.

Kësaj here shtangu nga tjetër gjë: Trupi i Gorit, që nuk kishte lëvizur prej vendi, nuk i ngjante më të mëparshmit. Nën pizhame duke-shin qartë muskujt e plotë të këmbëve, të tendosur për ta mbajtur drejt peshën e shtatit të tij të madh. Shpatullat e mbushura mirë i uleshin e i ngriheshin sa herë e lëvizte makinën e rrojës nëpër faqe. Ç'kam kështu, tha ajo me vete e trembur, mos më bëjnë sytë, apo?... Deshi të shtonte: apo kam lajthitur, por fjala i mbeti në mes, sepse hasi sytë e tij që vazhdonin ta shihnin butë nga pasqyra. Pagjumësia është e keqe, të lodh, t'i dobëson nervat, i tha vetes, ndërsa përpiqej t'ia kthente buzëqeshjen Gorit.

— Jemi që jemi gati, nisemi me trenin e parë, — tha Gori. — Arrijmë në Tiranë para se njerëzit të kenë dalë nga shtëpitë për të shkuar në punë.

Sana deshi ta pyeste se përse u dashka të arrijnë në Tiranë para se të jenë mbushur rrugët me njerëz, ç'lidhje kishte mbërritja e tyre me orarin e punës, po, si gjithnjë, një dorë e fshehtë ia zuri fytyrën e nuk nxori dot tingull.

Ai u vesh shpejt e shpejt, ndërsa Sana nxitoi të dorëzonte në sportel të hotelit pajisjet elektrike që kishin marrë me qira.

Deri në gjysmën e rrugës nuk shkëmbyen asnjë fjalë. Sana ndiente një angushti që erdhi duke iu rritur aq sa iu duk se po ai zinte frymën. Mëngjesi sapo zbardhte e ishte ende freskët. Nga deti frynte një fllad që të hynte brenda në trup nëpër të gjitha porët e lëkurës. Ajo kaloi valixhen në dorën e majtë dhe me bulat e gishtave të së djathtës fshiu lehtë ballin e ujcitur nga djersët. Me një zë të shuar, që nuk ia kishte dëgjuar kurrë vetes, i tha Gorit të ndaleshin të pushonin pak.

— U lodhe?

— Jo, po sikur s'jam fort mirë.

— Ma jep mua edhe valixhen tënde! Harrova që ti tani s'duhet të mbash pesha. — Ai bëri një buzagaz fajtori.

— Jo, nuk është e rëndë, nuk e kam prej saj. — Sana as që e vuri re buzagazin e tij. Tërë

bota përreth i luhatej e i shtrembërohej si e zhytur në ujë.

Gori nuk vazhdoi më. Qëndruan një grimë herë ashtu, më këmbë, në anë të rrugës, pastaj Sana bëri shenjë me kokë të niseshin dhe ngriti e para valixhen e vet.

— Po u lodhe, ma jep mua!

— Mirë, — iu përgjigj ajo vetëm sa për të mos e zgjatur. Nuk kishte asnjë dëshirë ta dëgjonte të fliste.

Tutje, atje ku bashkohej deti me qiellin, nga një e çarë që nuk shquhej dot me sy, në dritën e hirtë të agut po shtohej me shpejtësi një e kuqe si ndryshk. Afronte lindja e diellit.

Në stacion kishte disa trena, të mbledhur aty për të kaluar natën. Ai që do të nisej, dallohej menjëherë, sepse rrinte në anë të platformës, me dyer të çelura. Sana priti Gorin sa mori biletat, pastaj u nisën ngadalë për te treni. Asaj sikur i kishte ikur pak ajo angushtia që e pati mbërthyer gjatë rrugës dhe e ndiente veten më të lehtë...

U ngjiten në vagonin e parë. Pjesa më e madhe e ndenjësive ishin të lira. Aty-këtu dëgjohehin zëra të ulët si çuçurima, që heshtja e madhe u jepte një kumbim fishkëllyes. Sana u ul, ndërsa Gori rregulloi me kujdes valixhet e çantat lart, në mbajtësen e teshave. Pastaj zuri vend përballë saj. Sana vuri re se atij nisi t'i dridhej mjekra dhe buza e poshtme, si ta kishte zënë një ngashërimë e thellë, e brendshme.

— Ja pra, erdhëm te deti, siç të kisha premtuar —

zuri të fliste ai dhe të përmbajturit me zor i ngashërimit iu bë edhe më i dukshëm. — Mirë, apo jo?! Pas nëntë muajsh ti do të kesh një fëmijë, kujtimin më të çmuar të këtyre pushimeve. — Këtu Gori ngriti kokën dhe u përpoq të buzëqeshte, po nuk mundi, sepse ishte i sunduar nga vaji. Sana nuk e kuptonte nga i vinte Gorit ai vaj, por edhe nuk guxonte ta pyeste. — Sa i qetë jam! Nuk mund ta marrësh me mend sa i qetë jam që ta mbajta fjalën! — shpërtheu ai, pasi heshti një copë herë.

Pastaj, pa i lënë më kohë Sanës ta vështronte se si i dridhej edhe më fort mjekra me gjithë buzën e poshtme, u ngrit me rrëmbim.

— Pse u ngrite, ku vete? — mundi Sana të nxirrte fjalën e parë.

Gori nuk u përgjigj.

— Ulu, pse rri në këmbë! — përsëriti ajo e trembur, tek shihte fytyrën e tij që nuk arrinte ta fshihte vuajtjen e thellë të vajtimit të pashfryrë.

— Unë nuk do të vij, — tha ai. Futi dorën me nxitim në xhep dhe nxori biletën e saj. Në vagon kishin nisur të shtoheshin udhëtarët.

— Si nuk do të vish?! Ku do të rriësh?

— Kam një punë këtu. M'u kujtua tek vinim.

— Ç'punë? — ia ktheu ajo me një mosbesim të hapur. — Lëri këto e ulu!

— Jo, kam vërtet një punë që duhet ta kryej patjetër.

— Po pse s'the, të rrinim të dy?! Rimë. Ko-

hë kemi. Ti, pastaj, gjithë këto ditë nuk ke zënë në gojë të kesh ndonjë punë në Durrës. S'të marr vesh, lojëra bën?! — Zëri i Sanës erdhi duke u mbytur, sepse në grykë iu ngjit një komb lotësh.

— E po...

U dëgjua altoparlanti që njoftonte se treni për në Tiranë ishte gati për nisje. Gorit i hovi trupi përpara për largim.

— Mos më lër vetëm, si do më lësh vetëm...

— S'je më vetëm, ke fëmijën.

— Mos ik, të lutem, mos më lër vetëm, boll...

— ...!

— Hë, do rrish? Thuaj se do rrish!

— Mirupafshim! — Gori sikur e mblodhi veten. — Me të mbërritur në Tiranë, — vazhdoi ai, — merr ndonjë taksì, se e ke të vështirë me gjithë këto plaçka deri në shtëpi!

Sana nuk i dëgjoi fjalët e fundit. Kishte mbe-tur si e ngrirë dhe për një çast iu duk se po i ftohej tërë trupi. Ai e përqafoi rrëmbimthi dhe e mbajti pak në kraharorin e vet fare të sheshtë. Pastaj e përshkoi gati me vrap korridorin midis ndenjësive dhe humbi te dera. Lokomotiva po fishkëllente si e çmendur.

Sana rrotullonte sytë majtas e djathtas nëpër dritaret e vagonit me shpresë ta shihte edhe një herë profilin e tij tek largohej. Kishte harruar ta pyeste me cilin tren do të vinte ai, që të dilte ta priste.

— Oh, m'u harroftë emri, si e humba kështu!

— mallkoi veten ajo dhe zgjati me shpejtësi koken në dritare. Nxori gati gjysmën e trupit jashtë, po më kot. Ai qe zhdukur si ta përpinte dheu me të vënë këmbën në tokë. Ajo deshi të mallkonte prapë veten për këtë harresë, por ia këputi fjalën në mes klithma e thekshme e lokomotivës, që oshëtiu tmerrshëm, si t'i ngulej papritur një thikë në ijë.

Epilog

Fletë nga ditari i Sanës:

«Qysh dje më duket sikur trupi im ka pësuar një transformim të çuditshëm. Dje më erdhi për vizitë një shok i vjetër i Luftës, Vilson Metani. Në të vërtetë ai ka qenë shoku më i ngushtë i Gorit dhe unë e kam njohur pasi ishim fejuar. E, sidomos pasi Gorin e zunë nazistët dhe e çuan larg, në kamp përqëndrimi, Vilsoni ka shprehur vazhdimisht ndaj meje një dhimbsuri të përmbajtur e një përkujdesje vëllazërore, duke m'u gjen-
dur në çdo nevojë. Duke u plakur, kjo dhimbsuri

i është bërë më prekëse dhe duket se e ka përcjellë edhe tek e shoqja, edhe te të bijtë, aq sa mua shpesh më bëjnë ta ndiej veten disi keq.

Me atë fytyrë të hequr edhe më fort nga zori që e mundonte, erdhi dje ai, u ul në minder ngadalë, si të ruhej mos thyente diçka shumë të brishtë dhe po qëndronte i heshtur. Unë e ndjeva se diçka kishte për të më thënë, po matej e nuk dinte nga t'ia fillonte. Një ditë më parë qe kthyer nga Mathauzeni, ku pati shkuar me një delegacion të Komitetit Kombëtar të Veteranëve të Luftës, për të marrë pjesë në kremtimet e dyzetvjetorit të fitores mbi fashizmin. Në shtëpinë e tij, në darkë, kur sapo mbërriti, mua, që i vajta për vizitë, dhe të gjithëve, na u duk tepër i lodhur nga rruga. Nuk na tregoi ndonjë gjë të madhe nga udhëtimi përveç një përshkrimi të shkurtër të mënyrës se si qenë organizuar festimet. Nuk e përmendi fare Gorin në fillim, dhe vetëm kur pa që unë prisja, tha se fotografia e tij ndodhëj dy herë e ekspozuar, një herë në stendën e shqiptarëve të mbetur në atë kamp e një herë në një nga dhomat më të mëdha e më të tmerrshme të gazit, ku edhe e patën mbytur. Edhe këto m'u duk se i tha me një mungesë të plotë vlerësimi, që mua më preku. Pastaj sikur e shfajësova pak, duke menduar se ende nuk e kishte mbledhur veten nga gjithë ajo barrë kujtimesh të trishtuara. Edhe ai i kishte kaluar muajt e fundit të Luftës në një kamp nazist përqendrimi diku në jug të Greqisë.

Dhe ja tani, kur s'e pritja fare, ai më erdhi në shtëpi dhe merrej vesh menjëherë që kishte diçka për të më thënë, diçka krejt të veçantë, përdërisa druhej aq fort ta sillte fjalën aty. As unë nuk po guxoja ta pyesja.

Ndenjëm ashtu nuk e di sa gjatë. Ai e piu kafen dhe vazhdoi të tymoste në heshtje. Ndërsa unë, në divanin tjetër përballë, seku e kisha humbur vështrimin. Nuk di të them nëse mendoja gjë apo jo në ato çaste. Prandaj më erdhi si i papritur zëri i tij kur nisi të fliste. Më tha se ishte bërë rikonstruktimi i tërë kompleksit muzeal të ish-kampit të tmerrshëm nazist. E në këtë rast ishte shfletuar edhe një herë gjithë dokumentacioni i tij, i kapur kur hynë aty forcat aleate. Kështu, që saktësuar edhe dita e ekzekutimit të shumë të internuarve, për të cilët më parë paska qenë dhënë një datë e përafërt. Midis tyre ishte edhe Gori. Ai nuk kishte vdekur më 29 qershor, siç e kemi ditur, po më 13 korrik.

Vilsoni i tha këto fjalë ngadalë e me një mundim të dukshëm, duke më parë drejt në sy, pastaj heshti. Fytyra i ishte hequr e zbehur edhe më tepër dhe prej së largu i dalloheshin damarët e hollë, që rrihnin me forcë nga mundimi për ta përcjellë lart gjakun.

Deri pak më parë unë vërtet nuk e kisha marrë dot me mend fare se ku do të dilte ai, po lajmi që më dha, që krejt i papërfytyrueshëm për mua, sado të përpiqesha. Siç duket, më ndërroi menjëherë fytyra, se e pashë Vilsonin që

përpëlitej të më thoshte diçka. Po nuk dinte. Edhe unë, po të isha në vendin e tij, nuk do të dija ç'fjalë do të qe e përshtatshme për një rast të tillë, Ngushëllimi? Po për çfarë duhesha ngushëlluar? Ngushëllimet për Gorin unë i kisha marrë dyzet vjet më parë. Të më thoshte të mos mërzitesha? Kjo fjalë, e dëgjuar mijëra herë që prej asaj kohe, më ishte bërë në vetvete një lloj mërzie dhe nuk kisha dëshirë ta dëgjoja. Ta nxitja të fliste për diçka tjetër, për të më bërë mua ta harroja sadopak atë që sapo dëgjova? Po a kishte vallë fjalë tjetër që mund ta përzinte nga truri im atë lajm të futur aty aq përdhunshëm? Pastaj, a shkonte një gjë e tillë për të? Vilsoni nuk kishte si ta gjente fjalën që i duhej, se edhe nuk e dinte tamam-tamam ç'po ndodhte tek unë atë sekondë.

Unë u trondita thellë prej atij lajmi të beftë dhe ndjenja e parë që më pushtoi, ishte një keqardhje e thellë për veten time. Ishë mësuar kaq vjet ta kisha 29 qershorin si ditë të madhe takimi me Gorin. Atë ditë shtëpia ime, ku jetoja krejt vetëm që prej dyzet vjetësh, gumëzhinte që nga mëngjesi herët e deri vonë në mbrëmje. Vinin shumë njerëz. Dhe të gjithë flisnin vetëm për Gorin, shihnin fotografitë e tij, komentnin, sillnin kujtime. Nga densiteti i përmendjes së tij, përshkrimi i fytyrës, i trupit, i mënyrës si fliste, si ecte, si sillej, krijohej edhe deri në ajrin e dhomës një lloj ngarkese elektrike, që dukej sikur do të shkrepente nga çasti në çast e do të çelte

diku në mur një shteg të fshehtë prej nga do të dilte ai, ashtu siç e mbanin mend ata. Prania e tij gati-gati fizike atë ditë më falte një komoditet të veçantë, që rrezatonte edhe në shumë ditë të tjera që vinin më pas. Pikërisht për këtë m'u dhimbs edhe më tepër vetja, sepse e pashë se tërë kjo kishte qenë disi e gënjeshtërt, përdërisa që ngritur në një përvjetor të paqenë.

Po m'u dhimbs edhe Gori. Në 29 qershor ai ishte ende i gjallë, ende mbahej me thonj pas jetës, ende shpresonte të dilte prej atij ferri, ende thurte ëndrra të bukura e kushedi, ndoshta më 29 qershor kishte ëndërruar tërë ditën për të ardhmen tonë të përbashkët, ndërsa unë, atë ditë dhe dy javët që erdhën më pas ia kisha mohuar padashur, ia kisha quajtur të vdekura. A s'i kisha bërë kështu pa dashje një padrejtësi? Nuk dija si t'i kërkoja falje, pasi më dukej sikur ia kisha ndjellur vdekjen, sado që tërë kjo kishte nisur të paktën një vit pasi ai nuk jetonte më.

Në mes të këtyre mendimeve më hyri rrëmbimthi një kujtim. Kur sa kishim nisur të dashuroheshim, ishim takuar e po rrinim në shtëpinë e Liljanës, një shoqes sonë që i kishte prindërit mësues në Shkollën Normale. Prindërit e saj seç kishin në shkollë atë pasdite dhe Liljana na ftoi e pastaj na la vetëm në dhomën e madhe, ku i ati mbante librat. Mua sesi më vajti dora e mora nga biblioteka një revistë. Në kapakun e saj ishte një fotografi me ngjyra, ku dukej një breg deti, mbushur me çadra dhe me njerëz

me rroba banje, që qëndronin shtrirë në rërë ose më këmbë.

— E ke parë ndonjëherë detin? — më pyeti Gori.

— Jo, — iu përgjigja.

— Kur të martohemi, — tha, — unë do të të çoj në det. Dhe do të rrimë dy javë atje. Do të kalojmë dy javë të bukura, që edhe jeta jonë e përbashkët të fillojë bukur e të vazhdojë bukur.

— E ku do të shkojmë?

— Në Durrës. Dhe nga ai dyjavësh në breg të detit ti do të kthehesh ndryshe nga si je nisur.

— Si? — pyeta unë, që nuk e mora vesh ku e kishte fjalën.

Ai vuri buzën në gaz.

— Nëntë muaj pas atij dyjavëshi ti do të lindësh çunin tonë, Si thua?

Unë u skuqa flakë e nuk fola më.

— Të kam dhënë fjalën, — tha ai, zgjati dorën dhe e mbështolli me timen. — Të kam dhënë një fjalë që as vdekja nuk do të ma bëjë dot të mos e mbaj.

As vdekja, përsërita me vete e m'u duk se diku në kokë më bëri diçka «krak». Sikur u liruan disa vidha të fshehta, që ishin mbajtur shtrënguar kaq vjet e nëpër të çarën që u krijua doli një rreze drite që vinte duke u hapur, duke u hapur, derisa përplasej në syprinën e lëmuar të syve dhe aty shndërrohej në figura. E kisha thirrur atë dyjavësh jetë të Gorit që nuk ia dija, për ta kaluar me mua, sot, kur kanë rrjedhur

dyzet vjet. Por tek unë nuk është ruajtur pothuajse asgjë prej asaj vajzës simpatike që ka qenë e fejuara e tij, trupi im është mpakur e lodhur, fytyra ime nuk e ka më lëkurën të butë e të ndritshme, ajo është rrudhur nga pak gjithandej, sytë kanë ardhur duke u zvogëluar e duke u futur në strofultat e veta, si të ndienin vazhdimisht nevojë të mbroheshin nga diçka, ndërsa mjekra është mprehur e ka dalë më përpara. Gori ka mbetuar ai i dikurshmi. Prandaj edhe unë, vetvetiu, për t'ia bërë vërtet të bukura ato dy javë, ashtu siç i kishte përfytyruar ai atëherë, thirra Sanën e parë, vërsniken e tij, që nuk mund të rrinte një ditë pa e parë. Mirëpo në sytë e minisa të mos shoh më veten, po dy të rinj që i kisha njohur dikur, të cilët u nisën me nxitim për në plazh.

Vilsoni e vuri re që unë nuk isha më aty. Siç duket, u lodh duke e kërkuar me mendje atë fjalën që të më qetësonte. Kur nuk e gjeti, u largua duke më lypur me gjysmë zëri lejë. Nuk di të them çfarë ndjeu. Ndoshta pendim që ma solli atë lajm. Ndoshta mendoj se në këso rastesh njeriu është më rehat vetëm sepse është i lirë të shfrehet. Nuk e di, por si nëpër mjegull e pashë të ngrihej e ashtu mjegullazi e dëgjova të më thoshte mirupafshim.

Ajo gjendje gjysmë ëndrre, gjysmë realiteti më zgjati deri sot. S'besoj të kem fjetur asnjë minutë. Por as zgjuar nuk kam qenë asnjë minutë. Aq s'isha në vete, saqë, kur ata u ndanë në sta-

cionin e trenit e nuk po i shihja më, pyeta veten gjithë seriozitet se vërtet ç'do të bëjë Gori i kanë mbetur edhe disa ditë, ku do t'i kalojë? Dhe po vetja ime m'u përgjigj: «Harrove që do të kthehet në Mathauzen?! Ka gjithë atë rrugë për të bërë, që të gjendet aty me 13 korrik. I duhet të jetë patjetër, se vdekja nuk pret.»

1985

PËRMBAJTJA

TEHU I SËPATËS	5
MBRËMJA ME PAK MJEGULL	18
HISTORI E PAMBYLLUR	28
DY JAVË PUSHIME	56
NJË LOJË PA TË KEQ	71
KTHIMI	81
LEGJENDA E MALIT TË BUKURISË	89
NJË MBRËMJE TETORI NË PARIS	120
FOTOGRAFIA	137
KOHË PEZULL	197
VERA PA KTHIM	261



Besnik Mustafaj ka lindur në qytetin «Bajram Curri» më 4 shtator 1958. Shkollën e mesme dhe të lartë i mbaroi në Tiranë për gjuhë frënge. Ka punuar mësues në Tropojë, pedagog i letërsisë së huaj në Universitetin «Enver Hoxha» të Tiranës, gazetar në «Zërin e popullit» dhe tani në Institutin e Studimeve Marksiste-Leniniste.

Ka botuar librat me poezi «Motive të gëzuara» (1978), «Pragu i verës» (1985), «Fytyrë burri» (1987) dhe librat me tregime e novela për fëmijë «Bregu i lumit të kthjellët» (1986), «Përrallë me një mbret të vërtetë» (1988).

Ka përkthyer e botuar përmbledhjen e zgjedhur poetike të poetit turk Nazim Hikmet «Peizazhe njerëzore» (1989).